



Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” Raporti i vetëvlerësimit

Prizren 2015/2016

Contents

<u>1. Historiku I Shkurtër I Universitetit.....</u>	<u>6 -</u>
1. Themelimi.....	6 -
2. Vendndodhja.....	6 -
3. Vlerësimet E Deritashme Nga Aka	6 -
4. Programet E Akredituara Në Upz:	6 -
<u>2. Parimi Udhëheqës Dhe Misioni.....</u>	<u>7 -</u>
2.1 Misioni Dhe Vizioni I Upz	7 -
2.2 Strategji Për Implementimin E Misionit Të Upz-	8 -
2.4.1. Si I Monitoron Institucioni/ Njësia Ndryshimet Që Zhvillohen Në Institucionet/ Njësitet Tjera Në Vend Dhe Jashtë Vendi?.....	9 -
2.4.2 Si Ndryshon Institucioni/ Njësia Me Qëllim Të Përmirësimit?.....	9 -
2.4.3 Si Iu Përshtatet Institucioni/ Njësia Kërkesave Të Reja, Sa Shpejt Iu Përgjigjet Kërkesave Nga Jashtë?.....	9 -
2.4.4 Si E Harton Institucioni/ Njësia Draft-Planin Strategjik Për Të Përbushur Misionin E Tij?	10 -
2.4.5 A Posedon Institucioni/ Njësia Mekanizma Për Sigurimin E Cilësisë?	12 -
<u>3. Organizimi Menaxhimi Dhe Planifikimi.....</u>	<u>13 -</u>
1. Emri I Institucionit:	13 -
2. Organogrami I Upz:	13 -
2.2.1. Organizimi I Strukturave Vendimmarrëse Në Administratë	15 -
2.3 Pjesëmarrja E Përfaqësuesve Te Studentëve Në Organet E Ndryshme Te Upz-Së.....	15 -
2.4.1 Procedurat Për Përzgjedhjen E Personelit, Posaçërisht Procedurat Për Emërimet (Thirrjet) Për Mësimdhënësit.....	15 -

2.5 Stafi Akademik Mundë Të Zgjidhet Në Këto Thirrje: - 15 -

4. Programet E Studimit - 17 -

1.1 Rregulloret Dhe Procedurat Për Zhvillimin/ Rishikimin Dhe Aprovimin E Kurikulave Te Reja - 17 -

1.2 Rregullorja Për Vlerësimin E Studenteve Dhe Progresin E Tyre Gjate Studimeve - 17 -

1.3 Rregullorja Për Ba Dhe Ma Është Bashkangjitur Këtij Raporti. - 18 -

4 Programet E Studimit - 19 -

4.1 Agrobiznesi (B.Sc.) - 19 -

1.1 TË DHËNAT THEMELORE PËR PROGRAMIN E STUDIMIT - 23 -

1.2 ARSYESHMËRIA E PROGRAMIT PËR TREGUN E PUNËS - 24 -

1.3 KRAHASUESHMËRIA NDËRKOMBËTARE E PROGRAMIT - 27 -

1.4 TARGET GRUPI QË I DEDIKOHET PROGRAMI..... - 28 -

1.5 ORIENTIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT SIPAS PARIMEVE UDHËHEQËSE TË INSTITUCIONIT - 28 -

1.6 QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT..... - 31 -

1.7 REZULTATET E PRITURA TË MËSIMIT..... - 31 -

1.8 RAPORTI NË MES TË PJESËS TEORIKE DHE ASAJ PRAKTIKE..... - 34 -

1.9 LLOGARITJA E ECTS-VE - 34 -

PROGRAMI I STUDIMEVE NË DREJTIMIN E AGROBIZNESIT ËSHTË ME KOHË TË PLOTË. PROGRAMI I STUDIMEVE ËSHTË 3 VITE (180 ECTS) I NDARË NË 6 SEMESTRA (1 SEMESTER KA 30 ECTS). TË GJITHA LËNDËT JANË TË NGARKUARA ME VLERËN E ECTS, DHE SE NJË (1) ECTS ËSHTË E BARABARTË ME (20) NJËZET DERI NË TRIDHJETË (30) ORË MËSIMI. ATO JANË LLOGARITUR SIPAS SHEMBULLIT TË TABELËS SI MË POSHTË: - 34 -

1.10 PRAKTIKE PROFESIONALE– INTERSHIP..... - 34 -

1.11 PLANI I KËRKIMIT NË KUADËR TË PROGRAMIT - 35 -

1.12 KUSHTET E REGJISTRIMIT DHE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE - 36 -

TITULLI I GRADËS AKADEMIKE DHE EMËRTIMI I DIPLOMËS NË FORMË TË PLOTË DHE TË SHKURTUAR - 37 -

1.13 PASQYRA E PROGRAMIT - 37 -

1.14 PËRSHKRIMI I MODULEVE..... - 39 -

4.2 Shkencat E Pyjeve Dhe Mjedisit (B.Sc.) - 83 -

2.1 Të Dhënat Themelore Për Programin E Studimit - 83 -

2.2 Arsyeshmeria E Programit Për Tregun E Punës - 85 -

2.3 Krahasueshmëria Ndërkombëtare E Programit - 86 -

2.4 Target Grupi Që I Dedikohet Programi.....	- 86 -
2.5 Orientimi I Programit Të Studimit Sipas Parimeve Udhëheqëse Të Institucionit	- 87 -
2.6 Qëllimi Dhe Profili I Programit	- 87 -
2.7 Rezultatet E Pritura Të Mësimit.....	- 88 -
2.8 Raporti Në Mes Të Pjesës Teorike Dhe Asaj Praktike	- 89 -
2.9 Llogaritja E Ects-Ve.....	- 89 -
2.10 Puna Praktike – Intership.....	- 89 -
2.11 Plani I Hulumtimeve Për Programin	- 90 -
2.12 Kushtet E Regjistrimit Dhe Të Pranimi Të Studentëve.....	- 90 -
2.13 Pasqyra E Programit	- 91 -
2.14 Përshkrimi I Moduleve	- 93 -
<u>4.3 Edukimi Fillor (Ba)</u>	<u>- 131 -</u>
3.2 Arsyeshmeria E Programit Për Tregun E Punës	- 134 -
3.3 Krahasueshmëria Ndërkombëtare E Programit Të Studimit	- 135 -
3.4 Grupi Që I Dedikohet Programi.....	- 136 -
3.5 Orientimi I Programit Të Studimit Ndaj Parimeve Udhëheqëse Të Fakultetit	- 136 -
3.6 Qëllimi Dhe Profili I Programit Fillor.....	- 137 -
3.7 Rezultatet E Pritura Të Mësimit.....	- 138 -
3.8 Raporti Ndërmjet Pjesës Teorike Dhe Praktike	- 139 -
3.9 Llogaritja E Ects-Ve.....	- 139 -
3.10 Puna Praktike -Intershipi	- 140 -

3.11 Plani I Hulumtimeve Për Programin	141 -
3.12 Kushtet Për Pranim Të Studentëve Dhe Procedurat E Zgjedhjes	142 -
3.13 Plani I Programit Të Studimit (Emri, Orët Javore, Ects Kreditë Dhe Statusi)	143 -
3.14.Përshkrimi I Lëndëve Të Programit Fillor.....	148 -
<u>4.4 Trashigimi Kulturore Dhe Menaxhimi I Turizmit</u>	<u>230 -</u>
4.3. Krahasueshmëria E Programit	232 -
4.5. Misioni I Programit	232 -
4.6. Qëllimi Dhe Profili I Programit:	232 -
4.10. Puna Praktike – Internship	233 -
4.11. Plani I Hulumtimeve Për Programin / Programet Në Vlerësim	234 -
4.12. Kushtet E Pranimi Dhe Regjistrimi I Studentëve	234 -
4.13. Programi I Studimit Master	235 -
4.14.Përshkrim I Shkurtër I Lëndeve:	237 -
<u>5. Stafi.....</u>	<u>248 -</u>
<u>6. Studentët.....</u>	<u>254 -</u>
<u>7. Menaxhimi I Cilësisë.....</u>	<u>258 -</u>
<u>8. Hpësiat Dhe Paisjet.....</u>	<u>259 -</u>
<u>9. Bashkëpunimi Ndërkombëtar Dhe Hulumtimi.....</u>	<u>264 -</u>
<u>10. Financat</u>	<u>267 -</u>
<u>11. Plani I Implementimit Të Rekomandimeve Të Grupit Të Ekspertëve Nga Procedura E Fundit E Akreditimit.....</u>	<u>271 -</u>
<u>12.Shtojca</u>	<u>273 -</u>

1. Historiku i shkurtër i Universitetit

1. Themelimi

Universiteti i Prizrenit (UPZ) është themeluar më 09.10.2009 me vendimin numër 01/87, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa pas një pune intensive përgatitore me konsulentë ndërkombëtarë ka nisur punën më 2010. Selia e Universitetit të Prizrenit është në Prizren. Tradita universitare fillon shumë më herët, me Shkollën e Lartë Pedagogjike (SHLP) në Prizren, në vitin 1962, që ishte guri i parë themeltar i këtij Universiteti. SHLP ishte bërë e pavarur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë i cili ishte institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë. SHLP në Prizren më vonë është shndërruar në Fakultetin e Edukimit-Dega në Prizren, në kuadër të Universitetit të Prishtinës. Dega e Fakultetit të Edukimit në Prizren nga viti 2010/2011 kalon në kuadër të Universitetit të Prizrenit. Në Programin Fillor, Programin Parafillor dhe Programin Matematikë-Informatikë në këtë Fakultet, mësimi organizohet edhe në gjuhën turke përkatësisht në atë boshnjake. E njëjta traditë ka vazhduar edhe me Universitetin e Prizrenit.

2. Vendndodhja

Të gjitha fakultetet e UPZ gjeenden në një kampus në adresën: Rruga e Shkronjave nr.1 në Prizren.

3. Vlerësimet e deritashme nga AKA

Programet e ciklit të parë të akredituara nga Agjencia Kosovare e Akreditimit (AKA) janë: Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me drejtimet: Software Design dhe Teknologji e Informacionit dhe Telekomunikimit; Fakulteti Ekonomik me drejtimet: Administrim Biznesi dhe Menaxhment Ndërkombëtar; Fakulteti Juridik; Fakulteti i Edukimit me programet: Fillor dhe Parashkollor; Fakulteti i Filologjisë, me programet: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe Programi Gjuhë Gjermane. Nga viti 2012 ka filluar edhe Programi në nivelin Master në Trashëgimi Kulturor dhe Menaxhim i Turizmit. Ndërkaq më 2014 kanë nisë punën edhe tre drejtime të reja në nivelin Master. Dy drejtime në Fakultetin Ekonomik: Master në Administrim Biznesi dhe Master në Kontabilitet dhe Auditim dhe një në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike. Komisione përkatëse me vendim të Senatit janë duke punuar intensivisht për hapjen e drejtimeve të reja komfor nevojave dhe kërkesave të tregut të punëve dhe trendëve ndërkombëtare në arsimin e lartë

4. Programet e akredituara në UPZ:

	Programi i studimit	I akredituar në vitin	I akredituar deri në vitin	Niveli i studimeve
1.	Administrim Biznesi	2015	2018	BA
2.	Menaxhment Ndërkombëtar	2015	2018	BA
3.	Juridik	2015	2018	LLM
4.	Software Design	2015	2018	BSc
5.	TIT	2015	2018	BSc
6.	Programi Fillor	2013	2016	BA

7.	Programi Parashkollor	2013	2016	BA
8.	Gjuhë dhe letërsi gjermane	2015	2018	BA
9.	Trashigimi kulturore dhe menaxhimi i turizmit	2013	2016	MA
10.	Gjuhë dhe letërsi gjermane	2014	2017	BA
11.	Gjuhë dhe letërsi angleze	2014	2017	BA
12.	Menaxhment ndërkombëtar	2014	2017	MA
13.	Kontabilitet dhe auditim	2014	2017	MSc
14.	Shkencat kompjuterike dhe telekomunikimi	2014	2017	MA

2. Parimi udhëheqës dhe misioni

2.1 Misioni dhe Vizioni i UPZ

Universiteti i Prizrenit shërben rajonin e Prizrenit dhe vendin me rekrutimin, zhvillimin dhe në edukimin e studentëve për të qenë të diplomuar të suksesshëm në tregun e punës në Kosovë, në rajon dhe në Evropë.

Universiteti i Prizrenit dhe Menaxhmenti i tij është i angazhuar për rritjen e cilësisë së mësimin dhe mësimdhënies dhe aktivitetet të lidhura të Universitetit, në mënyrë që të forcojë pozitën e vet dhe krahasueshmërinë me institucionet e tjera në rajon dhe Evropë.

Universiteti është institucion autonom i arsimit të lartë, që zhvillon arsimim akademik, kërkime shkencore, krijimtari artistike, këshillime profesionale dhe fusha të tjera të veprimtarive akademike. Universiteti ka këto qëllime:

- Të veprojë si institucion qendër udhëheqëse për avancimin e diturisë, ideve dhe shkencës në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës;
- Të veprojë si institucion luajë rolin udhëheqës në zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës;
- Të ndihmojë në procesin e promovimit të demokracisë qytetare;
- Të synojë të krijojë dhe mbështesë standardet më të larta në fushën e ësimdhënies dhe mësimnxënies, kërkimeve shkencore dhe krijimtarisë artistike;
- Të shfrytëzojë burimet e veta në mënyrë sa më efektive;
- Të bashkëpunojë maksimalisht dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e arsimit të lartë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- Të përshtatet standardeve evropiane;

- Të integrohet plotësisht në zonën evropiane të arsimit të lartë (konform Deklaratës së Bolonjës, Konventës së Lisbonës mbi Njohjen dhe në zonën evropiane të kërkimeve shkencore) në Zonën Evropiane të Kërkimeve Shkencore si dhe të ndërmarrë hapat adekuat reformues të nevojshëm për arritjen e këtij misioni. objektivi.

Kërkimet shkencore janë prioritet i UPZ-së. Njëri nga hapat e para të UPZ-së është themelimi i grupit për kërkime shkencore, si rezultat i kësaj botimi i parë i punimit shkencor u publikua dhe një numër i konferencave shkencore janë mbajtur në universitetin tonë.

2.2 Strategji për implementimin e misionit të UPZ-së

Të bashkangjitur me raportin e vlerësimit ju mund ta gjeni strategjinë për sigurimin e cilësisë e UPZ-së. Strategjia e sigurimit të cilësisë është dokumenti i parë i zhvillimit strategjik në UPZ, i cili përcakton prioritetet bazë të arsimit të lartë në fushën e sigurimit të cilësisë dhe mënyrat e realizimit të tij. Ky punim shënon natyrën relevante dhe permanente të Universitetit e cila njëkohësisht, duke u varur në nevojat dhe arsyet e undshme, mund të rishikohet dhe ndryshohet periodikisht, e shtuar respektivisht dhe të mund të shërbejë si një hartim i planeve të veprimit në afatin e shkurtët, të mesëm dhe të gjatë në fushën e sigurimit të cilësisë.

Qëllimi kryesor për draftimin e kësaj strategjie është arritja e qëllimeve të prezantuara juridike dhe vizionit të zhvillimit të mëtutjeshëm të arsimit të lartë në universitet dhe jashtë. Në mënyrë që të arrijë qëllimet thelbësore afatgjate, Universiteti është i angazhuar në pikat vijuese:

- Progresi i cilësisë gjithëpërfshirëse të arsimit të lartë në universitet dhe programet e tij.
- Zgjerimi i efikasitetit studimor.
- Përmirësimi i cilësisë në programet studimore, mësimdhënien dhe mësimnxënien dhe kushtet e punës.
- Përmirësimi i hulumtimit shkencor dhe punës pedagogjike të stafit akademik të universitetit.
- Rritja e kontributit, jetës akademike të Universitetit dhe kontributit i cili ofrohet në komunitetin lokal dhe

Kosovar në përgjithësi.

2.3 Udhezim i zhvillimit për universitetin tonë është strategjia jonë e sigurimit të cilësisë e cila është prezentuar tek të gjitha njesitet dhe e njëjta obligohet të harmonizohet në punën e tyre të përditshme.

2.4.1. Si i monitoron institucioni/ njësia ndryshimet që zhvillohen në institucionet/ njësitet tjera në vend dhe jashtë vendit?

Institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë, përfshirë Universitetin e Prizrenit (UPZ), janë të përkrahura në mënyre ligjore nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në Kosovë (MASHTK), për të kryer, zhvilluar, formuar dhe vlerësuar qëndrueshëm reformat bazuar në principet vijuese: efektiviteti dhe efikasiteti; roli i menaxhmentit, stafit akademik dhe administrativ; pjesëmarrja e studentëve në organet qeverisëse; përkrahja studentore; promovimi i lëvizshmërisë akademike dhe studentore; krijimi i mundësive për zhvillim të stafit; bashkëpunimi me palët relevante me interes; garantimi i transparencës, lirisë së studimit dhe hulumtimit artistik dhe shkencor, respektimi i edukimit përfshirës; pajtueshmëria dhe krahasimi i programeve studimore me standardet dhe udhëzimet Evropiane; përgjegjësia sociale institucionale

2.4.2 Si ndryshon institucioni/ njësia me qëllim të përmirësimit?

UPZ në baza të rregullta dërgon stafin akademik dhe punonjës tjerë në trajnime dhe konferenca. Nga këto trajnime stafi ka mundësi të njihet dhe të mësojë nga të tjerët lidhur me trendet e reja dhe eksperiencat dhe dijen ta sjell dhe implementoj në UPZ. Njëra nga konferencat që vlen të përmendet është Forumi për Sigurimin e Cilësisë. Këtë Forum e përcjellim rregullisht dhe përpiqemi të sjellim praktikat më të mira në Universitet.

2.4.3 Si iu përshtatet institucioni/ njësia kërkesave të reja, sa shpejt iu përgjigjet kërkesave nga jashtë?

UPZ është ende program i MASHT-it. Të gjitha vendimet e sjella nga MASHT implementohen automatikisht në UPZ. Dihet se MASHT bazon punën e vetë kur bëhet fjalë për arsimin e lartë në Udhëzimet e Komisionit Europjan. UPZ gjithashtu qartë e ka paraqit qëndrimin e vetë në Strategjinë për Sigurimin e Cilësisë se bazë për zhvillim të mëtutjeshëm janë dokumentet në vijim:

1. Deklaratën e Bolonjës;
2. “Standardet dhe Udhëzimet e Sigurimit të Cilësisë në Fushën e Arsimit të Lartë Evropian”, Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (AESC)
3. Konventa e Lizbonës;
4. Ligji i Kosovës për Arsimin e Lartë;
5. Udhëzimet e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës.

2.4.4 Si e harton institucioni/ njësia draft-planin strategjik për të përmbushur misionin e tij?

Siç kemi përmendur edhe më herët UPZ ndjek Strategjinë e vetë për sigurimin e cilësisë në zhvillimin dhe reformimin e mëtutjeshëm. Të gjitha praktikatat e parapara në strategji janë planifikur të realizohen në planin dinamik të strategjisë për sigurimin e cilësisë në vijim:

Principet	Aktivitetet	Planifikimi kohor	Trupi përgjegjës	Instrumenti matës
1.1 Efektiviteti dhe efikasiteti	Pranimi i studentëve	Në vazhdimësi	Menaxhmenti i UPZ-së	Statistics
	Mjedisi mësimor	Në Vazhdimësi	Zyra për infrastrukturë	Buxheti për infrastrukturë
	Profili i studentëve (kreativiteti, inovacioni, motivimi)			Numri i të diplomuarve të punësuar
	Digjitalizimi	Ne vazhdimësi	Zyra për infrastrukturë dhe departamenti IT	Performanca e IT
Stafi akademik	Zhvillimi dhe avancimi i procesit mësimor	Në vazhdimësi	Stafi akademik dhe strukturat e universitetit	Instrumentet adekuate të vlerësimit
	Puna kërkimore shkencore	Në vazhdimësi	Qendra për hulumtime shkencore	Të dhënat statistikore
	Pjesëmarrja dhe prezantimi i punimeve në konferenca vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Njësia akademike QHSH Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare	Të dhënat statistikore
Stafi administrativ	Implementon politikat dhe vendimet e Universitetit	Në vazhdimësi	Zyra e Sekretarit të përgjithshëm	Instrument vlerësues për stafin administrativ
	Trajnimi	Sipas nevojës	Zyra e Sekretarit të përgjithshëm	Instrument vlerësues për trajnim dhe performanca
Pjesëmarrja e studentëve në organet udhëheqës e	Zgjedhja e strukturave udhëheqëse të parlamentit studentor	Në bazë të statutit të UPZ	Komisioni Zgjedhor	Rezultati zgjedhor
	Organizimi i aktiviteteve të ndryshme arsimore dhe shkencore	Në vazhdimësi	Parlamenti i studentëve	Të dhënat statistikore
Mbështetja studentëve	Krijimi i kushteve adekuate për studime	Në vazhdimësi	Strukturat e UPZ	Pyetësorët, sondazhet, kutija e ankesave
Promovimi i mobilitetit për stafin akademik dhe studentë	Aktivitetet nga pika 1.5 e Strategjisë	Në vazhdimësi	Menaxhmenti i UPZ, Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare, QHSH dhe Parlamenti i studentëve	Të dhënat statistikore

Sigurimi i transparencës, lirisë së studimit dhe hulumtimit shkencor dhe artistik	Nxjerrja e rregulloreve	Sipas nevojës	Senati	Vlerësimet nga grupet e ndryshme të interesit
Përputhshmëria dhe krahasueshmëria e programeve studimore me udhëzimet dhe standardet europiane.	Vendosja, harmonizimi dhe implementimi i standardeve europiane të arsimit të lartë	Në vazhdimësi	UPZ	Raporti i vetëvlerësimit dhe raporti i jashtëm nga Agjencioni për Akreditim

2.4.5 A posedon institucioni/ njësia mekanizma për sigurimin e cilësisë?

Nga ky vit UPZ ka emëruar edhe prorektorin për çështje të sigurimit të cilësisë ndërsa ky është viti i tretë prej funksionimit të zyrës për sigurimin e cilësisë. Të dytë janë përgjigjës që punën e tyre ta harmonizojnë me strategjinë për sigurimin e cilësisë dhe të ndjekin planin dinamik të implementimit të praktikave që dalin nga strategjia për sigurimin e cilësisë.

Disa nga përgjigjësitë e koordinatorit për sigurimin e cilësisë janë:

- Rritja e aktiviteteve ndërgjegjësuese brenda institucionit në lidhje me Sigurimin e Cilësisë (QA).
- Zhvillon dokumentet e nevojshme / udhëzime të tjera për sigurimin e cilësisë dhe në bazë të nevojave të UPPz.
- Në mënyrë aktive kontribuon në institucionin për kryerjen e aktiviteteve:
 - o Harton raportet e vetë-vlerësimit të brendshëm;
 - o mbledh / zhvillon dokumentet e nevojshme të kërkuara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës.
 - o Mbështet procesin e përgjithshëm të akreditimit të UPPz.


3. Organizimi Menaxhimi dhe planifikimi

Organizimi dhe menaxhimi i UPZ është i bazuar në statutin e UPZ të aprovuar në Parlamentin e Republikës së Kosovës, neni 15 i statudit.

1. Emri i institucionit: Universiteti i Prizren “Ukshin Hoti”

2. Organogrami i UPZ:


 Universiteti i Prizrenit
 University of Prizren
 "UKESHIN HOTI"
 Propozuar me dt. 28.04.2014
 Zyra e Propozimit Nr. 1 pro...
 306 01-826



U.d. Rektori: Prof. Dr. Zahadin Shemsidini



Zahadin Shemsidini

2.2.1. Organizimi i strukturave vendimmarrëse në administratë

Autoritetet kryesore qeverisëse të universitetit janë Këshilli drejtues,

Rektori dhe Senati.

- Të gjitha autoritetet qeverisëse të universitetit ushtrojnë aktivitetin e tyre mbi parimin e votimit me shumicë votash, nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë Statut.
- Mandati i të gjithë zyrtarëve qeverisës dhe autoriteteve qeverisëse e anëtarëve të tij fillon me 1 tetor, nëse nuk përcaktohet ndryshe me këtë

2.3 Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Studentëve në organet e ndryshme të UPZ-së

- Këshilli i studentëve shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve në fakultet.
- Këshilli i studentëve realizon interesat e veta lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor, përmes përfaqësuesve të vet në këshillin e fakultetit.
- Anëtarët studentë të këshillit të fakultetit marrin pjesë në propozimin e kandidatëve për dekan.
- Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore të cilave
- Interesat e studentëve do të përfaqësohen në kuadër të universitetit me këto organe:
- Parlamenti i studentëve në nivel të universitetit;
- Këshilli i studentëve në nivel të njësisë akademike.
- Parlamenti i studentëve është organi më i lartë i përfaqësimit të

studentëve.

2.4.1 Procedurat për përzgjedhjen e personelit, posaçërisht procedurat për emërimet (thirrjet) për mësimdhënësit

I gjithë personeli akademik do të emërohet nga Rektori sipas vendimit të Senatit i bazuar në propozimin e këshillit të njësisë akademike.

2. Nëse propozimi refuzohet, ai i kthehet për rishqyrtim këshillit të njësisë akademike.

3. Nëse këshilli i njësisë akademike edhe pas rishqyrtimit sjellë të njëjtin propozim, Senati merr vendim përfundimtar.

4. Procedurat për emërim do të bëhen në mënyrë transparente me shpalljen e konkursit publik për postin.

2.5 Staf i akademik mundë të zgjidhet në këto thirrje:

1.1. Mësimdhënie akademike;

1.2. Kërkime shkencore;

1.3. Krijimtari artistike.

2. Personeli akademik përbëhet nga:

2.1. Profesorët e rregullt;

2.2. Profesorët e asocuar;

2.3. Profesorët asistentë;

- 2.4. Asistent universiteti;
- 2.5. Lektorët dhe korepetitorët(Fakulteti i Arteve).
- 3. Shkurtesat zyrtare për personelin akademik janë:
 - 3.1. Profesor i rregullt – Prof. dr.;
 - 3.2. Profesor i asocuar – Prof. asoc. dr.;
 - 3.3. Profesor asistent – Prof. ass. dr.;
 - 3.4. Asistent universiteti – Ass.

Për detaje lidhur me zgjedhjen në këto thirrje ju lutem referohuni në artikullin 171- 179 të statutit të UPZ-së.

4. Programet e studimit

1.1 Rregulloret dhe procedurat për zhvillimin/ rishikimin dhe aprovimin e kurikulave të reja

Idetë për programet e reja të studimit mund të vijnë nga përfaqësuesit e universitetit, duke përfshirë rektorin, dekanët e fakulteteve, studentëve. Ideja paraqitet në Senat i cili vendos nëse programet e studimit i plotësojnë kriteret për zhvillimin e mëtejshëm dhe nëse programet janë në harmoni me politikën shtetërore dhe të universitetit.

Disa nga kushtet që duhet marrë parasysh para aplikimit me program të ri të studimit janë: studimi i tregut të punës; politikat shtetërore; mungesa e kuadrit në fusha të caktuara.

1.2 Rregullorja për vlerësimin e studenteve dhe progresin e tyre gjatë studimeve

Ka tri afate të rregullta dhe dy afate të jashtëzakonshme të paraqitjes së provimeve. Mbajtja e provimeve organizohet nga fakultetet përkatëse dhe profesorët janë të detyruar të paraqesin në planin mësimor në fillim të semestrit i cili gjithashtu përmban procedurën e vlerësimit të studentëve. Kjo varet nga profesorët të vendosin për kriteret e provimit.

1. Provimet shërbejnë si mënyrë e rregullt e vlerësimit të dijes.
2. Provimet mund të organizohen veç e veç për çdo lëndë ose të kombinohen për më shumë lëndë në pajtim me programin e studimeve (provim me komision).
3. Provimet janë publike dhe mbahen në këto mënyra:
 - 3.1. Me shkrim;
 - 3.2 Me gojë;
 - 3.3. Me shkrim dhe me gojë;
 - 3.4. Praktikë.
4. Provimet e kombinuara me gojë dhe me shkrim bëhen brenda shtatë ditëve.
5. Provimet vlerësohen nga një pyetës ose nga një komision për provime.
6. Provimet mund të mbahen nga një komision për provime nëse:
 - 6.1. Studenti është ankuar me shkrim;
 - 6.2. Është caktuar me programin e studimeve.
7. Procedura e mbajtjes së provimit është e përcaktuar me programin e studimit.
8. Mënyra e përcaktimit të dijes dhe të dhënies së provimit do të përcaktohet me programin mësimor të lëndës – syllabus.

Neni 108

1. Provimet për studimet bachelor dhe master mbahen gjatë afatit të provimeve.
2. Afatet e provimeve përfshijnë afatin e dimrit (janarit), pranverës (qershorit) dhe vjeshtës (shtatorit). Periudha e saktë për çdo afat është e përcaktuar me kalendarin e përgjithshëm të tudimeve, i cili është i pranuar nga Senati dhe i hapur për publikun. Hollësitë rreth datës së fillimit dhe përfundimit të secilit afat të provimeve përcaktohen nga këshillat e njësive akademike.
3. Oraret e afateve të provimeve, ku janë të përfshira oraret ditore, shpallen në fillim të vitit akademik.
4. Oraret e provimeve do të përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë.
5. Oraret e provimeve, pasi të jenë shpallur, janë detyruese si për pyetësin ashtu edhe për studentin.

1.3 Rregullorja për BA dhe MA është bashkangjitur këtij raporti.

Punimi i diplomës për bachelor dhe master

1. Programet e studimeve bachelor përfundojnë me punimin e diplomës për bachelor ose me provim para komisionit në pajtim me programet etyre të studimeve.
2. Punimi i diplomës për bachelor punohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara shkencore.
3. Punimi i diplomës për bachelor mund të elaborohet bashkë nga dy ose tre studentë (grup hulumtues) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.
4. Kërkesa për elaborimin e punimit të diplomës për bachelor nga dy ose tre studentë vendoset nga këshilli i njësisë akademike.
5. Procedura për aplikim, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për bachelor përcaktohet këshilli i njësisë akademike.

Neni 115

1. Programet e studimeve master përfundojnë me punimin e tezës për master në pajtim me programet e studimeve.
2. Punimi për master punohet individualisht nga studenti, duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore në fushat e caktuara shkencore.
3. Punimi i diplomës për master elaborohet nga dy ose tre studentë (grupi kërkimor), dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.
4. Aplikimi për elaborimin e punimit të diplomës për master nga dy ose tre studentë vendoset nga këshilli i njësisë akademike.
5. Procedura për paraqitje, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për master përcaktohet nga këshilli i njësisë akademike.

4 Programet e studimit

4.1 Agrobiznesi (B.Sc.)

1. Pjesa e përgjithshme e Fakultetit / Struktura organizative

Iniciativa për themelimin e programeve të reja studimore që lidhen me ushqimin, mjedisin dhe bujqësinë ka filluar nga Rektori Prof. Dr. Ramë Vataj, ku në dhjetor të vitit 2014 i propozoi senatit të universitetit ngritjen e një komisioni profesional që do të merret me hulumtimin e tregut të punës dhe kapaciteteve të universitetit për një fakultet të ri dhe programe të reja studimore. Komisioni në përbërje prej, Dr. Bekim Gashi, Dr. Isuf Lushi dhe Dr. Hysen Bytyqi, pas një konsultimi të gjerë me ekspertë të ndryshëm por edhe me universitet e tjera në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Slloveni dhe Itali si dhe Institucione të ndryshme shtetërore, propozoi që në kuadër të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren të themelohet edhe një fakultet i ri në fushën e shkencave jetësore. Mbështetur në programet studimore që do të ofron ky fakultet dhe shembujt e tjerë nga bota perëndimore por edhe kodet e lëmive sipas Erasmus, komisioni hartoi raportin dhe i propozoi Senatit dhe KD-së që kjo njësi akademike, të emërohet: Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit.

Bazuar në specifikat e UPZ-së dhe kërkesat e tregut të punës në regjionin e Prizrenit por edhe mbarë Kosovës, programet e reja studimore të prezantuar në këtë raport do të kontribuojnë në rritjen e performancës së UPZ-së në përgjithësi por edhe identifikimit të këtij universiteti në veçanti. Duke marrë parasysh traditën e regjionit të Prizrenit por edhe pozitën gjeografike, atëherë, këto programe do të ndikojnë direkt ose indirekt në rritjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm ekonomik por edhe shkencor të këtij regjioni përmes kualifikimit të ekspertëve të lëmive të ndryshme.

Mbështetur në dispozitat e nenit 55 dhe 56 të Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, dhe sipas propozimit të komisionit dhe rektorit, Këshilli Drejtues i UPZ-së përkrahi iniciativën (Vendimi nr. 183/2015, dt. 03.06.2015) që të themelohet Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit në kuadër të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

Misioni i Fakultetit

Misioni themelor i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (FSHJM) do të jetë ofrimi i nivelit të edukimit universitar dhe pasuniversitar si dhe të merret me hulumtimet shkencore

dhe punë konsultative që kanë të bëjnë me Shkencat e natyrës së gjallë, Mjedisit dhe Agrobiznesit. Në kuadër të orientimit të vetë drejt studimit të burimeve natyrore dhe menaxhimit të qëndrueshëm të tyre, fakulteti është njëri ndër institutet për të cilin ka nevojë çdo shtet me qëllim të formimit dhe mbajtjes së identitetit të tij. Mbrojtja e relievit dhe natyrës, mbrojtja e trashëgimisë natyrore, shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe miqësor i burimeve natyrore, prodhimi dhe procedimi i ushqimit cilësor, së bashku me teknologjinë moderne paraqesin një sfidë globale e cila mund të adresohet pozitivisht duke zbatuar hulumtimet gjithnjë më të avancuara.

Misioni i fakultetit do të mbështet nga komuniteti akademik i pedagogëve, hulumtuesve shkencor, stafit teknik dhe studentëve, të cilët janë përgjegjës për mbajtjen dhe kontributin e aktiviteteve të fakultetit me nismat e tyre, punën e përhershme, diturin profesionale dhe rezultatet e punës kualitative.

Vizioni i Fakultetit

Vizion i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit është përparimi i dijes, përmes aftësimit të profesionistëve të shkathtë, dhe zbatimi i saj në zhvillimin e potencialit njerëzor në funksion të zhvillimit të një shoqërie moderne në Kosovë të orientuar drejt zhvillimit duke synuar përvetësimin e trendëve moderne globale në aspektin shoqëror dhe social si dhe atë arsimor.

Me programet e tij edukative dhe shkencore, FSHJM përshpejton dhe inkurajon bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe multidisiplinor në fushën e shkencave jetësore si dhe hulumtimet integrale të problemeve të zhvillimit që janë në masë të madhe shumë shtresore e të ndërlydhura me interesat e profesioneve të ndryshme. Prandaj fakulteti do të siguroj në të gjitha disiplinat shkencore dhe në programet e studimit kualitet të lartë dhe bashkëpunim, njohje me karakter internacional dhe profesional të bazuar në ekselencë.

Garancion tjetër i nivelit të edukimit, hulumtimit dhe aktiviteteve të zhvillimit në kuadër të FSHJM është krahasueshmëria e tij ndërkombëtare. Fakulteti ka nevojë të ketë pozitë profesionale solide dhe vështrim në të gjitha çështjet sociale praktike në të gjitha fushat që përfshihen në programet e tij. Kështu ai ka nevojë që aktivisht të merr pjesë në krijimin e politikave të natyrës, zhvillimit rural dhe në politikat që kanë të bëjnë me teknologjinë e pylltarisë dhe teknologjinë e ushqimit, si dhe fushat tjera gjegjëse.

Departamentet dhe Programet studimore

Për shkak të specifikave dhe disiplinave të ndryshme, ky fakultet pastaj duhet të ndahet në këto Departamente:

1. Departamenti i Agrobiznesit;
2. Departamenti i Shkencave të Ushqimit (*i planifikuar për të ardhmen e afërt*);
3. Departamenti i Shkencave të Mjedisit.

Programet studimore që propozohen në kuadër të këtij fakultetit, janë:

Departamenti i Agrobiznesit:

- Programi: Agrobiznes

Departamenti i Shkencave të Ushqimit

- Programi: Shkencat e Ushqimit dhe të Ushqyerit (*i planifikuar për vitin akademik 2017/18*)

Departamenti i Shkencave të Mjedisit

- Programi: Planifikim Hapësinor (*i planifikuar për vitin akademik 2017/18*)
- Programi: Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit


Të gjitha këto programe studimore do të jenë 3 vjeçare (Bachelor me 180 ECTS) dhe më vonë duhet të vazhdojnë me ciklin e dytë të studimeve Master, në mënyrë që të arrihen njohuri bazike si për punë ashtu edhe për aktivitete hulumtuese shkencore.

Struktura organizative e fakultetit / organogrami i fakultetit

Struktura organizative e Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit do të përbehet nga Dekani, prodekani për çështje mësimore dhe prodekani për çështje materiale.

Këshilli i Fakultetit - sipas statutit (neni 73) Këshilli duhet të ketë së paku 15 anëtarë të zgjedhur nga radha e profesorëve, deri në 2 anëtarë të zgjedhur nga radha e asistentëve, dekani, dy prodekanët, një prej administratës dhe një përfaqësues të Këshillit studentor. Anëtarët e Këshillit nga stafi akademik zgjidhen me zgjedhje të rregullta që organizohen në nivel të Universitetit Ukshin Hoti në Prizren.

Komisioni i Studimeve- është organ këshillëdhënës për Këshillin e Fakultetit, përbëhet prej 9 anëtarëve, dhe kryesohet nga Dekani i Fakultetit. Ky komision përbëhet nga prodekani për çështje mësimore, pesë mësimdhënës, një asistent dhe dy student.



Organogrami i FSHJM-së

Në kuadër të fakultetit të FSHJM-së, do të funksionojnë edhe *Komisioni disiplinor* dhe *Komisioni për nostrifikimin e diplomave*. Të gjitha komisionet, emërohen nga Këshilli i Fakultetit me propozim të Dekanit.

1.1 Të dhënat themelore për programin e studimit

Emri i programit të studimit	Agrobiznes
Niveli kualifikimit sipas KKK (me shkurtesat BA, MA, PhD, program doktrate, kurs universitar, certifikatë apo diplomë profesionale)	Bsc (Bachelor i Shkencave)
Grada akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar	Agrobiznes (Bsc. Agribusiness)
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC)	01.2
Profili i programit akademik (specializimi)	Shkencat e Jetës (Menaxhim Agrobiznesi)
Kohëzgjatja minimale e studimit	3 vite
Forma e studimit (e rregullt, pa shkëputje nga puna, studim në distancë etj.)	E rregullt
Numri i ECTS kredive (total dhe për vit)	180 ECTS
Modulet /Lëndët (titujt)	Matematikë Prodhim Bimor Ekonomiks Sociologji Rurale Gjuhë Angleze I Bazat e Marketingut Prodhim Shtazor Ekonomia Bujqësore Bazat e Statistikës Gjuhë Angleze II Lëndë zgjedhore Kontabilitet Statistikë Biznesi E drejta në Biznes Informatikë në Agrobiznes Hortikulturë Bazat e Financave Marketing Agroushqimor Menaxhim Agrobiznesi Menaxhimi i burimeve Njerëzore Komunikim Biznesi Lëndë zgjedhore Menaxhimi Financiar

	Menaxhimi i Fermave Projekte në Agrobiznes Çmimet dhe tregjet e produkteve Bujqësore Teknologji e prodhimit dhe përpunimit të produkteve Bujqësore Sjellja Konsumatore Mjediset e Mbrojtura Prodhimtaria Organike Zhvillimi Rural Praktika Profesionale B.Sc. Teza Lëndët zgjedhore: Administrim Biznesi Biznes ndërkombëtar BE dhe Politikat e përbashkëta Bujqësore Administrim Publik Mbrojtja e bimëve Teknologjia e pasvjeljes Logjistikë e Avancuar në Agrobiznes Parandalimi i sëmundjeve të shtazëve Bimët aromatike dhe mjekësore dhe menaxhimi i tyre Vreshtari dhe Enologji Menaxhim Agroturizmi
Numri i vendeve të studimit	50
Udhëheqës i programit studimor	Dr. Isuf Lushi Dr. Ilir Kapaj
Personeli i përhershëm shkencor/artistik (Numri sipas kategorive të personelit)	8 - Profesor asistentë (Prof. Ass. Dr.)
Taksat e studimit	50 €/*/student/vit

**Sipas udhëzimit administrativ të MASHT do të aplikohet pagesa për studime!*

1.2 Arsyeshmëria e programit për tregun e punës

Industria e Agrobiznesit në Kosovë po rritet me ritme mjaft të shpejta dhe me kontribute jo të pakta në ekonominë e Kosovës, po ashtu sektorët e bujqësisë, blegtorisë dhe të industrisë ushqimore janë prioritet në zhvillimin e vendit tonë. Në bazë të statistikave zytrare nga ATK (Administrata tatimore e Kosovës), rezulton që në rajonin e Prizrenit ushtrojnë aktivitetin e tyre mbi 200 ndermarrje të Agrobiznesit, pra të prodhimit të ushqimit dhe ky numër pritet të

rritet në të ardhmen, pavarësisht nga efektet e krizës globale, përfshirë këtu edhe atë të industrisë së Agrobiznesit si rezultat i rënies së kërkesës.

Çdo formë e biznesit (në gjithë zinxhirin e ushqimit), në zonat rurale apo jo, që sjell përfitime ekonomike dhe sociale për banorët e këtyre zonave dhe që bën të mundur ndërthurjen mes burimeve prodhuese dhe nevojave të popullsisë për ushqim, mund të përkufizohet si ndërmarrje Agrobiznesi. Këto ndërmarrje janë të shumëllojta dhe mund të përfshijë gjithë ndërmarrjet që e gjejnë veten në sistemin e Agrobiznesit: industrinë e ofrimit të inputeve për fermën bujqësore, ferma bujqësore, industrinë e përpunimit të produkteve bujqësore, industrinë e tregimit të këtyre produkteve si dhe të gjithë aktorët (bizneset) që bëjnë të mundur lëvizjen e produktit deri tek konsumatori i fundit. Ndërmarrjet e Agrobiznesit orientohen nga eksperiencia, zhvillohen sidomos në zonat që janë relativisht të populluara dhe përqëndrohen më tepër në zona që kanë aktivitet të theksuar të prodhimit bujqësor (rasti i Prizrenit dhe komunave që e rrethojnë). Pikërisht duke nuhatur një nevojë imediate për specialistë të fushës së menaxhimit të Agrobiznesit UPz ndërmorri këtë inicativë për hapjen e një programi studimi në Agrobiznes. Të diplomuarit e këtij programi i cili orientohet kryesisht nga ekonomia e Agrobiznesit dhe drejtimi i tij do të jenë liderat e së ardhmes për industrinë e Agrobiznesit, gjithmonë e më shumë në rritje në rajonin e Prizrenit.

Konsideruar sa më sipër, por dhe jo vetëm, synimi i hapjes së drejtimit të ri të studimeve të ciklit të parë në nivelin **Bachelor**, me profilin “**Agrobiznes**” është që studentët të marrin njohuritë e mjaftueshme dhe të jenë të aftë të kontribuojnë si pjesë e komunitetit rural në mirëpërdorimin e mundësive prodhuese dhe mirëmenaxhimin e bizneseve të formës Agrobiznes, të cilat përtej afatit të shkurtër rezultojnë me përfitim për vetë ata si edhe për familjet në zonat rurale. Një sistem Agrobiznesi që funksionon mirë jep përfitime direkte dhe indirekte për të gjithë aktorët e përfshirë, pra edhe për familjet fermere.

Ndjekja e studimeve të ciklit të parë në nivelin Bachelor në profilin “Agrobiznes”, do t’ju japë atyre një mundësi me shumë për të gjetur vehten të përfshirë në sipërmarrjen dhe menaxhimin aktiviteteve të Agrobiznesit. Kërkesat për këtë drejtim do të vijnë duke u rritur, pasi në përgjithësi, Agrobiznesi është perspektiva bazë e zhvillimit ekonomik në vende në zhvillim siç është edhe rasti i Kosovës.

UPz deri tani ka patur një profil të Agrobiznesit brenda fakultetit ekonomik, ku studentët e departamentit Administrim Biznesi në vitin e tretë kanë patur mundësinë për të zgjedhur dy profile ku njeri prej tyre ka qënë ai i Agrobiznesit. Por duke patur parasysh kërkesat që ka tregu i punës për specialistë të mirëfilltë Agrobiznesi UPz e gjykon mjaft të domosdoshëm hapjen e një drejtimi të ri Agrobiznes që nga viti i parë. Me akreditimin e këtij programi të ri, zgjedhja aktuale për studentët e Administrimit të Biznesit për profilin Agrobiznes do të pushojë së ekzistuari.

Na duhet të bëjmë me dije se në hapësirën tonë universitare mungon një drejtim i tillë i mirëfillte studimesh, ndërkohë që eksperiencia botërore por edhe e vendeve që kanë një status ekonomik të krahasueshëm me atë të Kosovës (rasti i Shqipërisë) tregon se fusha të tilla studimi janë mjaft të pranishme dhe shumë të kërkuara. Për këtë arsye, gjatë hartimit të kurrikulës së studimit jemi konsultuar me mjaft programe të universiteteve jashtë vendit që kanë drejtime të ngjashme studimi, si Universiteti Brno, Czech Republic Universiteti i Nitrës, Slovakia; Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit si dhe Universiteti Ukshin Hoti ka bazën e domosdoshme për hartim dhe realizimin e planit mësimor, sepse përparësia e kryesore e këtij plan programit të hartuar dhe i propozuar për akreditim, mbështetet në nevojën e padiskutueshme që ka sistemi i agrobiznesit në rajonin e Prizrenit por edhe në Kosovë për specialistë të kësaj fushe.

Punësimi i supozuar/mundshëm i studentëve pas përfundimit të studimeve

Studentët e diplomuar në nivelin e parë të studimeve në programin “**Agrobiznes**”, kanë kualifikimin e nevojshëm për të punuar në një numër të madh fushash si:

Menaxhimi i ndërmarrjeve që ofrojnë inpute për fermat bujqësore. Ndërmarrjet/bizneset që merren me ofrimin e fareravë, plehrave kimike, mekanikës bujqësore. Këto ndërmarrje kërkojnë specialistë që kanë njohuri menaxheriale, të marketingut, financave dhe kontabilitetit por edhe njohuri bazike për sa i përket prodhimit bimor dhe atij shtazor, njohuri të cilat ne pretendojmë që të diplomuarti në drejtimin e ri ‘Agrobiznes’ ti zotërojnë dhe aplikojnë.

Menaxhimin e fermave bujqësore dhe blektorale të orientuara nga tregu. Shumë ferma bujqësore të orientuara nga tregu (që shesin mbi 50% të prodhimit të tyre në vlerë) janë të interesuar për specialistë/menaxherë që kanë njohuri në fushat e prodhimit bujqësor dhe blektoral, menaxhimit dhe marketingut të produkteve të tyre. Po ashtu ato janë të interesuara edhe për kompetenca dhe aftësi në financat e fermave dhe kontabilitetin e tyre.

Menaxhimin e ndërmarrjeve të përpunimit të produkteve bujqësore. Shumë kompani të përpunimit të produkteve bujqësore dhe prodhimit të ushqimit kanë një nevojë imediate për specialistë/menaxherë agrobiznesi, të tilla si ato të përpunimit të perimeve, të përpunimit të mishit, të përpunimit të qumështit, të përpunimit të frutave dhe rrushit. Studentët e diplomuar në këtë drejtim mund të shërbejnë në këto kompani si menaxherë të përgjithshëm, drejtorë marketingu, agjentë shitjesh, specialistë financash si edhe kontabilistë.

Agjensi të ndryshme shtetërore. Studentët e diplomuar në drejtimin ‘Agrobiznes’ janë të aftë dhe dinjitozë (në terma të njohurive që kanë përfituar) për të punuar edhe në institucione shtetërore (p.sh. në Ministrinë relevante që merren me bujqësinë apo me zhvillimin ekonomik në përgjithësi apo agjensi tjera që kanë në fokus zhvillimin rural në përgjithësi dhe zhvillimin e sektorit të Agrobiznesit në veçanti). Institucionet dhe agjensitë publikë kanë nevojë për specialistë me njohuri në menaxhimin e agrobiznesit, në marketing apo edhe në financat e ndërmarrjeve të Agrobiznesit. Njohuritë e tjera bazë në fushën e prodhimit bimor, shtazor dhe në hortikulturë plotësojnë figurën e këtij specialisti që ne pretendojmë të përgatitim me këtë drejtim të ri.

Sistemi bankar dhe ai i mikrofinancës. Bazuar në faktin se studentët e diplomuar në drejtimin Agrobiznes marrin njohuri edhe në lidhje me bankat dhe agjensitë e mikrofinancës ata mund ta gjejnë veten shume mirë edhe si të punësuar në këto institucione. Veçanërisht është për tu theksuar mundësia e madhe që kanë këta specialistë për tu punësuar në agjensitë e mikrofinancës që mund të operojnë apo që do të operojnë në Kosovës në ndihmë të zhvillimit të sektorit bujqësor në përgjithësi dhe sektorit të Agrobiznesit në veçanti. Ata mund të punësohen në këto institucione si analistë kredie apo edhe si menaxherë të niveleve të ndryshme.

Në nivelin e politik-bërjes. Të diplomuarit në drejtimin e agrobiznesit mund të vijnë karrierën e tyre, edhe duke u angazhuar në nivelin e politikave të zhvillimit bujqësor në Kosovë. Me njohuritë që fitojnë ata janë kompetentë për të qënë pjesëmarrës aktivë në këtë proces. Kjo do të nënkuptont anëtarë të grupeve të punës të ministrive relevante për hartimin e politikave bujqësore apo punonjës në departamente të tjera me lidhje direkte apo indirekte me politik-bërjen.

Institucione të tjera publike dhe private. Ka shumë mundësi të zhvillimit të karrierës për studentët e diplomuar në fushën e Agrobiznesit. Studentët mund të punojnë për kompanitë e sigurimeve dhe sidomos për ato që përfshijnë në portofolin e tyre edhe sigurimin në bujqësi. Ata mund ta zhvillojnë karrierën e tyre edhe si sipërmarrës privatë të një agrobiznesi që e gjen veten në një nga tre hallkat e sistemit të Agrobiznesit, mund të vetëpunësohen si konsulentë agrobiznesi dhe asistojnë sipërmarrësit e agrobizneseve me plan biznese, me konsulencë menaxheriale apo edhe të marketingut. Ata mund të punësohen gjithashtu edhe si

specialistë për organizma të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, që merren me çështje të zhvillimit rural dhe atij bujqësor dhe në veçanti me çështje të zhvillimit të agrobiznesit.

1.3 Krahasueshmëria ndërkombëtare e programit

Fakulteti: **Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit**

Emërtimi i programit të studimit: **Agrobiznes**

Bachelor Master Doktoratë

Numri i ECTS kredive për programin e propozuar të studimeve: **180**

Programi e studimit të universiteteve evropiane me të cilat është i krahasueshëm programi Agrobiznes i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (Universiteti #1 nënkupton Universitetin me të cilin programet e studimit janë në pajtueshmëri 75% dhe Universitetet #2 nënkupton Universitetin me të cilin jeni të ngjashëm)¹.

	Universiteti Ukshin Hoti, në Prizren	Universiteti #1	Universitetet #2
Emërtimi i universitetit	Universiteti Ukshin Hoti	Mendel University in Brno (Republika Çeke)	^a Universiteti i Bujqësor i Nitrës (Slovakia) ^b Universiteti Bujqësor i Tiranës (Shqipëri) ^c Rhine-Vaal University of Life Sciences
Fakulteti	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	Faculty of Agronomy Mendel University in Brno	^a Faculty of Economics and Management ^b Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit ^c Faculty of Life Science

¹Bashkangjitur me Raportin e Vetvlerësimit do të gjeni kopjet e Programit të Mendel University in Brno, Slovak Agricultural University in Nitra, Agricultural University of Tirana dhe Rhine-Vaal University of Life Sciences.

Titulli i programit	Agrobiznes	Agribusiness	^a Economy and Management of Agribusiness sector
			^b Drejtimit Agrobiznesi
			^c Agribusiness
% krahasuesh mërisë		Rreth 75%	Rreth 25%

1.4 Target grupi që i dedikohet programi

Në vitin e parë të studimeve në programin e Agrobiznesit mund të regjistrohen të gjithë kandidatët të cilët kanë kryer Shkollat e Mesme të Larta (gjimnaze apo shkolla profesionale), kanë dhënë provimin e maturës dhe kalojnë testin provues nga njohuritë e shkencave natyrore dhe të njohurive elementare matematikore. Pranimi i kandidatëve bëhet nga lista e formuluar nga numri i poenëve të kandidatëve.

Kushtet e tjera i vendos Senati i UPZ-së.

1.5 Orientimi i programit të studimit sipas parimeve udhëheqëse të institucionit

Kurikula e studimeve të drejtimit Agrobiznes është në përputhshmëri me rregullat dhe kriteret e studimeve sipas sistemit të Bolonjës dhe dy vite akademike kanë edhe lëndë zgjedhore, ndërsa shpërndarja e ECTS-ve bëhet sipas peshës së lëndës. Numri i kredive është 60 kredi për vit të studimit që do të thotë nga 30 kredi për semestër. Nga kjo nënkuptohet se studimet Bachelor në këtë drejtim, kanë gjithsej 180 kredi. Studentët mund të zgjedhin lëndët zgjedhore sipas listës së veçantë që ofrohet në kuadër të kësaj kurrikule (tabela e lëndëve zgjedhore) dhe numri i tyre përcaktohet sipas plotësimit me numrin e kredive për semestrin e cakëtuar. Programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite evropiane (ECTS) (më tej: kredite) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike;

Format e mësimi

a. Format kryesore të punës mësimore janë leksionet, punët laboratorike, seminarët, ushtrimet, detyrat me shkrim, projektet dhe detyrat e kursit, praktikat (ekskursionet) mësimore, praktikat profesionale, provimet e kursit, tema (teza) e diplomës dhe provimi i formimit.

- b. Departamenti, me miratim të Dekanit, mund të përcaktojë edhe forma të tjera të punës mësimore.
- c. Përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e mësimit është vetë pedagogu, brenda detyrave të përcaktuara nga departamenti.
- d. Në dobi të ndihmës së ndërsjelltë, në Fakultetin e Shkencave të Jetae zhvillohet praktika e mësimeve (leksione & seminare) të hapura për të gjitha kategoritë e stafit akademik.

Format e zhvillimit të mësimit dhe vlerësimit të studentëve

- a. Format e zhvillimit të mësimit janë leksionet, punët laboratorike (për modulin e informatikës), seminarat, ushtrimet, detyrat me shkrim (provime ndërmjetëse), detyrat e kursit, projektet e kursit, praktikat mësimore etj.
- b. Secili prej elementeve të mësipërm vlerësohet me pikë, pjesë e pandarë kjo e programit të modulit dhe planit mësimor të departamentit.

KONTROLLI I DIJEVE

Detyrimet e studentit

- a. Pedagogu i modulit përcakton numrin dhe peshën (në pikë) të secilit prej elementeve të mësimit.
- b. Çdo element i mësimit vlerësohet për pjesëmarrjen dhe për dijet e përfituara.
- c. Pjesëmarrja e studentëve në mësim:
- d. Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 50%;
- e. Frekuentimi i seminareve dhe ushtrimeve është i detyrueshëm në masën 80%;
- f. Frekuentimi i punëve laboratorike është i detyrueshëm në masën 100%.

Format e kontrollit të dijeve

- a. Format bazë të kontrollit të dijeve janë provimi dhe kolokiumi. Mënyra e kontrollit të dijeve (provim/kolokium), përcaktohet në planin mësimor të Departamentit/Fakultetit.
- b. Provimi është formë kryesore kontrolli për vlerësimin e nivelit të dijeve që studenti ka përvetësuar gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një moduli. Provimi zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar, sipas gjykimit të pedagogut dhe miratimit të departamentit dhe është pjesë e pandarë e programit të modulit dhe planit mësimor të departamentit.
- c. Kolokiumi është formë e kontrollit të përvetësimit të modulit që përfundon brenda periudhës së mësimit. Kolokiumi mund të përsëritet brenda javës pasardhëse.

- d. Studentit i lind e drejta e futjes në provim/kolokium, kur shlyerja e detyrimeve konfirmohet nga pedagogu/ët në Pasqyrën e Rezultateve të Detyrimeve dhe Provimit, duke pasqyruar këtu edhe shumën e pikëve të fituara gjatë zhvillimit të procesit mësimor.
- e. Kontrolli i dijeve për modulin përkatës realizohet në dy faza:
- f. Kontrolli i fazës së parë përfshin kontrollin gjatë procesit mësimor, ku kontrolli i dijeve realizohet përmes pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentit në leksione, seminare, ushtrime, punët laboratorike, detyrat me shkrim (provime ndërmjetëse), detyrat e kursit, projektet e kursit, praktikën mësimore etj.
- g. Pavarësisht sasisë së pikëve të realizuara, studenti që ka munguar apo është vlerësuar negativisht në detyrat e kursit, projekte kursi, apo në praktikën mësimore, është i detyruar t'i shlyejë ato në javën e fundit të zhvillimit të procesit mësimor. Nëse vlerësohet negativisht, ai humbet të drejtën e hyrjes në provim.
- h. Kontrolli i fazës së dytë përfshin kontrollin nëpërmjet provimit përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar përfshin rezultatin e arritur nga studentit gjatë vitit si dhe rezultatin në provimin përfundimtar.

Kushtet për hyrjen në provim dhe kontrolli i dijeve

- a. Studentit i lind e drejta e hyrjes në provim mbasi pedagogu i lëndës ia ka komunikuar atij këtë të drejtë në orën e fundit të mësimit.
- b. Emrat e studentëve që kanë fituar të drejtën për të hyrë në provimin e lëndës pasqyrohen në Pasqyrën e Rezultateve të Detyrimeve dhe Provimit.

Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi i studentëve

- a. Mënyrat e kontrollit të dijës (provim/kolokium) përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve.
- b. Provimi është formë e kontrollit të dijeve që duhet të përfundojë brenda afateve të parashikuara. Provimi mund të zhvillohet: me shkrim, me gojë ose i kombinuar (me shkrim e me gojë). Departamenti përcakton nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.
- c. Kolokiumi është formë e kontrollit të përvetësimit të modulit që përfundon brenda periudhës së mësimit. Kolokiumi mund të përsëritet brenda javës pasardhëse.

- d. Provimi/kolokiumi zhvillohet nëpërmjet tezave të provimit, të cilat hartohen nga titullari/pedagogu i modulit së bashku me asistentin e tij (nëse ka) dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit.
- e. Për çdo provim hartohen teza alternative dhe zgjedhja e tezës, që u jepet studentëve, si rregull bëhet në prani të përgjegjësit të grupit mësimor kërkimor.
- f. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet ndërrimi i tezës.
- g. Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve, pranë çdo Fakultetit ngrihet Komisioni i Provimeve të Fakultetit.

1.6 Qëllimi dhe profili i programit

Të përgatitë specialistë me formim të thelluar teorik dhe profesional, të aftë të mirë-orientohen në fushat e agrobiznesit, të njohin aspektet menaxheriale dhe kuadrin rregullator të sektorit të Agrobiznesit. Është një fushë studimi (*brenda Fakultetit të Shkencave të Jetës*) ende e pa elaboruar nga ana jonë deri tani dhe sipas vëzhgimeve tona rezulton se të diplomuarit në këtë program studimesh do të jenë mjaft të kërkuar në tregun e punës.

Programi i studimit të ciklit të parë_Bachelor në “Agrobiznes”, është në dobi dhe në mbështetje të nevojave dhe kërkesave për një lloje diversifikimi të mëtijshëm të diplomave që ofron UPz, në dobi të studentëve që pranojnë në këtë fakultet.

Të diplomuarit në këtë program studimesh do të mund t’i përgjigjen mjaft mirë nevojave të vendit, veçanërisht të zonave rurale dhe sistemit të Agrobiznesit për vënien në efikasitet të burimeve natyrore. Duke marrë formimin e nevojshëm në fushën e menaxhimit të Agrobiznesit, ata (*të diplomuarit*) do të jenë promotorë dhe një potencial mjaft i mirë në dobi të organizimit të bizneseve të reja në sektorin e Agrobiznesit dhe menaxhimit me efikasitet të këtij sektori, por dhe jo vetëm; zhvillimit të qëndrueshëm të zonave rurale; si dhe orientimit të zhvillimit të sipërmarrjeve bujqësore drejt mirëfunksionalitetit të tyre.

Gjithashtu si qëllim është edhe ti aftësoj studentet për të vazhduar studimet e tyre në programin e ciklit të dytë – Master.

1.7 Rezultatet e pritura të mësimin

Deri në fund të kursit, studentët duhet të:

- Përfitojë njohuri për proceset ekonomike dhe të biznesit, mbi implikimet mikroekonomike të tregjeve, mbi parimet bazë mikroekonomike dhe makroekonomike si dhe efektet e tregjeve mbi performancën e bizneseve.

- Fitojë njohuri dhe kompetenca për menaxhimin dhe zhvillimin ekonomik të Agrobiznesit në përgjithësi. Të kuptohet roli shumë i rëndësishëm i marketingut në tregtinë e produkteve bujqësore dhe blektorale.
- Jetë i aftë të trajtojë faktorët që ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë bujqësore, veçoritë e prodhimit bujqësor, format e organizimit të subjekteve prodhuese në bujqësi, llojet dhe strukturën e tregjeve agrare si dhe veçoritë e kërkesës dhe të ofertës bujqësore për produkte e grup-produktesh bujqësore
- Jetë i aftë të përdorë aparatën e kontabilitetit për të bërë të mundur përdorimin e tij në llogaritjen e vlerës kontabile të ndërmarrjeve të agrobiznesit, në përpilimin e bilancit kontabël dhe në llogaritjen e treguesve të performancës së ndërmarrjeve duke u bazuar tek informacioni kontabël.
- Jetë në gjendje të analizoje ndërvarësinë midis dy ose me shume variablaive ekonomike dhe që ndikojnë në performancën e bizneseve, të studioje lidhjen që ekziston midis tyre duke u bazuar në modelime të thjeshta dhe të përbëra, të analizojë lidhje korelative midis variablaive. Studenti duhet gjithashtu të jetë në gjendje të analizoje fenomenet e ndryshme në kohë duke përdorur analizën dinamike të serive kohore, të bëjë prognozime për të ardhmen dhe të studioje efektet stinore.
- Ketë njohuri mbi konceptet kryesore të financës. Të marrë njohuritë bazë të menaxhimit të flukseve financiare të njësisive ekonomike, të jetë në gjendje të vlerësojë riskun në një biznes si dhe të njohë tre komponentët bazë të sistemit financiar.
- Zotërojë njohuri mbi funksionet e marketingut bujqësor, dobisë-shtese, strukturat e tregut dhe institucionet e marketingut të produkteve agro-ushqimore. Gjithashtu studentit duhet të kontribuojë në alternativat e marketingut në vendimmarrje të prodhuesve dhe ndërmjetësve, duhet të japë njohuri të nevojshme për strukturat e tregut, pozicionin e prodhimit dhe çmimeve të tregut.
- Të jetë në gjendje të interpretojë sistemin e agrobiznesit në ekonominë kombëtare të një vendi, si dhe të njohë dhe të vlerësojë tërësinë e faktorëve që kushtëzojnë lindjen dhe zhvillimin e sistemit të agrobiznesit. Në rolin e menaxherit të një firme agrobiznesi, studentit aftësohet në drejtim të procesit të marrjes së vendimeve për të gjitha problemet me të cilat mund të përballet biznesi.
- Ketë njohuri të avancuara, në lidhje me përdorimin specifik të koncepteve, të teorive dhe të metodave nga menaxhimi i burimeve njerëzore. Ai duhet të jetë i aftë të përfshihet në

menaxhimin e resurseve humane, në mënyrën e organizimit të punës deri tek motivimi i punonjësve, vlerësimi dhe shpërblimi i performacës së tyre si dhe siguria në punë.

- Zotërojnë njohuri mbi modelet e organizimit të fermave bujqësore, dhe të njoh rolin e drejtimit (parimet, funksionet dhe fushat e tij) në suksesin e një biznesi bujqësor. Studenti është i aftë tashmë të përdorë parimet ekonomike në identifikimin e niveleve dobiprurës të faktorëve të prodhimit, dhe madhësisë së aktiviteteve të veçanta.
- Jenë të aftë dhe të zotërojnë njohuri teorike dhe teknike për përpilimin, vlerësimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme nga agrobiznesi. Po ashtu studentit bëhet i aftë të njohë dhe të kuptojë funksionimin e tregjeve në kushtet e konkurrencës së pastër dhe asaj jo të pastër përfshirë të gjitha format përkatëse por duke vënë më shumë theksin tek konkurrenca jo e pastër si formë e cila ndeshet më shpesh në praktike.
- Fitojnë njohuri në lidhje me sjelljen konsumatore, kuptojnë përse dhe si konsumatorët marrin vendimet të caktuara dhe si sjelljet e tyre ndryshojnë nën ndikimin e faktorëve të caktuar. Studenti tashmë kupton ndikimin e faktorëve psikologjik të konsumatorit, faktorëve të mjedisit të jashtëm dhe situatave e gjendjes në të cilat mund të ndodhet konsumatori kurdo që vendosë të blejë diçka.
- Duhet të theksohet se studentit është i aftë të kuptojë jo vetëm aktin e blerjes por edhe procesin para dhe pas blerjes, madje edhe se si posedimi ose mungesa e gjërave mund të ndikojnë në sjelljet konsumatore në përgjithësi. Studenti zotëron tashmë modelin më të avancuar për të kuptuar marrjen e vendimeve konsumatore, gjë që shërben si një program për suksesin e bizneseve në ekonominë e tregut dhe në kohën e hiperkonkurrencës.
- Përfitojnë njohuri dhe kompetenca bashkëkohore në fushat e menaxhimit të organizatave private dhe publike. Këtu përfshihen njohuri të domosdoshme mbi konceptin e menaxhimit dhe rolin e tij në shoqëri, identifikimin dhe sqarimin e funksioneve bazë menaxheriale (planifikim, organizim, udhëheqje & motivim dhe kontroll). Rëndësi e veçantë i kushtohet aspekteve teorike praktike të liderit dhe sjelljes menaxheriale si dhe identifikimit të faktorëve të mjedisit menaxherial.
- Zotërojnë informacion në lidhje me shumë skema mbështetëse të përdorura gjerësisht për politikën bujqësore dhe veçanërisht Politikave të Përgjithshme Bujqësore (PPB) të BE-së në mënyrë të qartë dhe të qëndrueshme. Efektet e PPB dhe politikave të ndryshme tregtare në çmimet e brendshme dhe ndërkombëtare, konsumit, prodhimit, dhe të ardhurat e tregtisë dhe të qeverisë do të shqyrtohet.

1.8 Raporti në mes të pjesës teorike dhe asaj praktike

Në secilën nga lëndët e përshkruara nga planprogram gjendet edhe raporti në mes të pjesës teorike dhe asaj praktike. Në përgjithësi raportet variojnë sipas kohës që i duhet studentit për të absorbuar njohuritë në lëndë të caktuara. Lëndët ekzakte dhe që implikojnë calculus kanë një raport nga 3:2 deri në 4:2, ndërsa lëndët e tjera të menaxhimit kanë raporte që variojnë nga 2:2 në 2:1.

1.9 Llogaritja e ECTS-ve

Programi i studimeve në drejtimin e Agrobiznesit është me kohë të plotë. Programi i studimeve është 3 vite (180 ECTS) i ndarë në 6 semestra (1 semester ka 30 ECTS). Të gjitha lëndët janë të ngarkuara me vlerën e ECTS, dhe se një (1) ECTS është e barabartë me (20) njëzet deri në tridhjetë (30) orë mësimi. Ato janë llogaritur sipas shembullit të tabelës si më poshtë:

Vëllimi dhe sasia e nevojshme e punës: Numri i kredive

Aktiviteti	Ore	Jave	Gjithsej
Ligjerata	3	15	45
Ushtrime	2	15	30
Kontakte me mësimdhënësin/kons.	1	15	15
Kolokviume	1	5	5
Detyra shtëpie	1	13	13
Koha e studimit vetanak e studentit	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	3	6
Projekte etj.	3	1	3
Gjithësej ngarkesa			152 orë

1.10 Praktike profesionale– intership

Përmes koordinorit për mësim ose prodekanit për mësim synohet për punë praktike në industrinë ushqimore apo fushat relevante. Qëllimi kryesor i yni është që t'ju mundësojmë

studentëve vizita studimore në universitet partnere e sidomos në Universitetin Bujqësor të Tiranës meqë edhe kemi marrëveshje bashkëpunimi me këto universitete për këtë profil studimor (shih marrëveshjet në Anex dokument- Nr. Prot. 1016 datë 20/06/2013). Gjithashtu studentët do të kenë mundësi për vizita studimore praktike edhe në ferma bujqësore, ndërmarrje që ofrojnë inpuite për fermën bujqësore, ndërmarrje të përpunimit të produkteve bujqësore dhe blektorale, agjensi publike që merren me ofrimin e informacionit për fermat bujqësore dhe Agrobizneset e përpunimit, ente publike që kanë në fokus ndihmën dhe zhvillimin e bizneseve bujqësore, Ministri apo institucione relevante.

1.11 Plani i kërkimit në kuadër të programit

Për këtë program, plani i kërkimit do të orientohet në drejtimet e mëposhtme.

- a. Mirëmenaxhimi me efikasitet i inpuiteve dhe outputeve në bujqësi.

Bazuar mbi parimet neoklasike mikroekonomike kërkimi do të fokusohet në efikasitetin e përdorimit të inpuiteve bujqësore, optimizimin e përdorimit të këtyre faktorëve, në optimizimin e të ardhurave të marra nga përdorimi i një sasive të kufizuar faktorësh në dispozicion. Po ashtu në përcaktimin e sasive optimale të prodhimit në Agrobizneset e të gjitha llojeve.

- b. Strategjitë dhe politikat e menaxhimit të agrobiznesit.

Aspekte bashkëkohore të menaxhimit si shkencë, faktorët që ndikojnë në performancën e menaxhimit dhe natyra e tyre. Matja e peshës së këtyre faktorëve në performancën e menaxherit. Kërkime mbi trendet moderne të metodave të menaxhimit (Lean Management), personaliteti i menaxherit, performanca financiare dhe ajo jo-financiara dhe matja quantitative e tyre.

- c. Politikat dhe metodat bashkëkohore të integrimit të fermerëve në tregje.

Në kuadër të kësaj pike kërkimi do të fokusohet në mënyrat që mundësojnë rritjen e pjesës që merr fermeri për çdo 1 euro që paguan konsumatori i fundit për ushqim. Modelet bashkëkohore të integrimit të fermerëve në tregje. A është i rëndësishëm roli i kontratave në sistemin e Agrobiznesit për të mundësuar integrimin e fermerëve në tregje. A është bashkëpunimi midis fermerëve por edhe midis aktorëve të tjerë në sistemin e Agrobiznesit një mënyrë e mirë për integrimin e tyre në tregje.

- d. Probleme të menaxhimit & marketingut në zinxhirin e vlerës

Aktorët në zinxhirin e vlerës dhe roli i secilës tipologji aktorësh në këtë zinxhir. Mirëfunksionimi i këtij zinxhiri dhe lidhshirësi në zinxhir. Pikëpamja e prodhuesit dhe

konsumatori mbi zinxhirin dhe të kuptuarit e tyre mbi outcome-in që jep ky zinxhir. Rekomandime në lidhje me atë se cili duhet të mbajë pozicionin e lidhshëm në zinxhir dhe përfitimet reciproke, p.sh në klasterin i qumështit apo atë të mishit!

- e. Strategjitë dhe politikat e financimit të sipërmarrjeve private në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të tyre.

Kërkimi do të fokusohet në identifikimin e një tipologjie agrobiznesi me potenciale për zhvillim të shpejtë, si dhe që krijon premisa pozitive për transmetimin e efektit pozitiv në gjithë sistemin e agrobiznesit, pra edhe tek ferma. Rekomandime për institucionet financiare kredihënëse në fushën e agrobiznesit për financimin e agrobizneseve. Kërkime mbi vlerësimin e indikatorëve financiarë të ndërmarrjeve dhe përcaktimin e mundësive të tyre për marrjen dhe shlyerjen e kredive. Modele për agrobizneset se kur duhet të financojnë një investim me kapitalin e vet dhe kur me borxh.

Në të ardhmen pritet që në bashkëpunim me mësimdhënësit me punimet e tyre të marrin pjesë në konferenca të ndryshme dhe të botohen nëpër revistat shkencore kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Mësimdhënësit e këtij programi, në formë individuale zhvillojnë hulumtime të ndryshme shkencore nga fushat e tyre studimore. Këto kërkime kryesisht synojnë arritjen dhe prezantimin e rezultateve shkencore nga fushat e studimit të tyre të cilat kohë pas kohe prezantohen në konferenca dhe takime tjera shkencore në vend dhe jashtë vendit.

1.12 Kushtet e regjistrimit dhe të pranimit të studentëve

Numri i studentëve të cilët pritet të regjistrohen në vitin e parë është 50, studentët do të regjistrohen në studime të rregullta.

Në vitin e parë të studimeve mund të regjistrohen të gjithë kandidatët të cilët kanë kryer Shkollat e Mesme të Larta (Gjimnaze apo shkolla profesionale), kanë dhënë provimin e maturës dhe kalojnë testin provues nga njohuritë e shkencave natyrore dhe të njohurive elementare matematikore. Pranimi i kandidatëve bëhet nga lista e formuluar nga numri i poenëve të kandidatëve.

Në këtë program, sikurse edhe në programet tjera të universitetit, pranohen kandidatë nga e gjithë Kosova, nga Shqipëria, Mali i Zi etj. Kandidatët nga viset jashtë Kosovës para konkurimit bëjnë nostrifikimin e shkollimit të tyre të realizuar jashtë Kosovës.

Titulli i Gradës akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar
Studimet në këtë program janë të nivelit BA (3 vjeçare), me gjithsejt 6 semestra nga 30 ECTS secili prej tyre, gjithsejt 180 ECTS.

Pas përfundimit me sukses të studimeve, kandidati merr titullin: *Baçellor i Shkencave në Agrobiznes*.

1.13 Pasqyra e programit

Programi: Agrobiznes – Niveli Bachelor (Bsc)

Viti Parë						
Semestri I			Orë/javë			
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Matematikë	4	2	8	Prof. Dr. Abdullah Zejanullahu
2.	O	Prodhim Bimor	3	2	6	Prof. Ass. Dr. Isuf Lushi
3.	O	Ekonomiks	3	2	7	Prof. Ass. Dr. Gani Gjini
4.	O	Sociologji Rurale	2	2	5	Prof. Asoc. Dr. Agim Muça
5.	O	Gjuhë Angleze I	2	2	4	Dr. Jusuf Mustafa
					30	
Semestri II			Orë/javë			
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Bazat e Marketingut	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Hysni Terziu
2.	O	Prodhim Shtazor	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Hysen Bytyqi
3.	O	Ekonomia Bujqësore	3	2	6	Prof. Dr. Stilian Apostoli
4.	O	Bazat e Statistikës	2	2	6	Prof. Asoc. Dr. Ana Mane
5.	O	Gjuhë Angleze II	2	2	4	Dr. Jusuf Mustafa
6.	Z	Lëndë zgjedhore			3	
					30	
Viti Dytë						
Semestri III						
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Kontabilitet	3	2	7	Prof. Dr. Sejdi Rexhepi
2.	O	Statistikë Biznesi	2	2	6	Prof. Asoc. Dr. Ana Mane
3.	O	E drejta në Biznes	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Muharrem Faiku
4.	O	Informatikë në Agrobiznes	2	2	5	Prof. Asoc. Dr. Ilir Kapaj
5.	O	Hortikulturë	3	2	7	Prof. Ass. Dr. Isuf Lushi
					30	
Semestri IV						
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Bazat e Financave	2	2	5	Prof. Dr. Drini Salko
2.	O	Marketing Agroushqimor	2	2	6	Prof. Ass. Dr. Isuf Lushi
3.	O	Menaxhim Agrobiznesi	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Ilir Kapaj
4.	O	Menaxhimi i burimeve Njerëzore	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Hamdi Hoti
5.	O	Komunikim Biznesi	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Drita Krasniqi
6.	Z	Lëndë zgjedhore			3	
					30	
Viti Tretë						
Semestri V						
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECT	

					S	
1.	O	Menaxhimi Financiar	3	2	6	Prof. Dr. Drini Salko
2.	O	Menaxhimi i Fermave	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Maksim Meço
3.	O	Projekte në Agrobiznes	3	2	5	Prof. Ass. Dr. Shukri Maxhuni
4.	O	Çmimet dhe tregjet e produkteve Bujqësore	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Ledia Boshnjaku
5.	O	Teknologji e prodhimit dhe përpunimit të produkteve Bujqësore	3	2	7	Prof. Ass. Dr. Isuf Lushi
					30	
Semestri VI						
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	
1.	O	Sjellja Konsumatore	2	2	5	Prof. Asoc. Dr. Eda Deçi
2.	O	Mjediset e Mbrojtura	3	2	6	Prof. Ass. Dr. Isuf Lushi
3.	O	Prodhimtaria Organike	2	2	5	Prof. Asoc. Dr. Sali Aliu
4.	O	Zhvillimi Rural	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Hysen Bytyqi
5.	Z	Praktika Profesionale			3	
6.	O	B.Sc. Teza			5	
					30	
Lëndët zgjedhore			Orë/javë			
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	
1.	Z	Administrim Biznesi	2	1	3	Dr. Drita Krasniqi
2.	Z	Biznes ndërkombëtar	2	1	3	Prof. Ass. Dr. Halil Kukaj
3.	Z	BE dhe Politikat e përbashkëta Bujqësore	2	1	3	Prof. Asoc. Dr. Hysen Bytyqi
4.	Z	Administrim Publik	2	1	3	Prof. Asoc. Dr. Remzi Keco
5.	Z	Mbrojtja e bimëve	3	1	3	Prof. Ass. Dr. Fadil Musa
6.	Z	Teknologjia e pasvjeljes	2	1	3	Prof. Asoc. Dr. Sali Aliu
7.	Z	Logjistikë e Avancuar në Agrobiznes	2	1	3	Prof. Asoc. Dr. Ilir Kapaj
8.	Z	Parandalimi i sëmundjeve të shtazëve	2	1	3	Prof. Ass. Dr. Avni Robaj
9.	Z	Bimët aromatike dhe mjekësore dhe menaxhimi i tyre	2	1	3	Prof. Ass. Dr. Bekim Gashi
10.	Z	Vreshtari dhe Enologji	2	1	3	Prof. Asoc. Dr. Bedri Dragusha
11.	Z	Menaxhim Agroturizmi	2	1	3	Prof. Asoc. Dr. Edmond Kadiu

Shkurtesat:

L – Ligjerata; O – Obligative; Z – Zgjedhore

1.14 Përshkrimi i moduleve

Lënda: Matematikë

Përshkrimi i lëndës: Bashkësitë. Vlera absolute. Vargu numerik, limiti i tij. Funkzioni, limiti, vazhdueshmëria, funksionet p.m.v dhe p.m.m. Derivati, derivatet e pjesëshme. Ekstremumet e funksionit me një dhe me dy variabla. Ekstremumet e kushtëzuara. Zbatime në Ekonomi. Diferenciali, kuptimi gjeometrik, zbatime të tij në llogaritjet e përafërta. Metoda e katrorëve më të vegjël. Integrali i pacaktuar, Integrali i caktuar dhe zbatime të tij. Seritë numerike, seritë polinomiale. Ekuacione diferencialë . Disa tipe ekuacionesh diferencialë te rendit të parë.

Elementë të Teorisë së Probabilitetit e Statistikës Matematike

Ngarjet e rastit, përkufizimi i probabilitetit të një ngjarje. Variablat e rastit diskrete e të vazhdueshem. Karakteristikat numerike të variablave të rastit pritja matematike, dispersioni etj. Shpërndarjet e variablave të rastit. Zgjedhja . Karakteristikat e zgjedhjes.

Vlerësimi pikësor dhe intervalor i pritjes matematike , dispersionit dhe i probabilitetit të një ngjarje. Verifikimi i hipotezave statistikore. Regresi linear.

Qëllimi i lëndës: Të pajisën studentët me konceptet dhe metodat bazë të matematikës që janë të domosdoshme për përvehtësimin e moduleve të specialitetit, si dhe të aftësohen ata për aplikimin e modeleve matematike në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në fushat përkatëse. Gjithashtu të jepen principet e teknikat fundamentale te Teorisë së Probabilitetit e Statistikës Matematike.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të:

- Të pajis studentët me konceptet dhe metodat bazë matematikës.
- Përvetësimin e lendeve të specialitetit si dhe zbatimin e metodave matematikore për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në fushën e Agrobiznesit.
- Matematika është bërë gjuha analitike e ekonomistëve të sotëm.
- Qëllimi i këtij moduli është të pajisë studentët e ekonomisë me konceptet bazë matematikë për të lexuar dhe kuptuar literaturën e sotme ekonomike.
- Aftësi matematike për të punuar me modele ekonomike më të sofistikuara dhe realiste.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike në laborator dhe terren, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokviume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Vlerësimi i dytë (kolokvium): 15%, Ushtrimet në laborator dhe terren: 10%, Provimi final: 60%. Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 3:2 (3+2 orë).

Literatura:

- Rrapo, Tabaku, Matematika e lartë dhe e Aplikuar, 1986
- Mitre, Stringa. Etj, Matematika I (ribotim) 2004
- Ruseti, Shundi, Leka, Ushtrime të Matematikës (ribotim) 2004
- Rrapo, Memetaj, Belegu , Probabilitet dhe Statistikë. 2006
- Rrapo, Belegu, Matematika , Tekst për studentët e Fakultetit të Ekonomisë dhe të Agrobiznesit. 2009.
- Mitre, Stringa etj, Matematika I (ribotim), 2004. Tiranë.
- Rrapo, Memetaj, Belegu, Probabilitet dhe Statistikë, 2006.
- Fundamental Methods of Mathematical Economics Alpha C. Chiang

- Mathematics for Economists, Carl P.Simo.

Lënda: Prodhimi Bimor

Përshkrimi i lëndës: Pjesa e parë përfshin njohuritë mbi tokën të cilat përfshijnë Cilësitë fizike dhe fiziko – mekanike, Kimike dhe Fiziko – Kimike të tokës, Ujin Tokësor, Lëndën Organike e tokës etj. Pjesa e dytë shpjegon në mënyrë të thjeshtuar bazat fiziologjike të prodhimit bimor marrja dhe shndërrimi i energjisë dhe elementëve ushqyes, si dhe ligjësitë e rritjes dhe zhvillimit të bimëve. Pjesa e tretë e modulit trajton ndikimin e faktorëve klimatikë në rritjen e zhvillimin e bimëve. Në këtë kapitull shpjegohen në mënyrë të ndarë ndikimi i temperaturës, lagështirës ndriçimit dhe CO₂. në rritjen e zhvillimin e bimëve. Pjesa e katërt dhe më e rëndësishme e modulit i dedikohet përshkrimit të teknologjisë së kultivimit të bimëve. Ndërhyrjet dhe vendimmarrjet e njeriut gjatë kultivimit të bimëve shpjegohen si përpjekje për të përputhur sa më mirë kërkesat e bimëve për faktorë të ndryshëm klimatiko-tokësorë dhe karakteristikat e klimës dhe tokës në zona të ndryshme.

Qëllimet e lëndës Objektivi kryesor i kësaj lënde është ngritjen e njohurive të studenteve lidhur me zhvillimin e një kuptim bazë të rolit të bimëve në bujqësi që t'u ofrojë njohuri mbi funksionet e prodhimit të bimëve, kushtet klimatiko-tokësore, rendimentet, cilësinë e prodhimit dhe qendrueshmëri. Do të kontribuoj në alternativat e prodhimit në vendimmarrje të prodhuesve dhe ndërmjetësve. Te japë njohuri të nevojshme për strukturat e tregut, pozicionin e prodhimit dhe çmimeve të tregut: po kështu dhe të përpunuesve: për fuqinë e firmave në treg e në lidhje marrëveshesh për shit-blerje. Për më tepër, ky kurs ka për qëllim që të ndihmojë studentët të kuptojnë shtrirjen e gjerë të disiplinave dhe mundësive që ekzistojnë në industrinë e bimëve dhe kontributin e tyre ndaj njeriut.

Rezultatet e pritura të nxënies:

- Studenti duhet të njohë karakteristikat e tokës, karakteristikat morfologjike dhe fiziologjike të bimës dhe faktorët klimatikë që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e bimëve.
- Definojnë kuptimin bazë të koncepteve dhe parimeve të shkencës së bimëve;
- Studenti të njohë cilat janë faktorët që ndikojnë në vendimmarrjet gjatë prodhimit të bimëve kryesore dhe si ndikojnë ato në kultivim.
- Studenti të njohë hallkat kryesore të teknologjisë së prodhimit të bimëve dhe parametrat bazë të kultivimit të bimëve kryesore.
- Studenti të jetë i aftë në interpretimin dhe analizën e kushteve të ndryshme tokësore dhe klimatike dhe të dijë të marrë vendime për prodhimin e bimëve në raport me këto kushte.
- Studenti të jetë i aftë në interpretimin dhe analizën e kushteve të ndryshme tokësore dhe klimatike dhe të dijë të marrë vendime për kultivimin e bimëve kryesore në raport me këto kushte.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, ekspedita , konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokfiume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- Bazat e Prodhimit Bimor Rroço E. Kristo I. 2006. Tiranë.
- Bazat e Prodhimit Bimor, Kristo I. Sallaku, F. 2010. Tiranë.
- Agronomia e Përgjithshme, Hariyaj, P. 2009. Tiranë.
- Shkenca e Tokës – Analiza laboratorike & Ushtrime. Kristo, I., F. Sallaku. S. Shallari.
- Coltivazioni erbacee da pieno campo, Bonciarelli F. 1992
- Agronomia Generale Bonciarelli F. 1992
- Pflanzenbau, biologische Grundlagen und Technik der Production. Geisler, 1988
- Fundamentals of Soils Gerrard, J. 2000
- Tokat e Shqiperise Gjoka, F., K. Cara. 2003
- Uji në Kontinuitetin Tokë-Bimë-Atmosferë Gjongecaj B. 1998
- Plant Physiology. Third Edition, Taiz L.; L. Zeiger 2002 “.

Lënda: Ekonomiks

Përshkrimi i lëndës: Nga kjo lëndë studentët do të marrin njohuri të përgjithshme për ecurite ekonomike dhe biznesi . Ne kuader te kesaj lende do te përfshinë të gjitha politikat dhe kategorit ekonomike që janë aktuale për ekonomin bashkëkohore . Përmbajtja e lëndës është e tillë që studenteve do te ju sjellë njohuri të mjaftueshme per proceset ekonomike dhe te biznesit .

Qëllimet e lëndës: Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri më të përafërta per proceset ekonomike dhe biznesore . Në këtë kontekst vlen të theksohet se lënda studenteve u sjellë njohuri të mjaftueshme dhe më bashkëkohore nga lëmia e ekonomis se pergjithshme me formë interaktive, studentët zgjerojnë dhe plotësojnë njohurite tyre nga fushveprimi i ekonomis dhe biznesit

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:

- Duke parë parasysh programin e lëndës me fjalë , mund të thuhet se studenti do të fitojë njohuri të mjaftueshme rreth proceseve të Biznesit .
- Me përvetësimin e materjes së kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të i sintetizojnë njohurit e tyre rreth ekonomis bazike
- Me njohurit e fituara nga lënda hyrja ne ekonomi te biznesit studentët do të ndihen profesionalisht të pregaditur për problemet ekonomike dhe biznesi bashkëkohor.
- Zgjedhjes se shportes me te mire dhe orientimi i tregut për produktet në studim.
- Teorin e prodhimit funksionet e prodhimitsipas afateve kohore etj.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ekspedita konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuime, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- Gaspar, Bierman, Kalari, Hise, Smith, Arreola – Risa : Hyrje në Biznes Tiranë, 2007

- 2. Gani Gjini : Tregtia e Jashtme si faktor i zhvillimit ekonomik të Kosoves . Prizren, 2005.
- 3. Musa Limani : Hyrje në Ekonomi Prishtine, 2002.
- 4. Ahmet Mançellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici : Hyrje në ekonomi, Pegi, Tiranë, 2007 .
- 5.N.Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor: Ekonomiksi Mikroekonomia UET Press.2012.
- 6.N.Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor: Ekonomiksi Makroekonomia UET Press,2012.

Lënda: Sociologji rurale

Përshkrimi i lëndës: Lindja dhe zhvillimi i sociologjisë. Raporti i sociologjisë me shkencat tjera shoqërore. Metodatat shkencore në sociologji. Nocione të përgjithshme mbi bashkësinë dhe familjen rurale. Karakteristikat themelore të fermave rurale. Vështrim sociologjik mbi vendbanimet rurale. Aspekti sociologjik i marrëdhënieve të fermerit me shoqërinë. Çështje të përgjithshme midis sociologjisë rurale me marrëdhëniet pronësore. Mentaliteti i ekonomisë së tregut dhe prodhimi bujqësor. Kooperimi në ekonominë bujqësore - në kushtet e ekonomisë së tregut. Veçoritë kryesore të jetës fizike të popullsisë. Kultura dhe arsimiti – si forma të civilizimit njerëzor në zonat rurale. Shtresat shoqërore, lëvizjet sociale dhe migracioni si formë i lëvizjeve sociale. Procese të zhvillimit ekonomik dhe social në zonat rurale të Shqipërisë dhe Kosovës.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t’u ofrojë njohuri themelore dhe qasje bashkëkohore mbi kategoritë themelore të sociologjisë në përgjithësi dhe asaj rurale në veçanti. Të kuptojnë rrjedhat e gjithëmbarshme të zhvillimit shoqëror, politik dhe demokratik të shoqërisë bashkëkohore, si dhe të zhvillojnë ndjenjën e tolerancës dhe të respektimit të mendimit të tjerëve në kuptimin e proceseve dhe fenomeneve të ndryshme shoqërore.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit me sukses të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje:

- Të fitojnë njohuri shkencore mbi sociologjinë rurale si shkencë mbi shoqërinë rurale dhe kushtet apo rrethanat historike të lindjes së saj, të jenë në gjendje që t’i kuptojnë rregullat e jetës në bashkësinë rurale, tipet e komunitetit rural si dhe raportet e tyre në bashkësinë rurale,
- Të kuptojnë dhe të dinë më shumë për rëndësinë dhe interesin e bashkëveprimit të njerëzve në vendbanimet rurale si dhe disa çështje aktuale lidhur me lindjen e vendbanimeve të reja,
- Të kuptojnë rëndësinë dhe mentalitetin e ekonomisë së tregut dhe prodhimit bujqësor dhe ndihmën e shtetit ndaj faktorit njerëzor në zonat rurale si dhe ndikimin e faktorëve natyrorë, socialë, ekonomikë dhe psikologjikë në jetën fizike të popullsisë rurale,
- Të jenë në gjendje t’i kuptojnë më drejtë çështjet që kanë të bëjnë me shtresat sociale, me lëvizjet sociale dhe migracionin si formë e lëvizjeve sociale – me mobilitetin dhe eksodin rural e para së gjithash, me shkaqet e eksodit rural në botë, etj.

Metodologjia e mësimdhënies: ligjërata, diskutime, punime seminarike, ekspedita, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokiume, provime etj.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (Kolokiumi) 20% , Vijimi i rregullt: 10%, Seminaret dhe angazhime tjera 10%, Provimi final:60%, Total:100%.

Mjetet e konkretizimit: Kompjuteri, projektori, tabela etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit : është 2 + 2 = 4 orë.

Literatura:

- **Antonny Gidenns**, Sociologjia, Shtëpia Botuese Çabej, Tiranë, 2001.
- **Artan Fuga**, Sociologjia, Libri universitar, Tiranë, 2004.
- **Agim Muçaj**. Sociologjia rurale dhe urbane, UBT, Tiranë, 2008
- **Fehmi Agani**, Në rrjedha të mendimit sociologjik, Rilindja, Prishtinë,1990.
- **Lekë Sokoli**, Sociologjia, “Elio” , Tiranë, 2008.
- **Luljeta Mayniku / Elidiana Cakaj**, Sociologjia rurale, UBT, Tiranë, 2008.

Lënda: Gjuhë Angleze I

Përshkrimi i lëndës: Lënda përqëndrohet në katër aspekte kryesore të gjuhës siç janë: Topics; Language; Vocabulary/Pronunciation dhe Skills Work ku mes tjerash do të përfshihen edhe titujt (Meeting People, Telephoning, Companies, Exchanging Information, Reporting, Socializing, Meeting, Making Arrangements, Describing Trends, Progress Updates, Planning, Comparing Information, Business travel, Company Visit Tackling Problems) si dhe njësitë gramatikore që korespondojnë me këtë nivel.

Qëllimet e lëndës Qëllimi i kësaj lënde është që ti ndihmojë studentët me njohuritë e nevojshme nga lëmia Biznesit me qëllim të përvetësimit dhe përdorimit aktiv të njohurive themelore teorike dhe praktike të gjuhës angleze në fushën e Biznesit. Po ashtu studentëve do të ju mundësohet që të përvetësojnë njohuritë e nevojshme për komunikim në nivel të kënaqshëm në gjuhën angleze, të jenë në gjendje që të kuptojnë dhe të shprehin mendimet e tyre themelore si dhe të krijojnë bazë të nevojshme për avancimin e njohurive të tyre në lëminë e terminologjisë biznese si dhe për të ecur në nivele më të larta të mësimi dhe komunikimit në gjuhën angleze. Pas përfundimit të semestrit, studentët duhet të jenë në gjendje që të kuptojnë dhe të përdorin shprehje dhe terminologji të zakonshme ekonomike e biznese me qëllim të përvetësimit të materialit të paraparë me plan-program si dhe të plotësojnë të nevojave të tyre konkrete.

Rezultatet e pritura të nxënies:

- Pas përfundimit të semestrit, studentët duhet të jenë në gjendje që të kuptojnë dhe të përdorin shprehje dhe terminologji të zakonshme ekonomike e biznese,
- Përvetësimit të materialit të paraparë me plan-program si dhe të plotësojnë të nevojave të tyre konkrete.
- Prania e patjetërsueshme e studentëve në ligjëratat dhe ushtrime, të bëjnë detyrat gjatë ushtrimeve në klasë, kryerja në kohë e detyrave të shtëpisë, realizimi i i dy kollokfiumeve (një në mes dhe një në fund të semestrit),
- Pjesëmarrja në grupe pune, përdorimi i literaturës së obliguar dhe leximi i teksteve plotësuese, aktiviteti i vazhdueshëm gjatë ushtrimeve dhe prezantimit gojor etj.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, diskutime, ushtrime, ekspedita , konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokfiume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1:1 (2+2 orë).

Literatura:

- BUSINESS OBJECTIVES Student`s Book – Vicki Hollet New Edition- Oxford- Oxford University Press
- BUSINESS OBJECTIVES Work Book – Vicki Hollet and Michael Duckworth New Edition- Oxford- Oxford University Press. A Modern English Dictionary, Fjalori dygjuhësor Anglisht/Shqip i terminologjisë ekonomike , Fjalori Anglisht-Shqip- Anglisht kasete, CD, gazeta etj.

Lënda: Bazat e Marketingut

Përshkrimi i lëndës: Njohje me lëndën, konceptet dhe përkufizimet e marketingut. Objektivat e studimit të marketingut. Parimet kryesore dhe parimet tjera të marketingut. Procesi, aktivitetet, detyrat dhe aksionet e marketingut. Funkcionet dhe drejtimi në parimet e marketingut mikro dhe makro. Koncepti dhe instrumentet e marketingut miks dhe marketingut integral. Metodatat e kërkimeve të parimeve të marketingut dhe shfrytëzimi i tyre në marketing. Plani i kërkimeve të marketingut dhe zbatimi i rezultateve kërkimore. Organizimi i kërkimeve dhe roli i marketingut në satisfacionin e nevojave dhe kërkesave të konsumatorëve. Ndikimi i makromjedisit dhe faktorët që ndikojnë në sjelljen e konsumatorëve, si dhe faktorët e mbrendshëm të ndërmarrjes që ndikojnë në sjelljen e konsumatorëve. Metodatat e kërkimeve të sjelljeve të konsumatorëve. Teknikat e modelimit për formimin e strategjive të marketingut, modeli i shitjeve dhe fitimit, analiza “Kostoja-vëllimi- fitimi (KVF), aplikime të modelev matematikore për ndërmarrjen. Linja e produktit, cesh-floë (qarkullimi), vlera në kohë të paras, vlersimi financiar, vlersimi i strategjive të tregut dhe marrja parasysh e reskut dhe e pa siguris. Matrica e pozicionimit të produktit dhe modeli i vlersimit të performancës marketing. Disa paraqitje të tjera të modelimit dhe të strategjive të marketingut

Qëllimet e lëndës Qëllimi i programit të lëndës është fitimi i njohurive dhe shkathtësive për menaxhimin dhe zhvillimin ekonomik të agrobiznesit në përgjithsi, nga aspekti i marketingut, studentët njihen me metodologjinë e poentimit të efekteve zhvillimore si nga aspekti mikro-ekonomik dhe njiashtu edhe nga aspekti, makro-ekonomik të marketingut. Qëllimi i lëndës Bazat e Marketingut është që të mbizotërohet metodologjia për përgatitjen e programeve ndërmarrëse në ekonomi, në agrobiznes si dhe në shkathtësitë menaxheriale për udhëheqje të marketingut në përgjithsi. Njohuritë, aftësitë teorike dhe mjeshtëritë metodike, studenti do të fitojë gjatë ligjeratave që organizohen duke përdorë metodat bashkohore me: projektor, kompjuter, media etj.

Rezultatet e pritura të nxënies: Studentët do të zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme për një promovim të suksesshëm të marketingut. Ata do të analizojnë aspekte specifike me të cilat do të ballafaqohen gjatë zhvillimit të koncepteve të marketingut në agrobiznes dhe do të fitojnë shkathtësi të nevojshme në menaxhimin e resurseve në mënyrë eficiente në ndërtimin e planeve të marketingut.

- Përmbajtja e lëndës pritet që të ndikojë në nivelin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të studentëve.
- Lenda transmeton te studentet njohuri per konceptet bazë të marketingut në, agrobiznes të tilla si metodat e kërkimit të sjelljeve të konsumatorëve, politikat e

marketingut si dhe ato të menaxhimit të tij, te cilat janë te domosdoshme për aplikime në punën e tyre.

- Dukurit ratregtare të veprimtarive të marketingut shfaqen si nevojë sociale të njerëzve, ndaj domosdoshmeria e studimit të menaxhimit të marrëdhënieve tregtare vjen edhe bëhet me e theksuar për shkak të vetë konceptimit të ri që po merr lenda marketingut, si lëndë shkencore mësimore, që mbart brenda vetes potenciale për tu komercializuar, për shkak se mundeson perceptime shërbimi.
- Studentët priten të aftësohen në zbatimin praktik të koncepteve të lëndës dhe të zhvillojnë sipas këtyre koncepteve dhe kritereve modele të orëve të edukimit intelektual në institucionet akademike universitare dhe shkencore të lëmis gjegjëse.
- Studentët priten të vetëdijsohen dhe ta kuptojnë rëndësinë e zhvillimit me profesionalizëm të mësimin të edukimit fizik dhe profesional për bazat e marketingut në universitete dhe të vlerësojnë njohuritë e fituara nga kjo lëndë.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, ekspedita, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokfiime, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- Prof.dr. Bardhyl Ceku, As.prof.dr. Ilia Kristo, Dr.Arjan Abazi dhe Dr. Artan Duka; Hyrje në Marketing 1998 Tiranë. Prof.Dr. Ali Jakupi “Bazat e marketingut” Prishtinë, 2000. Unniversiteti i Prishtinës Fakulteti Ekonomik.
- Prof.Dr. Bardhyl Ceku, dhe Prof.Dr.Nail Reshidi “Marketingu”Universiteti i Prishtinës, 2006 Fkulteti Ekonomik.
- Philip Kotler and Keven Keler: Maarketig Managment, 2012 Prof.Dr. Nexhmi Rexha, “Marketingu” Prishtinë 1982 Universiteti i Prishtinës Fakulteti Ekonomik.
- Prof.ass.dr. Liliana Elmazi “Strategjia e Marketingut” Tiranë 2002 Universiteti i Tiranës..

Lënda: Prodhim Shtazor

Përshkrimi i lëndës: Kjo lëndë, vënë në theks të veçantë në rolin e kafshëve, si gjedheve, deleve, shpezëve, derrave, dhive etj., për t’i shërbyer njerëzve. Për më tepër, ky kurs ofron bazat themelore shkencore të prodhimit blegtoral, mbarështimit e kafshëve dhe aplikimin e përmirësimit gjenetik në përmirësimin e kafshëve, sistemet e prodhimit dhe tregu, si dhe industrinë e kafshëve në përgjithësi.

Qëllimet e lëndës: Lënda **Prodhim Shtazor** ka për qëllim ngritjen e njohurive të studentet lidhur me zhvillimin e një kuptim bazë të rolit të kafshëve në bujqësi (në Kosovë, rajon, BE dhe me gjere). Programi i kësaj lende do të ndihmojë të organizojë informacionin dhe të sigurojë një kornizë konceptuale për të lehtësuar të kuptuarit e nxënësve dhe zotërim të Shkencave të Kafshëve dhe kontribuojë në përgatitjen e eksperteve në shkencat zooteknike, veterinare, ushqimit dhe prodhimit të ushqimit për të rritur nivelin ekzistues të ulët të prodhimit. Për më tepër, ky kurs ka për qëllim që të ndihmojë studentët të kuptojnë shtrirjen e

gjerë të disiplinave dhe mundësive që ekzistojnë në industrinë e kafshëve dhe kontributin e tyre ndaj njeriut.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:

- Definojnë kuptimin bazë të koncepteve dhe parimeve të shkencës kafshëve;
- Përshkruajnë evolucionin e kafshëve shtëpiake dhe taksonominë e llojeve të kafshëve shtëpiake;
- Shpjegojnë bazat e efektivitetit të shfrytëzimit të energjisë dhe proteina nga produktet bujqësore për llojet specifike dhe sistemet e prodhimit;
- Përshkruajnë bazat biologjike dhe teknologjitë e ndryshme të prodhimit të kafshëve;
- Njohin parimet themelore të seleksionimit në prodhimtarinë e kafshëve.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuime, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, vizite ne ferma dhe njesi përpunuese te prodhimeve shtazore, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- [W. Stephen Damron](#). 2012. Introduction to Animal Science (5th Edition). ISBN-13: 978-0132623896.
- Hysen Bytyqi. 2011. Basic Principles of Livestock Management. LAP LAMBERT Academic Publishing GmbH & Co. KG Address: Dudweiler Landstraße 99 66123 Saarbrücken, Germany.
- Hysen Bytyqi. 2011. Chapter in "Milk Production / Book 2", Chapter 11. "Effect of Environmental Sensitivity in Milk Production under Small-scale and Semi-extensive Conditions in Kosovo". ISBN 979-953-307-695-8.

Lënda: Ekonomi Bujqësore

Përshkrimi i lëndës: Ekonomia Bujqësore në sistemin e shkencave ekonomike, koncepti, objekti dhe metodat që përdoren në sistemin e veprimtarisë prodhuese në bujqësi. Definicioni dhe kriteret e klasifikimit të prodhimit bujqësor, lidhja e tij me degët e tjera të ekonomisë kombëtare. Veçoritë me karakter tekniko-teknologjik dhe organizativo-ekonomik të prodhimit bujqësor. Organograma e subjekteve prodhuese në bujqësi dhe tipare kryesore të tyre. Aftësia prodhuese e sektorit bujqësor dhe faktorët që e kushtëzojnë atë. Teoritë e zhvillimit bujqësor, llojet e sistemeve agrare, faktorët që i kushtëzojnë dhe teoritë e qëndrueshmërisë të sistemeve agrare. Faktorët themelore të prodhimit, klasifikimi, konsumimi dhe amortizimi i tyre. Faktorët natyrore dhe institucional, progresi teknik, efektet e tij. Tregjet agrare, degët e përpunimit, roli i magazinimit, shpërndarja e produkteve. Nevojat dhe të mirat ekonomike, kërkesa konsumatore dhe e tregut, kurbat e Engelit. Oferta bujqësore, faktorët që e kushtëzojnë, veçoritë e kërkesë-ofertës në bujqësi. Tepricat prodhuese e konsumatore, teprica e kërkesës dhe e ofertës.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i Ekonomisë Bujqësore është trajtojë faktorët që ndikojnë në zhvillimin e saj, veçoritë e prodhimit bujqësor, format e organizimit të subjekteve prodhuese

në bujqësi, karakteristikat rurale të saj, zhvillimet në etapa të ndryshme ekonomiko-shoqërore, progresin teknik në bujqësi, llojet dhe strukturën e tregjeve agrare, veçoritë e kërkesës dhe të ofertës bujqësore për produkte e grup-produktesh bujqësore dhe rolin e tyre në zhvillimet bujqësore.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të njohin parimet e Ekonomisë Bujqësore si pjesë e sistemit të shkencave ekonomike
- Të kuptojnë faktorët e prodhimit dhe mënyrën e përdorimit të tyre
- Të kuptojë dhe interpretojë teoritë e zhvillimit bujqësor si edhe faktorët që afektojnë këtë zhvillim, llojet e sistemeve agrare, si dhe parimet e qëndrueshmërisë së këtyre sistemeve.
- Të kuptojnë dhe interpretojnë kërkesën dhe ofertën e produkteve bujqësore si edhe tepicën konsumatore dhe tepicën e prodhuesit.
- Të kuptojë rolin e dhe kontributin e ekonomisë bujqësore në zhvillimin ekonomik të vendit

Metodologjia e mësimdhënies: Leksione, Seminare, Detyrë Kursi, Ese, Provime Ndërmjetëse, & Përfundimtar.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokium): 15%, Seminarët ose angazhime tjera: 15%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Tekste, materiale suplementare, kompjuterë, projektori, tabela, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 3:2

Literatura:

- Christopher Ristan, Agricultural Economics, University of Reading, V.1988
- Calman – Yang, Principles of Agricultural Economics, Manchester, 1993
- Aleksandar Murarcaliev, Ekonomika na Agrarot, Skopje, 1999
- Frenk Ellis, Peasant Economics, Kembrixh, V.1992
- Favareti G.- Economia Agraria, Padova, V.1988
- Economia dell’Azienda Agraria, Bologna, V.1994
- Kajtaç Fazlia, Organizimi i Prodhimtarisë Bujqësore, Prishtinë, V.1997.

Lënda: Bazat e Statistikes

Përshkrimi i lëndës: Statistika dhe zbatimet e saj, grumbullimi i të dhënave, vlefshmëria e të dhënave statistikore. Grupimet statistikore, teknikat e grupimit. Llojet e serive statistikore, llojet e pasqyrave statistikore. Paraqitja grafike e të dhënave statistikore. Raportet statistikore dhe rëndësia e tyre. Analiza e serive të variacionit, treguesit e lokalizimit, treguesit e variacionit, studimi i ligjshmërive të shpërndarjeve statistikore. Analiza e serive vendore, treguesit e shpërndarjes territoriale. Vrojtimi me zgjedhje, vlerësimi pikësor dhe intervalor.

Qëllimet e lëndës: Studenti të jetë në gjendje të identifikojë të dhënat statistikore, të mund ti grupojë, t’i paraqesë dhe t’i përdore ato sipas qëllimit të studimit. Studenti të jetë në gjendje të realizojë një analizë të shpërndarjes mbi bazën e ndryshoreve sasiore e cilësore, kohore e territoriale, duke llogaritur tregues të tillë si mesatarja, moda, mediana, quartilet, dhe tregues të variacionit, dhe të jete në gjendje të beje interpretimet përkatëse.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studenti duhet të jetë në gjendje:

- Studenti të kuptojë tipet e ndryshoreve statistikore dhe menyrat e përdorimit të tyre
- Që në rastin e kryerjes së një sondazhi, studenti të jete në gjendje të përballet me problemet e zgjedhjes përfaqësuese nga popullimi, madhësinë e përshtatshme të zgjedhjes, analizën e saj dhe kryerjes se interpretimeve për popullimin.
- Po ashtu ai duhet të llogarisë dhe interpretojë parametrat nga analiza e serive kohore
- Studenti duhet të jete në gjendje të realizojë një analizë të thjeshtë diskriptive të të dhënave.
- Studenti duhet të jete në gjendje të realizojë një përshkrim grafik të të dhënave në përputhje me tipologjinë e tyre.

Metodologjia e mësimdhënies: Leksione, Seminare, Detyrë Kursi, Provime Ndërmjetëse, & Përfundimtar.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 15%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuter, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 2:2

Literatura:

- “Statistika I”, J. Vathi, A. Mane, I.Pagria, 2008
- “Statistics for business and economics”, H. Kohler, 1989, Amherst College
- “Modern Elementary Statistics”, J.E. Freund, 1998, Prentice- Hall, New Jersey, USA
- “Statistics for Business and Economics”, D. R.Anderson, 2005, 9e South – Wester, Ohio Sweeney, D.J. Williams, T.A
- “Introduction to statistics and econometrics”, Anemija, T. (1994), Londer, Angli.
- “Statistique”, Kauffmann, P. (1994), Dunod, Paris, France.

Lënda: Gjuhë Angleze II

Përshkrimi i lëndës: Java e orientimit, Meeting people, describig jobs, Comuters, Personality profile, Prepositions-jobs. Telephoning : Starting calls, Transferring information, describing what to do, Request. Telephone language: *learn and borow*, spelling the alphabet, telephone numbers: skills Work-Listening: messages. Companies: Company profiles, Facilities, Organizations, Current activities, Company strength, Present Continious and Present Simple Tenses Company Departments: -s endings, Numbers. Listening: A presentation of BICC, Speaking : Exchange Information: Descriptions, Explaining what you need, Size and dimension, Sorting words. Vocabulary/Prounanciation: Sorting and recording new vocabulary, Words with different spelling that sound the same, Skills Work, Speaking: A crossword, Listening:A sales team briefing Reporting: Company history, Saying when, Reporting on a trip, Complaints, Language: Past Simple tense, Vocabulary/Pronunciation: in/on/at and time phrases, -ed verb endings: /d/,/t/,/id/. Skills Work: Reading: Marketing problems, Socializing: Business Lunches, Offers, Interests and routines, Chatting. Language: *some and any*, Expressions of frequency, Polite replies. Countable and uncountable nouns- food. Meetings: Recommending action, Asking for opinions, Making suggestions, Justifying decisions, Problem solving. Language: *Should, Expressing opinions, Going to(future)*.

Listening: Taking notes of decisions at a meeting. Making Arrangements: Dates, Timetables, plans and arrangements. Making appointments, Invitations, Fixing a time. Language: Present Simple and Continuous tenses (future), *Would*. Describing Trends: Rises and falls, Describing changes, graphs, Giving reasons. Language: prepositions-finance, verbs of change, Adjectives and adverbs.

Qëllimet e lëndës Qëllimi i kësaj lënde është që ti ndihmojë studentët me njohuritë e nevojshme nga lëmia Biznesit me qëllim të përvetësimit dhe përdorimit aktiv të njohurive themelore teorike dhe praktike të gjuhës angleze në fushën e Biznesit. Poashtu studentëve do të ju mundësohet që të përvetësojnë njohuritë e nevojshme për komunikim në nivel të kënaqshëm në gjuhën angleze, të jenë në gjendje që të kuptojnë dhe të shprehin mendimet e tyre themelore si dhe të krijojnë bazë të nevojshme për avancimin e njohurive të tyre në lëminë e terminologjisë biznese si dhe për të ecur në nivele më të larta të mësimin dhe komunikimit në gjuhën angleze.

Rezultatet e pritura të nxënies:

- Pas përfundimit të semestrit, studentët duhet të jenë në gjendje që të kuptojnë dhe të përdorin shprehje dhe terminologji të zakonshme ekonomike e biznese
- Përvetësimit të materialit të paraparë me plan-program si dhe të plotësimit të nevojave të tyre konkrete.
- Prania e patjetërsueshme e studentëve në ligjërata dhe ushtrime, të bëjnë detyrat gjatë ushtrimeve në klasë, kryerja në kohë e detyrave të shtëpisë, realizimi i i dy kollokuimeve (një në mes dhe një në fund të semestrit),
- Pjesëmarrja në grupe pune, përdorimi i literaturës së obliguar dhe leximi i teksteve plotësuese, aktiviteti i vazhdueshëm gjatë ushtrimeve dhe prezentimit gojor etj.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, ekspedita , konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokfiume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1:1 (2+2 orë).

Literatura:

- BUSINESS OBJECTIVES Student`s Book – Vicki Hollet New Edition- Oxford- Oxford University Press
- BUSINESS OBJECTIVES Work Book – Vicki Hollet and Michael Duckworth New Edition- Oxford- Oxford University Press.
- A Modern English Dictionary, Fjalori dygjuhësor Anglisht/Shqip i terminologjisë ekonomike , Fjalori Anglisht-Shqip-Anglisht kaseta, CD, gazeta etj

Lënda: Kontabilitet

Përshkrimi i lëndës: Kuptimi i lëndës së Kontabilitetit si teori dhe praktikë. Shkollat e Kontabilitetit. Organizimi i Kontabilitetit dhe sistemet më të përdorshme të tij. Detyrimet ligjore të dokumentacionit bazë. Llogaria dhe elementët e saj. Aktivitet Afatgjatë dhe

kontabiliteti i tyre. Aktivet Afatshkurtra dhe kontabiliteti i tyre. Kapitali dhe Detyrimet, kontabiliteti i tyre. Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve. Bilanci dhe Pasqyrat e tjera financiare. etj.

Qëllimi i lëndës: Ka për qëllim që tu ofrojë studentëve njohuri të nivelit mesatar lidhur me konceptet, rolin, detyrat dhe fushat e vendimmarrjes të drejtuesve të fushës së kontabilitetit.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të:

- Të njohë studentët me konceptet bazë të kontabilitetit dhe rëndësinë e tij në vendimmarrje.
- Të mësojë teorikisht dhe praktikisht teknikat e regjistrimit në llogari nëpërmjet sistemit të regjistrimit të dyfishtë.
- Të realizohet aftësimi teorik dhe praktik i regjistrimit të transaksioneve të ndryshme financiare që lidhen me Aktivet Afatgjata, Aktivet Afatshkurtra.
- Të realizohet aftësimi teorik dhe praktik i regjistrimit të transaksioneve të ndryshme financiare që lidhen me amortizimin, inventarët, etj.
- Të realizoj aftësimin si teorik dhe praktik të studentëve në hartimin e Pasqyrave Financiare dhe Bilanceve Kontabël.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike në laborator dhe terren, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokviume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Vlerësimi i dytë (kolokvium): 15%, Ushtrimet në laborator dhe terren: 10%, Provimi final: 60%. Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 3:2.

Literatura:

- Standardet e Kontabilitetit; botim i vitit 2008.
- Plani Kontabël; botim i vitit 2008.
- Teksti i Kontabilitetit; autor Prof. As. Dr. Agim BINAJ dhe Prof. Dr. Flutura KALEMI; Botim i vitit 2011.
- Ligji për “Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; viti 2008. Leksione – Agim BINAJ (www.agimbinaj.com).

Lënda: Statistike Biznesi

Përshkrimi i lëndës: Kuptimi mbi Analizën e Variacionit, ANEVA 1 faktoriale, ANEVA 2 faktoriale, Lidhjet statistikore dhe funksionale, kuptimi mbi analizën regressive dhe korelative (ARK), ARK e thjeshtë: ARK lineare, vlerësimi dhe interpretimi i modelit të regresionit, testimi i rendësish se koeficientit të regresionit, testimi i rëndësisë së modelit, lidhja e ARK me ANEVA, testimi i rëndësisë së koeficientit të korelacionit, ARK jo-lineare, ARK shumëfaktoriale, vlerësimi dhe interpretimi i modeleve regressive, vlerësimi dhe interpretimi i koeficientit të korelacionit shumëfaktorial, Analiza dinamike mbi bazën e serive kohore, vlerësimi i prirjes themelore duke përdorur: shtesën mesatare, ritmin mesatar, mesataret rrëshqitëse, metoda analitike, sheshimin eksponencial, vlerësimi i komponentit stinor, prognozimi, koovariacioni dhe defazimi, Kuptimi mbi indekset, Indekset individuale, Indekset e përgjithshëm, Indekset agregate, Indekset mesatare, Indekset sipas strukturës, Vetitë e indekseve, Disa indekse të njohur, Vendim-marrja dhe pasiguria, Vlera mesatare e pritshme, Pema e vendim-marrjes, Pasqyra e humbjeve oportune, Vlera e informacionit jo të plote.

Qëllimet e lëndës: Studenti duhet të jetë në gjendje të analizoje skemat dy ose më shumë faktoriale, të analizoje efektin e ndikimit të një ose me shumë faktorësh në skemë, të mund të krahasojë dy ose më shumë grupe të ndryshme duke u bazuar në ANOVA. Studenti të jetë në gjendje të analizoje ndërvarësinë midis dy ose me shumë variabla, të studioje lidhjen që ekziston midis tyre duke u bazuar në modelime të thjeshta dhe të përbëra, të analizojë lidhje korelative midis variabla. Studenti të jetë në gjendje të analizoje fenomenet e ndryshme në kohë duke përdorur analizën dinamike të serive kohore, të bëjë prognozime për të ardhmen dhe të studioje efektet stinore.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi:

- Studentet duhet të jete ne gjendje te realizojne nje analize faktoriale.
- Studenti të jete në gjendje të analizoje ndërvarësinë midis dy ose me shumë variabla, të studioje lidhjen që ekziston midis tyre duke u bazuar në modelime të thjeshta dhe të përbëra, të analizoje lidhje korelative midis variabla.
- Studenti duhet të jete ne gjendje te analizoje rendesine dhe testimin e variableve bazuar ne llogaritjen dhe interpretimin e treguesve te ndryshem
- Studenti të jete në gjendje të analizoje fenomenet e ndryshme në kohe duke përdorur analizën dinamike të serive kohore.
- Studenti duhet të kuptoje dhe te perdore indekset
- Studentet duhet të jete ne gjendje te realizojne nje analize te vendimmarjes

Metodologjia e mësimdhënies: Leksione, Seminare, Detyrë Kursi, Provime Ndërmjetëse, & Përfundimtar.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 15%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 2:2

Literatura:

- “Statistike Biznesi”, J. Vathi, A. Mane, I.Pagria, 2008
- “Statistika” M. Osmani, (2004)
- “Statistics for business and economics”, H. Kohler, 1989, Amherst College
- “Modern Elementary Statistics”, J.E. Freund, 1998, Prentice- Hall, New Jersey, USA
- “Statistics for Business and Economics”, D. R.Anderson, 2005, 9e South – Ëester, Ohis Sëeeney, D.J. Ëilliams, T.A

Lënda: E drejta në biznes

Përshkrimi i lëndës: Kjo lëndë ofron njohuritë e përgjithshme dhe bazë të së drejtës biznesore vendore dhe ndërkombëtare, studenteve kjo lëndë do t’u ofroj mundësi që të zhvillojnë njohuri mbi sistemin juridik të biznesit dhe menyren e funksionimit të tij. Konsiderat do t’i jepet aktiviteteve të së drejtës në biznes në përgjithësi. Një analizë më në detaje do t’i kushtohet edhe ligjeve, akteve juridike mbi të cilat funksionon e drejta biznesore, objektet dhe subjektet e së drejtës, burimet në krijimin e detyrimeve, kontratat dhe klasifikimi i tyre i mundësojn studenteve një vizion të përgjithshëm rrethe dinamikës së marrëdhënieve të së drejtës biznesore, marrëdhëniet juridike të pronësisë. Kjo lëndë është planifikuar të

ndihmoje studentet që të permirësojnë kontekstin e tyre personal brenda së drejtës biznesore në Kosovë. Një rëndësi do ti kushtohet problemeve juridike- ekonomike në biznes. Fitimi i njohurive dhe të drejtave rreth lëndës në agrobiznes.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë njohjen teorike dhe aspektet praktike të funksionimit dhe të drejtës në bizneseve në tërësi dhe rolit të të drejtës së biznesit në Kosovë në veqanti.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:

- Pas përfundimit të këtij kursi (lënde), studenti pritet të jetë në gjendje që:
- Të kuptojë parimet themelore të së drejtës në biznes.
- Të qartësojë poziten dhe rolin e kësaj lënde tani dhe në të ardhmen në vendin tonë, mbi interesat e kësaj lëmie;
- Të kritikojë dhe debatojë, mbroj çështjet aktuale të lëndës dhe të argumetojë qëndrimin e vet duke u bazuar në parimet dhe rregullat juridike kombëtare dhe atyre ndërkombëtare.
- Te rrisë aftësitë e studentit për të kuptuar peshen e së drejtës në biznes;
- Te rrisë aftësitë e studentit për të kuptuar shprehite e mirëfillta të së drejtës në biznes.
- Te rrisë aftësitë e studentit në aspektin personal dhe profesional– zbatues në këtë trend europian e atë global si ne aspektin teorik dhe ne atë praktik dhe rolit të së drejtëse në këtë fushe.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike nëpër shoqëritë biznesore në vend dhe rajon, projekte të pavarura biznesore, detyra shtëpie, kolokuiume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është (2+1 orë) si lëndë zgjedhore.

Literatura:

- The legal envirement of buisniss. F. William mc. Carty & Johon Bagby.
- G,G Oglez: EU Bussnis Law, 5-th edition Amsterdam, 2002.
- Prof. Dr. Mazllum Baraliu “E Drejta Biznesore”, Prishtinë 2010;
- Riza Smaka, E drejta Biznesore, Universiteti Ilira Prishtinë-Tiranë 2008; Mehdi J. Hetemi: E drejta me njohurit themelore të së Drejtës Afariste, Prishtinë 2006;
- *Ligjin mbi shoqërin Tregëtare:* Neni. 48, 49-65, 66-67. Boture në Gazeten Zyrtare, shif në: www.gazetazyrtare.com
- Richard A. Chapman, Etika në Shërbimin Publik për Mijëvjeçarin e Ri, New Jork, 2002.
- Hysen Çela –Etika e Biznesit, Tiranë, 2009.
- Auron Pasha “Etika Ekonomia dhe Biznesi, 2004.
- Barry, Norman *The Morality of Business Enterprice, Aberdeen:* Aberdeen University Press.1991 .
- Benett-Alexander, Harrison, *Hass The Legal Ethical And Regulatory Of Business* 1999.
- Boucher, Dale “*An Ethical Codenot a code of conduct*”, 1996.
- Minson, Jeffry, “*Ethics in the service of the state*”, 1998.

- Tom L. Beauchamp and Norman E. Bowie (eds.), *Ethical Theory and Business*, fifth edition (Upper Saddle River, N.J.: Prentice-Hall, 1997); ISBN: 0-13-398520-2.
- Rohr, John. *Ethics for Bureaucrats*. New York: Marcel Dekker, 1978
- Washington, Sally. *Ethics in the Public Service*. Paris: OECD, 1999.
- Mundësi shtesë për studim dhe thellim të dijës në këtë fushë paraqesin edhe faqet e ndryshme të internetit.

Lënda: Informatikë Biznesi

Përshkrimi i lëndës: Dizenjimi i një databaze, diagramet e klasave, ngjarjet. Databazet relacionarë. Normalizimi i të dhënave, tabelat, klasat dhe celsat. Konvertimi i klasës diagram në lidhje të normalizuara një-me-shumë, shumë-me-shumë. Ms Access, sistem administrimi i bazës së të dhënave. Tabelat dhe format. Informacioni nga baza e të dhënave, pyetësorët, dhe raportet. Hyrje në SQL. Ndërtim aplikimesh dhe hyrje në VBA. Ms Excel. Funkcionet dhe formulat. Transformimi i të dhënave në informacion. Automatizimi i veprimeve përsëritëse (rutina), macrot. Skenarët dhe parashikimet. Goal Seek. Matricat dhe Exceli. Solver, një mjet optimizimi. Zbatime.

Qëllimet e lëndës: Të kuptojnë dhe të njohin modelet të cilat janë të rëndësishme në sistemet e dizenjimit të bazës së të dhënave. Të identifikojnë tre rregullat kryesore të normalizimit dhe të tipeve të tyre që mund të përdorin DMBS, për të siguruar detyrim tërësor të të dhënave. Të njohin dhe përdorin Ms Access si një sistem administrimi i të dhënave bazë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

- Të demonstrojnë aplikimet e njohurive të Ms Access, Ms Excel dhe VBA në organizata të ndryshme.
- Të përcaktojnë një makro për të thjeshtuar ekzekutimin e një rutine si në Access ashtu dhe në Excel.
- Të identifikojnë Solverin si një mjet që ndihmon në optimizimin dhe caktimin e burimeve për të arritur qëllimin e dëshiruar.
- Të kuptojë dhe zbatojë funksionet dhe formulat në MS Excel
- Të kuptojë natyrën dhe metodat e transformimit të të dhënave në informacion
- Të jetë në gjendje të ndërtojë skenarë në funksion të parashikimeve

Metodologjia e mësimdhënies: Leksione, Seminare, Detyrë Kursi, Provime Ndërmjetëse, & Përfundimtar.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokium): 15%, Seminarët ose angazhime tjera: 15%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Tekste mesimore, materiale suplementare, kompjuterë, laboratorë kompjuterik, software, projektori, tabela, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 2:2

Literatura:

- Robert T. Grauer, Maryann Barber, Microsoft Office 2000 Professional, Volume (I+II), Prentice Hall, 1999
- Gerald V. Post, Database management Systems Designing and Bulding Business Applications, McGraw-Hill 2000
- Papakroni H., Programe Përdorimi Kompjuteri (2), Pegi 2010

- Papakroni H., Programe Përdorimi Kompjuteri (1), Pegi 2002
- Papakroni H., Sistemet e Administrimit Database dhe Analiza e Informac., Erik 2006
- Developing Decision Support Systems ëith Microsoft Excel, Brooks/Cole 2007.

Lënda: Hortikulturë

Përshkrimi i lëndës: Njohje me lëndën, çka është hortikultura, definicionet e hortikulturës, klasifikimi i hortikulturës, Faktorët ambiental. Faktorët fizik. Faktorët biologjik. Teknologjia e kultivimit të fidanëve, Kontrollin e të ushqyerit, Lënda e Perimtarisë, klasifikimi. Lënda e Pemëtarisë, klasifikimi. Prodhimi i fidanëve në hortikulture, Lënda e Vreshtarisë, Serrat dhe prodhimi në serra, Bimët zburuese roli dhe rëndësia e tyre.

Qëllimet e lëndës Hyrjen, Klasifikimin e zhvillimit të lëndës së Hortikulturës , duke përfshirë edhe vlerësimin e përparësive dhe teknologjitë e reja të prodhimit të bimëve hortikulturore, Faktorët: ambiental, biologji, fizik. Te ushqyerit e bimëve, pesticidet dhe masat tjera të agroteknike, etj. Kultivimin e fidanit me teknologjitë e reja. Njohurit për: Perimet, Pemëtarin, Vreshtarin, Bimët zburuese, Prodhime organike, Mbrojtje të integruar, etj. Lënda ofron njohuritë bazë mbi çështjet e prodhimit dhe praktiken në fushën e hortikultures dhe përgatit studentet për një menaxhim në ndërmarrjeve publike e private, testimin e ideve, vlerësimin e mundësive, prodhimin, tregun, marketingun e produkteve etj.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të ligjëratave, studenti do të jetë në gjendje të:

- Zhvillojë dhe kuptojë lëndën e Hortikulturës.
- Të analizojë në mënyrë kritike veprimet aktuale dhe të analizojë ndikimin e tyre potencial në hortikulturë
- Do të zgjeroj dijen mbi Hortikulturën në Kosovë e me gjerë.
- Zhvillon aftësitë e të menduarit kritik dhe të vlerësoj dhe vepron në sektorin e hortikulturës.
- Zgjeroj njohurit personale për lidhjet në mes të Hortikulturës dhe degëve tjera në Agrikulturë.
- Fitojë njohuri të përgjithshme të lidhjes midis: Prodhimit, konservimit, burimeve natyrore.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, diskutime, ushtrime, ekspedita , konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokviume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- T.Efendija, Pemëtaria e përgjithshme, 2000, Prishtinë.
- D. Qakalli & E. Kullaj "Biologjia e bimëve Hortikulturore", 2007, Tiranë.
- Vasil Shqahu, Enciklopedi e Kopshtaris, 2007, Tiranë.
- Sallaku, G. & Balliu, A., Perimtaria, 2012, Tiranë.
- Oktrova, A. et, al. Perimtaria, 1984, Tiranë.
- Competences: In-depth understanding of horticultures.

- Introduction to Horticulture-Hunt,JD,2000,Greater Perfections;thepractice of Garden theory, Thomes and Hudson.
- HARTMMAN, A.H. DAVIES, F.T., (1990), Plant Propagation . Pinciples and practies. Englewood Cliffs, New Jersey.

Lënda: Bazat e Financës

Përshkrimi i lëndës: Financa, kuptimi roli, rëndësia dhe lidhja e saj me shkencat e tjera ekonomike. Ambienti financiar: Tregjet, institucionet, instrumentet financiare dhe normat e interesit. Konceptet baze në finance: vlera në kohe e parasë. Vlera e ardhshme, vlera aktuale, e përvitshmja. Interesi i thjeshte dhe i përbëre. Risku dhe norma e kthimit. Konceptet e vlerësimit: Vlerësimi i aktiveve financiare.

Financat e ndërmarrjes dhe rentabiliteti i saj. Buxheti i kapitalit: Teknikat, rrjedhat e parëse dhe risku. Kostoja e kapitalit, struktura e kapitalit dhe politika e dividendit. Planifikimi financiar dhe kontrolli. Drejtimi i kapitalit qarkullues dhe financimi. Procesi i investimit dhe borxhi afatgjate.

Qëllimet e lëndës: Të njohë studentet me konceptet kryesore të financës. Të marrë njohuritë bazë të menaxhimit të flukseve financiare të njësive ekonomike. Të jetë në gjendje të vlerësojë riskun në një biznes. Të njohë tre komponentët bazë të sistemit financiar

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studentët duhet të jenë në gjendje të:

- Të njohë konceptet bazë të financës
- Të identifikojë dhe kuptojë lidhjen midis financës dhe shkencave të tjera
- Të kuptojë dhe interpretojë lidhjen midis institucioneve financiare dhe kuptimin e normës së interesit si kosto e kapitalit.
- Të kuptojë riskun e investimeve kapitale dhe të përdorë llogaritjen e riskut në marrjen e vendimeve financiare
- Të kuptojë dhe ndërtojë buxhetin e ndërmarrjes dhe rrjedhjen e parasë në ndërmarrje si dhe mënyrat e përdorimit të saj.
- Të jetë i aftë të përdorë metodat për llogaritjen e kapitalit qarkullues neto dhe format e investimit me borxh.

Metodologjia e mësimdhënies: Leksione, Seminare, Detyrë Kursi, Provime Ndërmjetëse, & Përfundimtar.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokium): 15%, Seminarët ose angazhime tjera: 15%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 2:2

Literatura:

- H.MAY Finance 2002
- BRIGHAM / BESLEY, Essentials of Managerial Finance, botimi i 13-te, International Student Edition Thomson Sowth-Western, ShBA, 2005.
- BUNDO SH : FINANCE; Tekst Universitar, Botim 2007.
- SALKO D: Cikli i leksioneve « Bazat e Financës”.
- Artikuj shkencore të huaj dhe vendas.

Lënda: Marketingu Agrorëshqimor

Përshkrimi i lëndës: Hyrje në Marketingun Bujqësorë. Marketingu roli dhe rëndësia e tij. Analizat e tregjeve të produkteve bujqësore dhe ushqimore. Prodhimi bujqësor dhe marketingu i produkteve bujqësore dhe ushqimit. Konsumi i ushqimeve dhe marketingu. Industria përpunuese dhe përpunimi i ushqimit. Shitja me shumicë dhe pakicë e ushqimit produkteve bujqësore dhe ushqimit. Tregtia ndërkombëtare e ushqimit. Analizat e çmimit dhe funksioni i këmbimit. Konkurenca në tregjet ushqimore. Çmimet e produktit të fermës dhe çmimet e ushqimit. Kostot e marketingut të ushqimeve. Organizimi ndryshueshem në tregjet ushqimore. Kooperativat në industrinë e prodhimit dhe ushqimit. Zhvillimi i tregut dhe zgjerimi i kërkesës. Fuqia në treg dhe fuqia për marrveshje. Informacioni mbi tregun. Standartizimi dhe shkallëzimi. Transporti. Magazinimi. Menaxhimi i riskut dhe tregjet në afat. Konsulta dhe përgatitje për provim. Prodhimi i produkteve bujqësore dhe ushqimit përbenë një komponent shumë me rëndësi për konsumatorët duke përfshirë ligjet, rregulloret, vendimet, veprimet dhe institucionet tjera që ndikojnë në prodhimet bujqësore dhe ushqimi, shpërndarjen dhe konsumin e tyre.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë njohuri mbi funksionet e marketingut bujqësorë, dobësi-shtese, strukturat e tregut dhe institucionet e marketingut të produkteve agro-ushqimore. Do të kontribuoj në alternativat e marketingut në vendimmarrje të prodhuesve dhe ndërmjetësve. Të japë njohuri të nevojshme për strukturat e tregut, pozicionin e prodhimit dhe çmimeve të tregut: po kështu dhe të përpunuesve: për fuqinë e firmave në treg e në lidhje marrëveshjesh për shit-blerje.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të ligjëratave, studenti do të jetë në gjendje të:

- Zhvillojë dhe kuptojë marketingun e produkteve agrorëshqimorë.
- Të analizojnë në mënyrë kritike veprimet aktuale dhe të analizojnë ndikimin e tyre potencial në marketingun agrorëshqimor.
- Do të zgjerojnë dijen mbi marketingun e bujqësisë në Kosovë e me gjerë.
- Analizojnë shkaqet dhe zgjidhjet e mundshme për marketingun e produkteve bujqësore.
- Zgjerojnë njohurit personale për lidhjet në mes të marketingut bujqësorë dhe ushqimit.
- Fitojnë njohuri të përgjithshme të lidhjes midis: Prodhimit, industrisë ushqimore, konservimit, burimeve natyrore dhe marketingut në përgjithësi.
- Integrojnë teorinë me ekonominë prodhuese e tregtare për të vlerësuar çështjet aktuale dhe në të ardhshmen të marketingut bujqësor.
- Do të jete në gjendje të marr vendime të cilat sjellin rezultat afarist pozitiv në mjedisë prodhuese, përpunuese e tregtare.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjëratat, diskutime, ushtrime, ekspedita, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokviume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- Kolnikaj,P. Verquni,A. Male,B. “Marketingu i produkteve bujqësore”,2009, Tiranë.
- Kotler, Ph. & Armstrong,G. (2013).”Principles of marketing”.13th edition.
- Ceku,B. Abazi,A. Loca,S. (2010). Bazat e Marketingut, Tiranë.
- R.L.KOHL, Joseph N.UHL.”Marketing of agricultural products”,Perdue University New Jersey, 2002.
- Ph.Aurier,L. Sirieix.”Le marketing des produits agroalimentaires”,Paris,2004.
- Fred Emerson Clark ”Principles of Marketing”-Marketing Principle in Agriculture.
- Kotler, Ph. & Armstrong,G.(2013)”Parimet e Marketingut,Botimi i 13-të,Tiranë.
- Hudson D. Agricultural markets and proces,Blackwell Publishing,2007.

Lënda: Menaxhim në Agrobiznes

Përshkrimi i lëndës: Sistemi i agrobiznesit. Format legale të organizimit të agrobiznesit. Format kooperativa të organizimit të agrobiznesit. Menaxheri i agrobiznesit dhe marrja e vendimeve të drejtimit. Planifikimi në ndërmarrjet e agrobiznesit. Organizimi i prodhimit duke përdorur parimet ekonomike. Drejtimi i marketingut në firmat e agrobiznesit. Risku i drejtimit të firmave të agrobiznesit. Kontrolli i kostove dhe përdorimi i analizës së pikës kufi. Kontrolli i aktivitetit të firmave të agrobiznesit. Financimi i firmave të agrobiznesit. Vendimet për buxhetimin e kapitalit. Ekipi i drejtimit dhe motivimi i punonjësve. Si të analizojmë një rast studimi.

Qëllimet e lëndës: Studenti të jetë në gjendje të interpretojë sistemin e agrobiznesit në ekonominë kombëtare të një vendi, si dhe të njohë dhe të vlerësojë tërësinë e faktorëve që kushtëzojnë lindjen dhe zhvillimin e sistemit të agrobiznesit. Në rolin e menaxherit të një firme agrobiznesi, të aftësohet studentin në drejtim të procesit të marrjes së vendimeve për të gjitha problemet me të cilat mund të përballë firma.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të ligjeratave, studentin do të jetë në gjendje të:

- Zhvillojë dhe kuptojë menaxhimin në fushën e Agrobiznesit.
- Ti analizon në mënyrë kritike veprimet aktuale dhe të analizojë ndikimin e tyre potencial në menaxhim.
- Do të zgjeroj dijen mbi menaxhimin e bujqësisë në Kosovë e me gjerë.
- Analizojë shkaqet dhe zgjidhjet e mundshme për menaxhimin e sektorit bujqësor..
- Zgjeroj njohurit personale për lidhjet në mes të menaxhimin bujqësisë dhe ushqimit.
- Fitojë njohuri të përgjithshme të lidhjes midis: Prodhimit, industrisë ushqimore, konservimit, burimeve natyrore dhe menaxhimin në përgjithësi.
- Integroj teorinë me ekonomisë prodhuese e tregtare për të vlerësuar çështjet aktuale dhe në të ardhshmen.
- Do të jete në gjendje të marr vendime të cilat sjellin rezultat afarist pozitiv në mjedisin prodhuese, përpunuese e tregtare.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, ekspedita , konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokfiime, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- Drejtim Agrobiznesi”, B. Musabelliu, 2003, 2009
- “Kooperimi & Integrimi në Bujqësi, B. Musabelliu, P Kolnikaj, 2006.
- “Agribusiness Management”. Steven P. Erikson, Jay T. Akridge, Freddie L. Barnard, W. David Downey, Third Edition, 2002.
- “Agribusiness Management”. W. David Downey & Steven P. Erikson, Second Edition, 1987.
- “Principles of Agribusiness Management”. James G Beierlein, Kenneth C. Schneeberger, and Donald D. Osborn, 1995.
- “Agribusiness Marketing. The Management Perspective”. James G. Beierlein, Michael W. Woolverton, 1991.
- “Business”. Fred Luthans, Richard M. Hodgetts, Second Edition, 1992.

Lënda: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Përshkrimi i lëndës: Ligjeratë hyrëse Zhvillimi i menaxhimit të burimeve njerëzore , Menaxhimi i Burimeve Njerëzore *Departamenti i burimeve njerëzore*, Mjedisi per MBNJ , Organizimi dhe analiza e punes , Planifikimi i Burimeve Njerëzore , Rekrutimi , Formimi , Tema: T e s t i I , Vlerësimi i performances, Menaxhimi i Shpërblimit , Perfitimet e Punetoreve , Marredheniet e Punes , Kontratat Kolektive , Shëndeti dhe siguria ne punemi qëllimi dhe rëndësia,risqet ne shëndetin dhe sigurinë në punë.

Qëllimet e lëndës Lënda ka për qëllim të ofroj njohuri të avancuara ,të aftësoj studentët për përdorim specifik të koncepteve të teorive dhe të metodave nga menaxhimi i burimeve njerëzore. Programi mësimor është i fokusuar në prezantimin e zhvillimeve të hershme të teorive që ndikojnë në menaxhimin e resurseve, pastaj mënyrën e organizimit të punës deri tek motivimi i punonjësve, vlerësimi dhe shpërblimi i performancës së tyre si dhe siguria në punë. Studentët të kuptojnë pse është i nevojshëm menaxhimi i resurseve njerëzore. Studentët të fitojnë njohuritë për planifikimin, rekrutimin, seleksionimin, motivimin, komunikimin, zhvillimin, dhe vlerësimin e performancës.

Rezultatet e pritura të nxënies: Në mbarim të të mësuarit të lëndës, studentët duhet të jenë të aftë të:

Kuptojnë se menaxhimi i burimeve njerëzore është proces për sigurimin e njerëzve të duhur në vendin e duhur dhe në kohën e duhur;

- Studentët të kuptojnë elementet themelore të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Kuptimin e aspekteve teorike dhe praktike mbi menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Të hartoj, analizoj planin e kompensimit, planin dhe seleksionimin në një ndërmarrje;
- Të identifikoj faktorët e nevojshëm për të siguru një staf të motivuar dhe të suksesshëm.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, ekspedita , konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokfiume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është (2+2 orë).

Literatura:Paul Banfield-Rebecca Kay :Hyrje në Menaxhimin e Burimeve njerëzore, Përkthyer nga: Jonida Bregu, Botimi UET Press 2011 Tiranë

- Manaxhimi i Burimeve Njerëzore, Raste studimi, Ushtrime; Dr. Ilirjan LIPI
- Manaxhimi i Burimeve Njerëzore, Tekst Universitar, Dr. Ymer HAVOLLI, 2003
- Menaxhimi i resurseve humane, Enver KUTLLOVCI, Prishtinë, 2004
- Metodologjia e punës shkencore kërkimore: Ali JAKUPI, dispensë, Prishtinë;
- Metodologjia e punës kërkimore shkencore për biznes, Nexhmi REXHA, Ligjërata të autorizuara, 2005 Prishtinë;
- Literaturë tjetër dhe materiale të ndryshme nga interneti.
- H T Graham & Roger Bennett: Human Resources management, Great Britain 1998.

Lënda: Komunikim Biznesi

Përshkrimi i lëndës Komunikimi është një koncept shumë i rëndësishëm në biznes dhe aftësia për të komunikuar efektivisht është një faktor kyç në arritjen e suksesit. Kjo lëndë merr në shqyrtim mjetet nëpërmjet të cilave komunikojnë individët dhe kompanitë e biznesit duke treguar se si ato mund të shfrytëzohen në mënyrë efektive. Përmbajtja e lëndës përfshin: mënyrat e ndërtimit të mesazheve efektive, kontekstin profesional, kulturor dhe social të komunikimit, stimulimin e vullnetit të mirë në komunikim, analizën e komunikimit me shkrim, aftësitë komunikuese ndërpersonale, përgatitjen vizuale të prezantimeve si dhe një numër të madh rastesh studimore.

Qëllimet e lëndës: Kjo lëndë synon të zhvillojë aftësitë e studentëve për të komunikuar në mënyrë efektive në çdo situatë që lidhet me aktivitetin e tyre profesional. Në mënyrë të veçantë synohet të zhvillohen aftësitë e tyre komunikuese ndërpersonale, si dhe në grup. Në këtë lëndë theksohet aspekti praktik dhe synohet përgatitja e individëve të aftë, që të përballen me realitetin konkurrues të tregut të punës

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:

- Përfitojnë njohuritë bashkëkohore mbi komunikimin verbal, me shkrim dhe me mjete elektronike.
- Kuptojnë i rëndësishëm së komunikimit në kontekstin organizativ bashkëkohor..
- Aftësohen për zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme komunikuese, në varësi të situatave konkrete në biznes.
- Për përvetësimin i metodave komunikuese që çojnë në performancë të lartë të punës në grup.
- Aftësohen për përgatitjen e prezantimeve verbale të suksesshme me ndihmën e mjeteve vizuale elektronike.
- Aftësohen për planifikimin e zhvillimit të karrierës profesionale.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, punime seminarike, konsultime, raste studimi, kolokviume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është (2+2 orë).

Literatura:

- Ervin Demo, Petrit Dollani: “Komunikimi në biznes – përmbledhje leksionesh”, 2007
- Andri KOXHAI, Florian TOMINI : “Manaxhimi i komunikimit”, Tiranë, 2006
- Polesana M. Angela, Communication Mix, "Come comunica l'impresa", , EGEA editore, 2007

Lënda: Menaxhim Financiar

Përshkrimi i lëndës: Ndërmarrja dhe mjedisi i saj. Këmbimet, flukset dhe stoqet, ciklet financiare, kapitali, teprica monetare, kërkesa për para dhe nevojat financiare. Qëllimi i drejtimit financiar i ndërmarrjes. të dhënat baze të studimit të gjendjes financiare, amortizimit, rrjedhjes së parasë, dokumentet baze. Treguesit e ekuilibrit, rentabilitetit dhe treguesit e tjerë financiarë. Mjedisi financiar dhe operacionet financiare. Ndërmjetësimi financiar dhe përqindja e interesit. Konceptet baze financiare: vlera në kohe e parë. Interesi i thjeshtë dhe i përbërë. Vlera e ardhshme, vlera aktuale, e përvitshme. Vendimi i investimeve: kuptimi i buxhetimit dhe teknikat e tij. Pasiguria dhe rreziku. Politika financiare e ndërmarrjes dhe burimet e financimit. Leva operationale dhe financiare. Kosto dhe struktura e kapitalit. Planifikimi financiar. Analiza e pikës kritike. Financimi afatshkurtër dhe drejtimi i thesarit. Negocimi i kredive. Rritja e ndërmarrjes: grupimi dhe efekti i operationeve financiare. Aspekte të drejtimit financiar ndërkombëtar dhe drejtimit të rrezikut, veprimtaria e shoqërive shumëkombëshe, diversifikimi i rrezikut, roli i investimeve të huaja direkte. Ndikimi i taksave dhe kursit të këmbimit.

Qëllimet e lëndës Lënda “Menaxhimi Financiar ” ka për qëllim që tu ofrojë studentëve njohuri të nivelit mesatar lidhur me konceptet, rolin, detyrat dhe fushat e vendimmarrjes të drejtuesve të financave të korporatës.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje:

- Të kuptojë dhe ta llogarisin ndryshimin e vlerës së parasë në kohë,
- Të analizojnë dhe konstatojnë gjendjen financiare në të cilën gjendet korporata,
- Të vlerësojnë projektet investuese dhe të marrë vendime të duhura investuese,
- Të dinë ta menaxhojë rrezikun financiar
- Të dinë së prej cilave burime financiare mund ta financojë korporatën,
- Të dinë që ta menaxhojë mirë kapitalin punues neto të korporatës etj.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, projekte të pavarura, kolloqiume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 3:2.

Literatura:

- Isa Mustafa, Menaxhmenti financiar, RIINVEST, Prishtinë, 2007
- Literatura Plotësuese:
- James C. Van Horne, John M. Wachowicz, "Fundamentals of Financial Management", Prentice Hall, New Jersey, 2004
- Fred Emerson Clark "Principles of Marketing"-Marketing Principle in Agriculture.
- Kotler, Ph. & Armstrong, G.(2013)"Parimet e Marketingut, Botimi i 13-të, Tiranë. Hudson D. Agricultural markets and proces, Blackwell Publishing, 2007.

Lënda: Menaxhim i Fermave

Përshkrimi i lëndës: Kuptimi i fermës dhe modelet e zhvillimit të tyre; kuptimi i drejtimit të fermave; funksionet dhe fushat e drejtimit; parimet bazë të drejtimit të fermave. Nevojat dhe burimet e sigurimit të informacionit; pjesët përbërëse të një sistemi kontabiliteti, bilanci kontabël dhe analiza e tij, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe analiza e saj. Parimet ekonomike me të rëndësishme të drejtimit të fermave. Funksioni dhe teknologjia e prodhimit, konceptet e kostove; zgjedhja e nivelit të përdorimit të faktorëve të prodhimit input (faktor) të përdorim; kombinimi i inputeve; sa produkt të prodhojmë; kombinimi i aktiviteteve prodhuese. Buxheti i aktiviteteve dhe buxheti i pjesshëm i fermës; planifikimi dhe buxhetimi i përgjithshëm i fermës; buxheti i lëvizjes së parave. Hapat në planifikimin e marketingut, vendimet e tregut (kur, ku dhe si të shesim). Llojet e analizave; vlerësimet e efektivitetit ekonomik; vlerësimet e efektivitetit të prodhimit; analiza e aktiviteteve.

Qëllimet e lëndës:

Studenti të jetë në gjendje të identifikoj modelet e organizimit të fermave bujqësore, dhe të njoh rolin e drejtimit (parimet, funksionet dhe fushat e tij) në suksesin e një biznesi bujqësor. Studenti duhet të dijë të përdorë parimet ekonomike në identifikimin e niveleve dobiprurës të faktorëve të prodhimit, dhe madhësisë së aktiviteteve të veçanta.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të hartoj një plan biznesi për fermën
- Të njoh modelet e buxheteve që hartohen dhe roli i tyre në përdorimin dobiprurës të burimeve prodhuese, si dhe dijë të hartojë një buxhet aktiviteti
- Të aftësohen në drejtim të analizës dhe vlerësimit të efektivitetit të prodhimit dhe efektivitetit ekonomik të biznesit të fermës.
- Të ndjehet hapat e hartimit të një plani marketingu për produktet bujqësore si dhe të bëjë planifikimin në marketing
- Të vlerësojë efektivitetin ekonomik të aktiviteteve të fermave sipas tipit të tyre.

Metodologjia e mësimdhënies: Leksione, Seminare, Detyrë Kursi, Provime Ndërmjetëse, & Përfundimtar.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokium): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Tekste mesimore, materiale suplementare, kompjuterë, projektori, tabela, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 3:2

Literatura:

- Ronald D. **Kay**, William M. **Edwards**, and Patricia A. **Duffy**, **Farm Management**, 5th Edition, by McGraw-Hill, 2004.
- Meço M., Sula R., Leksinaj E., **Drejtimi i Fermave**, 2011, “Dita 2000”; Tirana.
- **E. N. Castle**, **M. H. Becker**, **A. Gene Nelson**, Farm Business Management Macmillan publishing company, Inc. 1987
- **Martin Upton**, Farm Management in Africa, Oxford University press 1973.
- **Raanan Weitz**, From peasant to farmer: a revolutionary strategy for development, Columbia university press, New York and London, 1971
- **M. D. Boehlje**, **V. R. Eidman**, Farm Management. By John Wiley and sons Inc.1984
- **C. S. Barnard**, **J. S. Nix**, Farm Planning and Control, Cambrige University Press.
- **Raymond R. Beneke**, Managing the Farm Business, John Wiely and sons, Inc.

Lënda: Projektet në Agrobiznes

Përshkrimi i lëndës: Investimet si faktor i politikës zhvillimore në kushtet e progresit teknologjik. Përkufizimi i investimeve. Llojet kryesore të investimeve dhe vendimeve investuese. Investimet kapitale. Procesi investues. Menaxhimi i fazës përgatitore të procesit investues. Huluntimi i tregut. Zgjedhja teknologjike dhe zgjidhja teknike. Analiza e lokacionit dhe aspekteve ekologjike. Planifikimi i kapaciteteve prodhuese. Planifikimi i shpenzimeve. Planifikimi i mjeteve të nevojshme investuese. Plani dinamik i realizimit të projektit investues. Burimet e financimit. Planifikimi i të hyrave. Përpilimi i pasqyrave financiare. Vlerësimi i efekteve financiare të projektit investues. Vlerësimi i likuiditetit dhe rentabilitetit të projektit investues. Vlerësimi i efekteve ekonomiko-shoqërore të projektit investues (Cost –Benefit analiza). Menaxhimi i fazës së realizimit të projektit investues.

Qëllimet e lëndës Qëllimi i lëndës “Projektet në agrobiznes” është që t’i pajisë studentet me njohuri teorike dhe t’i aftësojë për përpilimin, vlerësimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme nga agrobiznesi. Pas përfundimit të suksesshëm të kursit, studenti do të zhvillojë aftësi dhe do të jenë në gjendje:

Të identifikojë projekte zhvillimore

Të përpilojë projekte investuese

T’i vlerësojë efektet financiare që gjeneron projekti

T’i vlerësojë efektet ekonomike dhe shoqërore që i gjeneron projekti

Të marrë vendime investuese

Të menaxhojë realizimin e projektit investues.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të suksesshëm të kursit, studenti do të zhvillojë aftësi dhe do të jenë në gjendje:

- Të identifikojë projekte zhvillimore
- Të përpilojë projekte investuese
- T’i vlerësojë efektet financiare që gjeneron projekti
- T’i vlerësojë efektet ekonomike dhe shoqërore që i gjeneron projekti
- Të marrë vendime investuese
- Të menaxhojë realizimin e projektit investues.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, ekspedita , konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokviume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1:1 (2+2 orë).

Literatura:

- Zef Gjeta, Menaxhimi I ciklit të projekteve në bujqësi, 2005, UBT, Tiranë
- Mustafa, M., Menaxhimi i Investimeve, RIINVEST, Prishtinë, 2009
- Doppler, W. (1996): Quantifying costs and benefits, Techniques of cost benefit analysis, Towards an economic, social and environmental evaluation. In: UPTON, M. (edit.) Planning and appraising agricultural
- Adnan Rovçanin, Savremene metode ocjene efikasnosti investicija, 2000, Ekonomski fakultet Universiteta u Sarajevu, Sarajevo.

Lënda: Çmimet dhe Tregjet e Produkteve Bujqësore

Përshkrimi i lëndës: Modelet dhe analiza e tregjeve në konkurrencën e pastër (kërkesa, oferta, gjendja e ekuilibrit), Konkurrenca jo e pastër (monopoli, oligopoli, konkurrenca monopolistike, teoria e lojës, përqendrimi i tregut), Përcaktimi i çmimit në struktura të ndryshme tregu, Diskriminimi i çmimit, Faktorët që përcaktojnë çmimet e produkteve bujqësore dhe roli i tyre, Metodatat e përcaktimit të çmimeve të produkteve bujqësore, Marzhet e marketingut, cilësia dhe roli i saj në vendimet për çmimet, sistemet e menaxhimit të cilësisë në bujqësi dhe agroindustri. Variacioni i çmimit në kohe dhe hapësire, dhe se fundi, teknikat e kërkimit dhe analizës se sjelljes se konsumatoreve.

Qëllimet e lëndës: Të njohë dhe të kuptojë funksionimin e tregjeve në kushtet e konkurrencës së pastër dhe asaj jo të pastër përfshirë të gjitha format përkatëse por duke vënë më shumë theksin tek konkurrenca jo e pastër si formë e cila ndeshet më shpesh në praktike. T'u japë studenteve disa njohuri bazë edhe mbi disa elemente jo shumë të njohur prej tyre si tregjet e së ardhmes, teoria e lojës, kjo e fundit me shumë për të kuptuar logjikën e aplikimit të saj, si dhe teknikat baze të analizës se sjelljes së konsumatorëve.

Rezultatet e pritura të nxënies:

- Studenti duhet të njohë të gjithë elementet të cilët ndikojnë dhe duhet të merren parasysh në përcaktimin e çmimit të produkteve bujqësore.
- Studentët duhet të fitojnë të gjitha njohuritë e nevojshme mbi metodatat e ndryshme të vendosjes se çmimeve, si dhe të aftësohen për të përcaktuar se cila prej tyre mund të përdoret në kushte të veçanta.
- Student të fitojnë të gjitha njohuritë e nevojshme për të kuptuar logjikën e ndryshueshmërisë se çmimeve të produkteve në kohe dhe hapësire.
- Studenti duhet të kuptojë tregjet e së ardhmes dhe avantazhet që ofrojnë në terma të reduktimit të risqeve të tregut
- Studenti duhet të kuptojë filozofinë e sjelljes konsumatore dhe teknikat bazë të analizës së kësaj sjelljeje.

Metodologjia e mësimdhënies: Leksione, Seminare, Provime Ndërmjetëse, & Përfundimtar.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokium): 30%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 3:2

Literatura:

- Hudson D. Agricultural markets and prices. Blackwell Publishing, 2007
- Tomek W. and Robinson K. Agricultural product prices, 4th edition. Cornell University Press, UK, 2003
- Ferris J. Agricultural prices and commodity market analysis. WCB – McGraw-Hill, New York, 1998
- Varian H. Microeconomic analysis, third edition. WW Norton and Company, New York, 1992

Lënda: Teknologjia e prodhimi dhe përpunimi të produkteve Bujqësore

Përshkrimi i lëndës: Njohje me lëndën, çka është Perimtaria, historiku, zhvillimi dhe, klasifikimi i Perimtaris. Faktoret ambiental dhe ndikimi i tyre në rritjen e produkteve te perimore. Faktoret ambiental dhe ndikimi i tyre në rritjen e produkteve te perimore. Faktoret ambiental dhe ndikimi i tyre në rritjen e produkteve te perimore. Kërkesat e produkteve perimore për elemente ushqyese(plehrimi) dhe ujitje. Kërkesat e produkteve perimore për elemente ushqyese(plehrimi) dhe ujitje. Prodhimi i produkteve ne sistemin hdroponik dhe Prodhimet organike. Shtimi(shumimi)i bimëve perimore, Teknologjia e kultivimit të fidaneve të perimeve. Perimet e familjes Solanore. Perimet e familjes Bostanore. Perimet e familjes Zambakore,Perimet e familjes Kryqore dhe Kompozite. Perimet e familjes Bishtajore,Perimet e familjes Kenopodiore, Kultivimi i kërpurdhave.Roli dhe rëndësia ekonomike Llojet e Kërpurdhave. Vjelja, klasifikimi, paketim dhe plasim në treg i produkteve perimore. Ruajtja e produkteve perimore. Teknologjia e përpunimit te produkteve te perimeve. Industria e konservimit, Përbërja kimike e frutave te perimeve.Mikrobiologjia e perimeve, Sterilizimi,teknologjike kombinuara te konservimit. Kontrolli dhe sigurimi i cilësisë në industrinë e konservimit. Konsulta dhe përgatitje për provim.

- Elizabeth Boo, Ecotourism: The Potential and Pitfalls 2001
- Douglas Pearce, Tourism Development 1995.
- Michael W. Woolverton, 1991.

4.2 Shkencat e Pyjeve dhe mjedisit (B.Sc.)

2.1 Të dhënat themelore për programin e studimit

Emri i programit të studimit	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit
Niveli kualifikimit sipas KKK (me shkurtesat BA, MA, PhD, program doktrate, kurs universitar, certifikatë apo diplomë profesionale)	Bsc (Bachelor i Shkencave)
Grada akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar	Bachelor i Shkencave të Pyjeve dhe Mjedisit (Bsc. Forest. and Environ.)
Fusha e studimit sipas Erasmus Subject Area Codes (ESAC)	01.6
Profili i programit akademik (specializimi)	Shkencat e Jetës (Shkencat e Pyjeve)
Kohëzgjatja minimale e studimit	3 vite
Forma e studimit (e rregullt, pa shkëputje nga puna, studim në distancë etj.)	E rregullt
Numri i ECTS kredive (total dhe për vit)	180 ECTS
Modulet /Lëndët (titujt)	Matematikë Kimi e përgjithshme dhe inorganike Bazat e ekonomisë Biologjia e shtazëve Fizikë Biologjia e bimëve Kimi organike Pedologjia e pyjeve Informatikë Gjuhë angleze Kimia e tokës Gjenetika e pyjeve Agropylltari Dendrometria Mikrobiologjia e tokës Silvikultura

	<p>Patologjia e pyjeve Entomologjia e pyjeve Sistematikë dhe botanikë e pyjeve Makanizimi i pyjeve Ekologjia e bimëve me gjeobotanikë Administrimi i resurseve pyjore dhe i mjedisit Ergonomia e pyjeve Monitorimi i mjedisit GIS për analizën e peizazhit Meteorologjia Meteorologjia Fitosociologjia e pyjeve Principet e menaxhimit të pyjeve Mbrojtja e pyjeve B.Sc. Teza</p> <p>Lëndët zgjedhore:</p> <p>Prodhimi i pyjeve Hidrologjia e pyjeve Prodhimi bimor Mykorhiza e pyjeve Silvikultura urbane Mbrojtja e pyjeve nga zjarret Inxhinieringu i pyjeve Politikat mjedisore Revitalizimi i pyjeve Punë praktike</p>
Numri i vendeve të studimit	50
Udhëheqës i programit studimor	Dr. Bekim Gashi Dr. Elez Krasniqi Dr. Rame Vataj
Personeli i përhershëm shkencor/artistik (Numri sipas kategorive të personelit)	1 - profesorë të rregullt (Prof. Dr.) 1 - profesor të asocuar (Prof. Asoc. Dr.) 3 - profesor asistentë (Prof. Ass. Dr.)
Taksat e studimit	50 €/student/vit

**Sipas udhëzimit të fundit administrativ të MASHT do të aplikohet pagesa për studime!*

2.2 Arsyeshmeria e programit për tregun e punës

Pyjet janë një hapësirë të veçantë të jetesës, ato ndihmojnë të krijojë ekuilibrin ekologjik dhe, në të njëjtën kohë, të sigurojë popullatën e njeriut me një burim themelor të ripërtitshëm, si dhe përfitimet e shumta jo-materiale. Zhvillimi i qëndrueshëm nuk është e mundur pa profesionistët e pylltarisë. Pothuajse 60% e territorit të Kosovës është e mbuluar me pyje, që është një veçori në Evropë dhe është një mundësi e shkëlqyer për zhvillimin, që nga burimet e rralla natyrore dhe deri te menaxhimi i qëndrueshëm i tyre. Programi i studimit kualifikon studentët për të punuar në ekosistemet pyjore në përputhje me parimet moderne të afërta me natyrën, dhe menaxhimin e qëndrueshëm. Një skemë e tillë kërkon lidhjen mes shkencave ekologjike, ekonomike dhe teknike. Ajo kërkon njohuri të ekosistemeve pyjore, aspektet sociale të menaxhimit të pyjeve, teknikat e ndryshme dhe teknologjit e përdorura në menaxhimin e pyjeve dhe njohja me mjete moderne metodologjike. Një avantazh i programit të studimit është veçantia mbi praktikën individuale dhe punës në ambient.

Universiteti Ukshin Hoti ka bazën e domosdoshme për hartim dhe realizimin e planit mësimor, sepse përparësia e kryesore e këtij plan programit të hartuar dhe i propozuar për akreditim, mbështet në trendët e zhvillimit bashkëkohorë të fushës së shkencave pyjore, ndërsa pozita gjeografike që ka regjioni i Prizren për shkak se është afër parkut nacional “Malet e Sharrit” e bënë këtë program edhe më të lehtë për të implementuar në praktikë në njërin anë, ndërsa në anën tjetër është edhe program i veçantë studimor ngase asnjë Universitet tjetër në Kosovë nuk ofron program studimor në Shkencat e Pyjeve.

Të diplomuarit mund të gjejnë punësim në ndërmarrjet e shërbimeve pyjore publike, organizatat për menaxhimin e kafshëve të egra dhe mbrojtjen e natyrës, organizatat ekonomike dhe shkolla (e mesme dhe arsimin e lartë). Gjithnjë e më shumë mundësi janë të siguruara nga vetë-punësimi - sipërmarrës të pavarur (të përpunimit fillestar të drurit, krijimin e pyjeve, tregtimin e drurit, pemëtari, prodhimi drumeve dekorativ, ekoturizmin, agjencitë private këshilluese në pylltari, inxhinieri biologjike, planifikim hapësinor, menaxhimin e zonave malore). Për shkak të sipërfaqeve të mëdha pyjore dhe rëndësinë e tyre në Kosovë, kërkesa për profesionistët pyjore në administratë, dhe në organizata qeveritare dhe jo-qeveritare që merren me mbrojtjen e natyrës, është në rritje.

Një numër i konsiderueshëm i të diplomuarve mund të punësohen edhe në ndërmarrje private, si serra për prodhim komercial (prodhim i pemëve dhe bimëve dekorative), por edhe në laboratorë të lëmisë relevante.

2.3 Krahasueshmëria ndërkombëtare e programit

Fakulteti: **Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit**

Emërtimi i programit të studimit: **Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit**

Bachelor Master Doktoratë

Numri i ECTS kredive për programin e propozuar të studimeve: **180**

Programi e studimit të universiteteve evropiane me të cilat është i krahasueshëm programi i Shkencave të Pyjeve dhe Mjedisit i Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (Universiteti #1 nënkupton Universitetin me të cilin programet e studimit janë në pajtueshmëri 80% dhe Universiteti #2 nënkupton Universitetin me të cilin jeni të ngjashëm)².

	Universiteti Ukshin Hoti, në Prizren	Universiteti #1	Universiteti #2
Emërtimi i universitetit	Universiteti Ukshin Hoti	Università Politecnica delle Marche (Ancona, Italy).	² Università degli Studi di Palermo (Palermo, Italy). ³ University of Ljubljana (Slovenia)
Fakulteti	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	Faculty of Agriculture	² Scienze Agrarie e Forestali ³ Biotechnical Faculty
Titulli i programit	Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit	Forest and Environmental Science	² Forest and Environmental Science ³ Forestry and Renewable Forest Resources
% e krahasueshmërisë		Rreth 80%	² Rreth 80% ³ Rreth 20%

2.4 Target grupi që i dedikohet programi

Në vitin e parë të studimeve në programin e Shkencave të Pyjeve dhe Mjedisit mund të regjistrohen të gjithë kandidatët të cilët kanë kryer Shkollat e Mesme të Larta (gjimnaze apo

²Bashkangjitur me Raportin e Vetvlerësimit do të gjeni kopjet e Programit të [Università Politecnica delle Marche](#), [Università degli Studi di Palermo](#) dhe [University of Ljubljana](#).

shkolla profesionale), kanë dhënë provimin e maturës dhe kalojnë testin provues nga njohuritë e shkencave natyrore dhe të njohurive elementare matematikore. Pranimi i kandidatëve bëhet nga lista e formuluar nga numri i poenëve të kandidatëve.

Kushtet e tjera i vendos Senati i UPZ-së.

2.5 Orientimi i programit të studimit sipas parimeve udhëheqëse të institucionit

Kurikula e studimeve e programit studimor Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit është në përputhshmëri me rregullat dhe kriteret e studimeve sipas sistemit të Bolonjës dhe në dy vite akademike kanë edhe lëndë zgjedhore por edhe punë praktike, ndërsa shpërndarja e ECTS-ve bëhet sipas peshës së lëndës. Numri i kredive është 60 kredi për vit të studimit që do të thotë nga 30 kredi për semestër. Nga kjo nënkuptohet se studimet Bachelor në këtë drejtim, kanë gjithsej 180 kredi. Studentët mundë të zgjedhin lëndët zgjedhore sipas listës së veçantë që ofrohet në kuadër të kësaj kurrikule (tabela e lëndëve zgjedhore) dhe numri i tyre përcaktohet sipas plotësimit me numrin e kredive për semestrin e cakëtuar.

Provimet mbahen me shkrim në formë të testit dhe me gojë – bashkëbisedim me arsimtarin. Kusht për të iu nënshtruar provimit është që studenti të ketë kryer gjatë vitit ushtrimet laboratorike me sukses dhe të ketë një vijueshmëri të kënaqshme në ligjërata. Si formë tjetër që ndikon në vlerësimin përfundimtar të studentit është edhe puna seminarike e cila aplikohet në disa lëndë. Në vlerësim përfundimtar të studentit ndikojnë edhe aktiviteti i studentit në ligjërata dhe ushtrime gjatë vitit akademik.

2.6 Qëllimi dhe profili i programit

Pylltaria është profesion, shkencë dhe aftësi e menaxhimit dhe ruajtjes së ekosistemeve pyjore për të mirën e përhershme të shoqërisë, mjedisit dhe ekonomisë. Prandaj, qëllimi është që të diplomuarit e pylltarisë të aftësohen për të menaxhuar ekosistemet pyjore nga aspektet biologjike-mjedisore, teknike dhe ekonomike.

Qëllimi kryesor i programit është që të ofrojë edukim të nivelit bachelor të pylltarisë. Për shkak të sipërfaqeve të mëdha pyjore dhe rëndësinë e tyre në Kosovë, kërkesa për profesionistët pyjore në administratë, dhe në organizata qeveritare dhe jo-qeveritare që merren me mbrojtjen e natyrës, është gjithnjë në rritje. Njohuri bazike në shkencat e natyrës, së bashku me aplikimin e tyre në pylltari, do të ofrojnë edukimin e nevojshëm për kërkesat e tregut të punës në lëmin e pylltarisë dhe shkathtësive të nevojshme në profesionale të

ndryshme, si dhe do ti aftësoj studentet për të vazhduar studimet e tyre në programin e ciklit të dytë – Master.

2.7 Rezultatet e pritura të mësimi

Ky program studimor është konceptuar për të udhëhequr studentët në një sekuencë logjike nga disiplinat themelore biologjike dhe teknike, përmes disiplinave ku ata njihen me komponentët e ekosistemit pyjor dhe me teknikat që lehtësojnë menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore.

Deri në fund të kursit, studentët duhet të:

- kryejnë aktivitetet e zyrtarit të pyjeve, apo bashkëpunëtor profesional në të gjitha aktivitetet pyjore;
- punojnë në kryerjen e inventarizimit të pyjeve dhe të marrin pjesë në zbatimin e programit të menaxhimit të pyjeve;
- kryejnë të gjitha punët profesionale në terren për kujdesin, revitalizimin dhe mirëmbajtjen e qëndrueshëm të pyjeve;
- njihen me pajisjet mekanike, teknikat dhe teknologjitë standarde që aplikohen në pylltari - kryesisht në marrjen e drurëve nga pyjet natyrore, kulturave pyjore dhe plantacionet.
- Për më tepër, Bachelor e Shkencave të Pyjeve dhe Mjedisit janë të trajnuar për të kryer punë profesionale për përmirësimin dhe planifikimin e pyjeve në rajonin e Kosovës por edhe për të mbrojtur pyjet kundër faktorëve abiotik dhe biotik, veçanërisht kundër zjarreve në pyje, dhe për të menaxhuar detyrat profesionale të zbatimit të programeve të menaxhimit të kafshëve të egra dhe bimëve, organizimin e gjuetisë bazë, dhe duke bashkëpunuar në hartimin e studimeve mjedisore.
- Ata gjithashtu do të njihen me teknikat dhe teknologjinë e ndërtimit të rrugëve pyjore, shitjen e asortimenteve drusore, organizimin e prodhimit në pylltari, dhe shëndetin dhe sigurinë në punë në pylltari.
- Ata janë të kualifikuar për të kryer punën individuale në ndërmarrjet private dhe si oficerë qarkut pyjore, ose për t'u përfshirë në punë ekipore në lidhje me të gjitha detyrat e tjera në pylltari, natyrën dhe mbrojtjen e mjedisit.

- Ata janë të përgatitur për të vazhduar zhvillimin e tyre profesional në seminare dhe punëtori gjatë punës së tyre dhe si rezultat i studimeve të tyre formale ata janë plotësisht të aftë të vazhdojnë studimet master.

2.8 Raporti në mes të pjesës teorike dhe asaj praktike

Në secilën nga lëndët e përshkruara nga planprogram gjendet edhe raporti në mes të pjesës teorike dhe asaj praktike. Në përgjithësi raporti ndërmjet pjesës teorike dhe ushtrimeve është përafërsisht 1:1 (50% me 50%).

2.9 Llogaritja e ECTS-ve

Programi i studimeve në drejtimin e Shkencave të Pyjeve dhe Mjedisit është me kohë të plotë. Programi i studimeve është 3 vite (180 ECTS) i ndarë në 6 semestra (1 semester ka 30 ECTS). Të gjitha lëndët janë të ngarkuara me vlerën e ECTS, dhe se një (1) ECTS është e barabartë me (20) njëzet deri në tridhjetë (30) orë mësimi. Ato janë llogaritur sipas shembullit të tabelës si më poshtë:

Vëllimi dhe sasia e nevojshme e punës: Numri i kredive

Aktiviteti	Ore	Jave	Gjithsej
Ligjerata	3	15	45
Ushtrime	2	15	30
Kontakte me mësimdhënësin/kons.	1	15	15
Kolokviume	1	5	5
Detyra shtëpie	1	13	13
Koha e studimit vetanak e studentit	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	1	5	5
Koha e kaluar ne vleresim (teste, provim final)	2	3	6
Projekte etj.	3	1	3
Gjithesejt ngarkesa			152 orë

2.10 Puna praktike – intership

Përmes koordinorit për mësim ose prodekanit për mësim synohet për punë praktike në pyje apo fushat relevante. Qëllimi kryesor i yni është që t'ju mundësojmë studentëve vizata studimore në universitet partnere e sidomos në Universitetin e Ljubljanes, Universitetin Politeknik ne Ankona dhe atë Bujqësor të Tiranës meqë edhe kemi marrëveshje

bashkëpunimi me këto universitete për këtë profil studimor (shih marrëveshjet në Anex dokument). Gjithashtu studentët do të kenë mundësi për vizita studimore praktike edhe në Ministri apo institucione relevante.

2.11 Plani i hulumtimeve për programin

Në të ardhmen pritet që në bashkëpunim me mësimdhënësit me punimet e tyre të marrin pjesë në konferenca të ndryshme dhe të botohen nëpër revistat shkencore kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Mësimdhënësit e FSHJM, në formë individuale zhvillojnë hulumtime të ndryshme shkencore nga fushat e tyre studimore, pra edhe në fushën e pylltarisë. Këto hulumtime kryesisht synojnë arritjen dhe prezantimin e rezultateve shkencore nga fushat e studimit të tyre të cilat kohë pas kohe prezentohen në konferenca dhe takime tjera shkencore në vend dhe jashtë vendit.

2.12 Kushtet e regjistrimit dhe të pranimit të studentëve

Numri i studentëve të cilët pritet të regjistrohen në vitin e parë është 50, studentët do të regjistrohen në studime të rregullta.

Në vitin e parë të studimeve mund të regjistrohen të gjithë kandidatët të cilët kanë kryer Shkollat e Mesme të Larta (Gjimnaze apo shkolla profesionale), kanë dhënë provimin e maturës dhe kalojnë testin provues nga njohuritë e shkencave natyrore dhe të njohurive elementare matematikore. Pranimi i kandidatëve bëhet nga lista e formuluar nga numri i poenëve të kandidatëve.

Në këtë program, sikurse edhe në programet tjera të universitetit, pranohen kandidatë nga e gjithë Kosova, nga Shqipëria, Mali i Zi etj. Kandidatët nga viset jashtë Kosovës para konkurimit bëjnë nostrifikimin e shkollimit të tyre të realizuar jashtë Kosovës.

Titulli i Gradës akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar

Studimet në këtë program janë të nivelit BA (3 vjeçare), me gjithsejt 6 semestra nga 30 ECTS secili prej tyre, gjithsejt 180 ECTS.

Pas përfundimit me sukses të studimeve, kandidati merr titullin: ***Baçellor i Shkencave të Pyjeve dhe Mjedisit.***

2.13 Pasqyra e programit

Programi: Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit - Bachelor (Bsc)

Viti I							
Semestri I				Orë/javë			
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi	
1.	O	Matematikë	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj	
2.	O	Kimi e përgjithshme dhe inorganike	3	2	6	Prof. Dr. Ramë Vataj	
3.	O	Bazat e ekonomisë	3	2	6	Prof. Ass. Dr. Hamdi Hoti	
4.	O	Biologjia e shtazëve	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Kasum Letaj	
5.	O	Fizikë	3	2	6	Prof. Ass. Dr. Meleq Bahtijari	
Total					30		
Semestri II							
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi	
1.	O	Biologjia e bimëve	3	2	6	Prof. Ass. Dr. Bekim Gashi	
2.	O	Kimi organike	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Musaj Paçarizi	
3.	O	Pedologjia e pyjeve	2	2	5	Mr. sc. Muhamet Zogu	
4.	O	Informatikë	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Malush Mjaku	
5.	O	Gjuhë angleze	2	2	5	Dr. Jusuf Mustafa	
6.	Z	Lëndë zgjedhore			3		
Total					30		
Viti II							
Semestri III							
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi	
1.	O	Kimia e tokës	3	2	6	Prof. Dr. Fran Gjoka	
2.	O	Gjenetika e pyjeve	3	2	6	Prof. Dr. Fatmir Laçej	
3.	O	Agropylltari	3	2	6	Prof. Ass. Dr. Shukri Maxhuni	
4.	O	Dendrometria	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Ervin Toromani	
5.	O	Mikrobiologjia e tokës	3	2	6	Prof. Ass. Dr. Shukri Maxhuni	
Total					30		
Semestri IV							
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi	
1.	O	Silvikultura	3	2	6	Prof. Dr. Vath Tabaku	
2.	O	Patologjia e pyjeve	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Fadil Musa	
3.	O	Entomologjia e pyjeve	2	2	5	Prof. Ass. Dr. Fadil Musa	
4.	O	Sistematikë dhe botanikë e pyjeve	3	2	6	Prof. Ass. Dr. Elez Krasniqi	
5.	O	Mekanizimi i pyjeve	2	2	5	Prof. Asoc. Dr. Vasilaq Mine	

6.	Z	Lëndë zgjedhore			3	
Total					30	
Viti III						
Semestri V						
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1	O	Ekologjia e bimëve me gjeobotanikë	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Fadil Millaku
2.	O	Administrimi i resurseve pyjore dhe i mjedisit	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Leonidha Peri Prof. Asoc. Dr. Orion Ngjela
3.	O	Ergonomia e pyjeve	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Vasilaq Mine
4.	O	Monitorimi i mjedisit	3	2	6	Prof. Asoc. Dr. Shukri Maxhuni
5.	O	GIS për analizën e peizazhit	3	2	6	Dr. Ferim Gashi
Total					30	
Semestri VI						
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1.	O	Meteorologjia	3	2	6	Prof. Dr. Arben Alla
2.	O	Fitosociologjia e pyjeve	3	2	6	Prof. Ass. Dr. Elez Krasniqi
3.	O	Principet e menaxhimit të pyjeve	2	2	5	Prof. Asoc. Dr. Leonidha Peri
4.	O	Mbrojtja e pyjeve	3	2	6	Prof. Ass. Dr. Elez Krasniqi
5.	Z	Punë praktike ose/dhe Lëndët zgjedhore			3	/
6.	O	B.Sc. Teza			4	
Total					30	

Lëndët zgjedhore			Orë/javë			
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS	Mësimdhënësi
1	Z	Prodhimi i pyjeve	2	1	3	Prof. Ass. Dr. Edmond Pasho
2	Z	Hidrologjia e pyjeve	2	1	3	Prof. Dr. Arben Alla
3	Z	Prodhimi bimor	2	1	3	Prof. Ass. Dr. Shukri Maxhuni
4	Z	Mykorhiza e pyjeve	2	1	3	Prof. Asoc. Dr. Fadil Millaku
5	Z	Silvikultura urbane	3	1	3	Prof. Dr. Vath Tabaku
6	Z	Mbrojtja e pyjeve nga zjarret	2	1	3	Prof. Ass. Dr. Ramiz Metaliaj
7	Z	Inxhinieringu i pyjeve	2	1	3	Prof. Asoc. Dr. Vasilaq Mine
8	Z	Politikat mjedisore	2	1	3	Prof. Ass. Dr. Elez Krasniqi
9	Z	Revitalizimi i pyjeve	2	1	3	Prof. Ass. Dr. Elez Krasniqi
10	Z	Punë praktike	2 javë (80 orë)		3	Përgjegjësi i programit

Shkurtesat: L – Ligjerata; O – Obligative; Z – Zgjedhore

2.14 Përshkrimi i moduleve

Lënda: Matematikë

Përshkrimi i lëndës: Gjeometri analitike. Vektorët gjeometrikë dhe veprimet me ta. Shprehja e veprimeve me vektorët. Prodhimi numerik vektorial. Ekuacione të vijave dhe veprimeve me vektorët. Prodhimi numerik vektorial. Ekuacione të vijave dhe sipërfaqeve. Algjebra lineare. Hapsirat vektoriale. Matricat. Përcaktoret. Analizë matematike. Bashkësitë, numrat realë. Funkzioni numerik. Integrali i përcaktuar. Integrali i caktuar. Probabiliteti. Parimi i shumëzimit. Statistika. Popullata dhe zgjedhja.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde do të jetë aftësimi i studentëve që njohuritë e fituara nga ky kurs t'i shfrytëzojnë me sukses në inxhinierin pyjore dhe në jetën e përditshme.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të kuptojnë problematikat themelore nga matematika dhe të analizojnë situata të ndryshme të një problemi duke zgjedhur zgjidhjen optimale.
- Të kuptojë se si aplikohen konceptet bazë të Matematikës në disiplinat e tjera.
- Të kuptojnë, të dinë dhe të diskutojnë për vektorët dhe aplikimin e gjeometrisë.
- Të kuptojnë rëndësinë e probabilitetit dhe metodave statistikore.
- Të kuptojnë dhe të shpjegojnë ekuacionet.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%. Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- Rrapo, Tabaku, Matematika e lartë dhe e Aplikuar, 1986
- Mitre, Stringa. Etj, Matematika I (ribotim) 2004
- Ruseti, Shundi, Leka, Ushtrime të Matematikës (ribotim) 2004
- Rrapo, Memetaj, Belegu, Probabilitet dhe Statistikë. 2006
- Rrapo, Belegu, Matematika, Tekst për studentët e Fakultetit të Ekonomisë dhe të Agrobiznesit. 2009.
- Mitre, Stringa etj, Matematika I (ribotim), 2004. Tiranë.
- Rrapo, Memetaj, Belegu, Probabilitet dhe Statistikë, 2006.
- Fundamental Methods of Mathematical Economics Alpha C. Chiang
- Mathematics for Economists, Carl P. Simo.

Lënda: Kimi e përgjithshme dhe inorganike

Përshkrimi i lëndës: Ekuacionet kimike. Gazrat. Ligji i kombinuar i gazrave. Gazi ideal, përzjerjet. Gazrat Real. Forcat ndërmolekulare: Ndryshimet fazor dhe gjendja e materies. Forcat ndërmolekulare: vetitë fizike të substancave të pastra. Diagramet e fazës. Ndryshimet e energjisë në sistemet kimike: parimet bazë. Termokimi. Entalpia në praktikë. Drejtimi i ndryshimeve kimike. Entropia. Energjia Gibbs. Tretësiart: përqendrimi. Koloidet. Ekuilibri kimik. Ekuilibrat në kushte të ndryshme. Acidet, bazat, kripërat. Elektrolitet dhe jo-elektrolite. Konstanta jonizuese, vlerat alfa, pH dhe përdorimet e tyre në praktike. Titrimi acid-bazë. Hidroliza. Pufferët. Indikatorët. Tretshmëria e elektroliteve, produktet e tretshmërisë. Elektrokimia e tretësirave. Reagjionet redox dhe nitrimet. Qelizat elektrokimike, përdorimi i tyre në praktikë. Përçueshmëria elektrike, përdorimi i saj praktik. Kinetika kimike. Normat ligjore. Renditja e reaksioneve vs mekanizmat e reaksionit. Efekti i temperaturës dhe kataliza. Lidhjet kimike. Polariteti, elektronegativiteti, momentet dipole, gjeometria molekulare.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë njohjen e kimit bazike inorganike dhe organike dhe aplikimin e njohurive të fituara në lëmin e Pylltarisë. Gjatë këtij kursi studentët mund të mësojnë më shumë edhe për proceset dhe reaksionet kimike dhe rëndësinë e tyre në praktikë.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të kuptojnë dhe të dinë më shumë proceset kimike.
- Të kuptojnë, të dinë dhe të diskutojnë ligjet kimike dhe rëndësinë e tyre në praktikë.
- Të kuptojnë, të dinë dhe të diskutojnë për proceset elektrokimie dhe rëndësinë e tyre në aplikimin praktik.
- Të kuptojnë rëndësinë e reaksioneve kimike dhe katalizën e tyre.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuime, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Vlerësimi i dytë (kolokvium): 20%, Seminarët ose angazhime në praktikën laboratorike: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 45%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisje laboratorike etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- Azem Lajci , Vuksan Kalaj: KIMIA, për studentet e Mjekesise, stomatologjise dhe Biologjise. Universiteti i Prishtines, Prishtine 1998.
- Bettelheim, F.A., Brown, W. H., March, J., 2001. Introduction to general, organic and biochemistry, Sixth Edition. Harcourt College Publishers. Philadelphia, 713 p.

Lënda: Bazat e ekonomisë

Përshkrimi i lëndës: Principet bazike të ekonomisë: Qëllimi dhe roli i ekonomisë si shkencë sociale. Ekonomia dhe të menduarit ekonomik në shkencat e pyjeve, principet e ekonomisë në nivelin individual, të tregut dhe ekonomi. Prodhimi dhe teoria e çmimit: Definimi i faktorëve të prodhimit dhe ligji i të ardhurave rënëse (zbritëse), Teoria e çmimit: variabla, fiksi, totali, mesatarja dhe çmimet margjinale. Optimumi ekonomik dhe analiza margjinale. Specifiteti i prodhimit dhe çmimi i ndërmarrjës në fushën e pylltarisë dhe industrinë e përpunimit të drurit. Teoria e tregut, principet themelore të mëshitetjes së tregut dhe kërkesës. Ekuilibri i tregut. Koncepti i elasticitetit dhe zabtimi i tij. Partikularitetet e tregut të produkteve pyjore, tregjet praktikë, gara perfekte. Dështimi i tregut, fuqija e tregut, efektet ansore dhe të mirat publike. Ndikimi dhe roli i shtetit. Tregu dhe shteti, logjika dhe mekanizmi i intervenimit të shtetit në treg të pyjeve dhe produkteve të tyre. Ekonomia e mirëqenies, principet perparësisë ekonomike. Koncepti i çmimit minimal dhe maksimal. Rregullimi i tregut dhe ndikimi i tij. Taksat dhe ndikimi i tyre në treg. Hyrje në makroekonomi; konceptet bazike dhe principet e makro-ekonomisë. Indikatorët e makroekonomisë: rritja e produktit vendor (domestic), inflacioni, papunësia, indeksi i shkembimeve, balanca e pagesave, borxhi public, indeksi-shkalla e interest. Mekanizmat dhe proceset e makroekonomisë.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë njohuri lidhur me principet bazike të ekonomisë, të menduarit ekonomik në sektorin e shkencave të pyjeve dhe mjedisit si dhe dhjetë principet themelore të ekonomisë në nivelin individual të tregut në ekonomi.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të zotërojnë konceptet baze ekonomike (pamjaftueshmëria e kostot oportune).
- Të njohin veçoritë e ekonomisë pyjore në raport me dege të tjera të ekonomisë.
- Të njohin konceptin e investimit e të zotërojnë metodat e llogaritjes së investimeve.
- Të kuptojnë, të dinë dhe të diskutojnë ligjet kimike dhe rëndësinë e tyre në praktikë.
- Të kuptojnë, të dinë dhe të diskutojnë për taksat dhe ndikimin e tyre në treg.
- Të kuptojnë rëndësinë e makroekonomisë.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuime, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- N. Gregory Mankiw, Mark P. Taylor: Ekonomiksi, UET Press. 2012.

Lënda: Biologjia e shtazëve

Përshkrimi i lëndës: Biologjia qelizore: Qeliza si njësi themelore të jetës. Metodën në biologjinë qelizore. Struktura dhe funksioni i qelizave eukariote dhe prokariote (organizmat njëqelizor dhe shumëqelizor); Membranat qelizore dhe transporti; kompartmentet brendaqelizore; metabolizmi; Cytoskeleti; ciklet qelizore dhe sinjalet qelizore; struktura dhe funksioni i indeve.

Struktura dhe shumëllojshmëria e kafshëve: Morfologjia dhe fiziologjia e sistemeve të ndryshme të organeve të kafshëve me theks në organizmat e model; riprodhimi dhe zhvillimi; ndërveprimi midis kafshëve dhe mjedisit të tyre; ndryshimet e mjedisit dhe ekosistemi.

Karakteristikat morfologjike, biologjike dhe ekologjike të shtazëve më të rëndësishme dhe tipike të taksonëve të pyjeve tona: Nematoda, Arachnida, Myriopoda, Insekta, Amphibia, Reptilia, Aves dhe Mamalia. Sistematika dhe dëterminimi i insekteve, veçanërisht insektet fitofage-dëmtuese të pyjeve Kosovare. Dinamika e popullacioneve.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë njohjen e proceseve biologjike themelore nga niveli qelizor e deri në nivel organesh apo organizmit shtazor. Fitimi i njohurive lidhur me morfologjinë, bionominë, etologjinë dhe ekologjinë e shtazëve pyjore dhe rëndësinë e tyre për drunjtë dhe pyjet.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:

- Të jenë në gjendje të diskutojnë ndërtimin dhe funksionin e strukturave qelizore.
- Të kuptojnë dhe të dinë më shumë për shumëllojshmërinë, morfologjinë dhe fiziologjinë e organizmave shtazor.
- Të dinë parimet bazë të aspekteve biologjike dhe ekologjike të shtazëve më të rëndësishme dhe tipike të pyjeve.
- Të kuptojnë rëndësinë e organizmave shtazor në funksion të ambientit.
- Të zbatojnë njohuritë teorike në praktike.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita konsultive, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuime, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- Isa Elezaj, Kasum Letaj. Biologjia qelizore. Universiteti i Prishtinës, 2012, Prishtinë.
- Dervish Rozhaja. Fiziologjia krahasuese. Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2002, Prishtinë.
- Ruppert, E.E., Barnes, D.R., 1996. Invertebrate zoology. Sixth edition. Saunders College Publishing.

Lënda: Fizikë

Përshkrimi i lëndës: Kinematika. Forca dhe ligjet e Njutonit. Puna dhe energjia. Impulsi dhe momenti i sasisë së lëvizjes. Oscilatori i thjesht harmonik dhe elasticiteti. Lëngjet. Temperatura dhe nxehtësia. Termodinamika. Valët dhe zëri. Forcat elektrike dhe fushat elektrike. Forcat magnetike dhe fushat magnetike. Valët elektromagnetike. Reflektimi dhe thyerja e dritës. Grimcat dhe valët. Fizika atomike, Modeli i Borit i atomit të hidrogjenti. Spektrat. Efekti fotoelektrik. Fizika bërthamore dhe radioaktiviteti. Rrezatimit jonizues, energjia bërthamore dhe grimcat elementare.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë njohjen e proceseve të fizikës themelore dhe zbatimin e sajë në shkencat e jetës.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që të:

- Të din konceptet dhe ligjet themelore të fizikës
- Të krahason dhe të nxjerr përfundime në lidhje me fenomene të ndryshme të fizikës.
- Të njihet dhe ti përvetson konceptet themelore të fizikës
- Të kuptoj ligjshmëritë e fenomeneve të caktuara fizike
- Të zbatoj njohurit e fituara në fenomene të ndryshme biologjike.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuime, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- Dr. S. Skenderi, Dr. R. Maliqi, Fizika për studentët e fakulteteve teknike, Prishtinë.
- Physics.F. J. Kelker, W. E. Gettys, M. J. Skove, 2nd ed. McGraw-Hill, Inc. New York 1993

Lënda: Biologjia e bimëve

Përshkrimi i lëndës: Citologjia e bimëve. Qeliza si strukturë bazike e të gjithë organizmave, komponimet elementare dhe molekulare, biomembranat dhe kompartmentarizimi qelizor; protoplasti; aloplasti, organelet qelizore; vakuola dhe muri qelizor; ndarja qelizore-mitoza

dhe mejoza. Histologjia, origjina e indeve bimore, kriteret për klasifikimin , tipat e indeve bimore dhe benifitet e tyre. Morfologjia e kormofiteve. Tipat e trupit të bimëve, vështrim mbi origjinën, strukturën dhe funksionin e organeve themelore të bimëve të larta; kërcelli, rrënja, gjethi; format e gjetheve të bimëve të larta dhe metamorfoza e bimëve e indukaur nga mjedisi. Shumimi seksual dhe aseksual i bimëve dhe kërpudhave.

Fiziologjia e bimëve. Potenciali uxor i bimëve, transporti i ujit dhe materieve minerale. Ushqimi mineral i bimëve. Fotosinteza, reaksionet e dritës dhe errësirës. Metabolizmi C3, C4 dhe CAM. Frymëmarrja bimore. Faktorët që ndikojnë në fotosintezë dhe frymëmarrje. Rritja dhe zhvillimi i bimëve, rregullatorët e rritjes. Fotoreceptorët e bimëve, lëvizjet e bimëve. Fiziologjia e rezistencës së bimëve.

Qëllimet e lëndës: Lënda ka si mision që studentëve t'u ofrojë njohjen anatomisë dhe morfologjisë së bimëve si dhe njohjen e proceseve fiziologjike që kryhen në organizmat bimor.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të din anatominë dhe morfologjinë e organizmave bimor.
- Të kuptojnë mënyrat e shumimit të bimëve.
- Të kuptojnë rëndësinë e procesit të ushqimit mineral, transpirimit, fotosintezës dhe të frymëmarrjes te organizmat bimor.
- Të kuptojnë dhe të shpjegojnë proceset e rritjes dhe zhvillimit të bimëve.
- Njohurit e fituara të zbatojnë në praktikë.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike në laborator, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuime, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 70%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- Peter H. Raven, Ray F. Evert, Susan E. Eichhorn: Biologjia e bimëve, (perkth. Endrit Kullaj) UFO Press, Tiranë, Albania, 2008.
- Ferat Rexhepi: Botanika 1 dhe 2, FSHMN, Universiteti i Prishtinës, 2000.
- Fiziologjia e bimëve (dispensë ligjëratah)
- Bekim Gashi: Praktikum i Fiziologjisë së bimëve (dispensë), 2015.
- Vjollca Ibro: Fziologjia e bimëve. Universiteti Bujqësor i Tiranës.
- More R. Clark W.D. (1995): Botany. Plant form and function. Wm. C. Brown Publishers, Dubuque, IA, USA.

Lënda: Kimi organike

Përshkrimi i lëndës: Hidrokarburet dhe derivatet e tyre të oksigjenit: hidrokarburet kryesore, alkoolet, fenolet, eteret, aldehidet, ketonet, acidet karboksilike dhe derivatet e tyre. Metodot e përgatitjes, vetitë, reaksionet, përdorimet praktike. Lipidet: vetitë fizike dhe kimike. Komponimet organike të azotit, fosfor dhe sulfurit. Izomeret: llojet dhe veçanërisht aktiviteti optik. Karbohidratet: Klasifikimi, reaksionet kimike dhe përdorimi praktik. Aminoacidet: Metodot e përgatitjes, vetitë acid-bazë, reaksionet.

Qëllimet e kursit(modulit): Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të thellojnë njohuritë për komponimet e karbonit dhe vetitë karakteristike të tyre, përmes aktiviteteve të ndryshme studimore dhe punëve laboratorike. Studentët duhet të zhvillojnë dhe të kultivojnë shprehitë dhe shkathtësitë për punë të pavarur teorike, eksperimentale e praktike dhe të krijojnë kulturë e edukatë për mbrojtjen e mjedisit.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

- Të njohin komponimet organike dhe vetitë e tyre.
- Të kuptojnë dhe të përshkruajnë reaksionet e komponimeve organike.
- Të krahasojnë komponimet organike me ato inorganike si dhe në mes grupeve të ndryshme të komponimeve organike.
- Të klasifikojnë komponimet organike sipas strukturës dhe grupeve funksionore të tyre.
- Të projektojnë dhe hartojnë metodat e analizës dhe të sintezës të komponimeve organike, me theks të veçantë në funksion të ushqimit.
- Të zbatojnë rregullat e unionit ndërkombëtar (IUPAC) për emërtim të komponimeve organike.

Metodologjia e mësimdhënies: Procesi mësimor zhvillohet nëpërmes leksioneve, debateve, punës laboratorike, demonstrimeve, kolokviumeve, punës seminarike etj.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Vlerësimi i dytë (kolokvium): 20%, Seminarët ose angazhime tjera: 5%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 50%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1:1 (2+2 orë).

Literatura:

- K. Peter C. Vollhard, N. E. Score, Organic Chemistry, Structure and function, New York, Basingstoke, 2003
- S. H. Pine, J. B. Handricson, D. J. Cram, G. S. Hammond, Organic Chemistry
- G. Damani, Kimia Organike, Teori dhe probleme të zgjidhura, Tiranë, 2006

Praktikumet:

D. L. Pavia, G. M. Lampman, G. S. Kriz, R. G. Engel Introduction to Organic Laboratory Techniques, (a small scale approach) ,Saunders College Publishing, 1990, Fort Worth, Philadelphia, San Diego, New York, Orlando, Austin, San Antonio, Toronto, Montreal, London, Sydney, Tokyo .

Ch. E. Bell, A. K. Clark, D. F. Taber, O. R. Rodig, Organic Chemistry Laboratory, Saunders College Publishing, 1998, Fort Worth, Philadelphia, San Diego, New York, Orlando, Austin, San Antonio, Toronto, Montreal, London, Sydney, Tokyo .

Lënda: Pedologjia e pyjeve

Përshkrimi i lëndës: Hyrje në pedologji, prezantimi i degëve, kërkimeve dhe fushave shkencore në Pedologji. Njohuri bazë për tokën dhe përbërjen e korës së tokës. Njohuri bazë për tokëformimin dhe kronologjinë gjeologjike. Mineralogjia dhe Petrografia. Vetitë fizike të tokës (mineralet e argjilit, tekstura, stuktura, dendësia, poroziteti, vetitë fiziko-mekanike). Vetitë ajrore të tokës (proceset e oksido reduktimit, përbërja e atmosferës së tokës, qarkullimi i ajrit). Vetitë ujore të tokës (format, lëvizja, cikli hidrologjik dhe ndikimi i njeriut, relacioni tokë-ujë). Vetitë kimike të tokës (koloidet e tokës, tretja e tokës, këmbimi i joneve, pH e tokës, kapaciteti i bufereve, përshtatshmëria e elementeve ushqyese). Materia organike e tokës (cikli i karbonit, akumulimi dhe shpërbërja, përbërja e humusit, vetitë dhe tipet e humusit, tipet e tokave organike, perdorimi dhe rëndësia e tyre për pylltari). Diversiteti i jetës në tokë (flora dhe fauna e tokës). Cikli bio-gjeo-kimik i elementeve në sistemin tokë-bimë, (makro dhe mikroelementet). Gjenezja dhe klasifikimi i tokës (faktorët dhe proceset pedogjenetike, horizontet e tokës, sistemet e klasifikimit dhe tipet e tokave në Kosovë).

Qëllimet e lëndës: Të ofroj studentëve njohuri bazë për përbërjen e tokës dhe formimin e saj. Njohuri bazë për vetitë fiziko-kimike e ujore të tokës, faktorët dhe proceset pedologjike. Të njohë llojet e tokave.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje:

- Të dinë përbërjen e tokës dhe faktorët e proceset e tokëformimit.
- Të njohin biodiversitetin e tokës (florën dhe faunën e tokës).
- Të kuptojnë ciklin e qarkullimit të elementeve në natyrë
- Të kenë njohuri të mjaftueshme për sjelljen në laborator dhe metodat analitike për analizë të tokës, si dhe interpretimi i rezultateve.
- Të aftësohen që të përgatisin projekte hulumtuese duke përshkruar vetitë e tokës.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike në laborator dhe terren, konsultime, seminare, kolokviume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium I): 20%, Vlerësimi i dytë (kolokviumi II): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 45%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, vizita terreni, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1:1 (2+2 orë).

Literatura:

- Shkencat e tokës I dhe II, Xh. Elezi, M. Zogaj, A. Halimi. 2004 (Materiale interne për student).
- Shkencat e tokës I dhe II – Pjesa praktike, Xh. Elezi, M. Zogaj, A. Halimi. 2004 (Materiale interne për student).
- Forest Soils, Properties and Management. Osman, Khan Toëhid, 2013. Springer
- Fundamentals of soil science, 8 E, Henry D.Foth, 1990.
- Soil Sampling, Preparation, and Analysis, Kim H. Tan, 1996.

Lënda: Informatikë

Përshkrimi i lëndës: Njohuri të përgjithëshme për informatikën. Sistemimi i numërimit në bazë. Sistemi i punës me Windows. Paketa Microsoft Office. Moduli Word, me element të dritarës. Veprimet me insert. Moduli Excel dritarja e tij. Elementët e Workbook dhe Worksheet. Veprimet me Matrica. Administrimi dhe në fund printimi. Grafikët dhe diagramat. Përpunimi i të dhënave. Përdorimi i Macros për automatizmin e detyrave. Krijimi i një raporti përmbledhës. Microsoft Excel Solver në zgjidhjen e problemeve.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë njohjen bazike të informatikës dhe aplikimin e sajë në shkencat e jetës, si dhe njohja e aplikimit të softeve kompjuterike që përdoren në matjet biometrike. Qëllimi mbështetet në njohjen e mënyrave më të lehta dhe shpejta për të databazave për hulumtimet në lëmin e bioshkencave.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të dinë për programet office dhe sistemin operativ windows.
- Të kuptojnë, të dinë dhe të diskutojnë për aplikimin e programeve të ndryshme kompjuterike në shkencat e jetës.
- Të dinë për aplikimin e programeve profesionale në fushën e tyre.
- Të dinë të hartojnë diagrame dhe grafika.
- Të formojnë shkathtësi për hulumtime në databaza të lëmisë së shkencave ekzakte dhe mjedisit.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuime, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 70%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1:1 (2+2 orë).

Literatura:

- Attwood, T.K. Parry-Smith, D.J. Introduction to Bioinformatics, Prentice Hall, 1999, United kingdom. ISBN: 0-582-32788-1.

Lënda: Gjuhë angleze

Përmbajtja: Me theks të posaçëm është disenjuar multi-silabus. Kursi fokuqohet në kompetencën e komunikimit, duke inkorporuar shkathtësit e komunikimit receptiv dhe komunikues- dëgjimin , të folurit, lëximin, shkrimin r kuptueshëm. Leksikografisë, fonologjisë, gramatikës dhe orografisë i është dhënë ven kryesor. Lëximi i kuptueshëm , analiza e teksteve shkencore dhe e teksteve faktuale dhe fiktionale. Shkrimi i qartë duke përfshirë korrespondencën biznesore. Të dëgjuarit e qartë duke përfshirë materialet autentike. Simulimit, luejtja e roli. Studime bazuar në shembuj, prezantime. Kursi mbullon tema të ndryshme që kanë të bëjnë me shkencën në fushëm e natyrës së gjallë: agronominë, pylltarinë, zooteknikën, biologjinë, mikrobiologjinë, bioteknologjinë, shkencën e ushqimit, arkitekturën e relievit, shkencën e drurit si dhe kontekste të ndryshme të komunikimit, duke filluar nga komunikimi i përgjithshëm deri të komunikimi biznesor.

Qëllimi i lëndës: Fitimi i shkathtësive në të folur dhe shkruar nga lëma e pylltarisë dhe biznesit. Të lëxuarit, dëgjuarit dhe të shkruarit e drejtë të gjuhës angleze për nga lëmi përkatës. Forma dhe metodat e mësimdhënies: Pjesëmarrja aktive në leksione është e detyrueshme; provimi është me gojë dhe shkrim.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i studentëve bëhet duke caktuar përqindjen e pjesëmarrjes së secilit vlerësim gjatë ushtrimeve në vlerësimin definitiv. Vlerësimi i parë: 20 %, Vlerësimi i dytë: 20%, Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%, Vijimi i rregullt 5%, Provimi final 45%, Totali 100%

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 70%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1:1 (2+2 orë).

Literatura:

- Screpita: English for You, compiled by Eleonora Marendic.

- Audio visual materials.
- Optional: The Oxford - Duren Pictorial English Dictionary, Oxford Univesrity Press, 1981, ISBN 0-19-281983-6.

Lënda: Kimia e tokës

Përshkrimi i lëndës: Përbërja kimike dhe mineralogjike e tokave. Përbërja mineralogjike e argjileve dhe roli i tyre. Përbërja thelbësore e tokave dhe qarkullimi i elementeve në natyrë. Koloidet e tokës dhe sorbimi i tyre. Efekti i këmbimit të kationeve në potencialin electrokinetic të koloideve. Karakteristikat e mekanizmave më të rëndësishm të sorbimit nga toka. Sorbimi i kationeve në tokë dhe ligjet e saj. Sorbimi i anioneve në tokë dhe modelet e sorbimeve. Kapaciteti buferik i tokës. Reaksionet e tokës, acidifikimi i tokave, metodat dhe trajtimi i tyre. Gjendja redox në tokë. Zgjedhja e tokës dhe metodat e studimit të tokës, tokat e kripura. Radioaktiviteti i tokës. Ajrosja e tokës. Strategjia për mbrojtjen e tokës – ruajtja nga acidifikimi, kripëzimi dhe ndotja e tokave në Kosovë dhe BE.

Qëllimet e lëndës: Ky kurs do të pajisë studentët me aftësinë për të shpjeguar se si fazat e ngurta të tokës ndikojnë në proceset kimike të sistemit të tokës. Njohja e proceseve të tilla do të japë studentëve një kuptim njohjes se çfarë procese dominojnë në vetit kimike dhe mineralogjike të tokave dhe që do të ndihmojë në marrjen e vendimeve rehabilitimit të tokës, rikuperimit dhe menaxhimit të tyre.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të dinë rreth karakteristikave kimike të tokave, të cilat ndikojnë në karakteristikat e tokës dhe të pjellorisë së tokës.
- Të njohin funksionet e rëndësishme të caktuar ekologjike të tokës.
- Të marrin njohuri mbi rregullimin e karakteristikave kimike të tokës, të cilat përcaktojnë pjellorinë qëndrueshëm dhe mbrojtjen mjedisit.
- Për të kuptuar dhe përcaktuar metalet toksike.
- Të dinë strategjinë për mbrojtjen e tokës në Kosovë dhe BE.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike në laborator, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuime, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Vlerësimi i dytë (kolokvium): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Provimi final: 50%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (3+2 orë).

Literatura:

- Soil and Water Chemistry: An integrated approach. Author: M.E. Essington, CRC Press, 2003
- Soil Chemistry, H.L. Bohn, B.L. McNeal and G.A. O'Connor, John Wiley, 2001

- The Nature and Properties of Soils, 14th Edition, N.C. Brady and R.R. Weil, Pearson (Prentice Hall), 2007

Lënda: Gjenetika e pyjeve

Përshkrimi i lëndës: Objekti i shkencës së Gjenetikës. Ndërtimi i qelizës. Struktura e ADN dhe ARN, si mbartës të informacionit gjenetik. Replikimi (vetdyfishimi) i ADN. Kromozomet, morfologjia dhe struktura e tyre. Roli i kromozomeve gjatë ciklit jetësor të qelizës, mitoza dhe mejoza. Rregullat e transmetimit të tipareve prindërore tek pasardhësit. Teoria kromozomike e trashëgimisë. Krosingoveri (kryqkëmbimi). Hartat gjenetike dhe trashëgimia e seksit. Transmetimi i informacionit gjenetik për sintezën e proteinave. Transkriptimi, translacioni, kodi gjenetik. Mutacionet, klasifikimi i tyre. Trashëgimia jashtë bërthamore. Trashëgimia në procesin e riprodhimit. Ndryshueshmëria, marrëdhëniet trashëgimi – mjedis. Gjenetika e tipareve sasiore. Gjenetika e popullatave. Ligji Hardy-Weinberg. Modifikimi i strukturës gjenetike të popullatave.

Qëllimi i lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t’u ofrojë njohjen bazike të proceseve gjenetike dhe ndikimin e faktorëve mjedisor në tiparet gjenetike. Qëllimi mbështetet në njohjen strukturës gjenetike dhe populacioneve.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të njohin objektin e shkencës së gjenetikës si dhe metodat e studimit në gjenetikë.
- Të njihen me rregullat e transmetimit të tipareve prindërore tek pasardhësit, sipas analizës mendeljane.
- Të njohin acidet nukleike si mbartës të informacionit gjenetik, si dhe kromozomet si forma të organizimit të ADN-së.
- Të njohin transmetimin e informacionit gjenetik për sintezën e proteinave.
- Të njohin mutacionet dhe trashëgiminë jashtë bërthamore.
- Të njohin marrëdhëniet trashëgimi- mjedis, gjenetikën e tipareve sasiore si dhe gjenetikën e popullatave

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike në laborator, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 70%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Përshkrimi i lëndës: Bazat e rritjes së pyjeve, kushtet e mjedisit. Rrezatimi, temperatura, uji, ajri dhe përmbajtja me lëndë ushqyese. Modelimi i kushteve të mjedisit. Ndarja e vegjetacionit në Evropë. Zonat fitoklimatike dhe tipet e pyjeve në Kosovë. Bonitimi i stacioneve pyjore. Grumbulli pyjor si mjet bonitimi. Struktura e grumbujve pyjore. Rritja e grumbujve të thjeshtë një moshare. Modele zonale të prodhimit. Rritja e drurerve individuale. Modele të drurëve përfaqësues të pavarur nga pozicioni i tyre në grumbull dhe të drurëve individuale të varur nga pozicioni i tyre në grumbull. Modelimi i ndërhyrjeve pyjore. Përshkrimi klasik i rrallimeve. Rrallimet në grumbujt e thjeshtë një moshare dhe në grumbujt e përzierë shumë mosharë.

Qëllimi i lëndës: Studenti duhet të njihet me bazat e rritjes së pyjeve, faktorët fizikë, zonat e vegjetacionit evropian, rrallimet, modelet e rrallimeve të pyjeve etj.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të njohin kushtet mjedisore të rritjes së pyjeve.
- Të dinë tipet e pyjeve të Kosovës.
- Të njohin modelet zonale dhe rritjen e drurëve individual.
- Të dinë për strukturën e pyjeve dhe bonitimin e pyjeve.
- Të dinë të bëjnë rrallimet dhe aplikimin e tyre në rritjen e prodhimtarisë pyjore.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike në laborator dhe pyje, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokviume, provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 70%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (2+1 orë).

Literatura:

- [James L. Bowyer](#), [Rubin Shmulsky](#), [John G. Haygreen](#): Forest Products and Wood Science: An Introduction, Balckwell, 2007.
- Mine V, Postolo A, Tabaku V. “Rrallimet Tregtare” 2002

Lënda: Hidrologjia e pyjeve

Përshkrimi i lëndës: Uji si substancë, cilësitë hidrologjike dhe analiza e të dhënave. Matja e precipitimit dhe ndërputja (interpolacioni). Efektet e ndryshimit të klimës dhe ndërrimet. Ndërprerja e precipitimit pyjor, modelet e rënjes dhe rrjedhës trungore. Mjegulla dhe vesa si burim i ujit. Bora dhe rolet e sajë. Gutacioni. Rënia efektive e shiut. Modelet e transpiracionit dhe evapotranspiracionit. Rezistenca gojëzore, rrezatimi dhe evaporimi. Klimatologjia dhe precipitimi i madh, vërshimet dhe lymë. Dendrokronologjia dhe rekonstrukcioni i klimës. Balanca ujore e tokës – dheut në modelet hidrologjike të pyjeve. Të reshurat acidike. Konceptet themelore në ekologji dhe limnologji. Karakteristikat kryesore të ujerave rrjedhëse dhe amule, struktura fizike e ekosistemit, habitatit, nisha ekologjike; statusi kimik i ujerave natyral, qarkullimi i materies dhe rrjedha e energjisë (ligjet e termodinamikës), në ujin natyral dhe ujin e ndotur të mjedisit; hapësira jetësore. Karakteristikat biotike, biocenozat, populacionet, biocenozat bentike, diversiteti i specieve dhe zinxhiri i ushqimit (kryesisht në mjedisin e ujerave pyjor), prodhimi dhe roli i zonës së pyllëzuar, dekompsimi, roli i materieve ushqyese në proceset eutrofike. Organizimi i ujerave rrjedhëse. Proceset e vet pastrimit, biomonitorimi, çrregullimet në mjediset ujore veçanërisht në zonat pyjore, roli dhe ndikimi i akumulimit të lumenjve.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t’u ofrojë më shumë njohuri me hidrologjinë e pyjeve dhe rëndësinë e kësaj lëmie në mjediset pyjore. Qëllimi mbështet në njohjen me formave të ndryshme të ujerave dhe efektin e tyre qarkullues në pyje.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të njohin rolin dhe rendësin e lendes, metodat, teknikat dhe mjetet te cilat aplikohen.
- Të dinë efektin e ujërave, mjegullës dhe borës në mjediset pyjore.
- Të njohin karakteristikat e ujërave rrjedhëse dhe efektin e të reshurave në pyje.
- Të dinë ekologjinë dhe diversitetin e specieve të gjalla që jetojnë në këto habitate ujore.
- Të dinë efektet e ujërave rrjedhëse të ndotura në zonat pyjore në veçanti.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Vlerësimi i parë (kolokvium): 20%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 45%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (2+1 orë).

Literatura:

- Chang, M. (2004). Forest Hydrology: An Introduction to Water and Forests. C.H.I.P.S.

Lënda: Prodhimi bimor

Përshkrimi i lëndës: Parimet kryesore të shkencës bimore (prodhimit bimor) do të jenë me fokus që të njihemi me ndikimin e faktorëve mjedisor në kultura bujqësore, efekti i masave agroteknike, llojet e plehrave kimike dhe organike. Qarkullimi bimor fushor, rëndësia e rotacionit. Lëvrimi, llojet dhe mënyrat e aplikimit. Fara dhe koncepti i saj, kategoritë e farës bujqësore, Rendimenti si dhe klasifikimi i bimëve lavërtarë bujqësore si dhe të njihen me legjislativin e BE. Gjatë këtij kursi ju mund të njoftoheni në mënyrë të detajuar me mënyrat e bujqësisë intensive të dhe asaj të kestenzive të punimit të tokës dhe inkorporimit të gjetiveve që janë me potencial prodhues gjenetike shumë të larta .

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë njohjen e metodave të ndryshme që ofron shkencë bimore dhe mundësia e tyre në aspektin praktik. Rol do të jepet edhe mundësisë së njohjes së bimëve bujqësore, posaçërisht atyre bimëve që janë shumë të rëndësishme dhe ekzistenciale për jetën e njeriut.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të njohin rolin dhe rendësin e lendes, metodat, teknikat dhe mjetet te cilat aplikohen.
- Të dinë efektin e faktorëve abiotik dhe biotik në kultivimin e bimëve.
- Të njohin aplikimin e masave agroteknike, përdorimin dhe normimin e farës.
- Të dinë të llogarisin normat për plehërim.
- Të dinë të bëjnë selektimin e farave për mbjellje.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 70%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (2+1 orë).

Literatura:

- Aliu S. 2012. Bazat e prodhimit bimor, Prishtine, Ligjerata te autorizuar.
- Jalonkai M. 2002. Crop Production, Budapest, Hungary.
- Wolf, B.: 1996. Diagnostic techniques for improving crop production. Food products press, 426 s., ISBN 1-56022-858-X

Lënda: Mykorhiza e pyjeve

Përshkrimi i lëndës: Bazat e biologjisë së tokës-dheut pyjore dhe interakcionet në rhizosferë. Hyrje në fiziologji të ushimit mineral, strukturë dhe funksion të rrënjëve të drunjëve pyjor. Format e simbiozës mikrorhiziale, partneret në simbiozë dhe funksionet e biomasës tokësore. Struktura dhe zhvillimi i rrënjëve ektomykorhiziale në drunjtë e pyjeve. Roli i mikorhizave në ciklin e karbonit, azotit, fosforit dhe ushqyesve tjerë. Identifikimi dhe fiziologjia e tipeve të ektomykorhizave. Metodatat e identifikimit të komuniteteve ektomykorhiziale dhe hyrje në ekologjinë molekulare të tipeve të ektomykorhizave. Roli i ektomykorhizave në ekosistemet pyjore, sukcesioni i kërpudhave mykorhiziale dhe ektomykorhioza. Masat silviokulturale dhe faktorët tjerë antropogjenik në komunitetet e mykorhiziale. Metodatat e bioindikacionit të stresit në tokat pyjore dhe ekosistemet pyjore.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë më shumë njohuri me rolin e mikorhizave dhe interaksionin që ato kanë me drunjtë pyjor. Qëllimi mbështet në njohjen me tipeve të ndryshme të mikorhizave pyjore dhe rolin e tyre në ekosistemet pyjore.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të njohin rolin dhe rendësin e biologjisë së tokës-dheut pyjore dhe interakcionet në rhizosferë.
- Të dinë format e simbiozës mikrorhiziale dhe rolin e rrënjëve të bimëve drusore në këtë proces.
- Të njohin rolin e mikorhizave dhe rolin e tyre në të ushqyerin e bimëve.
- Të dinë për rolin e tyre në ekosistemet pyjore në përgjithësi.
- Të dinë metodatat që aplikohen për hulumtimet mikrorhiziale.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 55%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (2+1 orë).

Literatura:

- Smith SE, read Dj. 1997. Mycorrhizal Symbiosis. 2nd edition. Academic Press, London.

- Coleman DC, Crossley DA Jr, Hendrix PF. 2004. Fundamental of Soil Ecology, 2nd edition , Elsevier , London.
- Buscot F, Varma A (Eds). 2005. Microorganisms in Soils. Roles in Genesis and Functions. Springer Heidelberg.

Lënda: Silvikultura urbane

Përshkrimi i lëndës: Hyrje në silvikulturën urbane (definicioni, konceptet dhe përfitimet ekonomike, sociale dhe faunistike). Masterplan për zhvillimin e pylltarisë urbane, vizioni, qëllimi dhe objektivat. Historiku dhe dokumentacioni, përfitimet dhe proceset e përpunimit të tij. Plani strategjik dhe plani i mbarshtrimit të zonave të gjelbra. Njohja dhe cilësitë e llojeve pyjore dhe bimëve dekorative. Grumbullimi i farave të llojeve pyjore, shkurreve dhe atyre dekorative. Prodhimi i fidanëve të llojeve të bimëve dekorative. Teoria e krijimit, kompozimit dhe mbjellja në breza gjatësore të thjeshtë dhe të përbërë. Gjelbërimi i rrjedhjeve të vendeve ujore dhe të gërryera në brendësi ose periferi të zonave urbane. Kompozimet e llojeve. Gjelbërimi i banesave, zonave të banuara. Kompozimi, krijimi dhe mirëmbajtja e pyjeve urbane. Krasitjet, prerjet dhe restaurimi i zonave të gjelbra urbane.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë më njohuri në lidhje me aplikimin e kësaj lëmie në rregullimin dhe gjelbërimin e hapësirave urbane.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të njohin rëndësinë e silvikulturës urbane dhe zhvillimin e sajë.
- Të njohin llojet pyjore cilësore dhe bimët dekorative.
- Të dinë për mënyrat e ndryshme që aplikohen për prodhimin e fidanëve nga llojet dekorative.
- Të dinë për kompozimin e llojeve në gjelbërimin e hapësirave të ndryshme urbane apo private.
- Të dinë që të bëjnë mirëmbajtjen e bimëve dekorative urbane.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 55%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (2+1 orë).

Literatura:

- [Cecil C. Konijnendijk](#), [Kjell Nilsson](#), [Thomas B. Randrup](#) (2005): Urban Forests and Trees: A Reference Book. Springer.

Lënda: Mbrojtja e pyjeve nga zjarret

Përshkrimi i lëndës: Përgjithësime mbi zjarret në pyje. Bimësia pyjore e vendeve mesdhetare dhe kushtet klimatike specifike që favorizojnë zjarret në keto teritore. Disa patologji dhe dëme nga insektet mbi bimët pyjore që krijojnë kushte favorizuese për zjarret. Shkaqet e zjarreve me natyrë aksidentale dhe ciklike. Përcaktimi i vatrave të mundëshme të zjarreve, ngritja e sistemit të vrojtimit sinjalizimit. Masat për parandalimin e zjarreve: masa silvoteknike, mekanike dhe të veçanta. Masat për kufizimin e një zjarri. Efektet e djegies mbi biocenozën e ekosistemeve pyjore. Efektet e djegies masive të pyjeve në ndotjen e ajrit. Mekanizimi dhe motorizimi i procesit të shuarjes së zjarreve në pyje. Disa organizma bimore, kërpudhore, bakteriale, etj., që instalohen të parat në një teritor të djegur, masat për favorizimin e instalimit të tyre. Legjislacioni ynë dhe ai evropian mbi mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.

Qëllimi i lëndës: mbështet në njohjen e legjislacionit vendor dhe evropian mbi mbrojtjen e pyjeve si dhe shkaktarët e mundshëm që mund të qojnë deri tek zjarret në pyje. Qëllimi mbështet njohjen e strukturës pyjore dhe efektet që shkaktojnë disa shkaktarë natyral por edhe aksidental nga njeriu.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të njohin konceptin zjarrit në pyll.
- Të njohin infrastrukturën e nevojshme që nderohet me qellim parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje.
- Të njohin dhe të monitorojnë dëmin e shkaktuar nga zjarret në pyje.
- Të zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e duhura për zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe përdorimin e mekanizmave efikase në mbrojtjen e pyjeve nga zjarret.
- Të dinë që të parandalojnë zjarret.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 55%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (2+1 orë).

Literatura:

- Brown A.A. & Davids K.P. (1973) – Forest fire control and use. McGraw-Hill. New York.
- CHANDLER C., CHENEY P., THOMAS P., TRABAUD L. & WILLIAMS D. (1983) – Fire in Forestry. John Wiley & Sons, New York.

Lënda: Inxhinieringu i pyjeve

Përshkrimi i lëndës: Qarkullimi dhe trafiku në pyje. Tipet e qarkullimit publik. Qarkullimi publik dhe roli i tij për pylltari. Zhvillimi historik, gjendja dhe ardhmeria e qarkullimit

(komunikimit), publik. Zhvillimi historik i trafikut pyjor dhe qarkullimit pyjor. Karakteristikat e trafikut pyjor. Ngarkesa e trafikut dhe cilësia e transportit. Grafiki i ngarkesës pyjore dhe transporti i qarkullimit pyjor. Profili longitudinal dhe faktorët igradient longitudinal. Tërthorizimi ideal maksimal longitudinal. Kursi i pjerrtësisë longitudinale dhe igradientit ekuivalent. Formësimi i pjerrtësisë longitudinale, pikat e pushimit-ndalesës. Formësimi dhe elementet e kurbës vertikale. Profilet kryqëzore të komunikimi-qarkullimit pyjor. Format bazike dhe speciale të profileve kryqëzore. Tipet e profilit kryqëzor. Faktorët e gjerësisë të shtresave të ulta të rrugëve. Kapaciteti trafikor i rrugëve pyjore. Elementet e linjës qendrore të rrugës pyjore. Inklinacioni kryqëzor i hekurudhave nëpër rrugët pyjore. Zgjerimi i rrugëve hekurudhore pyjore dhe profili i hapur. Rrugët me leqe. Puna konstruktive për shtresën e ulët të rrugës. Konstruksioni për shtresën e sipërme të rrugës. Rruga hekurudhore dhe formimi i drenazhës. Rrugët pyjore në bazën shkëmbore jo stabile. Mirëmbajtja e rrugëve pyjore. Procedurat e mirëmbajtjes, organizimi dhe puna e mirëmbajtjes. Sigurimi i transportit nëpër rrugët pyjore dhe kategorizimi i rrugëve pyjore. Standardet e mirëmbajtjes. Rrugët pyjore në pronat pyjore private.

Qëllimi i lëndës: mbështet në njohjen e qarkullimit dhe rolin e rrugëve pyjore në ekosistemet pyjore.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:

- Të njohin konceptin qarkullimit dhe trafikun pyjor.
- Të njohin karakteristikat, cilësinë dhe ngarkesat e trafikut pyjor
- Të njohin format dhe rëndësinë e rrugëve pyjore.
- Të zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e duhura për hapjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve pyjore.
- Të dinë që të ruajnë pyjet nga efektet e mekanizmit dhe rrugëve pyjore në ekosistemin e pyjeve.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminarët ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 55%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 1.5:1 (2+1 orë).

Literatura:

- Potocnik, I., 2003. Forest road formation ëidth as an indicator of human impact on forest environment. Ekologia (Brtisl.).
- Potocnik, I., 1998. The environment in planning a forest road network. Forestry Sciences. Vol.54. Dordrecht; Boston, London: Kluwer Academic Publishers.

Lënda: Politikat mjedisore

Përshkrimi i lëndës: Politikat mjedisore në dobi të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale në harmoni me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Politikat-Aktet ndërkombëtare mjedisore lidhur me biodiversitetin (Konventa e Ramsarit, Konventa e Bernës, Konventa e Bonit, Konventa mbi tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe të faunës së egër-CITES, Konventa e Rios, Konventa e Aarhusit, Protokollin e Kartagjenës). Legjislacioni mjedisor në Kosovë. Legjislacioni për pyjet në Kosovë.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrohet njohuri bazë për politikat mjedisore në nivelin ndërkombëtar dhe në nivelin vendor. Kjo parashihet të ndërlihet edhe me përvoja praktike në ekosisteme të ndryshme nga mjedisi i Kosovës duke përfshirë edhe hapësira të përzgjedhura pyjore të Kosovës.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:

- të diskutojnë lidhur me rëndësinë e politikave mjedisore
- të kuptojnë dhe të dinë më shumë për Aktet ndërkombëtare mjedisore
- të kuptojnë dhe të dinë më shumë për politikat mjedisore vendore
- të kuptojnë rëndësinë e mbrojtjes së biodiversitetit në përgjithësi, në veçanti biodiversitetit në pyje
- njohuritë e fituara t'i zbatojnë në teori dhe në praktikë përmes aplikimit të njohurive që kanë të bëjnë me mjedisin.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ushtrime-ekspedita hulumtuese në natyrë, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuiume, seminare, Vlerësime (I&II), provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë: 10%, Vlerësimi i dytë: 10%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, materiale nga natyra (fotografi dhe incizime nga mjedise të ndryshme) etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 2:1 (2+1).

Literatura:

- Burnett, A. (2015): international Environmental Law. Electronic resource Guide (e-RG/...last updated April 5, 2015). American Society of International Law.
- MMPH (2013): Legjislacioni mjedisor në Kosovë 2007-2013. Vëllimi I. NTG "Blendi". Prishtinë. 541 p.
- REC-Shqipëri (2011): Akte ndërkombëtare mjedisore-Biodiversiteti. Gent. Grafik. Tiranë. 251 p.

Lënda: Revitalizimi i pyjeve

Përshkrimi i lëndës: Pyjet dhe rëndësia e tyre. Degradimi dhe shkaktarët e degradimit të pyjeve. Revitalizimi i pyjeve (Pse, ku, si të bëhet revitalizimi i pyjeve). Revitalizimi i funksioneve ekologjike. Revitalizimi i vlerave socio-ekonomike. Kthimi i peizazhit në gjendje të mëparme pylli. Revitalizimi i tipeve të ndryshme të pyjeve. Revitalizimi pas çrregullimeve (pas zjarreve, stuhive, menaxhimi i rrezikut nga llojet aliene invasive, kontrollimi i erozionit, rivendosja e pyllit në hapësirën (tokën) e braktisur). Respektimi i legjisllacionit për pyjet.

Qëllimet e lëndës: Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë njohuri bazë për revitalizimin e pyjeve. Kjo parashihet të ndërlihet edhe me përvoja praktike në ekosistem pylli në hapësira të përzgjedhura pyjore të degraduara por edhe të ruajtura të Kosovës.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje që:

- të diskutojnë lidhur me rëndësinë e revitalizimit së pyjeve
- të kuptojnë dhe të dinë më shumë për degradimet në pyje
- të kuptojnë pse, ku dhe si të bëhet revitalizimi i pyjeve
- të kuptojnë revitalizimin e funksioneve ekologjike dhe revitalizimin e vlerave socio-ekonomike
- të kuptojnë rëndësinë e revitalizimit pas çrregullimeve në pyje
- njohuritë e fituara t'i zbatojnë në teori dhe në praktikë

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ushtrime-ekspedita hulumtuese në natyrë, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuime, seminare, Vlerësime (I&II), provime.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i parë: 10%, Vlerësimi i dytë: 10%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%, Vijimi i rregullt: 10%, Provimi final: 60%, Total: 100%.

Mjetet e konkretizimit/ TI: Kompjuterë, projektori, tabela, pajisjet laboratorike, material nga herbariumi, material nga natyra (pylli) etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit: Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është 2:1 (2+1 orë).

Literatura:

- Elliott, S. D., D. Blakesley and K. Hardwick (2013): Restoring Tropical Forests: a practical guide. Royal Botanic Gardens, Kew; 344 pp.
- Mansourian, S., Vallauri, D., Dudley, N.. (2005): Forest restoration in Landscapes-Beyond planting trees. Springer. Printed in USA. Springeronline.com. 437 p.
- Lamb, D., Gilmour, D. (2003): Rehabilitation and Restoration of Degraded forests. IUCN. Gland. Switzerland and Cambridge. UK and WWF, Gland, Switzerland. x+110 pp.

Lënda: Punë praktike

Përshkrimi i lëndës: Praktika zhvillohet nën mbikëqyrjen e mentorëve të fakultetit dhe ndërmarrjeve që operojnë në fushën e pylltarisë, menaxhimit të burimeve pyjore dhe ruajtjen e natyrës. Përveç shërbimit pyjor publik, praktikë mund të zhvillohet edhe në ndërmarrjet e mëdha koncesionare por edhe ndërmarrje dhe organizata të specializuara të fushave

përkatëse. Gamë të gjerë të mundësive të punësimit për të diplomuarit pyjore dhe shumëllojshmëri të gjerë të organizatave do të thotë se përmbajtja e praktikës është e përshtatur për fushat specifike të punës së organizatave dhe ndërmarrjeve. Për detajet e programit të praktikës duhet pajtuar në mes të studentëve, dekanit dhe mentorit në fakultet por edhe në organizatë. Programi mund të përfshijë fushat e mëposhtme të punës: Silvikultura, mbrojtjen e pyjeve, të planifikimit të menaxhimit të pyjeve, prerja e pyjeve, inxhinierinë e pylltarisë, gjuetisë dhe të menaxhimit, pylltari urbane dhe arboritis, kontaktit me pronarët e pyjeve dhe publikun, ekonomia dhe organizimi i ndërmarrjeve pyjore. Praktika mund të zhvillohet edhe jashtë vendit. Vlerësimi i studentit duhet të prodhojnë një ditar të detajuar të punë së përditshme praktike dhe të marrë një certifikatë të praktikës së kryer.

Qëllimi i lëndës: mbështet në njohjen e punës praktike në fushën e pylltarisë dhe mjedisit.

Rezultatet e pritura të nxënies: Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të njihen me punën praktike nga: Silvikultura, mbrojtjen e pyjeve, të planifikimit të menaxhimit të pyjeve, prerja e pyjeve, inxhinierinë e pylltarisë, gjuetisë dhe të menaxhimit, pylltari urbane dhe arboritis, kontaktit me pronarët e pyjeve dhe publikun, ekonomia dhe organizimi i ndërmarrjeve pyjore. Praktika mund të zhvillohet edhe jashtë vendit.

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë: Vlerësimi i studentit duhet të prodhojnë një ditar të detajuar të punë së përditshme praktike dhe të marrë një certifikatë të praktikës së kryer.

Literatura:

Literatura duhet zgjedhur në bashkëpunim me mentorin, në lidhje me përmbajtjen e detyrueshme dhe e cila është në posedim të organizatës që ofron praktikën.

4.3 Edukimi Fillor (BA)

Emri i programit të studimit	Programi Fillor
Niveli i kualifikimit sipas KKK (me shkurtesat BA, MA, PhD, program doktrate, kurs universitar, certifikatë apo diplomë profesionale)	BA
Grada akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtër	Baçellor i Edukimit Fillor
Fusha e studimit sipas <i>Erasmus Subject Area Codes</i> (ESAC)	05 Edukimi fillor
Profili i programit akademik (specializimi)	Programi Fillor
Kohëzgjatja minimale e studimit	8 semestra, 4 vite
Grupi të cilit i orientohet oferta	Atyre që kanë kryer shkollën e mesme të lartë dhe ekuivalente me te.
Forma e studimit (e rregullt, pa shkëputje nga puna, studim në distancë etj.)	E rregullt
Numri i ECTS kredive (total dhe për vit)	4X60 ECTS, Gjithsej 240 ECTS
Modulet /Lendet (titujt)	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gjuhë shqipe I, II dhe III³ 2. Matematikë I dhe II 3. Gjuhë angleze I 4. Filozofi e edukimit 5. Shkathtësitë e mësimit akademik

³ Me bold janë dhënë lëndët obligative

	<p>6. TIK në edukimin fillor</p> <p>7. Bazate arsimit muzikor me metodologji</p> <p>8. Praktika pedagogjike I, II, III dhe IV</p> <p>9. Komunikimi në arsim (z)</p> <p>10. Histori e arsimit kombëtar (z)</p> <p>11. Vizatim (z)</p> <p>12. Hyrje në psikologji</p> <p>13. Teori e mësimit</p> <p>14. Gjuhë angleze II</p> <p>15. Interpretimi me instrumente (z)</p> <p>16. Edukatë qytetare (z)</p> <p>17. Edukim Fizik shëndetësor (z)</p> <p>18. Shkathtësitë e komunikimit me fëmijë (z)</p> <p>19. Letërsi për fëmijë</p> <p>20. Metodologji e mësimit të matematikës I</p> <p>21. Histori kombëtare</p> <p>22. Dramatizimi dhe shfaqja me kukulla (z)</p> <p>23. Artet e bukura (z)</p> <p>24. Psikologji zhvillimore (z)</p> <p>25. Të drejtat e fëmijëve dhe etika e mësimit (z)</p> <p>26. Metodologji e shkencave</p>
--	--

	<p>shoqërore</p> <p>27. Metodologji e arteve figurative</p> <p>28. Bazat e shk. natyrore me metodologji I</p> <p>29. Shkolla dhe komuniteti (z)</p> <p>30. Arsimimi gjatë gjithë jetës (z)</p> <p>31. Tendencat bashkëkohore në arsim (z)</p> <p>32. Metodologji e leximit letrar (z)</p> <p>33. Statistikë elementare (z)</p> <p>34. Strategjitë dhe metodat e shkrim leximit</p> <p>35. Edukimi gjithëpërfshirës me metodologji</p> <p>36. Psikologji edukimi</p> <p>37. Edukimi mjedisor</p> <p>38. Zhvillimi i kurrikulave (z)</p> <p>39. Vështirësitë në të nxënë (z)</p> <p>40. Gjuhë angleze për mësues (z)</p> <p>41. Bazat e shkencave natyrore me metodologji II (z)</p> <p>42. Edukimi dhe mediat (z)</p> <p>43. Metodologji e mësimit të matematikës II</p> <p>44. Histori e letërsisë kombëtare</p> <p>45. Metodologji e edukimit fizik</p> <p>46. Metodologji e gjuhës shqipe</p>
--	---

	47. Etnologji dhe letërsi popullore (z) Vlerësimi në arsim (z) Psikologji e personalitetit (z) Menaxhimi i klasës dhe disiplina (z) Fëmijët dhe mësimi në natyrë (z) Bazat e hulumtimit në edukim Punimi i diplomës
Numri i vendeve të studimit	150 studentë të rinj në studime të rregullta për vitin akademik 2016/2017
Udhëheqësi i programit të studimit	Prof.Asoc.Dr.Ismet Temaj
Personeli i përhershëm shkencor/artistik (Numri sipas kategorive të personelit)	I dhënë në aneks
Taksat e studimit	Sipas marrëveshjes me MASHT-in

15. 3. 2016

3.2 Arsyeshmeria e programit për tregun e punës

Programi Fillor është një nga programet për të cilat ka kërkesa në tregun e punës për faktin se gjithmonë e më shumë rrjeti i Shkollave në vend po zgjerohet, po ashtu edhe ndryshimi i gjeneratave ka krijuar hapësirë të mjaftueshme që ky profesion të jetë mjaft i kërkuar. Ndryshimet dhe zhvillimet për klasat I-V bazuar në Kornizën e Kurrikulit të Kosovës shtrojnë kërkesën për mesimdhënës të kualifikuar, gjë e cila i jep dhe më shumë forcë këtij programi.

Fakulteti i Edukimit, aktualisht e ka tregun më të sigurt të punës nga të diplomuarit. Pas përfundimit të studimeve, studentët janë të gatshëm të gjejnë punë në shkollat fillore të Kosovës. Në Kosovë, Universitetet private nuk kanë të drejtën ligjore të ofrojnë programe për përgatitjen e mesimdhënësve të rinj, prandaj Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti" mbetet institucioni që përgatit mesimdhënës për arsimin fillor.

Mësimdhënësit e diplomuar në Fakultetin e Edukimit fitojnë njohuri dhe do të mësojnë rregullat e mësimdhënies dhe të mësuarit e fushave të ndryshme mësimore, si dhe do të njihen me relacionet ndërmjet proceseve mësimore në një anë dhe individit dhe shoqërisë në anën tjetër. Po ashtu, të diplomuarit në Fakultetin e Edukimit përfitojnë spektrin e plotë të kompetencave të veçanta profesionale që kërkohen për zotërimin e fushave të tyre studimore dhe/ose disiplinën në të cilën ata do të punojnë si profesionist (mësimdhënie, këshillim, etj.)

3.3 Krahasueshmëria ndërkombëtare e programit të studimit

Fakulteti: ___**Fakulteti i Edukimit**__

Emërtimi i programit të studimit: _____**Programi Fillor**_____

Bachelor Master Doktoratë

Numri i ECTS kredive për programin e propozuar të studimeve: _____ 240 _____

Programi e studimit të universiteteve evropiane me të cilat është i krahasueshëm programi fillor i Fakultetit të Edukimit.

Emërtimi i Universitetit	Universiteti i Prizrenit	Universiteti # 1	Universiteti # 2	Universiteti # 3
Emërtimi i Universitetit	Universiteti i Prizrenit	Universiteti i Prishtinës	Universiteti i Ljubljanes Universiteti i Mariborit	Universiteti i Zagrebit Universiteti i Rijekes
Fakulteti	Fakulteti i Edukimit	Fakulteti i Edukimit	Faculty of Education	Faculty of Teacher Training Faculty of Philosophy
Emërtimi i programit të studimit	Programi Fillor	Programi Fillor	ŠOLSKA VZGOJA	odgojitelj djece školske dobi
% e krahas.		~ 90-100~ %	~ 85 ~ %	~70-80 ~ %

(Universiteti #1 nënkupton Universitetin me të cilin programet e studimit janë në pajtueshmëri 85% dhe Universiteti #2 nënkupton Universitetin me të cilin jeni të ngjashëm)⁴.

Përgjegjësi i programit të studimit: Programi Fillor

Prof.asoc. Dr.Ismet Temaj

3.4 Grupi që i dedikohet programi

Në këtë program studimi mund të regjistrohen të gjithë kandidatët të cilët kanë kryer Shkollën e Mesme të Lartë (shkollimi 12 vjeçar), kanë dhënë provimin e maturës dhe kalojnë testin provues nga njohuritë e komunikimit gjuhësor dhe të njohurive elementare matematikore. Pranimi i kandidatëve bëhet nga lista e formuluar nga numri i poenëve të kandidatëve. Po ashtu, është shumë e rëndësishme që studentët të cilët zgjedhin këtë drejtim të kenë dëshirë dhe pasion për punën me nxënës.

Studentëve që vendosin të studiojnë në Programin Fillor në Fakultetin e Edukimit iu ofrohet mundësia për përfitimin e njohurive dhe kompetencave nga lëndët e përgjithshme, akademike dhe didaktiko-metodologjike. Këto kompetenca përfshijnë: njohuri për lëndën e tyre përkatëse (njohuri akademike), reflektimin dhe aftësimin profesional të nevojshëm për zgjidhjen e problemeve; aftësimin për komunikim dhe punë ekipore me profesionistë të tjerë në arsim; konceptim holistik të fëmijëve dhe të rinjve; familjarizimin dhe të kuptuarit e karakteristikave zhvillimore të nxënësve; të kuptuarit e dallimeve dhe nevojave të nxënësve, etj.

3.5 Orientimi i programit të studimit ndaj parimeve udhëheqëse të Fakultetit

Njëkohësisht si në nivelin qendror të Fakultetit, me themelimin e Fakultetit të Edukimit (2002), mbështetur nga KEDP në bashkëpunim me MASHT, dhe ish Shkollën e Lartë Pedagogjike, u vendos që në kuadër të Fakultetit të Edukimit të fillojë organizimi i studimeve të Programit Fillor edhe në qendrën në Prizren me detyrë të formojë mësimdhënës për nxënës të shkollës fillore nga klasa I deri V. Gjithashtu, tanimë ky program ekziston edhe në Fakultetin e Edukimit në Universitetin Publik të Prizrenit.

⁴Bashkangjitur me raportin e Vetvlerësimit do të gjeni kopjet e Programeve të Universitetit të Ljubljanes, Universitetit të Mariborit, Universitetit të Zagrebit dhe Universitetit të Rijekës.

Në kuadër të këtij programi të Fakultetit të Edukimit, do të sigurohet arsimim i lartë i mësimdhënësve të ardhshëm të shkollës fillore gjatë katër viteve të studimeve universitare, gjatë të cilave do të realizohen 240 ECTS kredi në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara sipas sistemit të Lartë arsimor të hapësirës Evropiane (marrëveshja e Bolonjës).

Egzistimi dhe funksionimi i këtij programi, përveç arsyeve të paraqitura në pikën 1.1. të këtij raporti është edhe:

- Nevoja e studentëve-mësimdhënës të ardhshëm të shkollës fillore nga rajoni i Prizrenit dhe rrethinës për të arritur kompetenca profesionale në përputhshmëri me kompetencat të cilat arrihen në fakultetet përkatëse të Evropës, duke respektuar veçoritë specifike të kulturës dhe traditës Kosovare në formimin e mësimdhënësve.

- Përgatitja e mësimdhënësve të ardhshëm të shkollës fillore bazuar në njohuri shkencore, krijimtari artistike, përvoja pedagogjike dhe në metodologjitë inovative – duke bërë përparim të dukshëm në promovimin e edukimit dhe arsimimit gjithëpërfshirës.

Duke pas parasysh ndryshimet progresive të kurrikulumit të arsimit, formimi i mësimdhënësve është segment i rëndësishëm në realizimin e ndryshimeve kurrikulare.

Mësimdhënësit kanë rolin kryesor sa i përket implementimit të kurrikulës nëpër insitucionet shkollore dhe përgatitja e tyre profesionale ka për qëllim të ndihmojë në tejkalimin e sfidave në organizimin e aktiviteteve mësimore.

Fakultetit të Edukimit në Prizrenit , si institucion i cili përgatitë mësimdhënës për dy nivelet e para të arsimit, vazhdon traditën e gjatë të ish SHLP “Xhevdet Doda” në përgatitjen e mësimdhënësve, disponon me kapacitetin kadrovik dhe plotëson kushtet e nevojshme për formimin e mësimdhënësve të shkollës fillore.

3.6 Qëllimi dhe profili i Programit Fillor

Aftësimi i studentëve për të realizuar lëndët mësimore të shkollimit fillor (gjuha amtare, matematika, natyra, shoqëria, të kulturës muzikore, të artit dhe atë shëndetësor, si dhe zbatimin e teknologjisë arsimore).

Ky program përgatitë studentët:

- *Për promovimin, organizimin, evaluimin dhe realizimin e kurrikulumit arsimor në mënyrë efektive te nxënësit, prindërit dhe anëtarët e tjerë të shoqërisë- komunitetit;*

- *Me dije, njohuri dhe shkathtësi në menyrë që t'iu përgjigjen kërkesave të shekullit 21,*
- *Për potencimin e opsioneve të ndryshme të studimit-mësimi të çështjeve edukativo-arsimore në kuadër të arsimit fillor;*
- *Për përvetësimin e shkathtësive në përdorimin e metodologjive të ndryshme të mësimdhënies përmes praktikave profesionale në institucionet shkollore.*
- *Të kuptuarit e rëndësisë së praktikës në institucionet shkollore;*
- *Sistemi i kredive mundëson thellimin në njohjen e fushave të caktuara në kuadër të lëndëve zgjedhore, përveç lëndëve obliguese të programit,*
- *Aftësimi për përdorimin dhe zbatimin e të arriturave bashkëkohore në fushën e arsimit fillor si dhe me zbatimin e teknologjisë informatike në zhvillimin e aktiviteteve me nxënësit e shkollës fillore (klasa I deri V),*
- Njohja me përmbajtjet interdisiplinore dhe arsimit inkluziv.

Familjarizimi me punën në institucionet e shkollave fillore gjatë realizimit të Praktikave profesionale zhvillohet në kuadër të didaktikave specifike.

Mësimin praktik të studentëve e koordinon dhe organizon koordinatori i Mësimi Praktik në Prizren në shkollat fillore të rajonit të Prizrenit.

3.7 Rezultatet e pritura të mësimi

Studimet në këtë program janë të nivelit BA (4 vjeçar), me gjithsej 8 semestra nga 30 ECTS secili prej tyre, gjithsej, 240 ECTS.

Gjatë studimeve katër vjeçare pritet që studentët të aftësohen në:

- Krijimin e një përvoje paraprake përmes mësimi praktik, mbi procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies
- Menaxhimin e suksesshëm të klasës
- Marrjen e një roli aktiv në ngritjen e cilësisë së të nxëniti tek nxënësit në shkolla
- Krijimin e një klime pozitive në klasë dhe organizimi i mësimi përmes formave të llojllojshme.
- Krijimin e raporteve profesionale me mësimdhënësit, drejtorët dhe prindërit,
- Ndërlidhjen e informacioneve teorike me punën praktike me nxënësit në shkolla me fëmijët e grupmoshave përkatëse,

- Në aplikimin e parimeve inkluzive në procesin edukativo arsimor.
- Ushtrimin e profesionit të mësimdhënësit bazuar në parimet bashkëkohore të mësimdhënies, etj.

3.8 Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike

Në secilën nga lëndët ë përshkruara gjendet edhe raporti në mes të pjesës teorike dhe asaj praktike. Përgjithësisht Fakulteti i Edukimit është i njohur për zhvillimin e praktikës profesionale e cila është edhe njëra nga karakteristikat themelore që e veçon këtë fakultet nga fakultetet e tjera. Praktika profesionale organizohet gjatë katër viteve të studimit.

Duke zhvilluar një partneritet cilësor me institucionet arsimore- shkollore, studentët në Fakultetin e Edukimit janë të lidhur me praktikën – mësimin praktik, i cili implementohet në 22 javë brenda 4 viteve të studimit. Me anë të mësimin praktik, studentët lidhin dhe pasurojnë njohuritë që ata fitojnë në fakultet, me përvojë praktike nën udhëheqjen e mësimdhënësve mentor.

3.9 Llogaritja e ECTS-ve

Programi i studimeve në drejtimin fillor është me kohë të plotë. Programi i studimeve është 4 vite (240 ECTS) i ndarë në 8 semestra (1 semester ka 30 ECTS). Të gjitha lëndët janë të ngarkuara me vlerën e ECTS, dhe se një (1) ECTS është e barabartë me (25) njëzet e pesë deri në tridhjetë (30) orë mësimi. Ato llogariten në bazë të tabelave si më poshtë:

Vëllimi dhe sasia e nevojshme e punës: Numri i kredive

Aktiviteti	ore	jave	gjithesejt
Ligjerata	3	15	45
Ushtrime	2	15	30
Kontakte me mësimdhënësin/kons.	1	15	15
Kolokviume			
Detyra shtëpie	1	15	15
Koha e studimit vetanak e studentit	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	3	6
Projekte etj.	3	1	3
Gjithsej ngarkesa			159 orë

3.10 Puna praktike -Intershipi

Përmes koordinatorit për mësim praktik në Fakultetin e Edukimit organizohet mësimi praktik, i cili është i obligueshëm për studentët dhe organizohet nga Fakulteti. Gjatë vitit të dytë, të tretë dhe të katërt, studentët shkojnë nëpër shkollat fillore të vendit dhe në pajtueshmëri me kërkesat që parashihen në Doracakun për mësimin praktik ata përfundojnë punën praktike. Shpërndarja e studentëve në shkolla bëhet sipas planit, i cili përpilohet brenda Fakultetit dhe harmonizohet me Drejtorinë Komunale të Arsimit.

Në tabelën e mëposhtme janë të definuara saktësisht të dhënat të cilat tregojnë kohën gjatë së cilës studentët janë të përfshirë në mësimin praktik në të gjitha fazat nëpër vitet e shkollimit.

Mësimi praktik në shkolla					
Fakulteti i Edukimit - Programi fillor					
Semestri	Në Fakultet	Në shkolla	Semestri	Në Fakultet	Në shkolla
1	/	Nuk kalohet kohë në shkolla	2	Ligjerat	Nuk kalohet kohë në shkolla
3	/	Nuk kalohet kohë në shkolla	4	Ligjerat	10 javë 20 DITË X5 =100 ORË çdo të hënë dhe të premtë
5	Ligjerat Kalohet kohë në shkolla	15 javë dy herë në javë çdo të hënë dhe të premtë	6	Vazhdon praktika në shkolla	30 DITË x5 = 150 ORË çdo të hënë dhe të premtë
7	/	Nuk kalohet kohë në shkolla	8	Praktika në	39 DITË X5 =195 ORË

				shkolla	çdo të martë, mërkurë dhe të enjte
--	--	--	--	---------	--

3.11 Plani i hulumtimeve për programin

Aftësimi i studentëve për hulumtim zhvillohet në kuadër të lëndëve si “Praktika pedagogjike” I,II,III dhe IV, “Edukimi special me metodologji” dhe “Bazat e hulumtimit në edukim”. Punimet hulumtuese të studentëve prezentohen në formë të forumeve përpara mësimdhënësve dhe kolegëve të tyre. Në të ardhmen pritet që në bashkëpunim me mësimdhënësit me punimet e tyre të marrin pjesë në konferenca të ndryshme dhe të botohen nëpër revistat shkencore kombëtare dhe ato ndërkombëtare.

Mësimdhënësit e Fakultetit të Edukimit, në formë individuale zhvillojnë hulumtime të ndryshme shkencore nga fushat e tyre studimore, pra edhe në fushën e edukimit fillor. Këto hulumtime kryesisht synojnë arritjen dhe prezantimin e rezultateve shkencore nga fushat e studimit të tyre, të cilat kohë pas kohe prezentohen në konferenca dhe takime tjera shkencore në vend:

1. Java e Shkencës në Kosovë (2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016),
2. Takimet e AlbShkencës (2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016),
3. Seminaret të ndryshme në Fakultetet e Univesiteti të Prishtinës etj.,

Gjithashtu, ka edhe shumë pjesëmarrje të stafit dhe paraqitje arritjesh hulumtuese e shkencore në konferenca ndërkombëtare shkencore jashtë vendit, siç janë: Annual Conference of the Association for Teacher Education in Europe, Teacher Education Policy in Europe, Congress of European Research in Mathematics Education (CERME), etj. Rezultatet e hulumtimeve të personelit të Fakultetit të Edukimit prezentohen në revista të njohura ndërkombëtare.

Në bashkëpunim të Fakultetit të Edukimit të Universitetit Publik të Prizrenit dhe Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës publikohet revista “Edukologjia” në të cilën publikohen punime nga mësimdhënësit dhe asistentët e FE si dhe hulumtuesve të tjerë nga fakultete dhe institucione tjera. Deri tash janë publikuar disa vëllime të kësaj reviste me punime të profesorëve dhe stafit të Fakultetit të Edukimit, por edhe kontribues nga jashtë Fakultetit dhe Universitetit.

3.12 Kushtet për pranim të studentëve dhe procedurat e zgjedhjes

Numri i studentëve të cilët regjistrohen në vitin e parë është 150 (në vitin akademik 2015-16 janë regjistruar 300 studentë, 7 meshkuj dhe 293 femra) në studime të rregullta.

Në vitin e parë të studimeve mund të regjistrohen të gjithë kandidatët të cilët kanë kryer Shkollat e Mesme të Larta (shkollimi 12 vjeçar), kanë dhënë provimin e maturës dhe kalojnë testin provues nga njohuritë e komunikimit gjuhësor dhe të njohurive elementare matematikore. Pranimi i kandidatëve bëhet nga lista e formuluar nga numri i poenave të kandidatëve.

Në këtë program, sikurse edhe në programet tjera të Fakultetit të Edukimit, pranohen kandidatë kryesisht nga rrafshi i Dukagjinit, por edhe nga pjesë tjera të Kosovës, nga Shqipëria, Mali i Zi etj. Kandidatët nga viset jashtë Kosovës para konkurimit bëjnë nostrifikimin e shkollimit të tyre të realizuar jashtë Kosovës.

Titulli i Gradës akademike dhe emërtimi i diplomës në formë të plotë dhe të shkurtuar

Pas përfundimit me sukses të studimeve, kandidati merr titullin: **Baçellor i Edukimit Fillor.**

3.13 Plani i programit të studimit (emri, orët javore, ECTS kreditë dhe statusi)

Viti i Parë - Programi Fillor							
Semestri I							
Kursi	Statusi	Emri i kursit	L	U	ECTS	Mësimdhënësit	
Edu 101	O	GJUHË SHQIPE PER PROGRAMIN FILLOR I	3	2	7	Prof.ass.Dr.Sindorela Doli-Kryeziu Ass.Ma.Albulena Alidemaj	
Edu 102	O	MATEMATIKË PER PROGRAMIN FILLOR I	3	2	7	Prof.asoc.Dr..Ismet Temaj Ass. Veli Gashi	
Edu 103	O	GJUHË ANGLEZE PER PROGRAMIN FILLOR I	2	2	6	Prof.ass.Dr.Sermin Tortula Ass.Herolinda Bylkbashi	
Edu 104	O	FILOZOFI E EDUKIMIT	2	1	5	Prof. ass. Dr. Behxhet Gaxhiqi Ass.Artan Reshani	
Edu 105	Z	SHKATHHTËSITË E MËSIMIT AKADEMIK	2	1	5	Prof. asoc.Dr. Naser Pajaziti	
Edu 113	Z	VIZATIM	2	1	5	Dr.sc. Ilir Muharremi	
*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).							
Semestri II							
Edu 106	O	GJUHË SHQIPE PER PROGRAMIN FILLOR II	3	2	6	Prof.ass.Dr.Sindorela Doli-Kryeziu Ass.Ma.Albulena Alidemaj	
Edu 107	O	MATEMATIKË PER PROGRAMIN FILLOR II	3	2	6	Prof.asoc.Dr..Ismet Temaj Ass. Veli Gashi	
Edu 108	O	TIK NË EDUKIMIN FILLOR	3	2	6	Prof.asoc.Dr.Naim Brahaj	
Edu 109	O	BAZAT E ARSIMIT MUZIKOR ME METODOLOGJI	3	1	5	Prof.Asoc.Dr Bajram Qupi	
Edu 110	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I (3 JAVE)	/		2	Prof.Dr.Dem Hoti	
Edu 111	Z	KOMUNIKIMI NË ARSIM	2	1	5	Prof.Asoc.Dr. Naser Zabeli	

Edu 112	Z	HISTORIA E ARSIMIT KOMBËTAR	2	1	5	Prof.asoc.Dr. Fahredin Shabani Ass. Mas. Artan Reshani

***Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).**

Viti i dytë - Programi Fillor						
Semestri III						
Kursi	Statu si	Emri i kursit	L	U	EC TS	Mësimdhënësit
Edu 114	O	GJUHË SHQIPE PER PROGRAMIN FILLOR III	3	2	6	Prof. asoc.Dr. Naser Pajaziti Ass.Ma.Albulena Alidemaj
Edu 115	O	HYRJE NË PSIKOLOGJI	3	2	6	Ma.sc.Emirjeta Kumnova
Edu 116	O	TEORI E MËSIMIT	2	2	5	Prof. Dr.Dem Hoti
Edu 117	O	GJUHË ANGLEZE PER PROGRAMIN FILLOR II	2	1	5	Prof.ass.Dr.Sermin Tortula Ass.Herolinda Bylkbashi
Edu 118	Z	INTERPRETIM ME INSTRUMENT	2	1	4	Prof.Asoc.Dr Bajram Qupi
Edu 119	Z	EDUKATË QYTETARE	2	1	4	Prof.asoc.Dr. Fahredin Shabani Ass. Mas. Artan Reshtani
Edu 120	Z	EDUKIMI FIZIK SHËNDETËSOR	2	1	4	Prof. ass. Dr. Qazim Elshani
Edu 121	Z	SHKATHTËSITË E KOMUNIKIMIT ME FËMIJË	2	1	4	Prof. ass. Dr. Behxhet Gaxhiqi
*Studenti zgjedh dy (dy) kurse zgjedhore nga lista e kurseve zgjedhore (Z).						
Semestri IV						
Edu 122	O	LETËRSI PËR FËMIJË	3	2	6	Prof.Dr. Sabaudin Cena Ass.Ma.Gjyle Totaj

Edu 123	O	METODOLOGJIA E MËSIMIT TË MATEMATIKËS I	3	2	7	Prof.asoc.Dr..Ismet Temaj Ass. Veli Gashi
Edu 124	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II (5 JAVE)	2	1	6	Prof.Dr.Dem Hoti
Edu 125	O	HISTORI KOMBËTARE	3	2	6	Prof.asoc.Dr. Fahredin Shabani Ass. Mas. Artan Reshani
Edu 126	Z	DRAMATIZIMI DHE SHFAQJET ME KUKULLA	2	1	5	Dr. Ilir Muharremi
Edu 127	Z	ARTET E BUKURA	2	1	5	Mr.sc. Bardha Buza
Edu 128	Z	PSIKOLOGJIA ZHVILLIMORE	2	1	5	Prof. ass.Dr. Behxhet Gaxhiqi
Edu 129	Z	TË DREJTAT E FËMIJËVE DHE ETIKA E MËSIMDHËNËSVE	2	1	5	Prof.asoc.Dr. Fahredin Shabani Ass. Mas. Artan Reshani

*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).

Viti i tretë - Programi Fillor

Semestri V

Kursi	Status i	Emri i kursit	L	U	EC TS	Mësimdhënesit
Edu 130	O	METODOLOGJIA E SHKENCAVE SHOQËRORE	3	2	7	Prof.asoc.Dr. Fahredin Shabani Ass. Mas. Artan Reshani
Edu 131	O	METODOLOGJIA E ARTEVE FIGURATIVE	3	2	6	Prof. ass. Dr.Haki Xhakli
Edu 132	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE III (6 JAVE)	2	1	6	Prof.Dr. Dem Hoti
Edu 133	O	BAZAT E SHKENCAVE NATYRORE ME TODOLOGJIA I	3	2	6	Prof.Dr.Isa Elezi Ass.Mas. Ismet Ahmetaj
Edu 134	Z	SHKOLLA DHE KOMUNITETI	2	1	5	Prof.asoc.Dr. Naser Zabeli
Edu 135	Z	ARSIMIMI GJATË GJITHË JETËS	2	1	5	Mr.sc.Milaim Cikaqi
Edu 136	Z	TENDENCAT BASHKËKOHORE NË ARSIM	2	1	5	Prof.asoc.Dr. Fahredin Shabani Ass. Mas. Artan Reshani
Edu 137	Z	METODOLOGJIA E LEXIMIT LETRAR	2	1	5	Prof.Dr. Sabaudin Cena Ass.Ma.Gjyle Totaj

Edu 138	Z	STATISTIKË ELEMENTARE	2	1	5	Prof. Dr. Fevzi Berisha
*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z)						
Semestri VI						
Edu 139	O	STRATEGJITË DHE METODAT E SHKRIM LEXIMIT	2	2	6	Dr. Muharrem Gashi Ass.Ma.Albulena Alidemaj
Edu 140	O	EDUKIMI GJITHËPËRFSHIRËS ME METODOLOGJI	2	2	6	Prof.asoc.Dr.Naser Zabeli
Edu 141	O	PSIKOLOGJI EDUKIMI	2	1	5	Prof. ass. Dr.Behxhet Gaxhiqi Ass. Ma. Dalila Lekaj
Edu 142	O	EDUKIMI MJEDISOR	2	1	5	Dr. sc. Bekim Gashi
Edu 143	Z	ZHVILLIMI I KURRIKULAVE	2	1	4	Mr.sc.Gjergj Gojani
Edu 144	Z	VËSHTIRËSITË NË TË NXËNIT	2	1	4	Mr.sc.Gjergj Gojani
Edu 145	Z	GJUHË ANGLEZE PËR MËSUES	2	1	4	Prof.ass.Dr.Sermin Tortula Ass.Herolinda Bylkbashi
Edu 146	Z	BAZAT E SHKENCAVE NATYRORE ME METODOLOGJI II	2	1	4	Prof.Dr.Isa Elezi Ass.Mas. Ismet Ahmetaj
Edu 147	Z	MEDIAT DIGJITALE	2	1	4	Xhevahire Izmaku
*Studenti zgjedh 2 (dy) kurse zgjedhore (Z) nga lista						
Viti i katërt - Programi Fillor						
Semestri VII						
Kursi	Status i	Emri i kursit			EC TS	Mësimdhënësit
Edu 148	O	METODOLOGJI E MËSIMIT TË MATEMATIKËS II	3	2	7	Prof.asoc.Dr..Ismet Temaj Ass. Veli Gashi
Edu 149	O	HISTORI E LETËRSISË KOMBËTARE	3	2	6	Prof.Dr. Sabaudin Cena Ass.Ma.Gjyle Totaj
Edu 150	O	METODOLOGJI E EDUKIMIT FIZIK	3	2	6	Prof. ass. Dr. Qazim Elshani
Edu 151	O	METODOLOGJI E GJUHËS SHQIPE	3	1	6	Dr.sc. Ragip Gjoshi Ass.Ma.Albulena Alidemaj
Edu 152	Z	ETNOLOGJI DHE LETËRSI POPULLORE	2	1	5	Prof.Dr. Sabaudin Cena Ass.Ma.Gjyle Totaj

Edu 153	Z	VLERËSIMI NË ARSIM	2	1	5	Prof.asoc.Dr.Illir Kelmendi
Edu 154	Z	PSIKOLOGJIA PERSONALITETIT E	2	1	5	Mr.sc.Gjergj Gojani Ass.Ma. Dalila Lakaj
Edu 155	Z	MENAXHIMI I KLASËS DHE DISIPLINA	2	1	5	Prof.asoc.Dr. Fahredin Shabani Ass. Mas. Artan Reshani
Edu 156	Z	FËMIJËT DHE MËSIMI NË NATYRË	2	1	5	Prof.Dr.Isa Elezi Ass.Mas. Ismet Ahmetaj
*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).						
Semestri VIII						
Edu 157	O	BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM	2	1	6	Prof.asoc.Dr.Naser Zabeli
Edu 158	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE IV (8 JAVË)	/		14	Prof.DrDem Hoti
Edu 159	O	PUNIMI I DIPLOMËS	/		10	/

3.14.Përshkrimi i lëndëve të programit FILLOR

Emërtimi i lëndës: *Gjuhë Shqipe I*

Përmbajtja:Gjuha si mjet komunikimi; gjuha si dukuri shoqërore e si sistem shenjash; III Shumësia e gjuhëve, familjet e nënfamiljet e gjuhëve; Gjuha - populli – kombi – shteti (raportet, përkimet); Piramida gjuhësore; Gjuhësia; Origjina dhe historia e gjuhës shqipe; Fonetika; Fonetika nyjëtimore; Fonetika akustike; Klasifikimi i tingujve zanorë dhe bashkëtingëllorë; Fonologjia; Ndryshimet fonemore – kombinatorike (të gjalla e historike); Prosodia, rrokja, theksi, intonacioni; Tingulli, grafia, fonema; drejtshkrimi/drejtshqiptimi.

Qëllimet e mësimit:Zgjerimi e thellimi i mëtejshëm i njohurive gjuhësore të fituara, zgjerimi i kulturës gjuhësore në planin teorik e praktik të sistemit gjuhësor në përgjithësi e sistemit tingullor në veçanti; Nxitja dhe motivimi për ligjërim të rrjedhshëm, me qëllim të përgatitjes për profesion e për jetë; Aftësimi për zotërimin e drejtshkrimit, drejtshqiptimit dhe për njohjen e lindjes e zhvillimin e gjuhës; Formimi i aftësive shprehëse gjuhësore fonologjike dhe fonetike për zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të fituara në mësimdhënie, në shoqëri e në jetën e përditshme.

Rezultatet e të nxënit të lëndës : Përvetësimi i njohurive dhe shkathtësive bazë për zotërimin e sistemit gjuhësor, sidomos tingullor e fonologjik, i shkathtësive shprehëse me gojë e me shkrim, zhvillimi i aftësive të pavarura dhe aftësimi për mësimdhënie të këtyre njohurive teorike e praktike, si dhe zbatimi praktik në punë e në shoqëri; Përvetësimi i teknikave, procedurave e strategjive metodologjike të shprehive profesionale praktike e teorike për zbatimin e suksesshëm në përditshmëri; Formimi i shprehive për punë të pavarur interpretuese e krijuese, zgjerimi i mëtejshëm i shkathtësive të të shprehurit me gojë dhe paraqitja drejtshkriore sa më mirë, bukur dhe pastër gjuhësisht.

Format/ Metodatat e mësimdhënies: e kombinuar, varësisht nga lloji i ligjëratis: (shpjegim – sqarim; ushtrime, analiza tekstore e ligjërimore; diskutime debatuese, punë në grupe, individuale, demonstrim e interpretim, shtruarje e shqyrtim idesh, hartime krijuese, hulumtim i vetësishëm.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
55%	45%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Bahtiar Kryeziu, *Gjuhë amtare (Fonetikë-Morfologji)*, Prishtinë, 2010

Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, kapitulli 4.4, f. 258-285

Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë 2004

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat (me ngjyra), gazetatat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

- Vlerësimi i njohurive të studentëve bëhet gjatë gjithë semestrit dhe në testin paraprak dhe përfundimtar të provimit;
- Do të ketë test paraprak nga java 15 e njësisë akademike;
- Provimi mbahet me test dhe do të pyeten gojarisht;
- Studentët që arrijnë pikët maksimale në test do të lirohen nga provimi final;
- Studentët të cilët zihen me kopje gjatë testit, nuk kanë të drejtë të hyjnë në provim për tri afate.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim: 15%

Angazhimi dhe marrja e plusave (+) gjatë semestrit: 30%

Provimi: 55%

Emërtimi i lëndës: *Matematika I*

Përmbajtja: Në këtë kurs shqyrtohen kuptimet themelore në matematikë, si: logjika matematikore, bashkësitë, relacionet binare, që paraqesin një kaptinë të rëndësishme të matematikës bashkëkohore. Relacionet e dinamizojnë punën me bashkësi dhe krijojnë hapësirë për zhvillimin e të menduarit “kritik”. Nga ana tjetër, bashkësia e numrave natyrorë N , bazohet në sistemin aksiomatik të Peanos dhe arsyetohet kërkesa për zgjerimin e saj, në numra të plotë Z , racional Q dhe real R . Zbatimi i ekuacioneve dhe inekuacioneve lineare në zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme dhe shqyrtimi i disa elementeve nga statistika dhe probabiliteti janë gjithashtu tema studimi të këtij kursi.

Qëllimet e mësim:

Qëllimi parësor i kursit është përvetësimi i njohurive për konceptet, strukturat dhe veprimet themelore nga matematika që janë të domosdoshme për një mësimdhënës të arsimit fillor. Qëllimi i dytë është zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive të studentëve për zgjidhjen, interpretimin, arsyetimin dhe vlerësimin e problemeve matematikore, integrimin e matematikës me fushat tjera dhe me problemet e jetës së përditshme.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje :

- të përdorin saktë simbolet e logjikës matematikore dhe të konkludojnë mbi saktësinë e formulave logjike;
- të zbatojnë veprimet me bashkësi për të formuar bashkësi të reja;
- të paraqesin relacionet binare me metoda të ndryshme;
- të përshkruajnë vetitë e relacioneve binare dhe të identifikojnë llojet e tyre;
- të përkufizojnë pasqyrimin dhe të dallojnë llojet e tij;
- të shqyrtojnë bashkësitë numerike dhe të kryejnë veprimet me numra;
- të zbatojnë ekuacionet dhe inekuacionet për zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme.
- të grumbullojnë, përshkruajnë, analizojnë të dhënat dhe t'i paraqesin ato me tabela dhe diagrame.

Format/ Metodat e mësimdhënies:

Mësim i rregullt, shpjegime, diskutime, punë e pavarur individuale, punë në grupe

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike: 50%	Pjesa praktike: 50%
--------------------	---------------------

Literatura:

S.Tahiri, S. Rudi, N. Hyseni (1986) “Matematika për studentët e grupit klasor” Prishtinë;

M.Efëndija; Q. Haxhibeqiri; R. Limani (2005). ”Matematika 11” Dukagjini.

Wesner, T and Nustad,H. (1991). “Algebra with applications –WCB.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, kalkulatori etj.

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete:

Pjesëmarrja në ushtrime 20% (Katër kuize)

Testi 1 20 %

Testi 2 20 %

Provimi përfundimtar 40 %

Kriteret e kalueshmërisë:

Nota përfundimtare:

Pikët (%) Nota

- 90-100 **10**
- 80-89 **9**
- 70-80 **8**
- 60-69 **7**
- 50-59 **6**

Emërtimi i lëndës: *Gjuhë angleze I*

Qëllimet e mësimit:Lënda e Gjuhës Angleze I është domosdoshmëri e programit studimor në fjalë, dhe mësimnxënia e nivelit elementar të gjuhës Angleze cilësohet si nevojë për të kompletuar njohuritë e studentëve që diplomohen në këtë program.

Programi i gjuhës Angleze synon përmirësimin e nivelit elementar në spektrin e përgjithshëm të Gjuhës Angleze. Si i tillë ofron praktikë sistematike në katër fusha kryesore të gjuhësisë, respektivisht në atë të gjuhës angleze : të lexuarit, të shkruarit, të folurit dhe të dëgjuarit, duke i hulumtuar dhe njohur situatat dhe përmbajtjet e temave që ofron literatura e përcaktuar sipas programit studimor.

Krahas modeleve gramatikore të nivelit përkatës, materiali përkatës ofron detyra dhe ushtrime, dialogje komunikimi, tregime që kanë të bëjnë për jetën e përditshme, etj.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Lexim të rrjedhshëm;

Përvetësim praktik të gramatikës elementare;

Komunikim verbal;

Përvetësim të të shkruarit;

Pasurim të fjalorit të gjuhës Angleze.

Format/ Metodat e mësimdhënies: Çdo javë përpos ligjërimit të lëndës përkatëse, një pjesë (rreth 30%) e ligjëratës do të ndahet për përforsim të lëndës. Metoda interaktive dhe çasja komunikative dominon në zhvillimin e planprogramit të paraparë për këtë kurs.

Ligjërata, diskutime, punë në grupe me përgjegjësi të ndara, prezantim në kuadër të ushtrimeve vlerësim të vazhdueshëm etj...

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
45%	55%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

-Headway Elementary – the third edition

Student’s book and Workbook, Liz and John Soars

-Games for language Learning- the third edition

Andrew Wright, David Betteridge, and Michael Bucky, 2010

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat (me ngjyra), gazetatat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Testimi dhe vlerësimi me gojë

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim: 15%

Angazhimi dhe kollokiumet gjatë semestrit: 30%

Provimi: 55%

Emërtimi i lëndës: *Filozofi e edukimit*

Përmbajtja: Ky kurs do t`u ndihmojë studentëve që të kuptojnë nocionet themelore të edukatës, historinë e edukimit dhe të shkollës gjatë etapave të ndryshme të zhvillimit shoqëror, konceptonet e filozofëve dhe pedagogëve të mëdhenj, roli dhe ndikimi i tyre. Po ashtu, kjo lëndë trajton edhe teoritë bashkëkohore të edukimit si: pragmatizmi, edukimi progresiv, kognitivizmi, konstruktivizmi, humanizmi etj.

Qëllimet e mësimit: Ky kurs i lëndës do të ofrojë dhe shtjellojë këto qëllime:

1. Që studentët të kuptojnë zhvillimin e edukimit dhe mendimit pedagogjik nga kohërat antike deri te idetë përparimtare moderne;
2. Të reflektojnë për teorinë bashkëkohore të edukimit, njohjen dhe konceptin e tyre;
3. Të zhvillojnë filozofinë personale dhe ta ndërlidhin atë me praktikën bashkëkohore të mësimdhënies, gjatë proceseve të ndryshme.

Rezultatet e të nxënës të lëndës: Studentet do të jenë në gjendje: Të analizojnë idetë pedagogjike të cilat pasqyrohen në praktikën e sotme të edukimit; Të demonstrojnë aftësi për projektimin e ideve filozofike në punën dhe programet shkollore; Të krahasojnë teorinë bashkëkohore të edukatës nga këndvështrimi praktik i mësimdhënies; Të demonstrojnë aftësi për njohuritë e fituara në fushën e edukimit me qëllim të avancimit të mësimdhënies dhe të nxënës gjatë punës mësimore.

Format/ Metodatat e mësimdhënies

Përmbajtja e kësaj lënde do të prezantohet përmes ligjëratave, diskutimeve, aktiviteteve në grupe të vogla, në çifte dhe në punë individuale me qëllim të analizimit të rasteve dhe zbatimit të përvojave që studentët i kanë arritur gjatë praktikës në terren. Me fjalë të tjera aktivitetet dhe detyrat që jepen do të zhvillohen në formë diskutimi e komunikimi me gojë dhe me shkrim.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
60%	40%

Literatura bazë:

Hajrullah Koliqi, Historia e pedagogjisë I, Prishtinë, 1997

Hajrullah Koliqi, Historia e pedagogjisë II, Prishtinë, 1998.

Hajrullah Koliqi, Gruaja ndër shekuj, Prishtinë, 2009

Musa Kraja, Pedagogjia, Tiranë, 2009

Bardhyl Musai, Psikologji edukimi,, Tiranë, 1999

Grup autorësh, Pedagogjia e përgjithshme, Prishtinë, 1997

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Vijueshmëria në ligjerata	5 pikë
Vijueshmëria në ushtrim	5 pikë
Pjesëmarrja aktive në mësim	20 pikë
Seminaret dhe prezantimet	20 pikë
Provimi përfundimtar	50 pikë

Kriteret e kalueshmërisë:

5 pikë

5 pikë

20 pikë

20 pikë

Provimi përfundimtar 50 pikë

Emërtimi i lëndës: *Shkathësitë e mësimit akademik*

Përshkrimi i lëndës: Studentët do të kenë mundësi të mësojnë si të: përvetësojnë shkathësitë e tyre akademike në të menduar, të shkruar, të lexuar, të dëgjuar, të folur në mënyrë akademike. Këto mundësi do t'u ofrohen nëpërmjet ligjeratave, diskutimeve, detyrave të kursit, punimeve seminarike, si dhe punimeve kërkimore – akademike, të cilat do t'i punojnë gjatë studimeve themelore brenda këtij kursi (lënde).

Qëllimet e lëndës: Qëllimi kryesor i këtij kursi është që të njohë studentët me konceptet themelore të menduarit, të shkruarit, të lexuarit, të shkruarit dhe të folurit të nivelit akademik. Ky qëllim do të arrihet kryesisht nëpërmjet detyrave praktike, leksioneve, diskutimeve, leximeve të materialeve dhe burimeve të tjera të shpërndara në literaturë, në artikuj të

gazetave dhe revistave të ndryshme. Kjo lëndë gjithashtu synon mësimin e artit të përmbledhjes dhe të terminologjisë më të zakonshme që përdoret në nivelin e komunikimit akademik.

Rezultatet e pritura të nxënies: Të hartohen me sukses detyrat e kursit nga lënda përkatëse që studentët të pajisen me aftësi akademike të nivelit që përkojnë me pritshmërinë e tyre. Pra, të aftësojmë studentët për procesin e të studimit dhe komunikimit të nivelit akademik; Të aftësohen në procesin e shkrimit akademik për të hartuar ese, punime seminari mbi bazat e shkrimit akademik. Më konkretisht, të aftësohen për të përdorur gjatë të shkruarit teknika dhe strategji e stile akademike që u japin mundësi për të prodhuar shkrime të argumentuara, të nivelit të caktuar intelektual; Të nxisin dhe zhvillojnë mendimin kritik dhe reflektiv, gjithnjë përmes procesit të komunikimit në formë të shkrimit, të leximit, të folurit dhe të menduarit. Të përdorin një sfond gjuhe në pikëpamje të përdorimit e të strukturës së gjuhës dhe të pasurisë së saj strukturore dhe leksikore të avansuar në të argumentuar; Të zbatojnë njohuritë nga kursi (lënda) përkatëse jo vetëm në diskutim, por edhe në hartimin e eseve dhe studimeve nga fusha e mendimit teorik, hulumtues dhe studimor.

Metodologjia e mësimdhënies: Mësimi i rregullt do të realizohet nëpërmjet punës individuale dhe në grupe, si dhe formës frontale. Do të sugjerojmë edhe modele alternative në formë të punimeve të shkruara (ese). Kursi zhvillohet në mbështetje të mësimit interaktiv përmes zbatimit të teknikave të reja të mësimdhënies, duke iu dhënë vazhdimisht hapësirë për pyetje dhe diskutime. Studentët janë të obliguar t'i kryejnë detyrat e dhëna, të punojnë ese si dhe të prezantojnë në grup.

Literatura bazë:

1. Musai, B., (2004), *Si të shkruajmë ese*, Tiranë.
2. Nishku, M. (2004), *Si të shkruajmë, procesi dhe shkrimet funksionale*, Tiranë.
3. Lewis, J. & Ed.D.(2005), *Studimi akademik*, Tiranë.
4. Meunier. J-P. & Peraya, D. (2009), *Hyrje në teorinë e komunikimit*, Tiranë.
5. Umberto Eco, *Si behet një punim diplome*, Tiranë, 1997
6. Shamiq, M. (2006), *Si shkruhet vepra shkencore*, Shkup-Tiranë-Prishtinë, 2006
7. X.J.Kennedy, Dorothy M. Kenedi, Maria F Muth, *Udhërrëfyes i avancuar i shkrimit akademik*, 2009, Tiranë..

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Vijueshmëria në ligjerata	5 pikë
Vijueshmëria në ushtrim	5 pikë
Pjesëmarrja aktive në mësim	20 pikë
Seminaret dhe prezantimet	20 pikë
Provimi përfundimtar	50 pikë

Kriteret e kalueshmërisë:

5 pikë

5 pikë

20 pikë

20 pikë

Provimi përfundimtar 50 pikë

Emërtimi i lëndës: *Gjuhë Shqipe II*

Përmbajtja: *Emri* (Gjinia, numri, rasa, trajta, rasat e shquarsisë, lakimet e emrit); *Mbiemri*, *Numërori*; *Përemri* (Kuptimi, klasifikimi i përemrave); *Përemri* (*Përemri dëftor*, *përemri lidhor*); *Përemri* (*Përemri i pacaktuar*, *përemri pronor*, *përemri pytës*); *Folja* (*Kategoritë*, format veprorë e joveprorë, trajta vetvetore, mënyrat, format e pashtjelluara, kohët, vetat dhe numri, zgjedhimet, tipet e zgjedhimeve, zgjedhimi vepror); *Ndajfolja*, *Parafjala*; *Lidhëza*, *Pjesëza*, *Pasthirrma*

Qëllimet e mësimin: Fjala si njësi gjuhësore; studimi morfologjik i fjalës; struktura përbërëse e fjalës; fjala dhe morfema si njësi gjuhësore; llojet e fjalëve të parme dhe jo të parme; tipet dhe mënyrat e fjalëformimit; fjalët si pjesë të ligjëratës; njohja e veçorive morfologjike dhe fjalëformuese dhe e funksioneve sintaksore të dhjetë pjesëve të ligjëratës; Përgjithësisht, kërkohet formimi i aftësive shprehëse gjuhësore morfologjike për zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të fituara në mësimdhënie, në shoqëri e në jetën e përditshme.

Rezultatet e të nxënit të lëndës (kompetencat, njohuritë dhe shkathtësitë): Do të përvetësojnë njohuri për analizën e përbërjes strukturore dhe fjalë-formuese të fjalëve; Do t'i njohin pjesët e ligjëratës në tekst dhe veçoritë e tyre përmes analizave morfologjike; Formimi i shprehive për punë të pavarur interpretuese e krijuese, zgjerimi i mëtejshëm i shkathtësive të shprehurit me gojë dhe me shkrim, pa gabime gjuhësore, dhe sa më mirë e bukur gjuhësisht.

Format/ Metodatat e mësimdhënies: e kombinuar, varësisht nga lloji i ligjëratës: (shpjegim – sqarim; ushtrime, analiza tekstore e ligjërimore; diskutime debatuese, punë individuale dhe në grupe, demonstrim e interpretim, shtruarje e shqyrtim idesh, hartime krijuese, hulumtim i mëvetësishëm etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
55%	45%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Bahtiar Kryeziu, *Gjuhë amtare (Fonetikë-Morfologji)*, Prishtinë, 2010

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e Gjuhës shqipe 1*, Tiranë, 2002

Musa Nushi, *Gramatika e sotme shqipe*, Gjakovë, 1998

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat (me ngjyra), gazetatat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

- **Vlerësimi i njohurive të studentëve bëhet gjatë gjithë semestrit dhe në testin paraprak dhe përfundimtar të provimit;**
- **Do të ketë test paraprak nga java 15 e njësisë akademike;**
- **Provimi mbahet me test dhe do të pyeten gojarisht;**
- **Studentët që arrijnë pikët maksimale në test do të lirohen nga provimi final;**
- **Studentët të cilët zihen me kopje gjatë testit, nuk kanë të drejtë të hyjnë në provim për tri afate.**

Kriteret e kalueshmërisë:**Pjesëmarrja në mësim: 15%****Angazhimi dhe marrja e plusave (+) gjatë semestrit: 30%****Provimi: 55%****Emërtimi i lëndës: *Matematikë II***

Përmbajtja: Kursi përmban një rishikim të koncepteve elementare algjebrike, shprehjet algjebrike, ekuacionet lineare, grafikun e ekuacioneve lineare, sistemet e ekuacioneve lineare me dy ndryshore dhe zbatimin e tyre. Po ashtu, në këtë kurs do të shqyrtohen kuptimet themelore nga gjeometria elementare si: trekëndëshi, perimetri dhe sipërfaqja trekëndëshe, katërkëndëshi dhe llojet e katërkëndëshave, rrethi, transformimet izometrike, madhësitë dhe matja e tyre, perimetri dhe syprina e sipërfaqeve shumëkëndëshe, trupat, syprina dhe vëllimi i tyre.

Qëllimet e mësimi: Qëllimi parësor i kësaj lënde është aftësimi i studentëve për të shqyrtuar disa koncepte themelore nga algjebra. Qëllim i dytë është zgjerimi dhe përgjithësimi i njohurive themelore nga gjeometria. Ndërsa, zhvillimi i aftësive dhe shkathtësive të studentëve për matjen e madhësive dhe zgjidhjen e problemeve të gjeometrisë në rrafsh dhe në hapësirë, është gjithashtu një nga qëllimet e rëndësishme të lëndës.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- të kryejnë veprimet me shprehjet e ndryshme shkronjore;
- të zbatojnë sistemet e ekuacioneve në zgjidhjen e problemeve nga jeta e përditshme;
- të përshkruajnë ndërtimin e gjeometrisë mbi bazën e sistemit aksiomatik;
- të dallojnë figurat gjeometrike në rrafsh sipas vetive të tyre;
- të analizojnë dhe të zgjidhin detyra të ndryshme lidhur me figurat gjeometrike;
- të gjejnë simetritë e figurave të ndryshme;
- të identifikojnë vetitë e trupave gjeometrik dhe analizojnë ato;
- të njehsojnë syprinën dhe vëllimin e trupave gjeometrik;
- të zgjidhin probleme të ndryshme nga jeta e përditshme.

Format/ Metodrat e mësimdhënies:

Ligjerata, shpjegim, diskutime, punë e pavarur individuale, punë në grupe

Literatura:

S.Tahiri, S. Rudi, N. Hyseni (1986) “*Matematika për studentët e grupit klasor*” Prishtinë;

Wesner, T and Nustad, H. (1991). “*Algebra with applications – WCB*”

M.Berisha, D. Kamberi, R. Gjergji, R. Zejnullahu (1990), *Përmbledhje detyrash nga matematika*, Prishtinë

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, kalkulatori etj.

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete:

Pjesëmarrja në ushtrime 20% (Katër kuize)

Testi 1 20 %

Testi 2 20 %

Provimi përfundimtar 40 %

Kriteret e kalueshmërisë:

Nota përfundimtare:

Pikët (%) Nota

- 90-100 **10**
- 80-89 **9**
- 70-80 **8**
- 60-69 **7**
- 50-59 **6**

Emërtimi i lëndës: *TIK në edukimin fillor*

Përmbajtja: Gjeneratat e kompjuterëve. Sistemi kompjuterik. Sistemet operative. Windows. Programet aplikative. Informacionet dhe komunikimet.

Qëllimet e mësimit: Njohja e studentëve me historikun e shkurtër të gjeneratës së kompjuterëve, njohja me njësitë themelore të kompjuterit, sistemin operativ WINDOWS, programin aplikativ WORD, programin aplikativ POWERPOINT dhe puna me INTERNET. Aftësimi për të shfrytëzuar programet aplikative në aktivitete me fëmijë. Lojrat arsimore me kompjuter.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

1. Të njohë pjesët themelore të kompjuterit dhe lidhjet e tyre;
2. Të përdorë sistemin operativ WINDOWS;
3. Të hartojë dototeka, vizatime dhe prezentime me programe aplikative;
4. Të realizojë aktivitete me anë të software arsimor për fëmijë,
5. Të aplikojë lojra arsimore me kompjuterë.

Format/Metodat e mësimdhënies: Ligjërata, Analiza e materialeve të shpërndara gjatë ligjëratave, Ushtrime, Puna individuale, Puna praktike në kompjuter individualisht, Punime seminarike.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
40%	60%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Dr. Agni Dika, Mr. Seb Rodiqi, *KOMPJUTERI PËR TË GJITHË*, Shkup 2000.

Xh. Thaqi & Sh. Bajrami, *Metodologjia e mësimdhënies së informatikës*, Prishtinë, 2010

Dr.sc. Edmond Beqiri: *Bazat e informatikës*, Pejë, 1999.

Mjetet e konretizimit:

kompjuteri, libri, fletorja, projektori etj

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi bëhet gjatë ligjeratave dhe ushtrimeve, të cilat janë të kombinuara me punë praktike dhe demonstrime në kompjuter përcjellur me diskutime

Kriteret e kalueshmërisë:

Vlerësimi i parë intermediar: 20%

Vlerësimi i dytë intermediar: 20%

Detyrat seminarike: 20%

Vijimi i rregullt 10%

Provimi final 30%

Total 100%

Emërtimi i lëndës: *Bazat e arsimit muzikor me metodologji*

Përshkrimi i lëndës: Kjo lëndë është me rëndësi të veçantë Fakultetin e Edukimit, me shtrirje të lëndës së Programit Parashkollor. Nevojë prioritare studentët e kanë të mësuarit e shkrim-leximit muzikor, duke u aftësuar që të këndojnë dhe interpretojnë në instrument me anë të notave muzikore.

Qëllimet e lëndës: Duhet të korrespondojnë me objektivat e Fakultetit përkatës, në funksion të aftësimit të studentëve për nxënie të duhur dhe aftësimin e tyre në kërkesat elementare në mësimdhënie të edukatës muzikore në të ardhmen. Mësohen për të qenë sa më praktik dhe të sukseseshëm në arritjen e qëllimeve në këtë fushë artistike, gjithnjë me synim të arritjes dhe zhvillimit të shijes artistike muzikore. Duke u marrë me të bukurën muzikore, bëhet synim edhe në ndërlidhjen e muzikës me lëndët dhe aktivitetet tjera mësimore, të cilat do të përvetësohen më me dashuri.

Rezultatet e pritura të nxënies: Kjo lëndë mësimore, tepër me rëndësi për këtë profil studimesh, arritjen e rezultateve e ka të sigurtë, nëse mësimdhënësi punon me përkushtim me studentet. Pritet që studentët do të aftësohen që: të përdorin dhe të kuptojnë shkrim leximin muzikor; të këndojnë dhe interpretojnë në një instrument; të ndërlidhin aktivitete nga fushat tjera me aktivitete muzikore.

Format/ Metodatat e mësimdhënies: e kombinuar, varësisht nga lloji i ligjëratis: (shpjegim – sqarim; ushtrime, analiza tekstore e ligjërimore; diskutime debatuese, punë në grupe,

demonstrim e interpretim, shtruarje e shqyrtim idesh, hartime krijuese, hulumtim i vetësishëm.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
55%	45%

Literatura:

Për pjesën teorike përveç literaturës tjetër, shfrytëzohet teksti shkollor “Prej notës deri te kënga”, ndërsa për interpretim në instrument përdoren shembuj më praktik të literaturës së autorëve vendor, si dhe shembuj të ushtrimeve dhe melodive të autorëve botëror.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsi, sintisaizer (instrument i domosdoshëm për studentët)

Metodat e vlerësimit:

Mësim i rregullt me metoda dhe teknika që mundësojnë nxënie të suksesshme.

Format e punës: frontale, grupore, individuale, etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrje dhe angazhim - deri në 15%

Test me shkrim -deri në 20%

Vijueshmëria deri në 5%

Provimi përfundimtar - 60%

Emërtimi i lëndës: *Praktika Pedagogjike I*

Përmbajtja: Në praktikën mësimore, studentët do të zhvillojnë shkathtësitë e vëzhgimit, do të njohin elementet bazë të programit me femijën në qendër, planifikimit të punës edukative të suksesshëm në këtë nivel arsimor, kuptojnë elementet e komunikimit të efektshëm ndërpersonal, si dhe krijimit të një klime të shëndoshë socio-emocionale në mjedisin e kopshtit.

Qëllimi i lëndës: Qëllimi parësor i komponentës së mësimimit praktik është që studentët të njoftohen me jetën në institucionet parashkollore, ambientet e punës me fëmijë, organizimi i

hapësirave dhe realizimi i punës edukative në fëmijërinë e hershme. Njohja, të kuptuarit dhe zbatueshmeria e punës edukative, do të arrihet përmes vrojtimit dhe gjatë asistimit të edukatoreve në procesin e realizimit të aktivitetit në ambiente pune. Ky kurs do të nxisë studentët që të demonstrojnë shkathtësi dhe të reflektojnë për trendet bashkëkohore në edukim.

Rezultatet e të nxënurit: Studentët do të bëjnë vëzhgim sistematik në ambientet e kopshtit; të përshkruajnë atë që kanë vëzhguar dhe t'i ndërlihdhin vëzhgimet e tyre me nocionet e zhvillimit të nxënësit dhe teorisë së edukimit në fëmijërinë e hershme; kuptojnë strukturën themelore të aktivitetit edukativ me fëmijët e moshave të caktuara në kuadër të fëmijërisë së hershme; të jenë në gjendje të planifikojnë aktivitete të thjeshta për grupe të vogla; të çmojnë rëndësinë e vetëvlerësimit nëpërmjet reflektimit me shkrim; të asistojnë në mënyrë efektive në punën edukative të cilën e realizon edukatorja.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Përmes praktikës pedagogjike, profesori do t'i vlerësojë sipas vëzhgimit të tij sistematik gjatë praktikës së tyre, të cilën e realizojnë në institucionet përkatëse.

Kriteret e kalueshmërisë:

Sipas asistimit të tyre në aktivitetet edukative me fëmijët e moshave të caktuara.

Emërtimi i lëndës: *Komunikimi në arsim*

Përmbajtja e lëndës: Kursi *Komunikimi në arsim* paraqet hyrje në teorinë dhe hulumtimet e komunikimit në fushën e arsimit. Ky kurs është i dizajnuar që të trajtojë problemin e komunikimit në aspektin teorik dhe atë praktik, gjë që do të mundësojë që të arrihet studimi i teorive dhe hulumtimeve aktuale në fushën e komunikimit, si dhe komunikimi i praktikuar gjatë procesit të edukimit. Në veçanti do të theksohen problemet e komunikimit në mjedisin edukativ institucional me qëllim që të njihin më mirë, të kuptojnë e të analizojmë procesin e komunikimit në arsim, roli i edukatorit, i nxënësit, e të faktorëve tjerë në këtë mjedis për një komunikim të efektshëm dhe më kompetent në institucion edukativ. Komunikimi në edukim përfshin çështje të komunikimit duke përfshirë, *procesi* i komunikimit, komunikimi

efektiv, parimet për komunikim të efektshëm, komunikimi kompetent, barrierat për komunikim efektiv, komunikimin interpersonal dhe komunikimin në grup të vogël, shkathtësitë e të dëgjuarit, komunikimi verbal dhe joverbal (Nga perspektiva e nxënësit dhe mësimitdhënesit), *strategjitë për të udhëzuar për debate, prezentim, rrëfim, persuazia në edukim.* Në këtë rast kuptohen edhe faktorë të tjerë, të cilët ndikojnë në komunikimin e arsimit dhe diskutohet për zhvillimin e shkathtësive për të krijuar një komunikim të efektshëm në procesin e edukimit.

Rezultatet e pritura: Në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje: Të kuptojnë nevojën për të reflektuar për komunikim në mjedise arsimore; Të njohin teorinë bazë dhe hulumtimet aktuale të komunikimit në arsim; Të kuptojnë dimensionin etik të komunikimit në arsim; Të analizojnë qëndrimet dhe shprehjet e komunikimit të efektshëm në klasë; Të analizojnë klimën e komunikimit efektiv në klasë; Të demonstrojnë njohuri dhe shkathtësi në situata të caktuara (të dëgjuarit aktiv, strategji të zgjidhjes së situatave konfliktuale,..); Të aplikojë eksperiencën teorike dhe praktike për hulumtime në fushën e komunikimit në arsim; Të gjurmojnë për modele të ndryshme të komunikimit në harmoni me teori të ndryshme po të komunikimit.

Strategjitë e mësimitdhënies: Do të zbatohet koncepti i mësimitdhënies interaktive ku studentët do të kenë mundësi të analizojnë aspekte të ndryshme të temave përkatëse dhe të jenë në gjendje të reflektojnë rreth praktikës së tyre profesionale në këtë kontekst. Studentëve do t'u jipet mundësi që të prezantojnë rreth temave të caktuara.

Vlerësimi:

Vlerësimi do të jetë i vazhdueshëm përmes punimeve me shkrim (ose edhe prezantimeve), testeve të vogla të caktuara nga ligjëruesi i kursit, si dhe përmes provimit përfundimtar në fund të semestrit.

Literatura :

4. Adler, B. R., Rosenfeld, B. L., Towne, N. (1983). INTERPLAY, The Process of Interpersonal Communication. New York: publisher.
5. Brajsa, Pavao (1994), Pedagogoska Komunikologija, Zagreb, "Skolske novine"
6. Breakwell, Glynis M. (2007), Vjestine vodenja intervjuja 2 izdanje, Zagreb . "Naklada slap"

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Ligjëratat, me pjesën e tyre teorike dhe orë të ushtrimeve, të cilat përfshijnë punën në grupe, punën individuale, diskutimet, detyrat javore të kursit si dhe punimet e seminarit.

Kriteret e kalueshmërisë:

Angazhimi 10%,

Seminaret 10%,

Testet provuese 20%, dhe

Testi përfundimtar 60%

Emërtimi i lëndës: *Historia e arsimit kombëtar*

Përshkrimi i lëndës Qëllimi i kursit është njohja e studentëve me zhvillimin historik të arsimit dhe mendimit pedagogjik kombëtar, me idetë pedagogjike të humanistëve shqiptarë, me institucionet kombëtare si: Akademia e re e Voskopojës, Rilindja kombëtare, Mësonjëtorja e parë, Normalja e Elbasanit, me personalitetet kombëtare si: motrat Qiriazit dhe Shkolla e Vashave, Kontributi pedagogjik i vëllezërve Frashëri, P. Bogdanit, P. Budit, Sh. Gjeçovi, A. Xhuvanit, etj.

Qëllimet e lëndës: Kursi ka për qëllim:

1. Të nxisë interesimin për traditën arsimore pedagogjike;
2. Të analizojë vlerat pozitive të traditës arsimore dhe mësimi bashkëkohor;
3. Të krahasojë idetë e pedagogëve shqiptarë në periudha të ndryshme të zhvillimit;
4. Të rrisë interesimin për kërkime shkencore në këtë fushë pedagogjike.

Rezultatet e pritura të të nxënësve: Studentët do të jenë në gjendje: 1. të analizojnë njohuritë për ndikimet e komunitetit të vet mbi mendimin edukativ - kombëtar; 2. të demonstronë lidhjet në mes personaliteteve kryesore edukative - kombëtare dhe programeve të tanishme të studimeve nga fusha e edukimit në Kosovë; 3. të demonstronë aftësi për të projektuar idetë pedagogjike kombëtare në praktikën mësimore; 4. të reflektojnë për institucionet dhe personalitetet e njohura të traditës arsimore kombëtare.

Format/ Metodatat e mësimdhënies

Mësimi i rregullt; format e ligjërimit: ligjërata, leximi i literaturës dhe komentimi, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezentimi në grup.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
45%	55%

Literatura bazë -

Koliqi, H. (2003), *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Prishtinë, Libri Shkollor

Grup autorësh (1990), *Historia e arsimit shqiptar*, Tiranë

Myzyri, H. (1973), *Shkollat e para kombëtare shqiptare*, Tiranë

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsi, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Gjatë ligjëratave, diskutimeve, punës në grupe me përgjegjësi të ndara, prezantim në kuadër të ushtrimeve, si dhe sistematizim të vazhdueshëm vlerësimi etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Vijimi i rregullt: 10%

Punë e pavarur e studentit/projektet	10 %
Kollokiumi i parë	20 %
Kollokiumi i dytë	20 %
Provimi përfundimtar	40%

Emërtimi i lëndës: *Vizatim*

Përmbajtja e lëndës: Në këtë kurs do të shfytëzohen njohuritë themelore si: Bisedë përgatitore për formën dhe përmbajtjen; Lloje vizatimi: vizatim nga natyra; vizatim dekorativ, vizatim tematik; Njohuri mbi perspektivën, formën, drejtpeshimin, hapësirën, ritmin; Dekoracionet gjeometrike; Logotipet; Peisazh nga natyra; Skica; Portreti; Autoportreti; Kroki; Karikatura; Ilustrimi me akuarel; Vija; zhgarravina dhe vizatimi; Vizatimi për parashkollorë dhe rëndësia e tij; Vizatimi simetrik me ndihmën e palosjes; Skica

dhe pikturimi në akualet; Vizatimi; Llojet e materialeve dhe përdorimi i tyre; Punimet me tush, bajc; Mjetet e duhura për përdorim; Vizatimi si formë e ndërgjegjes shoqërore; Vizatimi dhe pjesët përbërëse të tij; Simbolet e figurave, psikologjia e artit, motivimi i fëmijëve përmes shkarravinave; Vizitë në galeri artesh.

Rezultatet e nxënies: Studentët do të aftësohet që: të njohë formën dhe përmbajtjen; vizatim nga natyra; vizatim dekorativ, Vizatim tematik; Të njohë perspektivën, formën, drejtëpeshimin, hapësirën, ritmin. Dekoracionet gjeometrike. Logotipet; Të realizojë Peisazh nga natyra. Skica, Portreti. Autoportreti. Kroki. Karikatura. Ilustrimi me akualet. Vija, zhgarravina dhe vizatimi; Të njohë Vizatimin për parashkollorë dhe rëndësia e tij. Vizatimi simetrik me ndihmën e palosjes. Skica dhe pikturimi në akualet. Të dijë të selektojë llojet e materialeve dhe përdorimi i tyre. Punimet me tush, bajc, mjetet e duhura për përdorim .Vizatimi si formë e ndërgjegjes shoqërore.Vizatimi dhe pjesët përbërëse të tij. Simbolet e figurave, psikologjia e artit, motivimi i fëmijëve përmes shkarravinave. Vizitë në galeri artesh.

Format/ Metodatat e mësimdhënies

Ligjërata, demonstrime të teknikave, ushtrime, punë individuale, vizita studimore jashtë fakultetit (në Galeri), punë në grupe etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
40%	60%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

7. Angela Gear, 'The Artist's Handbook', Abbeydale Press 2007
8. Bardhyl Musai, Metodogji e mësimdhënies, PEGI, Tiranë, 2003Ernst H. Gombrich, Historia e artit, Fondacioni Soros, Shqipëri 1996
9. Silvana Nini, Valbona Duraj, Mehmet Xhelili dhe Blerina Arbana, Artet – Arti pamor, muzika, teatri, kërcimi, PEGI, Tiranë 2009

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, blloqe vizatimi etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, demonstrime të teknikave, ushtrime, punë individuale, vizita studimore jashtë fakultetit (në Galeri), punë në grupe etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 60% dhe pjesa teorike 40%.

Emërtimi i lëndës: *Gjuhë Shqipe III*

Përshkrimi i lëndës: Në këtë kurs studentet do të marrin njohuri të reja, duke i zgjeruar njohuritë e tyre paraprake, përkitazi me organizimin e tekstit: objektin e studimit të sintaksës, klasifikimin e togfjalëshave, klasifikimin dhe llojet e fjalive për nga struktura e tyre, modaliteti etj., gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët plotësuese të fjalisë: Po ashtu ata do t'i thellojnë njohuritë e tyre edhe në fushën klasifikimit dhe të llojeve të fjalisë së përbërë (fjalitë e bashkërenditura dhe fjalitë e nënrenditura).

Qëllimi i lëndës është që studentët:

T'i thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë e tyre në fushën e gjuhësisë në përgjithësi e të organizimit të tekstit (sintaksës) në veçanti; Të njihen teorikisht dhe praktikisht në mënyrë që t'i dallojnë togfjalëshat nga fjalitë; fjalitë e thjeshta nga fjalitë e përbëra; gjymtyrët kryesore nga ato plotësuese, si dhe problemet e tjera që shtrun sintaksa; Të fitojnë aftësi për të dalluar trajtat dhe format normative nga ato që nuk janë normative në ligjërimin e folur dhe të shkruar, në mënyrë që t'i zbatojnë këto aftësi në të ardhmen të nxënësit e ciklit të ulët të shkollës fillore.

Rezultatet e pritura të të nxënës: Studentët do të jenë në gjendje: T'i dallojnë njësitet sintaksore në tekst; T'i përdorin mjetet ndërtimore dhe renditjen e tyre për një gjuhë sa më funksionale, të kuptueshme dhe shprehëse, si në formën e folur ashtu edhe në atë të shkruar, sipas rregullave të shqipes standarde, si gjatë studimeve të tyre, ashtu dhe të fëmijët e institucioneve Fillore; T'i identifikojnë dhe zbatojnë drejt e qartë ndërtimet-njësitet sintaksore të nxënësit e ciklit të ulët të shkollës fillore.

Format/ Metodatat e mësimdhënies: e kombinuar, varësisht nga lloji i ligjëratës: (shpjegim – sqarim; ushtrime, analiza tekstore e ligjërimore; diskutime debatuese, punë në grupe, demonstrim e interpretim, shtruarje e shqyrtim idesh, hartime krijuese, hulumtim i vetësishëm.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
55%	45%

Literatura baze

1. Jashari Ali & Kryeziu Bahtijar (2010), *Gjuhë amtare* për studentët e Fakultetit të Edukimit, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
2. Biba, dr. Elona (2008), *Ndërtimet sintaksore të shqipes përmes shembujve praktikë – ushtrime sintaksore*, Korçë.
3. Akademia e Shkencave të Shqipërisë (2002), *Gramatika e Gjuhës shqipe II*, Tiranë.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsi, gazetata, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Gjatë ligjëratave, diskutimeve, punës në grupe me përgjegjësi të ndara, prezantim në kuadër të ushtrimeve, si dhe sistematizim të vazhdueshëm vlerësimi etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Studentët do të hyjnë në dy procese vlerësimi, si me shkrim, po ashtu do të pyeten edhe me gojë. Gjithsesi, do të merren parasysh dhe vlerësimi dhe marrja e plusave gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve.

Emërtimi i lëndës: *Hyrje në psikologji*

Përmbajtja e lëndës: Kjo është një lëndë hyrëse në psikologji dhe ka për qëllim t'i njoftojë studentët me fushën e studimit të psikologjisë, lëndën e studimit të saj, parimet, rregullat, teoritë themelore, si dhe historinë e zhvillimit të psikologjisë si shkencë, metodologjinë dhe zbatimin e psikologjisë në praktikë. Në përgjithësi kursi përfshinë bazat e psikologjisë së përgjithshme. Studentët do të njoftohen me bazat e krijimit të psikologjisë si shkencë moderne. Atyre do t'ju prezantohen proceset psikike bazë dhe metodat e mjetet e hulumtimit të këtyre proceseve. Ky kurs përshkruan në mënyrë shkencore, përmes gjetjeve empirike dhe qasjeve të ndryshme, sjelljen e njeriut dhe proceset e tij psikike.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

- Të njohë faktet, teoritë dhe hulumtimet themelore në fushën e studimit të psikologjisë;
- Të kuptojë fushën e psikologjisë në aspektin historik dhe aktual;
- Të njohë metodologjinë hulumtuese shkencore të përdorur nga psikologët, dhe të analizojë përparësitë dhe mangësitë e këtyre metodave përkitazi me zhvillimin e psikologjisë si shkencë; -Të njohë motivet, personalitetin, ndërveprimet sociale dhe forcat biologjike që ndikojnë në sjellje;
- Të njohë proceset e involvuara në të mësuarit dhe të menduarit.

Metodologjia e mësimdhënies: Fokusi kryesor i metodologjisë së përdorur në kurs do të jetë kalimi përtej qasjes tradicionale në ofrimin dhe synimin e njohurive që studentëve t'iu mundësohet të zhvillojnë aftësitë vetëreflektuese, mendimin kritik dhe interaksionin grupor në mënyrë që të arrijnë ta kuptojnë më mirë sjelljen e vet dhe të tjerëve. Studentët do të kenë rastin të analizojnë gjatë praktikës një fëmijë/nxënës si “rast studimi” në mënyrë që të lidhin teorinë me praktikën.

Literatura bazë:

Materiale të ndryshme të mbledhura nga shfletimi i literaturës nga Ass. Blerta P. Shehu

”Psikologjia e Përgjithshme”- Prof. Dr. Pajazit Nushi, Prishtinë 2002

“Psikologjia (Një hyrje koncize)”- Pettijohn. F. Terry, 1996

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Leksion i avansuar, diskutime, punë në grupe, punë në çifte, punë individuale, metoda ndërvepruese të mësimdhënies

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim 5%

Angazhimet / detyrat 5%

Prezentimet nga hulumtimi 10%

Vlerësimi i parë 30%

Vlerësimi final 50%

Emërtimi i lëndës: *Teoria e mësimit*

Përmbajtja: Ky kurs do t'u ndihmojë studentëve që të kuptojnë nocionet themelore të edukatës, historinë e edukimit dhe të shkollës gjatë etapave të ndryshme të zhvillimit shoqëror, konceptet e filozofëve dhe pedagogëve të mëdhenj, rolin dhe ndikimin e tyre. Po ashtu, kjo lëndë trajton edhe teoritë bashkëkohore të edukimit si: pragmatizmi, edukimi progresiv, kognitivizmi, konstruktivizmi, humanizmi etj.

Qëllimet e mësimit:

Ky kurs i lëndës do të ofrojë dhe shtjellojë këto qëllime:

1. Që studentët të kuptojnë zhvillimin e edukimit dhe mendimit pedagogjik nga kohërat antike deri te idetë përparimtare moderne;
2. të reflektojnë për teoritë bashkëkohore të edukimit, njohjen dhe konceptin e tyre;
3. të zhvillojnë filozofinë personale dhe të ndërlidhin atë me praktikën bashkëkohore të mësimit, gjatë proceseve të ndryshme.

Rezultatet e të nxënësve të lëndës:

Studentet do të jenë në gjendje: të analizojnë idetë pedagogjike të cilat pasqyrohen në praktikën e sotme të edukimit, trendet dhe konceptet e ndryshme; të reflektojnë për faktorët themelore të zhvillimit të personalitetit, të njeriut në përgjithësi; të krahasojnë teoritë bashkëkohore të edukatës nga këndvështrimi praktik gjatë mësimit; të demonstron aftësi për të krahasuar rolin e mësimit dhe nxënësve duke u bazuar në historinë e edukimit dhe në filozofinë bashkëkohore të edukimit.

Format/ Metodatat e mësimit

Përmbajtja e kësaj lënde do të prezantohet përmes ligjëratave, diskutimeve, aktiviteteve në grupe të vogla, në çifte dhe në punë individuale me qëllim të analizimit të rasteve dhe zbatimit të përvojave që studentët i kanë arritur gjatë praktikës në terren. Me fjalë të tjera aktivitetet dhe detyrat që jepen do të zhvillohen në formë diskutimi e komunikimi me gojë dhe me shkrim.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike 60%	Pjesa praktike 40 %
-------------------	---------------------

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Hajrullah Koliqi, *Historia e pedagogjisë I*, Prishtinë, 1997

Hajrullah Koliqi, *Historia e pedagogjisë II*, Prishtinë, 1998.

Hajrullah Koliqi, *Gruaja ndër shekuj*, Prishtinë, 2009

Musa Kraja, *Pedagogjia*, Tiranë, 2009

Bardhyl Musai, *Psikologji edukimi*, Tiranë, 1999

Grup autorësh, *Pedagogjia e përgjithshme*, Prishtinë, 1997

Nuredini, V. *Teoria e mësimet me nxënësin-studentin në qendër*, FSDEK, Prishtinë 2008.

Nuredini, V. *Teknologjia e mësimet*, F.E. Prishtinë 2005.

Marzano, R., *Nastavne strategije*, 'Educa', Zagreb. 2006.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Ligjëratat, me pjesën e tyre teorike dhe orë të ushtrimeve, të cilat përfshijnë punën në grupe, punën individuale, diskutimet, detyrat javore të kursit si dhe punimet e seminarit.

Kriteret e kalueshmërisë:

Angazhimi 10%,

Seminaret 10%,

Testet provuese 20%, dhe

Testi përfundimtar 60%

Emërtimi i lëndës: Gjuhë angleze II

Qëllimet e mësimet: Programi i gjuhës angleze synon përmirësimin dhe nxënien e nivelit të parë të gjuhës angleze. Ky program ofron praktikë sistematike në katër fusha kryesore të gjuhësisë, respektivisht në atë të gjuhës angleze: të lexuarit, të shkruarit, të folurit dhe të

dëgjuarit, duke i hulumtuar dhe njohur situatat dhe përmbajtjet e temave që ofron literatura e përcaktuar sipas programit studimor.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Lexim të rrjedhshëm, përvetësim praktik të gramatikës elementare, komunikim verbal, përvetësim të të shkruarit, pasurimin e fjalorit të gjuhës angleze.

Format/ Metodat e mësimdhënies: Çasje komunikative në mësimin e gjuhës angleze; Testimi dhe vlerësimi me gojë

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
45%	55%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Teksti shkollor - Headway Pre-intermediate, the third edition

Libri dhe fletorja e punës

Teste nga interneti

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat (me ngjyra), gazetatat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Testimi dhe vlerësimi me gojë

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim: 15%

Angazhimi dhe kollokiumet gjatë semestrit: 30%

Provimi: 55%

Emërtimi i lëndës: *Interpretim me instrumente*

Përmbajtja: Kursi është i ndarë në disa pjesë: njohja me instrumentin, mundësitë teknike pjesët e tij, mënyra e interpretimit, interpretimi i shkallëve (C, G, me dy duar D, A, E, H, FIS, CIS, F, B, ES, AS, DES, GES, CES me nga një dorë, interpretimi i shkallëve (a, e, me dy duar h, fis, cis, gis, dis, ais, d, me dy duar g, c, f, b, es, as, me nga një dorë, interpretimi i 8

këngëve me specifika të grupmohës së të vegjëlve, përkatësisht të klasës së parë të shkollës fillore, interpretohen 5 lojëra muzikore përkatësisht 8 këngë të klasës së tretë të shkollës fillore, interpretimi në veglat e Orfit të këngëve të realizuara në instrument klasik-interpretimi i 4 modeleve

Qëllimet e mësimit: Përmes kusit studenti do të interpretojë këngë fëmijërore, artistike popullore shqiptare dhe të popujve të tjerë; Të interpretojnë shkallët diatonike dur dhe mol; Të realizojnë ushtrime teknike për arritjen e shkathtësive dhe shprehive në interpretim; Përvetësojnë koncepte nga bazat e arsimit muzikor; Të aftësohen që në praktikë krijimtarisht të zbatojnë dhe të sistemojnë dituritë e arritura në mënyrë të llojëllojshme, të realizuara varësisht nga komponentet e veçuara në edukatën muzikore parashkollore përkatësisht atë të nivelit të parë të shkolles fillore; Të kuptojnë konceptet themelore, ligjshmëritë dhe informacionet për mjetet, shprehjet muzikore, format dhe llojet të cilat mundësojnë të kuptuarit e muzikës.

Rezultatet e të nxënit të lëndës (kompetencat, njohuritë dhe shkathtësitë)

1. Të njohë konceptet themelore nga të interpretuarit në instrument; 2. Të kuptojë rëndësinë e instrumentit dhe mundësitë që iu ofrojnë studentëve interpretimin dhe në realizimin e edukatës muzikore fillore, përkatësisht të nivelit të parë, të ciklit të ultë (në shkollë fillore); 3. do të njihen me rolin e instrumenteve, mundësitë teknike të tyre si dhe zotërimin për interpretim; 4. Të aftësohen për punë ekipore në interpretim grupor-kolektiv; 5. Formojnë qëndrim të drejt ndaj interpretimit dhe edukimit muzikor, fitojnë shkathtësi për interpretim dhe shprehi pune; 6. Aftësohen për interpretim individual dhe të përbashkët të këngëve që dalin nga programi i edukatës muzikore fillore, përkatësisht të nivelit të parë të shkollës fillore. Ky kurs ndikon fuqishëm në formimin e personalitetit të njeriut, në ngritjen e tij kulturore dhe profesionale.

Format/ Metodat e mësimdhënies

Ligjërata grupore, ndërsa pjesa praktike organizohet në grupe të vogla prej 15 studentësh.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike 50%	Pjesa praktike 50%
--------------------------	---------------------------

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Seniha Spahiu, Edukatë muzikore, EMMK, Prishtinë, 1976

S. Spahiu, S. Gjinali, Gëzimi ynë, EMMK, Prishtinë, 1980

Edukatë muzikore I, II, II, IV, V, Dukagjini, Pejë

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsi, sintisaizer (instrument i domosdoshëm për studentët)

Metodat e vlerësimit:

Mësim i rregullt me metoda dhe teknika që mundësojnë nxënie të suksesshme.

Format e punës: frontale, grupore, individuale, etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrje dhe angazhim - deri në 15%

Test me shkrim -deri në 20%

Vijueshmëria deri në 5%

Provimi përfundimtar - 60%

Emërtimi i lëndës: *Edukatë qytetare*

Përmbajtja: Kursi është konceptuar për të përfshirë sa më shumë tematika nga jeta shoqërore.

a) Njohuritë: Studentët duhet të fitojnë njohuri solide mbi rrjedhat reale shoqërore dhe domosdoshmërinë e sjelljes bazuar në to; nxitjen e tyre për vetedukim; njohjen me progresin dhe të metat në rrjedhat shoqërore; njohjen se sjellja e qytetëruar është një bazament për progres kombëtar e shtetëror.

b) Shkathtësitë: Nepërmjet njësive të përgjithëshme do të krijohen shkathtësi motorike për përshtatje çdo situatë konkrete; të mësohen të zbatojnë rregullat e jetës në familje, sjelljes në rrugë; sjellje të duhur në shkollë dhe institucione tjera; respektimin e realitetit politik dhe ekonomik të Kosovës; shmangien nga dukuritë negative dhe krijimin e kulturës qytetëruese.

c) Qëndrimet: Studentët duhet të kuptojnë rëndësinë e sjelljes, veshmbathjes dhe raporteve të mira me të gjithë ata që jeton dhe bashkëvepron; të ketë qëndrim të respektueshëm ndaj natyrës dhe ruajtjes së saj; të ketë qëndrime korrekte dhe mirëkuptimi ndaj minoriteteve dhe shmangien nga konfliktet si të natyrës politike, ekonomike, kulturele etj.

Rezultatet e pritura të nxënies: Studentët do të kuptojnë: 1) Jetën komplekse shoqërore dhe nevojën për mbështetje dhe sjellje bazuar në normat e aprovuara ligjore, morale dhe tradicionale; 2) Të krijohen shprehje të sjelljes në varësi të rrethanave konkrete ; 3) Të aftësohen për jetë dhe mesimdhënie sa më të drejtë dhe objektive; 4) të jenë të gatshëm për raporte të mira ndërnjerezore dhe kolegjiale; 5) të angazhohen për të luftuar dukuritë negative në shoqëri dhe për zhvillimin e demokracisë.

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjerata, bashkëbisedim, seminare dhe teste provuese.

Lieteratura bazë:

1. Patrice Canivez, *Të edukohet qytetari*, Pejë, 2004. fq. 15-54.
2. Anthony Giddens, *Sociologjia*, Tiranë, 2004
3. Hajrullah Koliqi, *Sistemi shkollor në Kosovë*, Prishtinë, 2006.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Ligjerata, bashkëbisedim, seminare dhe teste provuese.

Kriteret e kalueshmërisë:

Angazhimi 10%,

Seminaret 10%,

Testet provuese 20%, dhe

Testi përfundimtar 60%

Emërtimi i lëndës: *Edukimi fizik dhe shëndetësor*

(kjo pjesë të përkthehet anglisht)

Përmbajtja: Lenda ofron informacione në lidhje me zhvillimin fizik dhe levizore në femrinë e hershme mjaft e rëndësishme dhe ngushtësisht me të gjitha fushat e të zhvillimit. Lenda ofron për studentet njohuri për nocionet themelore, për rëndësinë e zhvillimit të shëndetit dhe

ati motorik, informacione rreth procesit te zhvillimit motorik, menyres se si femijet i mesojn lëvizjet , intelengjencen kinezetike si dhe iden e aktiviteteve te cilat mbështesin zhvillimin optimal te femijve ne kete fushe.

Qëllimet e mësimimit: Synohet qe studentet te zotrojn nocionet themelore lidhur me shëndetin dhe zhvillimin motorik , aftesit levizore , bazike , ato fine, lakomotore dhe jolakomotore, aftesit e kordinimit syvizdor dhe te orientimit ne hapesir dhe kohe. Komponent shum e fuqishme eshte kujdesi per vehte , ku nderthuren aftësimi per plotësim te rutinave ditore dhe shmangje te rreziqeve te mundshme. Qellimi i lendes eshte edhe sigurimi i lidhmeris me përmbajtjen e lendeve te tjera me qellim integrimin e njohurive dhe shkathtësive permes qasjes toksore dhe femijen ne qender.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Pas këtij kursi studenti do të jetë i pajisur me njohuri që të jetë në gjendje t'i kontribuojë ruajtjes së shëndetit vetanak dhe të tjereve, të njohë anatominë dhe fiziologjinë elementare të trupit. Do të njohë lidhshmërinë në mes të organizmit të njeriut dhe ambientit përreth tij, si dhe ndikimin e faktorëve të dëmshëm dhe atyre të favorshëm për shëndetin. Do të inkurajohet dhe mishërohet personalisht me edukimin fizik shëndetësor vetanak duke ua përcjellë të tjerëve njohuritë lidhur me rëndësinë e tyre për shëndetin. Do të mësojë të identifikojë disa sëmundje ngjitëse dhe jongjitëse të moshës parashkolllore dhe shkolllore si dhe për vendimet (prevencën dhe masat për përkujdesjen elementare nga to).

Format/ Metodatat e mësimdhënies

Mësimi i rregullt organizohet në ligjërata grupore, ndërsa pjesa praktike organizohet në grupe të vogla prej 15 studentësh.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
70%	30%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Ramadani N, *Shëndetësia Publike & Etika*, Prishtinë, 2005.
2. Pollozhani A, Kendrovski V, Krasniqi S, *Ekologjia Humane & Shëndeti Publik*, 2009.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Ligjëratat, me pjesën e tyre teorike dhe orë të ushtrimeve, të cilat përfshijnë punën në grupe, punën individuale, diskutimet, detyrat javore të kursit si dhe punimet e seminarit.

Kriteret e kalueshmërisë:

Angazhimi 10%,

Seminaret 10%,

Testet provuese 20%, dhe

Testi përfundimtar 60%

Emërtimi i lëndës: *Shkathtësitë e komunikimit me fëmijë*

Përmbajtja: Kursi shtjellon më tutje njohuritë e fituara paraprakisht në kurset e lëndëve psikologjike, për t'i aftësuar studentët t'i zbatojnë ato njohuri në ndërveprimin që kanë me fëmijët; teorinë e Vigotskit dhe të Piaghesë mbi format e komunikimit dhe punës me fëmijët; Çfarë na thonë hulumtimet më të reja për format e komunikimit me fëmijë, për ndikimin e të rriturve tek fëmijët, për ndikimet e mjeteve të informimit dhe komunikimit masiv.

Qëllimet e mësimi: Të zhvillojë shkathtësitë e studentëve për të komunikuar dhe ndërvepruar me fëmijë; Të zhvillojë shkathtësitë e studentëve për të nxitur bashkëpunimin dhe për zgjidhje të konflikteve; Të zhvillojë aftësitë intrapersonale dhe interpersonale të studentëve; Të zhvillojë aftësitë e empatisë dhe të dëgjuarit aktiv të studentëve; Të zhvillojë të menduarit kritik të studentëve.

Rezultatet e të nxëniti të lëndës: Studenti do të aftësohet të reflektojë dhe të përmirësojë aftësitë e veta të komunikimit; të aftësohet për të qenë vetkritik dhe ndjeshëm ndaj sjelljeve komunikuese; të aftësohet për zgjidhje të konflikteve mes fëmijëve dhe nxitje të bashkëpunimit mes tyre; të zotërojë artin e empatisë dhe të dëgjuarit aktiv

Format/ Metodatat e mësimdhënies:

Njohuritë dhe shkathtësitë e studentëve do të zhvillohen kryesisht përmes punës në klasë (përfshirë vetreflektim, studim situatash, lojë me role) dhe përmes ligjëratave formale

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike: 40%	Pjesa praktike: 60%
--------------------	---------------------

Literatura:

Haden Elgin, Suzette, "The Gentle Art of Communicating ëith Children", Wiley, 1996

Lockhart, Estes "Communicating with Kids", Undercurrents Press, 1990

Miller, Bonie, "Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënës", Prishtinë, 2005

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsi, sintisaizer (instrument i domosdoshëm për studentët)

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi i përgjithëshëm i studentëve, përveç kolloqfiumit I dhe II, testit final dhe punës individuale në rastin e studimit, do të bëhet duke pasur parasysh edhe kontributin e tyre në aktivitetet në klasë dhe përkushtimin për diskutim dhe komentim gradual të punës individuale të rastit të studimit në formë të esesë

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrje dhe angazhim - deri në 15%

Test me shkrim -deri në 20%

Vijueshmëria deri në 5%

Provimi përfundimtar - 60%

Emërtimi i lëndës: *Letërsi për fëmijë*

Qëllimet e mësimi: Struktura letrare në letërsinë për fëmijë: proza, poezia, drama dhe rrymat tjera letrare bashkëkohore. Analiza dhe interpretimi i veprave të njohura të letërsisë për fëmijë shqipe dhe botërore.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë të aftë që: Të dallojnë format e strukturës letrare për fëmijë: prozë, poezi, dramë, si dhe rrymat moderne. Të mund të hartojnë dhe të zhvillojnë analiza dhe interpretime të pavarura.

Të vlerësojnë drejt epokat e ndryshme të kësaj letërsie, si dhe në kontest me traditën tonë në tërësi.

Format/ Metodatat e mësimdhënies:

Ligjërata, ushtrime, puna në grupe seminare, diskutime etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
40%	60%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Shkrimtarë shqiptarë I, II

Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqipe, 2009*

Rexhep Qosja, *Asdreni – Jeta dhe vepra*

Grup autorësh, *Historia e letërsisë shqiptare*, AShA – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Rilindja, Prishtinë, 1989.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Ligjëratat, me pjesën e tyre teorike dhe orë të ushtrimeve, të cilat përfshijnë punën në grupe, punën individuale, diskutimet, detyrat javore të kursit si dhe punimet e seminarit.

Kriteret e kalueshmërisë:

Angazhimi 10%,

Seminaret 10%,

Testet provuese 20%, dhe

Testi përfundimtar 60%

Emërtimi i lëndës: Metodologjia e mësimit të matematikës I

Përmbajtja: Në lëndën **Metodologjia e mësimit të matematikës I** shqyrtohen: teoritë e të nxënit të matematikës, mësimdhënia dhe të nxënit për zhvillimin e koncepteve themelore, zhvillimi i konceptit numër dhe numërim, thyesat dhe modelet për thyesat, veprimet themelore në matematikë, shfrytëzimi i mjeteve të konkretizimit dhe atyre manipulative, të menduarit kritik gjatë të lexuarit dhe të shkruarit dhe planifikimi i planeve ditore .

Qëllimet e mësimit:

Qëllimi parësor i lëndës ‘Metodologjia e mësimit të matematikës I’ është përgatitja e studentëve për mësime të matematikës në klasat I-V të shkollës fillore. Qasja e bazuar në kompetenca e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe parimet e Kurrikulës janë bazë e zhvillimit të aftësive dhe shkathtësive personale të studentëve që u mundësojnë atyre të bëhen mësime të shkëlqyeshëm.

Rezultatet e të nxënësve të lëndës:

Në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje: të shqyrtojnë teorinë e nxënësve të matematikës dhe fazat e zhvillimit të edukimit matematikor; të integrojnë parimet e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës në planifikimet e orëve të matematikës; të analizojnë strategji të ndryshme për zhvillimin e koncepteve themelore matematikore; të integrojnë në projektet e aktiviteteve mësimore fushën e gjuhës, artit dhe shkencat duke shfrytëzuar metodat e të nxënësve ndërveprues; të demonstrojnë se si materialet manipulative mund të lehtësojnë të nxënësve; të harmonizojnë mësime të nxënësve me stilet e të nxënësve të nxënësve dhe intelegjencat e shumfishta gjatë aktiviteteve me numra dhe veprimeve me numra; të përdorin metoda të ndryshme të vlerësimit të përparit të nxënësve gjatë planifikimit të mësimeve

Format/ Metodatat e mësimit:

Shpjegim, bashkëbisedim, prezantimi i punës në grupe, diskutim në grup, punë individuale

Literatura:

Van de Walle, J. (2007). *Elementary and middle school mathematics: Teaching developmentally*. (5th ed.). Boston, MA: Allyn and Bacon/Longman, Inc.

Liping Ma; *Knowing and teaching elementary mathematics*, LEA-London (1999)

Musai, B (2005) *Mësime dhe të nxënësve ndërveprues – Modele për zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve në matematikë I- 5*, Tiranë: CDE

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, kalkulatori etj.

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete:

Pjesëmarrja në ushtrime 20% (Katër kuize)

Testi 1 20 %

Testi 2 20 %

Provimi përfundimtar 40 %

Kriteret e kalueshmërisë:

Nota përfundimtare:

Pikët (%) Nota

- 90-100 **10**
- 80-89 **9**
- 70-80 **8**
- 60-69 **7**
- 50-59 **6**

Emërtimi i lëndës: *Praktika pedagogjike II*

Përshkrimi i lëndës: Gjate kursit do te shqyrtohen çështje të tilla si: planifikimi i një njësie mësimore, planifikimi i një serie të njësive të ndërlidhuara, vlerësimi dhe notimi i nxënies së nxënësve, përgatitja e mjeteve mësimore duke përdorur materialet të cilat janë në dispozicion.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i kursit është njohja e studentëve me metodat dhe strategjitë bashkëkohore të punës me femijëve e ciklit fillor. Të cilat synojnë të ndryshojnë praktikën e tanishme mësimore, si dhe rrisin cilësinë dhe efikasitetin e punës me këtë grupmoshë. Ky kurs do të nxisë studentët që të demonstrojnë shkathtësi dhe të reflektojnë për trendet bashkëkohore në fushën e edukimit parashkollor.

Rezultatet e pritura të nxënies: Studentët do të:

kuptojnë konceptin e një njësie të mësimdhënies dhe ndërlidhjen e saj me programin e tërë;

interpretojnë kurikulin për të planifikuar një njësi mësimore në një kurs;

zbatojnë strategji të ndryshme të nxënies dhe dinë kur secila nga ato zbatohen në mënyrë adekuate;

planifikojnë, realizojnë dhe vlerësojnë një njësi të mësimit në një kurs;
vetëvlerësojnë zhvillimin e tyre profesional dhe caktojnë qëllime të nxënies për vetëvetën.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Përmes praktikës pedagogjike, profesori do t'i vlerësojë sipas vëzhgimit të tij sistematik gjatë praktikës së tyre, të cilën e realizojnë në institucionet përkatëse.

Kriteret e kalueshmërisë:

Sipas asistimit të tyre në aktivitetet edukative me fëmijët e moshave të caktuara.

Emërtimi i lëndës: *Histori kombëtare*

Përmbajtja: Kursi është i ndarë në disa pjesë: Fillimet historike nisnin nga civilizimet më të hershme të ilirëve, për t'u lidhur pastaj me civilizimin mesjetar arbëror, si dhe ndikimet e këtij civilizimi në rrjedhat e përgjithshme europiane me theks te veçantë në periudhen e humanizmit dhe renesansës europiane, Rilindjes Kombëtare, perudhën e Shpalljes së Pavarësisë, për të përfunduar me shtetin e Kosovës. Gjatë këtij rrugëtimi historik theksi do të vihet jo vetëm në aspektet politike, që kanë të bëjnë me krijimin e shteteve dhe ndryshimeve në funksionimin e tyre, por edhe në zhvillimet socio-ekonomike, në zhvillimin kulturor dhe intelektual, demografik, në shfaqjen e religjioneve dhe rolit të tyre në marrëdhëniet ndërshtetërore. Gjithashtu, programi i kësaj lënde ka për qëllim aftësimin e studentëve në mënyrë që ata t'i bartin përvojat e fituara edhe tek të tjerët.

Qëllimet e mësimt: Qëllimet e mësimt të kësaj lënde janë: Të aftësohen për t'i përshkruar dhe diskutuar rrjedhat, ngjarjet, zhvillimet dhe çështjet më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar që nga civilizimi i hershëm ilir deri tek periudha luftërave kundër pushtimit osman, si dhe lidhshmërinë ndërmjet tyre dhe Evropës.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës: Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do: Të aftësohen për të diskutuar dhe shpjeguar lidhshmërinë ndërmjet të arriturave në shoqëri, kulturë, politikë, ekonomi, filozofi, religjion, shkencë, me fusha të tjera; të njohin origjinën e popullit – nga ilirët deri tek shqiptarët, historinë mesjetare shqiptare dhe pozitën e shqiptarëve nën sundimin osman. të njihen me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare deri te Shpallja e Pavarësisë 1912; të kuptojnë zhvillimet historike të Kosovës që nga Konferenca e Londrës deri në vitin

2008; të kuptojnë zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social e kulturor të Kosovës nëpër periudha të ndryshme historike; të aftësohen të shfrytëzojnë literaturën duke e shqyrtuar në aspektin kritik dhe analitik, si dhe t'i përcaktojnë dhe vlerësojnë çështjet themelore që duhen adresuar;

Format/ Metodatat e mësimdhënies: Ligjerata interaktive, puna në grupe si dhe angazhimi i studentëve me punë seminarike/projekte.

Pjesa teorike	Pjesa praktike
60%	40%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

ASh e Shqipërisë, *Historia e Popullit Shqiptar, v. I,II,III dhe IV*, Toena, Tiranë, 2002-2009.

Noel Malcolm, *Kosova një Histori e Shkurtër*, Koha-Prishtinë & Libri shkollor-Tiranë, 2001.

Et'hem Çeku, *Kosova në sfondin e diplomacisë së Jugosllavisë dhe të Shqipërisë 1945-1981*, Brezi'81, Prishtinë, 2008.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrime, punë individuale, punë në grupe etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 40% dhe pjesa teorike 60%.

Emërtimi i lëndës: *Dramatizimi dhe shfaqjet me kukulla*

Përmbajtja: Dramatizimi i një teksti qoftë ai roman apo tregim. Tekst dramatik i shkurtuar dhe i dramatizuar për teatër. Zanafilla e teatrit të kukullave. Zhvillimi i këtij Teatri. Loja e aktorit me kukullën. Pantomima. Teatri i hijeve dhe zanafilla e këtij teatri. Lëvizjet skenike, teknika e zërit, luftrat skenike dhe diksioni. Raporti i aktorit me tekstin. Muzika, kostumografia, skenografia, ndriçimi në teatrin e kukullave....

Qëllimet e mësimit: Është që studentët përmes kësaj lënde mësimore do të fitojnë njohuri të reja dhe aftësi për të punuar me gjeneratat e reja në entet parashkollore duke i përdorur të gjitha kërkesat didaktikopedagogjike të kulturës së përgjithshme të dramatizimit dhe shfaqjeve të kukullave, kjo e cila në entin parashkollor do të përdoret vetëm si një aktivitet.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Me zhvillimin e kësaj lënde mësimore studentët do të aftësohen për zhvillimin e aftësive tek fëmijët dhe plotësimin e kërkesave të tyre për ta lozur rolin e artistit-kukull të moshave të ndryshme pa kufizim gjinie dhe të njoftohen me personazhet, skenografinë, me stilistikën, dritën, hijen dhe zërin.

Fëmijët do të fitojnë botëkuptime të reja mbi teatrin me kukulla dhe teknikat e punës duke u njohur me punën me materialin didaktik teknikat e punës dhe aplikimin e tyre, dhe tek fëmijët do të zhvillohen aftësitë e tyre kreative në nivel më të lartë për teatrin me kukulla, për t'i lozur në teatër me kukulla të gjitha rolet e parapara të teatrit me kukulla.

Rezultatet do të jenë edhe me konkrete duke besuar edhe në koorelacionin me gjinitë e tjera të arteve, si dhe në begatimin e jetës së fëmijut duke marrë pjesë vetë në rolin e artistit. Nuk është befasi se nga gjeneratat e enteve parashkollore do të na lindë ndonjë artist i kalibrit më të lartë botëror.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike: 50%	Pjesa praktike: 50%
--------------------	---------------------

Literatura:

Vladimir Jevtovic, *Uzbudljivo pozorise,*

Fadil Hysaj, *Teatrologji, dramaturgjia, regjiturë dhe aktrim,*

Flori Slatina, *Prirje të sotme të teatrit,*

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat me ngjyra, projektori, etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrimeve, punë individuale, punë në grupe, shfaqje teatrale në fakultet etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 60% dhe pjesa teorike 40%.

Emërtimi i lëndës: *Artet e bukura*

Përmbajtja e lëndës: Në këtë kurs do të shfrytëzohen njohuritë për historinë e artit, për punën në grupe, punën praktike dekorative me letra, formësim gjësendesh nga kartoni ose letre. Mjetet e punës për kreativitet figurativ dhe përdorimi praktik i tyre. Teknikat e artit figurativ me aplikacion. Përdorimi i shablloneve, kopjimi, prerja dhe ngjitja. Vizatimi simetrik me ndihmën e palosjes. Pikturimi akuarel, kolazhi, mozaiku, metodat dhe avantazhet e aplikimit të tij. Pikturimi, llojet e materialeve dhe përdorimi i tyre. Formësimi me plastelinë e brum, mjetet e duhura për përdorim. Vizitë në galeri artesh. Ekspozita me punimet më të mira të nxënësve. Ndërtimi i planditarit dhe plankonspektit.

Rezultatet e nxënies: Studentët janë në gjendje të:

Shpjegojnë konceptet themelore në fushën e artit figurativ; Analizojnë problemet e kategorive të fëmijëve/nxënësve me vështërsi në mësim; Demonstrjnë strategji mësimore për gjithëpërfshirje të nxënësve në procesin edukativo mësimor; Vlerësojnë njohuritë e nxënësve.

Metodologjia e punës: ligjëratë, seminar, ese, diskutim, konkretizim i njohurive në realizimin e tyre, vizitë institucioneve kulturo-artistike e arsimore.

Literatura bazë:

Matematikë në Artet figurative, Tiranë

Musai, Bardhyl: “*Metodologjia e Mësimdhënies*”, Tiranë, 2003

Ago, S. *Historia e artit shqiptar*, Tiranë, 1980.

Album, *Arti popullor në Shqipëri*, Tiranë, 1985

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, blloqe vizatimi etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, demonstrime të teknikave, ushtrime, punë individuale, vizita studimore jashtë fakultetit (në Galeri), punë në grupe etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 60% dhe pjesa teorike 40%.

Emërtimi i lëndës: Psikologji e zhvillimore

Përmbajtja: Kursi do të përfshijë trajtimin e çështjeve psikologjike të përfshira në fushën e edukimit si dhe aplikimin praktik të parimeve psikologjike të mësimdhënies. Theks i veçantë do të vihet tek të nxënë, mësimdhënia, motivimi, kreativiteti në klasë, dhe ndikimet që ka mjedisi tek sjellja e individit.

Qëllimet e mësim: Në përgjithësi kursi tenton të qartësojë nocionet e zhvillimit të gjithmbarshëm të fëmijës, dhe ndërveprimet e fëmijës me individët tjerë në mjedisin ku ai jeton dhe sesi këto ndërveprime ndikojnë në zhvillimin e tij. Kursi synon në aftësimin e studentëve për të kuptuar më mirë zhvillimin e fëmijës në aspektin fizik, motorik, mendor, emocional dhe social, mënyrat e tij të reagimit, si i shfaqë emocionet, si zhvillohen ato, si socializohet fëmiju, sa është e rëndësishme njohja e emocioneve dhe aspekteve sociale të zhvillimit të fëmijut, si mëson fëmija, si zhvillohet intelektualisht dhe si të kujdesemi për fëmijën që mos të krijojme vështirësi emocionale dhe sociale në zhvillimin e tyre etj.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde), studenti do të jetë në gjendje që: Të njohë zhvillimin e fëmijëve përgjatë staveve kohore; të njohë teoritë dhe hulumtimet themelore psikologjike mbi zhvillimin e fëmijëve; të njohë teknikat e punës me fëmijë që kanë vështirësi intelektuale, në të nxënë, motorike, mendore, emocionale dhe sociale; të dijë të identifikojë dhe shpjegojë përjetimet emocionale dhe sociale; të njohë fazat e zhvillimit tek fëmijët; të njohë efektet dhe pasojat e çrregullimeve të hershme të zhvillimit në moshë të rritur.

Format/ Metodat e mësimdhënies: Mësim i rregullt përmes ligjeratave, diskutimit dhe punës në grupe, konsultimeve individuale, si dhe përvojës praktike dhe seminarike.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
70%	30%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Vasta, R., Haith, M. Marshall, & Miller A. Scott, *Psikologjia e Fëmijës: Shkenca Moderne*. John Wiley Sons, Inc., 1992,

Rashela Cikuli, "Të rrisim fëmijë të shëndetshëm," Tiranë, 1984

Bardhyl Musai, "Psikologjia e Edukimit"

Pettijohn. F. Terry, "Psikologjia (Një hyrje koncize)"

Prof. Dr. Pajazit Nushi, "Psikologjia e Përgjithshme"

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrime, punë individuale, punë në grupe etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 40% dhe pjesa teorike 60%.

Emërtimi i lëndës: *Të drejtat e fëmijëve dhe etika e mësimitdhënës*

Përmbajtja: Konsiderohen implikime të ndryshme morale për teorinë dhe praktikën e mësimitdhënies. Karakteri moral i mësimitdhënies – koncepte të ndryshme të mësimitdhënies; teoria etike – filozofët e mëdhenj të moralit, theksojnë problemet e objektivitetit apo vlerave morale të mësimitdhënës; teoria bashkëkohore e etikës shqyrton moralin aktual dhe debatin social me referenca të koncepteve siç janë emocionizmin, utilitarizmin, etikën e vlerave, liberalizmin dhe komunikimin.

Rezultatet e të nxënësve të lëndës: njohuri bazike të çështjeve arsimore brenda arsimit etik sikurse edhe konceptet e etikës; Zhvillimi i kompetencave për të menduar individual lidhur me çështjet e mësimitdhënies dhe transferimi i tyre te të tjerët.

Format/ Metodat e mësimitdhënies: Ligjëratat formale, strategji të mësimitdhënies interaktive, punë në grupe, debate dhe punë individuale.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike 60 %	Pjesa praktike 40 %
---------------------------	----------------------------

Literatura bazë që shfrytëzohet për lëndën:

Drejtskrimi i gjuhës shqipe, IAP, Prishtinë, 1974;

Ismajli, Rexhep, *Drejtskrimet e shqipes*, ASHAK, Prishtinë, 2005;

Memushaj, Rami, *Shqipja standarde*, Toena, Tiranë, 2005 .

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, laps, projektori, etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrimeve, punë individuale, punë në grupe, etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 60% dhe pjesa teorike 40%.

Emërtimi i lëndës *Metodologji e shkencave shoqërore*

Qëllimet e mësimit: Kursi ofron vizionin e përgjithshëm të zhvillimit dhe formimit të ideve, koncepteve, kategorive shoqërore, në predimensionim të mirëqenies. Ofron të kuptuarit dhe interpretuarit e kategorisë së shoqërisë dhe të fenomenologjisë së saj. Shtron rrafshet e të kuptuarit të botës së shoqërisë, përmes shpjegimit të fenomeneve sociale, antropologjike, politike, ekonomike në strukturën sociale, në forcat sociale dhe në raportet shoqërore.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Pas përfundimit me sukses të kursit, studentët do të arrijnë që: Të kuptojnë dhe interpretojnë kategoritë e shoqërisë dhe të fenomenologjisë së saj; Të shpjegojnë temat e socializimit: socialitetit, socioabilitetit dhe sociogjenitetit; të kulturës, të ndërtimeve sociale të dijes, jobarazive, raporteve etnike, raporteve socio-etike, të fenomeneve të pronës dhe pasurisë dhe trajtesa të sociologjisë politik; Të kuptojnë perspektivën e shkencave shoqërore, e teorive sociologjike dhe antropologjike, ekonomike, psikologjike, kulturore, politike; T'i zbatojnë këto teori në eksplikime në çështjet aktuale sociale, për të ndriçuar lidhjen kritike të strukturave, institucioneve, formave sociale, sistemeve sociale, grupeve sociale:primare e sekondare; aksionet sociale, statusin dhe rolin, rolin e konflikteve, normave e vlerave, konformiteteve e devijimeve.

Format/ Metododat e mësimdhënies

Ligjëratat, ushtrime, puna në grupe seminare, diskutime etj

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
35%	65%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë

1. Dr. Ali Dida, Studime nga Shkencat shoqërore, Prishtine, 1984.
2. Lizandra Torres, Lina Torres, Shkencat shoqërore (Ciencias sociales), 1998.
3. Dr. Ante Fiamengo, Sociologjia e Përgjithshme, Prishtinë, 1967

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Ligjëratat, me pjesën e tyre teorike dhe orë të ushtrimeve, të cilat përfshijnë punën në grupe, punën individuale, diskutimet, detyrat javore të kursit si dhe punimet e seminarit.

Kriteret e kalueshmërisë:

Angazhimi 10%,

Seminaret 10%,

Testet provuese 20%, dhe

Testi përfundimtar 60%

Emërtimi i lëndës: *Metodologji e arteve figurative*

Qëllimet e mësimi: Përmes artit figurativ, realizojmë pjesën krijuese të aktiviteteve, të cilat i eksperimentojmë me materiale të ndryshme artistike dhe elemente figurative: zbulojmë, kërkojmë dhe verifikojmë.

Në mënyrë krijuese fëmija (nxënësi) përpunon përvojën e vet dhe kuptimin përmes kreativitetit dhe formave figurative;

Rezultatet e të nxënit të lëndës Në fund të kursit, studenti do të përvetësojë programin e lëndës; të njohë artet figurative dhe specifikën e shprehjes; të zhvillojë metodologjinë e organizimit të orës mësimore; të aftësohet për përpilimin e planit dhe programit; të aftësohet për zgjedhjen e njësisë mësimore, lëmvive, teknikave e materialeve të përshtatura për nivelin e nxënësit.

Format/ Metodatat e mësimdhënies

Ligjëratat, ushtrime, puna në grupe, seminare, diskutime etj

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
35%	65%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë

Musai, Bardhyl, *Metodologjia e Mësimdhënies*, Tiranë

Guxholli, Eduard, *Mjeshtër të pikturës*,

Ago, S. *Historia e artit shqiptar*, Tiranë, 1980.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, blloqe vizatimi etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, demonstrime të teknikave, ushtrime, punë individuale, vizita studimore jashtë fakultetit (në Galeri), punë në grupe etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 60% dhe pjesa teorike 40%.

Emërtimi i kursit: *Praktika pedagogjike III*

Përshkrimi i lëndës: Gjate kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: planifikimi i njësive dhe programit si dhe plane individuale për zhvillim e fëmijëve në varshmëri me nevojat, potencialin zhvillimor të tyre, përgatitja e mjeteve mësimore, vlerësimi i nxënies së nxënësve, strategjitë interaktive për të gjithë klasën dhe për grupe të vogla, bashkepunimi pëe stafin profesional në shkollë, familje dhe komunitet. Ndërkohë, studentët vetëvlerësojnë ngritjen e tyre profesionale/

Qëllimet e lëndës: Qëllimi kursit është njohja e studentëve me metodat dhe strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies, të cilat synojnë të ndryshojnë praktikën e tanishme mësimore si dhe rrisin cilësinë dhe efikasitetin në mësim. Ky kurs do të nxisë studentët që të demonstrojnë shkathtësi dhe të reflektojnë për trendet bashkëkohore të mësimdhënies.

Rezultatet e pritura të nxënies: Studentët do të: kuptojnë konceptin e një njësie të mësimdhënies dhe ndërlihdjen e saj me programin e tërë; interpretojnë kurikulin për të planifikuar një njësi mësimore në një kurs; zbatojnë strategji të ndryshme të nxënies dhe dinë kur secila nga ato zbatohen në mënyrë adekuate;

- planifikojnë, realizojnë dhe vlerësojnë një njësi të mësimit në një kurs;
- vetëvlerësojnë zhvillimin e tyre profesional dhe caktojnë qëllime të nxënies për vetvetën.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Përmes praktikës pedagogjike, profesori do t'i vlerësojë sipas vëzhgimit të tij sistematik gjatë praktikës së tyre, të cilën e realizojnë në institucionet përkatëse.

Kriteret e kalueshmërisë:

Sipas asistimit të tyre në aktivitetet edukative me fëmijët e moshave të caktuara.

Emërtimi i lëndës: *Bazat e shkencave natyrore me metodologji I*

Përmbajtja: Lënda bazat e shkencave natyrore përmban njohuri themelore nga: astronomia, fizika, dhe kimia.

Qëllimet e mësimit: Në këtë kurs studentët fitojnë dituri të reja për shkencat natyrore dhe lidhjet e tyre në mes vete. Nëpërmes lëndës Bazat e shkencave natyrore, studentët do të njihen me rolin e njeriut në ndërrimin, shfrytëzimin dhe zotërimin e ligjeve të natyrës. Në këtë mënyrë ata formojnë qëndrim të drejtë ndaj ruajtjes së mjedisit jetësor, kursimit të energjisë si dhe fitojnë shkathhtësi jetësore e shprehi të punës. Fizika si shkencë e natyrës së bashku me shkencat tjera ndikon fuqishëm në formimin e personalitetit të njeriut, në ngritjen e tij kulturorore dhe profesionale.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: Të njoh natyrën, ligjet natyrore, trupat qiellor, lëvizjet, molekulat dhe atomet, lëngjet dhe gazet, atmosferën, syrin, veshin, rrymën elektrike etj.; Të njohin lidhshmërinë e shkencave natyrore në mes vete; Të kenë njohuri të duhura për Tokën, planetet e sistemit diellor, rrymën elektrike, zërin, veshin, syrin, energjinë, atmosferën dhe përbërësit e saj; Njohuri të kenë edhe në zgjidhjen dhe zbatimin e aparatit matematikor në shkencat natyrore;

Të dijnë t'i paraqesin ligjet fizike, kimike, duke përdorur aparatën matematikor, si dhe të dijnë t'i zbatojnë këto ligje dhe demonstrime eksperimentalisht në laboratore.

Format/ Metodën e mësimdhënies: ligjërata, seminare, workshops, video prezantim, laborator, ushtrime numerike etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë që shfrytëzohet:

Skripta bazat e shkencave natyrore, Prishtinë, 2011

Prof. Dr. A. Angelov, *Biokimija*, Sofija-1995

Dr. Rasim Bejtullahu, *Astronomia kl. IV*, Prishtinë, 2002

Dr. A. Veseli, *Biofizika*, Prishtinë, 2004

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, (tek kabineti shkencor) etj.

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete:

Pjesëmarrja në ushtrime 40%

Testi 20 %

Provimi përfundimtar 40 %

Kriteret e kalueshmërisë:

Nota përfundimtare:

Pikët (%) Nota

- 90-100 **10**
- 80-89 **9**
- 70-80 **8**
- 60-69 **7**
- 50-59 **6**
- **Emërtimi i lëndës: *Shkolla dhe komuniteti***

- **Përmbajtja:** Në këtë lëndë studentët do të kenë mundësi që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe praktike të përgatiten për njohjet me rëndësinë e bashkëpunimit të shkollës dhe komunitetit si dhe për zbatimin e kësaj njohurie në praktikë. Studentët do të kenë mundësinë që të njohin dhe aplikojnë forma të ndryshme të bashkëpunimit me komunitetin, duke i stimuluar dhe inkurajuar ata që të organizojnë nga një aktivitet në grupe për të bashkëpunuar me komunitetin në cilësi të mësimdhënësit.
- Përmes kësaj lënde gjithashtu synojmë një lëvizje progresive në ngritjen e cilësisë dhe avansimin tek mësimdhënësit e ardhshëm për të parë komunitetin partner shumë të rëndësishëm në punën e tyre profesionale.
- **Qëllimet e mësimi:** Me mbarimin e këtij kursi studenti do të jetë i përgatitur në mënyrë praktike për rëndësinë e bashkëpunimit me komunitetin; format e bashkëpunimit me komunitetin; implementimin e strategjive për bashkëpunim me komunitetin etj.
- Rezultatet e të nxënës të lëndës (kompetencat, njohuritë dhe shkathhtësitë). Pas kompletimit të kursit studenti do fitoj kompetencat që: të dijë: Të njohë strategjitë për bashkëpunim praktik me komunitetin; Të njihet me rëndësinë e përfshirjes së komunitetit në zhvillimin e cilësisë në shkollë; Ta trajtojë komunitetin faktor të rëndësishëm në punën e tyre si mësimdhënës; Të planifikojnë forma konkrete të bashkëpunimit me komunitetin; Të jenë në gjendje implementimin e bashkëpunimit me komunitetin etj.
-
- **Format/ Metodatat e mësimdhënies**
- Ligjerata interaktive, puna në grupe si dhe angazhimi i studentëve me punë seminarike/projekte.

Pjesa teorike	Pjesa praktike
60%	40%

- **Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë**
- Afërdita Zuna dhe bashkautorë, “ *Partneriteti shkollë-familje, komunitet*”, Prishtinë, 2009.
- Bonnie Miller “*Si të krijohet kontakti i suksesshem me nxënësit*”, Prishtinë 2003

- Hank Rubin, *Collaborative Leadership: Developing Effective Partnerships for Communities and Schools*, Second Edition, SAGE, 2009.
- **Mjetet e konkretizimit:**
- Libri, fletorja, projektori etj.
- **Metodat e vlerësimit:**
- *Leksion i avansuar, diskutime, punë në grupe, punë në çifte, punë individuale, metoda ndërvepruese të mësimdhënies*
-
- **Kriteret e kalueshmërisë:**
- Pjesëmarrja në mësim 5%
- Angazhimet / detyrat 5%
- Prezentimet nga hulumtimi 10%
- Vlerësimi i parë 30%
- Vlerësimi final 50%

Emërtimi i lëndës: *Arsimimi gjatë gjithë jetës*

Përshkrimi i lëndës: Qëllimi parësor i kursit është thellimi i njohurive për rolin e shkollës në vënieën e themeleve për mësim gjatë gjithë jetës, rolin e mësimdhënësve në motivimin për mësim të pandërprerë, globalizimi dhe arsimit gjatë gjithë jetës, kuptimi historik dhe bashkëkohor i arsimit permanent, determinantet e arsimit permanent dhe modalitetet e tij si: arsimit formal dhe joformal, arsimit me shkëputje dhe pashkëputje nga puna, arsimit i herëpashershëm, vetëarsimimi, format e punës vetëarsimore.

Qëllimet e lëndës: Kursi ka për qëllim: 1. të shqyrtojë politikën arsimore, të cilat ofrojnë një mjedis institucional që lehtëson procesin e të mësuarit të individëve në çdo moshë dhe në çdo profesion; 2. të analizojë rolin e shkollës dhe të mësimdhënësit për arsimin gjatë gjithë jetës; 3. të nxisë aktivitetet mësimore për të rriturit; 4. të sintetizojnë njohuritë e fituara me qëllim të avancimit profesional.

Rezultatet e pritura të të nxënit : Studentët do të jenë në gjendje: 1.të artikulojnë forcat shoqërore të cilat kanë krijuar nevojën e mësimi gjatë gjithë jetës; 2. Të bëjnë dallime ndërmjet koncepteve dhe zbatimit të dijes dhe të nxënies; 3. reflektojnë për nevojën e globalizimit të arsimit gjatë gjithë jetës; 4.të krijojnë draftin e një programi të nxënies për aftësimin e tyre si mësimdhënës.

Format/ Metodatat e mësimdhënies

Mësimi i rregullt; format e ligjërimit: ligjërata, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantimi në grup.

-Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
45%	55%

Literatura bazë -

Koliqi, H. (1997), *Andragogjia*, Prishtinë

Korniza europiane e kualifikimeve (KEK) për mësimin gjatë gjithë jetës (2008), Prishtinë

Hoti, D. (1998), *Arsimi permanent dhe modalitetet e tij*, Separat nga "Buletini i Fakultetit Filozofik, Prishtinë

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsi, sintisaizer (instrument i domosdoshëm për studentët)

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve, përveç kolloqfiumit I dhe II, testit final dhe punës individuale në rastin e studimit, do të bëhet duke pasur parasysh edhe kontributin e tyre në aktivitetet në klasë dhe përkushtimin për diskutim dhe komentim gradual të punës individuale të rastit të studimit në formë të esesë.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim 5%

Angazhimet / detyrat 5%

Prezantimet nga hulumtimi 10%

Vlerësimi i parë 30%

Emërtimi i lëndës: Tendencat bashkohore ne arsim

Përmbajtja: Ky kurs ka të bëjë me aftësimin e studentëve për zanafillën, nevojën dhe aktualitetin e pedagogjisë komparative që ka për njohjen e disa nga sistemet arsimore të shteteve ballkanike, evropiane dhe botërore. Kjo njohje, do t'u mundësojë që të bëjnë krahasime, duke i parë specifikat, dallimet dhe ngjashmëritë në mes vete. Të përvetësojnë njohuri gjithashtu për tendencat e përgjithshme në fushën e arsimit të të gjitha niveleve të shkollimit, të reformës arsimore, duke nënkuptuar këtu: politikën arsimore, autonomia e shkollës, demokratizimi i shkollës, decentralizimi- centralizimi, standardizimi i arsimit, kurrikuli, teknologjia e arsimit, financimi i arsimit etj.

Qëllimet e mësim: Të kuptuarit e koncepteve bazë për përmbajtjen dhe rëndësinë që ka Pedagogjia comparative për sistemin e arsimit; Përgatitja e studentëve për studjuar dhe krahasuar burime nga fusha e pedagogjisë komparative; Aftësimi i tyre për të bërë krahasime të sistemeve të ndryshme arsimore evropiane, dhe për t'u njohur me të arriturat dhe standardet arsimore të këtyre sistemeve.

Rezultatet e të nxënit të lëndës (kompetencat, njohuritë dhe shkathtësitë): Në përfundim të lëndës, studenti: Të jenë në gjendje që t'i zbatojnë në praktikë veçantitë dhe risitë e sistemeve arsimore të disa shteteve ballkanike, evropiane dhe botërore, duke i nënkuptuar këtu faktorët, përcaktuesit, strategjitë, tendencat arsimore të sistemeve të ndryshme, reformën demokratike, etj. Të jenë në gjendje të bëjnë krahasime ndërmjet sistemeve arsimore, lidhur me përmbushjen standardizimit të kriterëve dhe të zhvillimit demokratik të tyre; T'i përcjellin në mënyrë permanente risitë në fushën e teknologjisë arsimore të sistemeve arsimore; Të shfrytëzojnë dhe hulumtojnë literaturën nga ky kurs që është në afirmim e sipër, për të krahasuar më lehtë sistemet arsimore të shteteve të ndryshme, dhe për të hetuar zhvillimet, përparësitë dhe dobësitë e tyre që kanë, të cilat mund të shërbejnë për sistemin tonë si përvoja pozitive për të ecur drejtë proceseve integruese evropiane.

- **Format/ Metodat e mësimdhënies:** Mësimi i rregullt organizohet në ligjërata grupore, ndërsa pjesa praktike organizohet në grupe të me vizita në natyrë.

- **Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit**

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

1. Rexhepagiq, Akademik, Jashar, (2002), Tema të Zgjedhura dhe Bashkëkohore Pedagogjike,”Libri Shkollor “, Prishtinë
2. Koliqi, Hajrullah (1997). Historia e pedagogjisë botërore I. Prishtinë: Universiteti I Prishtinës.
3. Koliqi, Hajrullah (1998). Historia e pedagogjisë botërore II. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës
4. Mato,Dr.Erlehta (2004), Arsimi dhe Globalizmi,Revista pedagogjike, nr. 3, ISP, Tiranë.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, laps, projektori, etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrimeve, punë individuale, punë në grupe, etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 60% dhe pjesa teorike 40%.

Emërtimi i lëndës: *Metodologji e leximit letrar*

Përmbajtja: Lënda Metodologji e *leximit letrar* përkufizon modelet e leximit të vëmendshëm dhe të kuptueshëm të krijimtarisë letrare-artistike me qëllim që të nxirret struktura e teksteve letrare që krijohen dhe perceptohen nga grupmoshat e fëmijëve parashkollorë. Kjo lëndë përmban shumë faktorë dhe mënyra të shprehjes letrare në një tekst, që na detyrojnë të bëjmë kujdes në përcaktimin sa më të saktë të domethënies së tij, zbulimit të natyrës së fjalëve, interpretimit të tyre, kapjes së synimit të autorit, vokacionit, ritmit të prozës, vargut, strofës. Në programin parashkollor, si tekste bazë për lexim do të jenë krijimtaria popullore (përralla, përrallëza, fabula, ninullat, gjëzat, këngët dhe lojërat popullore) dhe ajo e shkruar për këtë grupmoshë të fëmijëve.

Qëllimi i mësimi: Studentët të njihen me aspektet logjike, estetike dhe semantike të artit të të shkruarit dhe të lexuarit, të dëgjuarit dhe të kuptuarit e rrafsheve gjuhësore, letrare, përmbajtësore dhe kuptimore të tekstit letrar, si dhe mundësisë së përformimit të tyre. Të identifikojnë funksionet transmetuese që realizon kjo letërsi dhe rëndësinë e tyre që kanë në formimin e karakterit e të shijes estetike të grupmohave të caktuara. Të perceptojnë dhe vlerësojnë këtë proces të veçantë letrar-artistik dhe të përforcojnë shkathtësitë e të dëgjuarit dhe interpretuarit të esencave kuptimore të tekstit letrar përgjithësisht.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Marrja e njohurive bazë mbi artin e të dëgjuarit, të lexuarit dhe të interpretuarit të tekstit letrar, si dhe identifikimit sa më të saktë të domethënies dhe nuancave kuptimore të tij.

Metodat e mësimdhënies: Ligjërata, seminare, komentime, të teksteve letrare, diskutime, punë individuale, në çifte dhe në grupe.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
60 %	40 %

Literatura bazë që shfrytëzohet për lëndën:

P. Tevo & Zh. Lekomt, *Komenti letrar (i përshtatur dhe me shembuj nga letërsia shqipe)* Tiranë, 2000.

Stefan Çapaliku, *Letërsia e interpretuar*, Tiranë, 1998.

Përralla, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1982.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, laps, projektori, etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrimeve, punë individuale, punë në grupe, etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 60% dhe pjesa teorike 40%.

Emërtimi i lëndës: Statistikë Elementare

Përshkrimi i lëndës: Lënda përmban informata dhe njohuri të rëndësishme praktike dhe teorike dhe prezanton një pamje gjithëpërfshirëse të teknikave dhe metodave të ndryshme statistikore të rëndësishme për mbledhjen, grupimin dhe analizimin e të dhënave të ndryshme si: Kuptimi dhe elementet e analizës statistikore; Fazat e studimit statistikor; Vlerat mesatare të karakteristikës; Madhësitë mesatare të pozicionit; Variacioni / shpërndarja/ i karakteristikës, Treguesit relativ të variacionit; Numrat indeksor; Analiza dinamike/seritë kohore; Nociione themelore të probabilitetit; Analiza e regresionit dhe korrelacionit, etj.

Qëllimet e lëndës: Objektivi i kursit të statistikës është që të ju mundësoi studentëve që gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve të fitojnë njohuri të mjaftueshme mbi rolin dhe rëndësinë e statistikës së përgjithshme dhe në veçanti të asaj ekonomike, lidhur me principet themelore, metodat dhe modelet statistikore dhe mënyrën e aplikimit të tyre në analizat ekonomike

Rezultatet e pritura të të nxënit : Studentët do të jenë në gjendje: 1.të artikulojnë forcat shoqërore të cilat kanë krijuar nevojën e mësimi gjatë gjithë jetës; 2. Të bëjnë dallime ndërmjet koncepteve dhe zbatimit të dijes dhe të nxënies; 3. reflektojnë për nevojën e globalizimit të arsimit gjatë gjithë jetës; 4.të krijojnë draftin e një programi të nxënies për aftësimin e tyre si mësimdhënës.

Format/ Metodatat e mësimdhënies

Mësimi i rregullt; format e ligjërimit: ligjëratat, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezantimi në grup.

-Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
45%	55%

Literatura bazë –

Robert D. Mason, Douglas A. Lind, William G. Marchal, Statistical techniques in business and economics, Tenth edition. The Irwin/Me Graw - Hill Series 2000.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsi, sintisaizer (instrument i domosdoshëm për studentët)

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi i përgjithëshëm i studentëve, përveç kolloqfiumit I dhe II, testit final dhe punës individuale në rastin e studimit, do të bëhet duke pasur parasysh edhe kontributin e tyre në aktivitetet në klasë dhe përkushtimin për diskutim dhe komentim gradual të punës individuale të rastit të studimit në formë të esesë.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim 5%

Angazhimet / detyrat 5%

Prezantimet nga hulumtimi 10%

Vlerësimi i parë 30%

Vlerësimi final 50%

Emërtimi i lëndës: *Strategjitë dhe metodat e shkrim leximit*

Përshkrimi i lëndës: Përmes këtij kursi studentët do t'i thellojnë njohuritë e tyre përkitazi me: parimet e drejtshkrimit të shqipes; strukturën e rregullave të drejtshkrimit të shqipes; drejtshkrimin e zanoreve të theksuara e të patheksuara në fjalë; grupet e zanoreve e të diftongjeve; për takimin dhe përdorimin e dy zanoreve të njëjta; apostrofin; theksin; drejtshkrimin e bashkëtingëlloreve; bashkëtingëlloret e zëshme në trup dhe në fund të fjalës; shkrimi i bashkëtingëllores H; fjalët me rr; nj-ja në trup dhe në fund të fjalës; takimi i bashkëtingëlloreve; takimi i dy bashkëtingëlloreve në fjalë; Po ashtu, do të mësohet edhe për disa trajta të shumësit të emrave dhe të mbiemrave; për shkrimin e nyjës së përparme; shkrimi i disa pjesëzave dhe parafjalëve; shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes; përdorimi i shkronjave të mëdha; për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit; për shkrimin e datave etj.

Qëllimet e lëndës: Qëllimi i kursit është që studentët: t'i thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë e tyre për parimet e drejtshkrimit të shqipes; strukturën e rregullave të drejtshkrimit të shqipes; drejtshkrimin e zanoreve të theksuara e të patheksuara në fjalë; grupet e zanoreve e të diftongjeve; për takimin dhe përdorimin e dy zanoreve të njëjta; apostrofin; theksin; drejtshkrimin e bashkëtingëlloreve; Të njihen teorikisht dhe praktikisht me elementet themelore të sistemit fonetiko-fonologjik dhe të normës gjuhësore – morfologjike; të fitojnë

aftësi për t'i dalluar trajtat dhe format normative nga ato që nuk janë normative në ligjërimin e folur dhe në atë të shkruar.

Rezultatet e pritura të nxënies: Studentët do të jenë në gjendje të mësojnë një drejtshkrim të mirë për komunikim në karrierën e tyre; të dinë për parimet e drejtshkrimit të shqipes; strukturën e rregullave të drejtshkrimit të shqipes; drejtshkrimin e zanoreve, grupet e zanoreve e të diftongjeve; për bashkëtingëlloret; të mësohen edhe për disa trajta të shumësit të emrave dhe të mbiemrave; për shkrimin e nyjës së përparme; shkrimi i disa pjesëzav dhe parafjalëve; shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes; përdorimi i shkronjave të mëdha; për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit; me njohuritë e fituara t'u mësojnë fëmijëve parashkollorë dhe nxënësve të klasës I-V drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e fjalëve sipas standardit të gjuhës;

Metodat e mësimdhënies: Ligjërata, seminare, komentime, të teksteve letrare, diskutime, punë individuale, në çifte dhe në grupe.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit.

Pjesa teorike	Pjesa praktike
60%	40%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë

Shemsedini Z., Veselaj Z. (2009) *“Bazat e shkencave natyrore me metodologji”*

Dispencë,

Veselaj Z. (2009)- *“Biodiversiteti”*, Universiteti i Prishtinës & WUS, Prishtinë

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, (tek kabineti shkencor) etj.

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete:

Pjesëmarrja në ushtrime 40%

Testi 20 %

Provimi përfundimtar 40 %

Kriteret e kalueshmërisë:

Nota përfundimtare:

Pikët (%) Nota

- 90-100 **10**
- 80-89 **9**
- 70-80 **8**
- 60-69 **7**
- 50-59 **6**

Emërtimi i lëndës: *Edukimi gjithëpërfshirës me metodologji*

Qëllimet e mësimimit: Ky kurs ka për qëllim njohjen e studentëve me konceptet themelore lidhur me çështjet e edukimit gjithëpërfshirës; Analiza e dëmtimeve dhe niveleve të kategorive të fëmijëve dhe të rriturve me nevoja të veçanta; Identifikimi i dëmtimeve dhe vështirësive në të nxënë të fëmijëve, duke krahasuar disa nga sistemet arsimore në botë me sistemin arsimor të Kosovës.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: në fund të këtij kursi studentët do të arrijnë që: të kuptojnë dhe përvetësojnë njohuri mbi konceptet themelore në fushën e Edukimit Special; të identifikojnë, analizojnë, krahasojnë dhe argumentojnë njohuritë e fituara; Demonstronë njohuri, shprehë dhe shkathtësi akademike e praktike përkitazi me trendet bashkëkohore të Edukimit Special.

Format/ Metodatat e mësimdhënies: Kombinatorika metodologjike sipas situatave, qëllimeve e përmbajtjeve mësimore-shkencore: ligjëratë-diskutim-analizë, seminar-diskutim, debatim, puna në grupe, puna individuale-grupore, format analitike e sintetike, induktive dhe deduktive.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
35%	65%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë

- Zabeli, Naser, (2010), *Edukimi inkluziv* (Dispensë për studentë), Prishtinë, Universiteti i Prishtinës & WUS

- Zabeli, Naser, (2008), Edukimi gjithëpërfshirës dhe Universiteti i Prishtinës, në Grup autorësh, *Zhvillimi i arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë – Sfidat dhe rezultatet*, Prishtinë, FSDEK.
- Xhuvani, A, (2002), *Hyrje në Edukimin special*, Sejko, Elbasan
- Grup autorësh, (2003), *Edukimi special në Kosovë*, Prishtinë, FSDEK.
- Zabeli, Dr. Naser, (2008), *Strategjitë psikopedagogjike për reduktimin e sjelljes së papërshtatshme në klasë*, Prishtinë, FSDEK & Libri shkollor.
- Zabeli, Naser, (2003), *Edukimi inkluziv – teori dhe praktikë aktuale*, Prishtinë, Save the Children – Denmark
- Indeksi për gjithëpërfshirje, (2014), përshtatur nga Zabeli, N. dhe Behluli, L., Save the Children.
- Zabeli, Naser, (2001), *Nxënësit me nevoja të veçanta*, Prishtinë, Save the Children & KEC.
- Duka, Ambera, (2011), *Probleme të punës mësimore me fëmijët me nevoja të veçanta*, Tiranë, Mediaprint.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrime, punë individuale, punë në grupe etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 40% dhe pjesa teorike 60%.

Emërtimi i lëndës: *Psikologji e edukimit*

Përmbajtja: Psikologjia e Edukimit synon të japë njohuri për zhvillimin, të nxënët dhe mësimdhënien. Kursi do të trajtojë çështje mbi edukimin e fëmijëve që nga lindja deri në moshat e rritura, zbatimin e psikologjisë në studimin e zhvillimit, të nxënët, mësimdhënies, motivimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me procesin e edukimit, si dhe aplikimin praktik të parimeve psikologjike të mësimdhënies.

Qëllimet e mësimit: Përftimi i njohurive mbi zhvillimin e individit; Të kuptuarit e parimeve dhe teorive mbi motivimin dhe të mësuarit, të lidhura këto me sjelljen, kognicionin dhe procesimin e informacionit; Përftimi i njohurive mbi teknikat e menaxhimit të klasës si dhe metodave për t'u përballur me probleme të sjelljes; Njohja me çështjet bashkëkohore të lidhura me edukimin.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Studentet do të aftësohen: Të shpjegojnë rëndësinë e njohjes nga elementet e ndijimit dhe perceptimit e deri të format më të nderlikura të të mënduarit dhe të inteligjencës. Të reflektojnë lidhur me faktorët që e ndihmojnë sidomos nxënie të suksesshme. Të dinë si zhvillohen proceset psikike, dhe fazat nëpër të cilat kalon zhvillimi i njeriut.

Format/ Metodatat e mësimit:

Ligjërime formale; ushtrimet/punëtoritë në klasë

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike: 60%	Pjesa praktike: 40%
--------------------	---------------------

Literatura:

Edmond Dragoti, *“Psikologjia Sociale”*, Tiranë, Ribotim, 2012

Edmond Dragoti, *“Psikologjia e adoleshentit”*, Tiranë, 2012

Theodor Karaj, *Psikologjia zhvillimore e fëmijës.*”, Tiranë, Botimi i dytë, 2015

Musa, Bardhyl, *Psikologjia e Edukimit*, Tiranë, 1999

Juniku, Neki, *Kapitina nga Psikologjia*, Shkup, 1994

Pettijohn. F. Terry, *Psikologjia (Një hyrje koncize)*, Tiranë, 1996

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrime, punë individuale, punë në grupe etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 40% dhe pjesa teorike 60%.

Emërtimi i lëndës: *Edukimi mjedisor*

Përmbajtja e lëndës: Kursi është i ndarë në disa pjesë: 1. Njohja me konceptet e përgjithshme të mjedisit: ekologjia dhe faktorët ekologjik, mjedisi si nocion, ndotja, ndotësi, rrugët e futjes, interaksionet dhe pasojat; 2. Substratet kryesore mjedisore: ajri, uji, toka dhe biodiversiteti dhe ndërlidhja mes tyre; 3. Pjesa mbi aktivitetet kryesore zhvillimore të njeriut, por me ndikim në mjedis: energjia, transporti, industria, bujqësia, turizmi etj. 4. Presionet kryesore në mjedisin tonë: mbeturinat, zhurma, urbanizmi dhe kimikatet; 5. Pjesa mbi problemet globale mjedisore: ndryshimet klimatike, hollimi i shtresës së ozonit, acidifikimi dhe ndotja e detrave e oqeanëve; 6. Masat globale, evropiane dhe nacionale për mbrojtjen e mjedisit: konventat, protokolet, strategjitë dhe planet e veprimit etj. si dhe qasja personale ndaj problemeve mjedisore. 7. Pjesa mbi mjedisin e Kosovës dhe problemet kryesore, edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm.

Qëllimet e mësimi: Me kursin studenti do: Të fitojë njohuritë bashkëkohore mbi edukimin mjedisor: konceptet, biosferën si tërësi, ciklet biogjeokimike në natyrë, ndotja, ndotësi, pasojat e ndotjes; Të fitojë njohuritë bazë bashkëkohore komponentet mjedisore: uji, ajri, toka dhe biodiversiteti; Të fitojë njohuritë mbi aktivitetet kryesore me ndikim në mjedis, presionet në mjedis dhe problemet globale mjedisore; Të fitojë njohuritë bazë mbi mekanizmat global, evropian dhe nacionale për mbrojtjen e mjedisit; Të fitojë njohuritë bazë mbi mjedisin e vendit tonë dhe problemet kryesore të tij.

Rezultatet e të nxënit të lëndës (kompetencat, njohuritë dhe shkathtësitë): Pas kompletimit të kursit studenti do të fitojë kompetencat që: të definojë konceptete kryesore të mjedisit dhe edukimit mjedisor, të interpretojë informatat për komponentet kryesore mjedisore; të dallojë ndikimet kryesore në mjedis, të njohë dhe interpretojë problemet globale mjedisore, të identifikojë mekanizmat kryesore globale, evropiane dhe nacionale për mbrojtjen e mjedisit, të interpretojë kushtet e mjedisit lokal, dhe të promovojë qasjen proaktive për ruajtjen e mjedisit.

Format/ Metodatat e mësimdhënies: Mësimi i rregullt organizohet në ligjërata grupore, ndërsa pjesa praktike organizohet në grupe të vogla prej 15 studentësh.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
70%	30%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Veselaj Z., (2009), *Njeriu dhe mjedisi jetësor*, Dispencë, Universiteti i Prishtinës & WUS Austria

Group of authors “ *Green Pack*” for Kosovo, Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe

Ramadani I., (2011), *Mjedisi jetësor, sfidat dhe perspektivar - roli i njeriut*,

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, projektori, mjetet e laboratorit etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrime, punë individuale, punë në grupe etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 40% dhe pjesa teorike 60%.

Emërtimi i lëndës: Zhvillimi i kurrikulave

Përmbajtja: Ky kurs do të ndihmojë studentët të kuptojnë bazat teorike të zhvillimit të kurrikulave, do të aftësojë në vlerësimin e tyre, si dhe në planifikimin dhe krijimin e një kurrikule të re.

Qëllimet e mësimit: Qëllimi i kësaj lënde është që studentet të përvetësojnë njohuri teorike dhe praktike nga fusha e zhvillimit të kurrikulit të edukimit Parashkollor. Studentët të kuptojnë konceptet themelore në fushën e kurrikulit, të analizojnë, të shpjegojnë konceptet themelore në fushën e kurrikulit, krahasojnë, argumentojnë, planifikojnë çështje që kanë të bëjnë me planifikimin e punës mësimore, të demonstronjë shkathtësi që ndërlidhen me hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e kurrikulës.

Rezultatet e të nxënës të lëndës (kompetencat, njohuritë dhe shkathtësitë): Të krijojnë bazë të mirë teorike mbi bazat filozofike të kurrikulës; Të njihen me parimet dhe objektivat e kurrikulës; Të bëjnë planifikimin e punës edukative në edukimin parashkollor që ndërlidhet me fushat e kurrikulës.

Format/ Metodat e mësimit: Ligjërata, diskutime, punë në grupe me përgjegjësi të ndara, prezantim në kuadër të ushtrimeve vlerësim të vazhdueshëm etj...

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Marsh, J.C (2009) *Koncepte themelore për të kuptuar kurrikulumin*. Tiranë. CDE

Ornstein C. Allan, Hunkis P. Francis (2003), *Kurrikula, baza, parime dhe probleme*, Tiranë

MASHT (2006), *Kurrikula e Edukimit Parashkollor në Kosovë, (3-6 vjeç)*, Prishtinë

MASHT (2011), *Standardet zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme, (0-6 vjeç)*, Prishtinë

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, laps, projektori, etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrimeve, punë individuale, punë në grupe, etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 60% dhe pjesa teorike 40%.

Emërtimi i lëndës: Vështirësitë në të nxënë

Përshkrimi i lëndës: Njohuritë mbi bazat e Vështirësive në të Nxënë, si dhe edukimi dhe arsimimi i nxënësve me vështirësi të tilla.

Qëllimi i mësimit të lëndës: Njohja me konceptet themelore lidhur me çështjet e Vështirësive në të Nxënë; Analiza e dëmtimeve dhe niveleve të kategorive të fëmijëve dhe të rriturve me Vështirësi në të Nxënë; Identifikimi i dëmtimeve dhe vështirësive në të nxënë të fëmijëve, duke krahasuar disa nga sistemet arsimore në botë me sistemin arsimor të Kosovës.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Kuptimi dhe përvetësimi i njohurive mbi konceptet themelore në fushën e Vështirësive në të Nxënë;

Identifikimi, analizimi, krahasimi dhe argumentimi i njohurive të fituara;

Demonstrimi i njohurive, shprehive dhe shkathtësive akademike e praktike përkitazi me trendet bashkëkohore në fushën e Vështirësive në të Nxënë.

Metodologjia e mësimdhënies: Kombinimi metodologjik sipas situatave, qëllimeve e përmbajtjeve mësimore-shkencore: ligjëratë-diskutim-analizë, seminar-diskutim, debatim, puna në grupe, puna individuale-grupore, format analitike e sintetike, induktive dhe deduktive

Literatura bazë:

Brestovci, B., *Gjendja dhe perspektiva e zhvillimit të edukimit dhe arsimimit të fëmijëve dhe të rinjve të retarduar në KSA të Kosovës*. Buletini informativ, vol. 1, 1-2, 1983.

ICIDH – 2, *International Classification of Functioning and Disability, Beta-2 Draft, Full Version*, Assessment, Classification and Epidemiology Group World Health Organization. Geneva, Switzerland, July, 2001.

Zylfiu, N., *Aftësimi dhe përsosja profesionale e mësimdhënësve, faktor me rëndësi në krijimin e marrëdhënieve të drejta ndaj nxënësve me pengesa në zhvillim*, Acta Defectologica, vol. 9, 1-2, 1991.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, laps, projektori, etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrimeve, punë individuale, punë në grupe, etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 60% dhe pjesa teorike 40%.

Emërtimi i lëndës: Gjuhë angleze për mësues

Përshkrimi i lëndës: Kursi i gjuhës angleze do të bazohet në “Headway – (Intermediate – Advanced)” tekst për ushtrimet në klasë, si dhe tekste të tjera plotësuese të përzgjedhura nga libra e revista të ndryshme nga lëmia përkatëse e studimit. Në këtë mënyrë studenti do të përfitojë nga nxënia e terminologjisë në gjuhën angleze nga fusha përkatëse. Studentët gjithashtu do të inkurajohen të bëjnë ese në lidhje me tekstet e lexuara.

Qëllimet e lëndës:

Qëllimi i mësimit të gjuhës angleze është që studentët të aftësohen që të kuptojnë dhe të shfrytëzojnë gjuhën angleze në lëmin e filozofisë, si dhe të përdorin literaturën nga ky lëmë gjatë studimeve dhe gjatë punës profesionale, hulumtuese dhe shkencore. Qëllimi i parashtruar realizohet me analizimin e teksteve (leksioneve) autentike. Kështu, studentët njihen me leksikon karakteristik në kontekstin burimor të tij.

Leksionet e zgjedhura nga literatura përkatëse, përfshijnë terminologjinë themelore filozofike që

mundësojnë dhe nxisin punën e mëtutjeshme të pavarur. Në këtë mënyrë studentët, gradualisht, fitojnë shprehje që të mendojnë, flasin dhe të marrin shënime në gjuhën angleze. Nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme gjuhësore, gramatikore dhe sintaksore, sqarohen problemet gjuhësore që hasen në leksionet përkatëse. Qasja e këtyllë bazohet në faktin se studentët kanë njohuri të përgjithshme paraprake dhe njohin “sistemin” e kësaj gjuhe. Në këtë kuptim, mësimi i gjuhës profesionale ka domethënie të një kursi më të lartë (specialistik) e jo të kursit fillestar. Gjatë kësaj, duhet pasur parasysh faktin se nëpërmjet kësaj lënde mësohet gjuha angleze në profesion e jo studimi i vetë profesionit

Rezultatet e pritura të nxënësit : Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:

1. Të përdorë literaturë të lëmit të filozofisë në gjuhën angleze dhe të pajiset me njohuritë e nevojshme për çështjen përkatëse.

2. Të aftësohet që të zgjerojë njohuritë e veta profesionale duke shfrytëzuar literaturë të shumëllojshme të këtij lëmi dhe të familjarizohet me terminologjinë filozofike në gjuhën angleze.
3. Njohuritë dhe shkathtësitë e fituara në këtë kurs të ushtrohet t'i shfrytëzojë për punë të mëtutjeshme kërkimore e shkencore, duke pasur parasysh ekzistimin e literaturës së begatë që ekziston në këtë gjuhë nga ky lëmë, si dhe mundësitë e mëdha që i ofron Interneti.
4. Të kuptojë problemet gjuhësore që hasen në leksikonet përkatëse dhe të njoh "sistemin" e kësaj gjuhe.

Format/ Metodatat e mësimdhënies

Mësimi i rregullt; format e ligjërimit: ligjërata, diskutime, punë individuale, punë në grupe, prezentimi në grup.

-Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
45%	55%

Literatura bazë -

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsi, sintisaizer (instrument i domosdoshëm për studentët)

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi i përgjithëshëm i studentëve, përveç kolokfiumit I dhe II, testit final dhe punës individuale në rastin e studimit, do të bëhet duke pasur parasysh edhe kontributin e tyre në aktivitetet në klasë dhe përkushtimin për diskutim dhe komentim gradual të punës individuale të rastit të studimit në formë të esesë.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim 5%

Angazhimet / detyrat 5%

Prezantimet nga hulumtimi 10%

Vlerësimi i parë 30%

Vlerësimi final 50%

Emërtimi i lëndës: *Bazat e shkencave natyrore me metodologji II*

Përmbajtja: Kursi është i ndarë në disa pjesë: Pjesa e parë trajton konceptet e përgjithshme të natyrës së gjallë: definicioni, jeta dhe karakteristikat e saj, ngjashmëritë dhe diversitetin e jetës; Pjesa e dytë trajton nivelet e organizimit të botës së gjallë: nga jo e gjalla deri te qeliza, nga qeliza deri te organizmat bimor dhe shtazor dhe tek biosfera; Pjesa e tretë trajton proceset bazë të jetës së gjallë në natyrë: metabolizmi, frymëmarrja, fotosinteza dhe proceset përcjellëse; Pjesa e katërt zbërthen njohuritë për pesë mbretëritë e qenieve të gjalla: Monerëve, Protistëve, Kërpuhave, Bimëve dhe Shtazëve- dallimet dhe ngjashmëritë; Pjesa e parë trajton natyrën e Kosovës: flora, fauna dhe zonat e mbrojtura të Kosovës; Pjesa e 6 trajton metodologjinë e njohjes dhe interpretimit të botës së gjallë.

Qëllimet e mësimit: Me këtë kurs, studentët arrijnë këto kompetenca, si: të fitojë njohuritë shkencore mbi natyrën dhe ligjshmëritë e funksionimit të jetës, nocionet kryesore, ndërveprimet e qenieve të gjalla në mjedisin ekologjik; të fitojë njohuritë mbi origjinën dhe evolucionin e jetës së gjallë: nga qeliza deri te organizmi dhe biosfera; të fitojë njohuritë bazë shkencore për proceset kryesore biokimike dhe fiziologjike që mbajnë jetën e gjallë në vazhdimësi; të identifikojë pesë mbretëritë e qenieve të gjalla, të njohë ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre; të fitojë njohuritë e përgjithshme mbi florën dhe faunën e Kosovës.

Rezultatet e të nxënimit të lëndës: Pas kompletimit të kursit, studenti do të jetë i aftë: të interpretojë njohuritë e përgjithshme mbi natyrën dhe biodiversitetin, të përcaktojë nivelet e organizimit të botës së gjallë, të interpretojë zhvillimin evolutiv dhe historik të qenieve të gjalla, të elaborojë funksionet bazë që karakterizojnë jetën e gjallë, të diferencojë ngjashmëritë dhe dallimet mes mbretërive të botës së gjallë, të interpretojë njohuritë për natyrën dhe vlerat e saj në Kosovë.

Format/ Metodatat e mësimdhënies: Mësimi i rregullt organizohet në ligjërata grupore, ndërsa pjesa praktike organizohet në grupe të vogla prej 15 studentësh.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike	Pjesa praktike
40%	60%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Dr.S.Rashiti, *Bashkëkohësimi i mendimeve socio-etike*, Prishtinë, 1994

Dr.Sadik Rashiti, *Kategoria e ndërgjegjes*, Prishtinë, 1997.

F. Klampfer, *Etiški pojmovnik za mlade*, Aristej, Šentilj 2003.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Leksion i avansuar, diskutime, punë në grupe, punë në çifte, punë individuale, metoda ndërvepruese të mësimdhënies

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim 5%

Angazhimet / detyrat 5%

Prezentimet nga hulumtimi 10%

Vlerësimi i parë 30%

Vlerësimi final 50%

Emërtimi i lëndës: *Edukimi dhe mediat*

Përmbajtja: Edukimi dhe mediat është proces përmes të cilit individët pajisen me arsimim për mediet, arrijnë ta kuptojnë medien në mënyrë kritike, në radhë të parë natyrën, teknikat dhe ndikimet e mesazheve të medieve dhe prodhimeve mediele. Kjo nënkupton mendimin kritik për tekstet mediatike [deshifrim, analizë dhe vlerësim të medias].

Në anën tjetër, në shkollat moderne ka një vetëdije në rritje për nevojën e të mësuarit në klasë për botën reale duke sjellë përmbajtje mediele.

Nga ky aspekt, përdorimi i medias në shkolla është përparësi. Po ashtu, bota virtuale [televizioni, kompjuteri, interneti etj. po dëshmojnë gjithnjë e më shumë edhe si një faktor që ndikon në izolimin e individit, duke i afruar atij një modus të jetës virtuale. Ky është një keqkuptim i cili duhet të diskutohet vijimisht në procesin e edukimit të nxënësve.

Përshkrimi i kursit: Në këtë kurs mësohen konceptet kyçe të masmedias dhe të kulturës popullore. temat kryesore që duhet të diskutohen janë:

Çka janë mediat? Kush rri prapa medieve? Mediet midis informimit dhe fitimit. Mediet dhe teknologjia. Parimet etike të medias? Audiencia e medieve. Mesazhi dhe ideologjia e

medieve. Teoria e Shkollës së Kolumbias dhe teoria e Shkollës së Frankfurtit. Efektet e medias në shoqëri dhe keq-funksionet e saj. Varshmëria nga mediet: vetizolimi i individit. Teori të tjera të medias [Agenda Setting, Increasing Knowledge Gap, Spiral of Silence etj.]. Media dhe argëtimi. Media dhe dhuna. Media dhe racizmi. Media dhe femra. Media dhe fëmijët. Media në situata të jashtëzakonshme. Mediet e shekullit XXI dhe individi-shoqëria: rrjetet sociale, Face Book, YouTube, Skype etj.

Rezultatet e pritura të nxënies: Edukimi medial nuk synon të japë përgjigje të sakta në pyetjet e shumta që mund të shtrohen ndaj medias dhe rolit të saj në shoqëri. Edukimi media synon të krijojë pyetje të drejta për medien. Roli i edukatorit në këtë rast është jo të krijojë prej studentit një enciklopedi dijes, për t'ia lehtësuar atij procesin e të menduarit kritik dhe dialogut për rolin e medias. Kështu, mësimmshënësi bëhet një bashkë-student. Studenti, në fund të kursit, është një individ që shtron pyetje të drejta për medien dhe mund të mendojë në mënyrë kritike për mesazhet që merr prej medieve dhe po ashtu, mund të dallojë dobinë dhe pasojat në marrëdhënien e njeriut bashkëkohor me medien.

Literatura:

Media Education / A Kit for Teachers, Students, Parents and Professionals, Editor Divina Frau-Meigs, UNESCO, Communication and Information Sector, 2006, Paris.

Maigret, Eric, *Sociologjia e komunikimit dhe e mediave*, Papirus, Tiranë, 2010.

Diminick, Joseph R., *Dinamika e komunikimit masiv/media në periudhën digjitale*, UET Press, Tiranë, 2010.

Balle, Francis, *Mediat & Shoqëritë*, përkthyer nga T. Nakuçi, S. Pasho, M. Marku, Papirus, Tiranë, 2011.

Bill Kovach & Tom Rosenstiel, *Elementët e gazetarisë*, ISHM, 2009

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Leksion i avansuar, diskutime, punë në grupe, punë në çifte, punë individuale, metoda ndërvepruese të mësimmshënies

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim 5%

Angazhimet / detyrat 5%

Prezentimet nga hulumtimi 10%

Vlerësimi i parë 30%

Vlerësimi final 50%

Emërtimi i lëndës: *Metodologji e mësimit të matematikës II*

Përmbajtja: Metodologjia e mësimit të matematikës II shqyrton zhvillimin e të menduarit gjeometrik dhe konceptet themelore gjeometrike, konceptet fillestare për matjet zhvillimi i koncepteve themelore për të dhënat dhe elementet statistikore, përdorimi i teknologjisë në matematikë, mësime përmes zgjidhjeve të problemeve dhe vlerësimi për përmirësimin e të nxënit.

Qëllimet e mësimit: Kursi Metodologjia e mësimit të matematikës II merr parasysh kursin e zhvilluar paraprakisht Edu 123, dhe qëllimi i tij është përgatitja e studentëve për mësime të matematikës dhe zhvillim të kompetencave të fushës së matematikës. Përgatitja dhe zhvillimi i aftësive të studentëve për të lidhur teorinë me praktikën është pjesë e punës praktike të studentëve gjatë zhvillimit të kursit.

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje: të zhvillojnë aktivitete sipas metodave bashkëkohore që kanë për bazë kompetencat themelore të fushës së matematikës; të integrojnë teorinë e të nxënit të matematikës në planet ditore dhe punën praktike; të integrojnë në orët e matematikës fushën e gjuhës, artit, muzikës dhe shkencës duke shfrytëzuar metodat ndërvepruese të mësimit; të harmonizojnë mësime me stilet e të nxënit të nxënësve dhe inteligjencat e shumëfishta gjatë aktiviteteve me figura gjeometrike, madhësi, matje, punën me të dhënat dhe gjatë zgjidhjes së problemeve nga jeta e përditshme; të planifikojnë aktivitete mësimore me bazë zgjidhjen e problemeve; të analizojnë metoda të ndryshme të vlerësimit që kanë për qëllim përpunimin e përbushjes së rezultateve të të nxënit.

Format/ Metodatat e mësimit:

Shpjegim, bashkëbisedim, prezantimi i punës në grupe, diskutim në grup, punë individuale

Literatura:

Van de Walle, J. (2007). *Elementary and middle school mathematics: Teaching developmentally*. (5th ed.). Boston, MA: Allyn and Bacon/Longman, Inc.

Liping Ma; *Knowing and teaching elementary mathematics*, LEA-London (1999)

.Musai, B (2005) *Mësimdhënia dhe të nxënësit ndërrpreues – Modele për zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve në matematikë 1- 5* Tiranë: CDE

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, projektori, kalkulatori etj.

Metodat e vlerësimit:

Leksion i avansuar, diskutime, punë në grupe, punë në çifte, punë individuale, metoda ndërrpreuese të mësimdhënies

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim 5%

Angazhimet / detyrat 5%

Prezantimet nga hulumtimi 10%

Vlerësimi i parë 30%

Vlerësimi final 50%

Emërtimi i lëndës: *Histori e letërsisë kombëtare*

Përmbajtja: Lënda përkufizon krijimtarinë letrare-artistike e krijuar në gjuhën shqipe nga autorët më eminentë. Kjo lëndë argumenton rëndësinë e madhe që ka prodhimi letrar artistik kombëtar. Kjo letërsi duke bërë ndikim estetik në marrësin (dëgjuesin dhe lexuesin fëmijë e të rritur) mundëson pasurimin shpirtëror të tij, njohjen e botës dhe vetvetes, e bënë dijen dhe edukimin më të qëndrueshëm.

Qëllimi i mësimi: Studentët të njihen me premisat, nocionet dhe konceptet e letërsisë kombëtare dhe me arsyet e ndarjes së mëvetësishme nga pjesa tjetër e letërsisë së përgjithshme. Të identifikojnë funksionet transmetuese që realizon kjo letërsi dhe rëndësinë e tyre që kanë në formimin e karakterit e të shijes estetike të grupmoshave të caktuara. Të përshkruajnë dhe vlerësojnë këtë proces të veçantë letrar-artistik dhe të përforcojnë njohurit

për proceset letrare artistike përgjithësisht, për tipologjinë, për stilet letrare, strukturat poetike, gjinitë, llojet e zhanret dhe të njihen me një sërë kërkesash të tjera letrare, pedagogjike, psikike e edukative që duhet t’i realizojë kjo krijimtari letrare për nxënës. Të thellojnë njohurit bazë për trashëgiminë historike, kulturore, letrare dhe edukative të letërsisë kombëtare, dhe të zbërthejnë vlerat e saj duke trajtuar krijimtarinë e autorëve më përfaqësues të kësaj letërsie që më vonë t’i procedojnë këto njohuri si edukatorë, mësimdhënës dhe si qytetarë akademikë.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Fitimi i njohurive dhe i shkathtësive bazë, duke shfrytëzuar njohuritë elementare të marra më parë për këtë proces dhe duke shfrytëzuar njohuritë e përfituara nga letërsia kombëtare në kursin paraprak, i cili për zhvillimin e tij duhet të plotësojë edhe një sërë kërkesash të tjera letrare, edukative, pedagogjike e psikike. Kjo lëndë përforcon kulturën e leximit, shkrimit, komunikimit, edukimit dhe arsimimit, fisnikërimin të shpirtit dhe, së fundi, u jep studentëve mundësinë e përjetimit dhe të interpretimit me kompetencë profesionale.

Metodat e mësimdhënies: Ligjërata, seminare, komentime, të teksteve letrare, diskutime, punë individuale, në çifte dhe në grupe.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
60 %	40 %

Literatura bazë:

Dr. sc. Faik Shkodra, *Letërsia për fëmijë nga fillimet deri sot*, Prishtinë, 2002.

Prof. as. dr. Astrit Bishqemi, *Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë*, “Sejko”, Elbasan, 2004.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, projektori etj.

Metodat e vlerësimit:

Leksion i avansuar, diskutime, punë në grupe, punë në çifte, punë individuale, metoda ndërvepruese të mësimdhënies

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim 5%

Angazhimet / detyrat 5%

Prezentimet nga hulumtimi 10%

Vlerësimi i parë 30%

Vlerësimi final 50%

Emërtimi i lëndës: Metodologji e edukimit fizik

Qëllimet: Përmes aplikimit të saj në procesin e mësimdhënies mundësohet organizimi, zhvillimi dhe rrjedha e mësimin në nivelin më të lartë profesional, duke iu përshtatur kushteve dhe kërkesave metodiko – didaktike.

Rezultatet e pritura të nxënjes: Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: Të planifikojnë dhe të përpunojnë materialin e lëndës; Të projektojnë modele të caktuara programore, varësisht nga qëllimi, kërkesat, moshën, gjinia etj.; Të iu mundësojë studentëve të njihen me të arriturat më bashkohore nga metodika e ed.fizik.; Të aftësohen për punë të pavarur praktike dhe teorike; Të iu mundësojë studentëve zotërimin me sukses / më me lehtësi / të përmbajtjeve programore të kurseve tjera .

Format/ Metodatat e mësimdhënies

Ligjërata teorike , diskutime , seminare , puna në grupe me metoda interaktive - përsëritja sipas nevojave individuale të përmbajtjeve programore .

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
35%	65%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë

B. Hasangjekaj: Metodika e ed.fizike ,U.P.,FKF,Prishtinë , 1998

J.Daci , V.Belliu : Metodika e edukimit fizik , Tiranë , 2000

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, etj.

Metodat e vlerësimit:

Leksion i avansuar, diskutime, punë në grupe, punë në çifte, punë individuale, metoda ndërvepruese të mësimdhënies

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim 5%

Angazhimet / detyrat 5%

Prezentimet nga hulumtimi 10%

Vlerësimi i parë 30%

Vlerësimi final 50%

Emërtimi i lëndës: *Metodologji e gjuhës shqipe*

Përmbajtja: Tekstet shkollore të gjuhës shqipe (përmbajtja, struktura); Kriteret shkencore dhe didaktike të hartimit të teksteve; Tekstet alternative dhe përzgjedhja e tyre; Integrimi si kriter bazë për ndërtimin e teksteve dhe të programit të gjuhës shqipe; Planifikimi vjetor i lëndës dhe përbërësit e planit ditor; Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë (vështrim historik). Kriteret e modernizimit shkencor e didaktikë të mësimit të gjuhës shqipe në shkollë. Problemet aktuale të mësimdhënies në mësimin e gjuhës shqipe në shkollë-koncepti i integritit. Gjuha dhe leximi, procese integruese. Integrimi në planin e synimeve dhe objektivave lëndore. Këndvështrime të reja shkencore dhe didaktike për mësimin e gjuhës shqipe. Standardi lëndor dhe standardet e përmbajtjes në lëndën e gjuhës shqipe etj.

Qëllimet e mësimit:*Metodologji e gjuhës shqipe* si lëndë në nivelin universitar synon të aftësojë profesionalisht studentët e profilit të mësimdhënësit për shkollën e mesme të ultë duke ngritur nivelin e përgatitjes profesionale në mësimdhënie. Didaktika e gjuhës shqipe synon t'u japë studentëve - mësimdhënës vizionin e mundësive metodologjike në kuadër të njohjes dhe përdorimit të parimeve, kriteve, metodave, teknikave, formave dhe strategjive që lidhen me mësimdhënien, të nxënit dhe vlerësimin e nxënësve etj.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Të njohin teorinë dhe përvojat e traditës si dhe mësimdhënien bashkëkohore të gjuhës; të krahasojnë teorinë e të mësuarit duke argumentuar përparësitë e njerës kundrejt tjetrës; të shprehin bindjet e tyre lidhur me teorinë më të përshtatshme për mësimdhënien dhe të nxënit në shkollën tonë; të dallojnë metoda, forma, strategji dhe teknika që nxisin një mësimdhënie dhe nxënie të suksesshme, ndërvepruese; të

krijojnë modele mësimdhënie, ku të përdorin metodat që nxisin mendimin kritik, të nxënit në bashkëveprim;

Format/ Metodatat e mësimdhënies: Mësim i rregullt me ndikim intenziv. Format e punës: frontale, grupore, individuale edhe ndonjë formë tjetër, si mësimi projekt etj.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:

Pjesa teorike: 80%	Pjesa praktike:20%
---------------------------	---------------------------

Literatura :

Mustafa, A., *Didaktika e gjuhës shqipe dhe e leximit letrar*, Shkup, 2004

Gjokutaj, M., Mërkuri, N., *Modele te suksesshme mësimdhënieje*, Tiranë, 2003

Gjokutaj, M., *Mësimdhënie dhe të nxënit ndërveprues*, Tiranë, 2008, 2009, 2013

Metodat e vlerësimit:

- **Vlerësimi i njohurive të studentëve bëhet gjatë gjithë semestrit dhe në testin paraprak dhe përfundimtar të provimit;**
- **Do të ketë test paraprak nga java 15 e njësisë akademike;**
- **Provimi mbahet me test dhe do të pyeten gojarisht;**
- **Studentët që arrijnë pikët maksimale në test do të lirohen nga provimi final;**
- **Studentët të cilët zihen me kopje gjatë testit, nuk kanë të drejtë të hyjnë në provim për tri afate.**

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesëmarrja në mësim: 15%

Angazhimi dhe marrja e plusave (+) gjatë semestrit: 30%

Provimi: 55%

Emërtimi i lëndës: *Etnologji me Letërsi popullore*

Qëllimet e kursit – lëndës: Kursi ka për qëllim t'i njohë studentët me njohuri të nevojshme nga letërsia popullore si formë e veçantë e krijimtarisë imagjinatave letrare.

Rezultatet e pritura të nxënies: Studentët do të jetë në gjendje që: Ta njohin mirë historinë folkloristike evropiane dhe shqiptare; t'i analizojnë strukturat artistike dhe vlerat e folklorit tonë letrar sipas gjinive dhe zhanreve; të ketë të njohuri bazë mbi trashëgiminë historike në fushë të artit letrar gojor, dhe të njohin mirë gjurmët e pasura të jetës shpirtërore të popullit tonë.

Format/ Metodatat e mësimdhënies

Ligjërata teorike, diskutime, seminare, puna në grupe me metoda interaktive - përsëritja sipas nevojave individuale të përmbajtjeve programore.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
60%	40%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë

Demush Shala, *Letërsia popullore*, Prishtinë, 1983

Gjergj Zhej, *Hyrje në folklor I*, Tiranë, 1994.

Shefqet Pllana, *Studime në fushë të folklorit*, Prishtinë, 2004

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, lapsat, projektori, etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrimeve, punë individuale, punë në grupe, etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 60% dhe pjesa teorike 40%

Emërtimi i lëndës: *Vlerësimi në arsim*

Përshkrimi i lëndës: Gjatë kursit do të shqyrtohen çështje të tilla si: Rëndësinë e vlerësimit në arsim, qasjet teorike rreth vlerësimit në arsim, njohja dhe zotërimi i aftësive për zbatimin e teknikave formale për vlerësim siç janë: dosja e punës së nxënësve, performanca e tyre, lista e kontrollit, regjistrimet e ndryshme të sjelljes përmes magnetofonit, kamerave, fotove,

vizatimet e femijeve, si dhe planifikimin e procedurës së vlerësimit. Peshë të veçantë në vlerësim ka dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura përmes këtyre teknikave.

Qëllimet e mësimi të lëndës: Qëllimi kursit është njohja e studentëve me përvojat që përfshijnë strategjitë të cilat çojnë në vlerësimin autentik, diagnostik, formativ, përmbledhës. Kursi do të përfshijnë, gjithashtu theksin mbi teknikat efektive të vlerësimit alternative.

Rezultatet e pritura të nxënies: Studentët do të: krijojnë rëndësinë e vlerësimit në arsim, qasjet teorike rreth vlerësimit në arsim, njohja dhe zotërimi i aftësive për zbatimin e teknikave formale për vlerësim siç janë: dosja e punës së nxënësve, performanca e tyre, lista e kontrollit, regjistrimet e ndryshme të sjelljes përmes magnetofonit, kamerave, fotove, vizatimet e femijeve, si dhe planifikimin e procedurës së vlerësimit. Peshë të veçantë në vlerësim ka dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura përmes këtyre teknikave; Të krijojë aftësi për shfrytëzim të të dhënave për planifikim të punës së individualizuar (zhvillimin e kompetencave sipas kurrikulës).

Metodologjie e mësimdhënies: Mësimi i rregullt do të realizohet *nepërmjet* punës individuale dhe në grupe si dhe formës frontale. Do të sugjerojmë edhe modele alternative në formë të punimeve të shkruara (ese). Kursi zhvillohet në mbështetje të mësimi interaktiv përmes zbatimit të teknikave të reja të mësimdhënies, duke ju dhënë vazhdimisht hapësirë për pyetje dhe diskutime. Studentët janë të obliguar t'i kryejnë detyrat e dhëna, të punojnë ese si dhe të prezantojnë në grup.

Literatura:

Assessment in Early Childhood Education (6th Edition) [Paperback]

Leipzig, J. Llesch, J. Rrutch, C (1997) *Studimi i fëmijëve përmes vëzhgimit dhe regjistrimit*

Early learning standards task force and Kindergarten assessment group Pensilvaniaja (2005)

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, laps, projektori, etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrimeve, punë individuale, punë në grupe, etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 60% dhe pjesa teorike 40%.

Emërtimi i lëndës: Psikologji e personalitetit

Përmbajtja: Kursi do të përfshijë trajtimin e çështjeve psikologjike të përfshira në fushën e edukimit si dhe aplikimin praktik të parimeve psikologjike të mësimdhënies. Theks i veçantë do të vihet tek të nxënësit, mësimdhënësia, motivimi, kreativiteti në klasë, dhe ndikimet që ka mjedisi tek sjellja e individit.

Qëllimet e mësimit: Në përgjithësi kursi tenton të qartësojë nocionet e zhvillimit të gjithmbarshëm të nxënësit, dhe ndërveprimet e nxënësve me individët tjerë në mjedisin ku ai jeton dhe sesi këto ndërveprime ndikojnë në zhvillimin e tij. Kursi synon në aftësimin e studentëve për të kuptuar më mirë zhvillimin e nxënësit në aspektin fizik, motorik, mendor, emocional dhe social, mënyrat e tij të reagimit, si i shfaq emocionet, si zhvillohen ato, si socializohet nxënësi, sa është e rëndësishme njohja e emocioneve dhe aspekteve sociale të zhvillimit të nxënësit, si mëson ato, si zhvillohet intelektualisht dhe si të kujdesemi për nxënësin që mos të krijojme vështirësi emocionale dhe sociale në zhvillimin e tyre. etj.

Rezultatet e të nxënit të lëndës: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde), studenti do të jetë në gjendje që: Të njohë zhvillimin e nxënësit përgjatë staveve; të njohë teorinë dhe hulumtimet themelore psikologjike mbi zhvillimin e fëmijëve; të njohë teknikat e punës me nxënës që kanë vështirësi intelektuale, në të nxënë, motorike, mendore, emocionale dhe sociale; të dijë të identifikojë dhe shpjegojë përjetimet emocionale dhe sociale; të njohë fazat e zhvillimit tek fëmijët; të njohë efektet dhe pasojat e çrregullimeve të hershme të zhvillimit në moshë të rritur.

Format/ Metodatat e mësimdhënies: Mësim i rregullt përmes ligjeratave, diskutimit dhe punës në grupe, konsultimeve individuale, si dhe përvojës praktike dhe seminarike.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
70%	30%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë(listoni literaturën deri në tre tituj.)

“Psikologjia e Edukimit” Bardhyl Musai

“Psikologjia (Një hyrje koncize)”- Pettijohn. F. Terry

”Psikologjia e Përgjithshme”- Prof. Dr. Pajazit Nushi

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, laps, projektori, etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrimeve, punë individuale, punë në grupe, etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Emërtimi i lëndës: *Menaxhimi i klasës dhe disciplina*

Përshkrimi i lëndës: Ky kurs është i dizajnuar për të mbështetur mësuesit në zhvillimin e një qasje praktike, efektive të menaxhimit në klasë. Fillimisht studentet do të kuptojnë për rëndësinë e Menaxhimit në klasë, Shpjegohet konteksti historik i disiplinës dhe menaxhimit në klasë si dhe teoritë kryesore mbi sjelljen njerëzore. Menaxhimi në klasë përmes organizimit të punës të mbështetura në rregullat dhe procedurat e caktuara në klasë janë më se të nevojshme për të përmbushur qëllimet edukative arsimore. Menaxhimi efektiv në klasë mund të përdoret për krijuar klimë socio-emocionale pozitive në klasë, çka nënkupton njehërit dhe për të minimizuar sjelljen përçarëse. Për të arritur këtë realizohet mësimi kooperues, respektimi i stileve të nxënies, organizimi në bazë të afiniteteve të fëmijëve, vlerësimi i drejtë dhe transparent, si dhe shumë strategji të komunikimit, të cilat ndihmojnë në menaxhimin në klasë. Strategjitë për planifikimin dhe menaxhimin e kohës mësimore në klasë: menaxhimin e kohës dhe problemet tipike me tranzicione, janë ndërkohë dhe çështje tjera me rëndësi për menaxhim të efektshëm në klasë.

Rezultatet e pritura të nxënies: Studentët do të: Kuptojnë rëndësinë e menaxhimit të mirë në klasë; Njohin procedurat për menaxhimin e klasës; Analizojnë procesin e zhvillimit të raporteve korrekte e të fuqishme me nxenes; Mësojnë të kene pritje të sakta dhe për të ruajtur vetëkontrollin kur kanë të bëjnë me ndërhyrje dhe ndërprerje nga studentë “me probleme”; Përdorin strategjitë për të vetë-drejtuar të mësuarit dhe për të ndaluar e eliminuar sjellje dhe probleme të përsëritura në mes të fëmijëve, apo në mes të fëmijëve me mesues.

Metodologjia e mësimdhënies: Mësimi i rregullt do të realizohet nëpërmjet punës individuale dhe në grupe si dhe formës frontale. Do të sugjerojmë edhe modele alternative në formë të punimeve të shkruara (ese). Kursi zhvillohet në mbështetje të mësimit interaktiv përmes zbatimit të teknikave të reja të mësimdhënies, duke iu dhënë vazhdimisht hapësirë për pyetje dhe diskutime. Studentët janë të obliguar t'i kryejnë detyrat e dhëna, të punojnë ese si dhe të prezantojnë në grup

Literatura:

Marzano, R. and Pickering, D. (2007) *Classroom Management that Works*. Chapters 1 and 5

Canter, L. (2011). *Assertive discipline: Positive behavior management for today's classroom*.

Bloomington, IN: Solution Tree Press. Chapters 2, 10, 11, 12, 13

Cangelosi, J. S. (1997). *Classroom management strategies*. White Plains, NY: Longman

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, laps, projektori, etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrimeve, punë individuale, punë në grupe, etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Emërtimi i lëndës: *Fëmijët dhe mësimi në natyrë*

Përmbajtja:Kursi është i ndarë në disa pjesë: 1. Pjesa e koncepteve të përgjithshme të natyrës dhe raporti i njeriut me natyrën, 2. Aktivitetet edukative e rekreative: fëmijët dhe trashëgimia natyrore; parqet nacionale dhe zonat e mbrojtura, vlerat edukative, ruajtjes së ekosistemeve dhe rekreacioni.3. Rolin e ecjes, ngjitjes, alpinizmit, turizmit dhe aktiviteteve tjera përcjellëse në natyrë; 4. Zonat e trashëgimisë natyrore dhe ekskursionet në Kosovë: zonat kryesore të vizituara, vlerat dhe statusi i tyre, pse dhe si mbrohen ato. 5. Edukimi në natyrë: vizita në kopshtet botanike/lulishte e zoologjike, muze natyrore etj.

Qëllimet e mësimit: Me kursin studenti do: të fitojë njohuritë bashkëkohore mbi natyrën dhe ndërlihdjen e njeriut me natyrën, evolucionin e natyrës dhe pozitën e njeriut në natyrë, vlerat që merr njeriu nga natyra dhe si ndikon ai në të; të fitojë njohuritë bazë bashkëkohore

komponentet përbërse të natyrës: bimët, shtazët, mikroorganizmat, ekosistemet dhe biomet kryesore; të fitojë njohuritë bazë si vlerat e trashëgimisë natyrore botërore dhe të vendit tonë, zonat më atraktive të Kosovës për vizita/eksursione; dhe të kultivojë dhe përcjell dobitë e ecjes në natyrë, alpinizmit, turizmit natyror, aktiviteteve për ruajtjen e natyrës si kampanjat e pastrimit, gjelbërimit etj.

Rezultatet e të nxënit të lëndës (kompetencat, njohuritë dhe shkathtësitë): Pas kompletimit të kursit, studenti do fitojë kompetencat që të definojë konceptet kryesore të natyrës dhe edukimit në natyrë, të interpretojë vlerat natyrore dhe të trashëgimisë natyrore; të njohë dhe të interpretojë konceptet e kopshteve natyrore botanike dhe zoologjike dhe botanike, të zhvillojë njohuritë dhe dëshirën për aktivitetet në natyrë, të dallojë dhe kategorizojë zonat e mbrojtura dhe vlerat e tyre, të zhvillojë dhe transmetojë tek të tjerët dëshirën e aktiviteteve në natyrë.

Format/ Metodat e mësimdhënies: Mësimi i rregullt organizohet në ligjërata grupore, ndërsa pjesa praktike organizohet në grupe të me vizita në natyrë.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit

Pjesa teorike	Pjesa praktike
50%	50%

Literatura bazë që shfrytëzohet në lëndë:

Veselaj. Z, 2009, *Njeriu dhe mjedisi jetësor*, Dispencë, UP & WUS Austria.

Group of authors 2010, *Green Pack for Kosovo*, Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe.

Ramadani I. , 2011, *Mjedisi jetësor, sfidat dhe perspektivat - roli i njeriut*.

Mjetet e konkretizimit:

Libri, fletorja, laps, projektori, etj.

Metodat e vlerësimit:

Do të vlerësohen gjatë ligjëratave, ushtrimeve, punë individuale, punë në grupe, etj.

Kriteret e kalueshmërisë:

Pjesa praktike nga ushtrimet dhe puna e pavarur.

Pjesa praktike 60% dhe pjesa teorike 40%.

Emërtimi i lëndës: *Bazat e hulumtimit në edukim*

Përmbajtja:Do të shqyrtohen çështje të tilla si: qasjet teorike të metodologjisë së hulumtimit në çështjet e arsimit në përgjithësi, zotërimi i aftësive për zbatimin e metodave hulumtuese dhe të nxëniet për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë, për përgatitjen e punimeve të ndryshme e sidomos të punimit të diplomës, diskutimet e të nxëniet në bashkëpunim të tjerët, komunikimi dhe prezentimi i rezultateve të hulumtimit.

Qëllimet e mësimet:Qëllimi i kursit është njohja e studentëve me metodat dhe strategjitë bashkëkohore të hulumtimit në fushën e arsimit në përgjithësi dhe të arsimit parashkollor në veçanti. Me anë të këtij kursi synohet të ndryshohet praktikën e tanishme mësimore si dhe të rrisin cilësinë dhe efikasitetin e studentëve në hulumtimet e fushës arsimore dhe të prezentimit të rezultateve të hulumtimit. Ky kurs do të nxisë studentët që të demonstrojnë shkathhtësi dhe të reflektojnë aftësitë e tyre në përgatitjen e punimit të diplomës.

Rezultatet e të nxëniet të lëndës: Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të shpjegojnë nocionet themelore të hulumtimit në arsimin parashkollor; analizojnë aspekte të teorive dhe stileve të ndryshme të hulumtimeve arsimore dhe strategjive bashkëkohore të mësimdhënies; identifikojnë aspektet e planifikimit të suksesshëm të një hulumtimi në arsim; të krahasojnë modele të sukseshme të hulumtimeve; të zbatojnë aftësitë e tyre në përgatitjen e punimit të tyre të diplomës.

Format/ Metodatat e mësimdhënies: Kursi zhvillohet në mbështetje të mësimet interaktiv përmes zbatimit të teknikave të reja të mësimdhënies në shkolla, pyetjeve dhe diskutimeve. Studentët i kryejnë detyrat e dhëna dhe bëjnë përgatitjet për prezentimin e rezultateve të tyre, punojnë ese, si dhe të prezentojnë në grup.

